



UNIVERSITETI I SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE
INSTITUTI I STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
SHKODËR

DOKTORATURË
PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR”

Gegërishtja në veprat e Arshi Pipës ,
Sami Repishtit dhe Filip Ndocajt
në rrafshin leksikor, fonetik, fjalëformues dhe morfologjik

Kandidati: MA. Aimir Osmani
Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Mimoza Prik

Mbrohet më dt. _____ përpara jurisë të përbërë nga:

- 1.....kryetar**
- 2.....anëtar**
- 3.....anëtar**
- 4.....anëtar**
- 5.....anëtar**

Shkodër, 2018

PËRMBAJTJA

Objekti dhe qëllimi i studimit.....	f.4
Metodologjia.....	f.5
Parathënia.....	f.6
Shkurtesa.....	f.8

Hyrje: Të dhëna për jetën, personalitetin dhe krijimtarinë letrare të autorëve:
Arshi Pipa , Sami Repishti , Filip Ndocaj f.9

Kreu i parë f. 16

Gjuha e përdorur në veprimtarinë krijuese të tre autorëve: A.Pipa, S. Repishti dhe F.Ndocaj

Disa veçori të gjuhës së veprës së autorëve:..... f. 16

1. Arshi Pipa.....	f. 16
2. Për gjuhën e njësuar shqipe.....	f. 17
3. Sami Repishti.....	f. 19
4. Filip Ndocaj	f. 20
5. Përmbyllje e kreut të pare.....	f. 21

Kreu i dytë..... f. 23

Rreth leksikut të veprave të tre autorëve: A.Pipa, S. Repishti dhe F.Ndocaj

1.a Fjalë, dialektizma-gegizma që i ndeshim në veprën e A. Pipës, S.Repistit dhe F.Ndocajt, disa prej të cilave edhe në Fjalorin gjuhës shqipe të vitit 2006...	f. 24
1.b. Leksema, dialektizma-gegizma që i ndeshim në veprën e A. Pipës, S. Repistit dhe F. Ndocajt, por jo në Fjalorin gjuhës shqipe të vitit 2006.....	f. 32
1.c. Disa krijime të A.Pipës, S. Repistit dhe F.Ndocajt, (Neologizma) ose krijime Popullore.....	f. 40
1.ç. Fjalë të huaja në leksikun e veprës së A.Pipës, S. Repistit dhe F.Ndocajt....	f. 43
2. Përmbyllje e kreut të dytë.....	f. 47

Kreu i tretë..... f. 50

Veçori fonetike të veprës së tre autorëve: A.Pipa, S. Repishti dhe F.Ndocaj

1.Theksi dhe togjet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve.....	f. 51
2. Zanorja ë dhe përdorimet e saj.....	f. 56
3. Veçori të tjera fonetike.....	f. 57
4. Përmbyllje e kreut të tretë.....	f. 60

Kreu i katërt f. 62

Veçori fjalëformuese në veprat e tre autorëve: A.Pipa, S. Repishti dhe F.Ndocaj

1. Parashtesimi..... f. 62
2. Prapashtesimi e mënyrat e tjera f. 63
3. Formimi me nyjëzim..... f. 63
4. Kompozimi..... f. 63
5. Përngjitja..... f. 64
6. Përmbyllje e kreut të katërt..... f. 70

Kreu i pestë.....f.72

Tipare morfologjike në veprat e tre autorëve: A.Pipa, S. Repishti dhe F.Ndocaj

1. Emri: gjinia, dygjinitia..... f.73
2. Shumësi i emrave dhe kategoria gramatikore e rasës..... f. 77
3. Mbiemri , shkallët e mbiemrit..... f. 99
4. Përemrat, llojet, veçoritë..... f.102
5. Folja: mënyra dëftore dhe habitore..... f.114
6. Mënyra lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore..... f.129
7. Rreth formave të pashtjelluara të foljes..... f.139
8. Foljet ndihmëse, gjysmë ndihmëse dhe modale..... f.151
9. Përmbyllje e kreut të pestë..... f.152

Kreu i gjashtë..... f.154

*Rreth pjesëve të pandryshueshme të ligjeratës në veprat e tre autorëve: A.Pipa,
S. Repishti dhe F.Ndocaj*

- 1.Ndajfoljet, veçoritë..... f.154
- 2.Parafjalët, përdorimet..... f.155
- 3.Lidhëzat, llojet, veçoritë e tyre..... f.163
- 4.Përmbyllje e kreut të gjashtë..... f.169

PËRFUNDIME..... f.170

BIBLIOGRAFI..... f.175

ABSTRAKT f.179

Objekti dhe qëllimi i studimit

Objekti i këtij studimi është që të vështrohen nga ana gjuhësore veprat e autorëve Arshi Pipa, Sami Repishti dhe Filip Ndocaj në rrafshin leksikor, fonetik, fjalëformues dhe morfologjik, duke parë edhe zhvillimet që po merrte gjuha shqipe para dhe pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe të vitit 1972. Do të përqendrohem në veprat e botuara për të analizuar se si paraqitet gegërishtja në këtë periudhë, veçoritë e saj, sa afër dhe sa larg qëndrojnë në mes tyre, ku vihet re prirja për të qenë sa më afër shqipes së njësuar. Të gjitha veçoritë gjuhësore janë nxjerrë nga veprat e botuara të tre autorëve gegë, të cilat janë shoqëruar me komentet përkatëse, mbështetur edhe në literaturë. Siç do ta përsërisim, nuk bëhet fjalë për një gegërishte arkaike që e ndeshim në disa autorë të Veriut të gjysmës së dytë të shekullit XIX, përkundrazi do të konstatojmë se edhe gegërishtja, si mbarë gjuha e sotme shqipe ka evoluar, duke u bërë më transparente. Në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar paraqitet më e përpunuar, me veçori më të pakta dalluese me gjuhën e sotme letrare.

Në këtë fushë disa autorë gegë përdorin një gjuhë sa më të zgjedhur, sa më afër gjuhës standarde, gjithnjë duke shkruar gegërisht, ku në mes të tjerëve, për mendimin tonë, spikat shkrimtari Martin Camaj. Por edhe A. Pipa në ndërhyrjet që bën në shkrime të botuara në vitet e fundit ë jetës së tij, vihet re se ai nuk përjashton zhvillimet e reja gjuhësore. Po kështu vepra e fundit e Sami Repishtit dallohet nga krijimet e tij të mëparshme, pasi gjuha e tij është më e zgjedhur, me më pak trajta gjuhësore dialektore, duke pëlqyer në mjaft raste trajtat gramatikore të shqipes së sotme. Ndërsa Filip Ndocaj në veprat që i shkruan pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe përdor standardin e sotëm. Duhet vlerësuar fakti që gegërishtja e përdorur u është larguar trajtave të ngushta dialektore dhe paraqitet mjaft e kodifikur që u shërbën më mirë shqipfolësve.

Metodologjia

Për hartimin e doktoratës, për të ndjekur zhvillimet e gegërishtes në veprat e tre autorëve gegë: Arshi Pipa, Sami Repishti e Filip Ndocaj, për të ballafaquar veçoritë e tyre gjuhësore, fillimisht kemi zbatuar metodën përshkruese-analizuese, që përmes analizës së dukurive gjuhësore të arrijmë në përfundime se si është përdorur gegërishtja në veprat e tyre, trajtat e përbashkëta si dhe risitë e tyre. E gjithë kjo analizë është parë në rrafshin leksikor, fonetik, fjalëformuese dhe morfologjik. Ka qenë një punë e vështirë për të dalluar se ç'është e gegërishtes dhe e gjuhës së sotme shqipe. Duke qenë se këta autorë veprat e tyre i kanë shkruar në gjysmës së dytë të shekullit XX, vërejmë se ata përdorin një gegërishte mjaft të standardizuar, e cila po shëshon hendekun me shqipen e sotme. Gjithashtu kemi zbatuar edhe metodën krahasuese dhe statistikore, pasi vetë tema e doktoraturës e ka kërkuar një metodë të tillë.

Pa krahasime në mes autorëve nuk mund të arrihej në përgjithësime dhe përfundime, gjë që do të vërehet gjatë gjithë trajtimit të kësaj teme. Por edhe kjo nuk ka qenë e mjaftueshme, pasi gjatë analizës së veçorive leksikore janë listuar gegizmat e përdorura nga autorët e sipërpërmendur, që janë vështruar edhe në përqasje me fjalorët krahinorë të shoqërisë “Bashkimi”, të Nikollë Gazullit, të Benedikt Demës, por edhe më fjalorët e gjuhës shqipe të vitit 1954, të vitit 2006 dhe Fjalorin e gjuhës shqipe të Mehmet Elezit të vitit 2007 etj. Prandaj ka qenë e domosdoshme për tema të caktuara përdorimi i metodës statistikore. Kështu edhe në analizën që i është bërë formave të pashtjelluara, e kemi parë të domosdoshme që të japim me shifra përdorimin e tyre në veprat e tre autorëve. Duke u mbështetur në këto metoda, në raste të veçanta edhe duke i gërshetuar, kemi hartuar doktoraturën gjithnjë për të vërtetuar ato çështje të përfshira në temën tonë, ku ideja jonë ka qenë që lexuesi ynë të njihet edhe me zhvillimet e gegërishtes edhe pas Kongresit të Drejtshkrimit, kur dihet se ajo pothuajse ka mbetur e izoluar, e ruajtur kryesisht në ligjërimin e folur të shqipfolësve gegë, në ndonjë botim të rrallë dhe në diasporë.

PARATHËNIE

Tema e doktoratës “Gegërishtja në veprat e Arshi Pipës, Sami Repishtit dhe Filip Ndocajt në rrafshin leksikor, fjalëformues dhe morfologjik” do të evidentojë se si paraqitet gegërishtja në gjysmën e dytë të shekullit XX te tre autorë që në llojin e shkrimeve nuk i përkasin të së njëjtit zhanër. Studiuesit tanë kanë theksuar se që në gjysmën e parë të shekullit XX shihet prirja edhe për t’i afruar në shkrim sa më tepër të dy dialektet e gjuhës sonë dhe se mbi bazën e veçorive të niveleve të ndryshme gjuhësore (fonetike, morfologjike, sintaksore, leksikore dhe fjalëformuese) veç tipareve të veçanta dalluese, vihet re se po tejkaloheshin edhe disa trajta e variante të ngushta dialektore.¹

1. Arshi Pipa krijimtarinë në gjuhën shqipe e ka kryesisht në dy botime me poezi në gjuhë të huaj, por të përkthyer në shqip nga vetë autori: “*Libri i burgut*” (Tiranë, 1994) dhe “*Rusha*” (1995). Ai ka botuar edhe ndonjë vepër apo studim në shqip para burgosjes së tij, siç do ta vërejmë kur trajtojmë jetëshkrimin e Arshi Pipës. Me interes është edhe një studim në shqip për veprën e Bogdanit e botuar në organin “*Albanica*”, 1990, nr.1 që botohej në SHBA. Botimet e tjera nuk janë shkruar në shqip. Kemi shfrytëzuar edhe ato shënime që autori i ka vendosur në botimin e tyre në Tiranë. Vështirësia nga ana jonë ka qenë në vjeljen e materialit se botimet janë përmbledhje poezish, prandaj është dashur të tregohet kujdes i veçantë për të evidentuar ato veçori që i përkasin gjuhës së autorit.

2. Sami Repishti i botoi dy vepra pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe “*Pika loti*” (Shkodër, 1997) dhe “*Nën hijën e Rozafës*” (Tiranë, 2004), ku vërehet se në veprën e dytë ka një evoluim në gjuhë, duke na dhënë një gegërishte me prirje afruese. Direkt apo indirekt trysnia e gjuhës mbarëkombëtare që zbatohet në Shqipëri, ka ndikuar sadopak, si tek autori i parë, ashtu edhe tek i dyti, ndonëse veprat e tyre janë shkruar në gegërisht, me një gjuhë të zgjedhur, të lexueshme dhe të pranueshme nga shqipfolësi.

3. Filip Ndocaj, në dallim nga dy të parët, gjithë krijimtarinë letrare e ka të botuar në Shqipëri. Në veprat para vitit 1972, me botimin e projekt drejtshkrimit të vitit 1967 vihet re në shkrimet e autorit ndikimi i këtij projekti, siç do ta shohim në vazhdim. Pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) F.Ndocaj shkruan në standard.

Të tre autorët nuk përdorin një gegërishte me trajta dhe forma gramatikore të theksuara dialektore, pasi vetë zhvillimi i gjuhës shqipe, lëvrimi dhe evoluimi i saj pas Luftës së Dytë Botërore besoj se ka ndikuar thekshëm tek këta autorë. Kështu mund të themi se kemi një gegërishte të standardizuar, me pak trajta të ngushta dialektore dhe me një përdorim të trajtave dhe të formave gramatikore të mbarë shqipes. Prandaj struktura e doktoratës fillimisht trajton jetën dhe veprimtarinë botuese të tre autorëve, meqë vetë rrethanat e kohës bënë që A.Pipa dhe S.Repishi të jetonin më shumë jashtë Shqipërisë, kështu që veprimtaria e tyre për disa është e njohur, për të tjerë pak ose aspak e njohur.

Doktoraturën e kemi konceptuar në 6 krerë.

Në hyrje kemi paraqitur të dhëna për jetëshkrimin e tre autorëve, si dhe krijimtarinë e tyre botuese.

Kreun e parë e kemi titulluar “Gjuha e përdorur në veprimtarinë krijuese të tre autorëve”, duke i trajtuar secilin më vete. Për A.Pipën kemi shtuar edhe një syth “Për gjuhën e njësuar shqipe.”

1. A.Haxhi-T.Topalli, *Histori e gjuhës së shkruar shqipe*, Shkodër, 2007, f.240

Kreu i dytë i doktoratës "Rreth leksikut të veprave të tre autorëve" i kushtohet asaj pjese të leksikut të veprës që janë veçori e gegërishtes.

Gjatë gjithë punës sonë jemi mbështetur në interpretimin dhe veçoritë gjuhësore të këtij leksiku dhe jo në leksikun e gjithë veprës, pasi do të ishte një objekt tjetër. Kemi shënuar radhazi leksikun e veçantë të tre autorëve, gjithnjë duke e krahasuar me Fjalorin e vitit 2006, pasqyrimi i tyre, por edhe krahasimi me fjalorët dialektorë, si të *Bashkimit*, N. Gazullit, B. Demës, Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954, Fjalorin e M.Elezit, (Tiranë, 2007), botimin e J.Thomait "*Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*", (Tiranë, 2001).

Pas analizës së leksikut janë nxjerrë individualitetet e tre autorëve në fushën e leksikut.

Kreu i tretë u është kushtuar veçorive fonetike të konstatuara në veprën e tre autorëve, si theksi dhe përdorimi i tij, krahasimi me standardin e sotëm, togjet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve që sot në standard përbëjnë një normë, por që pasqyron një qëndrueshmëri edhe në gegërishten. Një trajtesë i është kushtuar përdorimit të zanorës *ë* në pozicione të ndryshme, disa në pajtim me normën e sotme, por edhe me luhatjet që vihen re në vepër. Është analizuar edhe grupi *vo* dhe alternimi *f/h*.

Së fundi janë nxjerrë elementet e përbashkëta dhe dalluese në mes tre autorëve, duke vënë në dukje se kemi një thjeshtësim të dukurive fonetike me karakter dialektor. *Kreu i katërt "Veçori fjalëformuese në veprat e tre autorëve"*, mbështetur vetëm në leksikun që i përket fjalëve dialektore. Janë analizuar veçoritë fjalëformuese të tyre.

Ky kapitull nuk ka një trajtim të gjerë, pasi nuk trajtohet formimi fjalëve për të gjitha veprat e tre autorëve, por i leksikut të gegërishtës të pasqyruara në kreun e dytë të doktoratës. Kjo nuk do të thotë se autorët e sipërpërmendur nuk kanë përdorur edhe mjete të tjera fjalëformuese, por ato i përkasin mbarë shqipes dhe jo vetëm leksikut të gegërishtes të veçuara në veprat tre autorëve tanë. Është analizuar parashtesimi, prapashtesimi, kompozimi, përngjitja dhe mënyrat e përziera si mënyra për pasurimin e leksikut ë gjuhës sonë. Të tre autorët kanë individualitet e tyre, prandaj janë bërë krahasime dhe përgjithësime. *Kreu i pestë "Veçori morfologjike në veprat e tre autorëve"*. Pjesa më e madhe e doktoratës përfshin veçoritë morfologjike, duke evidentuar ato probleme gjuhësore që i ndeshim jo vetëm si dukuri të gegërishtes, por edhe në pajtim me gjuhën e sotme. Ideja jonë nuk ka qenë të bëjmë një gramatikë të këtyre autorëve, por të analizojmë ato veçori që paraqesin interes për gegërishten dhe në ndojë rast edhe për gjuhën e sotme shqipe. Kemi vënë në dukje ato dukuri që pasqyrohen në veprat e tre autorëve, por që kanë pasur ndikim edhe në gjuhën standarde. Është vërejtur se jo gjithnjë autorët kanë qenë koherent, në përdorimin e së njëjtës trajtë, pasi kemi ndeshur edhe raste që kanë përdorur dy trajta njëkohësisht. Në doktoratë, siç e theksuam, nuk do të ndeshemi me të gjitha veçoritë dhe kategoritë gramatikore të pjesëve të ndryshme të ligjeratës, por me ato që kanë nevojë për t'u evidentuar, të cilat siç, do ta vërejmë, janë dukuri të mbarë gegërishtes. Këtu kemi vënë në dukje se ç'kanë të përbashkët të tre autorët, çfarë dukurish të përdorura në veprat e tyre përbëjnë risi.

Kreu i gjashtë "Pjesët e pandryshueshme të ligjeratës." Janë trajtuar ndajfoljet, parafjalët, përdorimi i tyre, ndonëse pjesa më e madhe e tyre janë të mbarë shqipes.

Në mbyllje janë shënuar përfundimet dhe bibliografia e përdorur.

Shkurtesat:

B.R.3= Revista “Bota e RE”, Tiranë, 1945, nr.3 dhe nr.5.

B.R.5= Revista “Bota e RE”, Tiranë, 1945, nr.5.

D= Filip Ndocaj , Dielli nën kreshtë,

F.2=Revista “Fryma”, Tiranë, 1944, nr.2, nr.7-8

K.1.Revista “Kritika”, Tiranë, 1944, nr. 1.

K.2, Revista “Kritika”, Tiranë, 1944, nr. 2.

K.3, Revista “Kritika”, Tiranë, 1944, nr. 3.

K.4 Revista “Kritika”, Tiranë, 1944, nr. 4.

L=1.A. Pipa, *Lundërtarë*, Tiranë, 1944.

L.B.=A.Pipa, *Libri i burgut*, Tiranë, 1994.

L.F.=A. Pipa, *Lundërtarë dhe Libri i dashunís dhe i Fatit*, Tiranë, 2010.

P.= Revista “Albanica”, 1990, nr.1 (SHBA). Shkrimi i A.Pipës “ Bogdani dhe gjuha Shqipe” (f 106-124)

P.L.=Sami Repishti, *Pika loti*, Shkodër, 1997.

R.=A.Pipa, *Rusha*, Tiranë.1995.

Ro = Sami Repishti, *Nën hijen e Rozafës*, Tiranë, 2004,

SR. =Filip Ndocaj, *Në sytë e rinisë*, Tiranë, 1961,

V.=Filip Ndocaj, *Vlaga e dheut*, Tiranë, 1968.

H y r j e

**Të dhëna për jetën, personalitetin dhe krijimtarinë letrare të autorëve:
Arshi Pipa, Sami Repishti dhe Filip Ndocaj**

1 A R S H I P I P A

Poeti, përkthyesi, studiuesi Arshi Pipa lindi në Shkodër, më 28 korrik 1920 dhe vdiq në SHBA, më 20 korrik 1997, duke lënë si amanet që hirin e të ndjerit ta hidhnin në detin Adriatik, amanet që e kreu shoqata “Durrësi”, në nëntor të atij viti në plazhin e atij qyteti.¹

Arshiu ishte i biri i Mustafa Pipës (1871-1948) avokat, që e ushtroi profesionin për disa kohë në Shkodër, i vendosur në këtë qytet në vitin 1925, pas disa ecejakeve në Libohovë, Turqi dhe së fundi në Shqipëri. U martua me Hatixhen, një vajzë shkodrane, pas dy martesave të tjera. Lindi me të katër vajza dhe një djalë Arshiu, ndërsa Myzaferin e kishte vëlla nga babai. Arshiu ishte një fëmijë shumë simpatik, inteligjent, që këtë zgjuarsë e manifestoi gjatë gjithë jetës.

Shkollën fillore e kreu te Jezuitët në Shkodër. Më pas ndoqi gjimnazin e shtetit po në këtë qytet, të cilin e përfundoi me rezultate të larta. Në vazhdim do të ndjekë Universitetin e Firencës në Fakultetin e Letërsisë dhe të Filozofisë. Ndonëse në këtë fakultet mësimet zgjasnin katër vjet, ai e përfundoi për tri vjet dhe në vitin 1941 kthehet në atdhe, duke u përfshirë në armatën e arsimtarëve të vendit tonë. Kështu në vitin shkollor 1941-1942, kur Shqipëria ishte e pushtuar nga Italia fashiste, emërohet pedagog në gjimnazin e Tiranës. Arshiu ishte një antifashist i flaktë. Kjo situatë bëri që Arshiu ta transferojnë në Shkodër. Kështu viti shkollor 1942-1943 e gjeti si mësimdhënës në gjimnazin e Shkodrës, tashti pranë familjes. Qëndroi vetëm një vit në qytetin e lindjes, pasi familja e Mustafa Pipës transferohet në Tiranë. Ai emërohet si mësues në shkollën femërore “Donika Kastrioti”, ku do të japë letërsi dhe italisht. Do të qëndrojë në Tiranë deri në vitin 1945, vit që do të transferohet në gjimnazin e Durrësit (1945-1946).

Arshiu do të botojë në vitin 1944 vëllimin poetik “Lundërtarë” që për autorin është libri i parë i një vargu tri unazash që përfshin, sipas autorit “Hi dashunije” dhe “Libri i fatit.” “Lundërtarë” dhe “Libri i dashunisë dhe i fatit”(dorëshkrim) u përfshi në vëllimin e parë të veprës së Arshi Pipës, botuar, pas vdekjes, nga shtëpia botuese “Plejad”, Tiranë, 2010, 142 f.

Pas botimit të vëllimit poetik “Lundërtarë”, në mars të vitit 1944 nisi botimin e revistës së tij të përmuejshme “Kritika”. Qarkulluan vetëm katër numra deri në qershorin e atij viti.

Revista pati jehonë, pasi morën pjesë si bashkëpunëtorë shumë personalitete me emër të kulturës shqiptare, si: Selman Riza, Mitrush Koteli, Myzafer Xhaxhiu etj. Ndërsa më pas i vëllai Myzafer Pipa nxori revistën tjetër të përmuejshme “Fryma”, e cila edhe kjo pati një jetë të shkurtër duke qarkulluar vetëm pak numra gjatë vitit 1944.

Arshi Pipa nuk e pranoi regjimin e ri monist, duke dalë hapur si kundërshtar i tij.

¹Për jetën dhe veprën e A.Pipës, shih: U.Kalakulla, *Arshi Pipa, njeriu dhe vepra*, Tiranë, 1999

Për idetë e tij politike, u burgos në vitin 1946, ku u dënua me 10 vjet burg, ndërsa i vëllai. Myzaferit vdiq në burg. Pasi kreu dënimin e plotë, më 26 prill 1956 lirohet nga burgu.

Ai vazhdonte të ishte kundërshtar i shtetit komunist, prandaj kërkoi një jetë të lirë dhe menjëherë u arratis në Jugosllavi bashkë me të motrën. Pak muaj qëndroi në hetuesi në Mal të Zi dhe pastaj në Sarajevë ku kaloi këtu më shumë se një vit. Dy vjet më vonë e lejojnë të largohet nga Jugosllavia dhe të vendoset në Itali dhe prej andej emigroi në SHBA.

Fillimisht aktivizohet në mërgatën shqiptare. Ai botoi në këtë kohë disa shkrime në shtypin shqiptar të Amerikës, si në gazetën “*Dielli*” dhe “*Flamuri*”. Amerika nuk ia hapi dyert menjëherë, prandaj Arshiu u detyrua të punojë si kasier në një hotel-restorant të Nju-Jorkut. U deshën tri vjet që Arshiu të përfshihet në radhën e pedagogëve të atij shteti të madh, duke u emërua në një kolegji amerikan. Por, pa nisur mirë punën në këtë kolegji, miq e dashamirës të Arshiut e sponsorizuan që të botojë në Itali, në vitin 1959 veprën “*Libri i burgut*”. Më pas Arshiu do të aktivizohet si pedagog në disa universitete amerikane dhe së fundi në Universitetin e Minnesotës në Minapolis si pedagog i italishtes. Këtu në këtë universitet doli në pension me titullin “*Profesor emeritus*”. Tashmë lë këtë qytet dhe vendoset përfundimisht në Uashington.

Për dy vjet 1991-1992 zgjidhet kryetar i federates “*Vatra*” dhe drejtor i gazetës “*Dielli*” në SHBA.


Vizitën e parë në Shqipëri e bëri në vitin 1992 pas përmbyesjes së regjimit monist, ku qëndroi në Shkodër pranë shokëve dhe kolegëve të tij. Gjatë kësaj kohe bëri takime me intelektualë, zhvilloi biseda, organizoi konferenca, si në Shkodër, Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Lezhë. Vjen në Shqipëri edhe dy herë të tjera.

Vdiq në moshën 77-vjeçare.
Është përfshirë në FESH².

Veprimtaria letrare dhe studimore.

Arshi Pipa ka botuar shumë vepra, përkthime dhe studime në italisht dhe anglisht. Në shqip trashëgojmë këto vepra letrare:

1. *Lundërtarë*, Tiranë, 1944, ribotim, Tiranë, 2010 ;
2. *Libri i burgut*, italisht, Romë, 1959 , Tiranë, 1994, shqip;
3. *Rusha*, Mynih, 1968, Tiranë, 1995, shqip;



2. Arshi Pipa, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Vëll.III, Tiranë, 2009, f.2022-2023.

Themeloi dhe drejtoi revistën “Albanica”(1900-1992). ku botoi në gjuhën shqipe studimim: “Bogdani dhe gjuha shqipe” (1990, nr.1).

Ka bashkëpunuar në revistën “Telos”.

Përmbledhja e veprës letrare në shqip në katër vëllimeu realizua nga shtëpia botuese “Plejad”:

Vëllimi I: *Lundërtarë dhe Libri i dashunis dhe i fatit*, Tiranë, 2010, 142 f.

Vëllimi II: *Autobiographia*, 1998, Tiranë 2010, 101 f. anglisht. Në shqip poezinë “Veneriada”, f.96-98;

Vëllimi III: *Lyrika latine* (përkthyer në shqip dhe paraqitur nga Arshi Pipa). Është shkruar në Sarajevë në vitin 1958, Tiranë, 2010, 296 f.

Vëllimi IV : *Lyrika evropiane moderne* (përkthyer në shqip nga autori), Tiranë, 2010, 148 f.(Tekstet e poezive në origjinal në disa gjuhë dhe në shqip).

Pas vdekjes:

-*Albanian Stalinizm: Ideo-Poletikal Aspects* (Stalinizmi shqiptar, anatomia e një patologjie politike, anglisht, 1990, përktheu nga origjinali Çapajev Zera (Tiranë, 2007, 331 f.) Në faqen e brendshme: Stalinizmi shqiptar, aspekte ideo-politike.

-*The politics of Language in Socialist Albania*, New-York, 1989, përkthyer në shqip nga Primo Shllaku me titull “*Politika e gjuhës në Shqipëri socialiste*”, (Tiranë 2010). Kundërshton zgjidhjet e Konsultës së Prishtinës, 1968 dhe të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, 1972.

-*Subvension drejt konformizmit, fenomeni Kadare*, New-York, 1987, përktheu në shqip Bardhyl Shehu, (Tiranë, 1999).

Ka botuar një radhë studimesh, si: *Montale and Dante*, 1968 (Montalja dhe Dantja).

Contemporary Albanian Literature 1991 (Letërsia bashkëkohore shqiptare);

Në fushën e historiografisë letrare shqipe përmendet triologjia:1“*Albanian Folk Verse structura and genre*”, 1978 (Poezia folklorike Shqiptare. Struktura dhe gjinitë)

2. *Hironymus de Rada* (Jeronim de Rada) 3. *Albanian Literature: Social Perspectives* (Letërsia shqiptare. Përspektivat shoqërore).

Kjo triologji u përkthye në shqip dhe u botua në Tiranë, në tri vëllime me titull “Triologjia Albanica”, Princi, Tiranë, 2013.

2 SAMI REPISHTI

Kush është Sami Repishti?

Është një veprimtar për çështjen kombëtare shqiptare dhe për të drejtat e njeriut, një studiues, kryesisht për problemin e “*Shqipërisë Lindore*.”

Sami Repishti lindi në Shkodër, më 5 korrik të vitit 1925 ku edhe kreu gjimnazin klasik në këtë qytet.¹

1. Për jetën dhe veprimtarinë botuese, shih: *Disa shënime biografike mbi autorin, nga botuesi, në S.Repishi, Pika loti,*

Shkodër. 1997, f.153-162. ; - *Për lexuesin, në S.Repishi , Nën hijen Rozafës, narrativë e jetueme, Tiranë , 2004.*

Ai si mjaft gjimnazistë të tjerë, ndoqi studimet e larta në Universitetin e Firencës në Itali për histori moderne.

Gjatë pushtimit fashist (1939-1944) u aktivizua në lëvizjen e rezistencës dhe nuk u pajtua me regjimin komunist të vendosur në Shqipëri. Shumë shpejt doli hapur kundër tij, por njëkohësisht u cilësua si armik i regjimit të ri. Nuk vonoi shumë dhe në vitin 1946 arrestohet dhe dënohet me 15 vjet burg, pasi kishte qendruar edhe 14 muaj në hetuesi. Pasi kryen dhjetë vjet burg, në vitin 1956 lirohet, por gjithnjë i përndjekur dhe i përbuzur. Bën plane për t'u arratisur nga Shqipëria. Në vitin 1959 pas tri vjetëve që kishin kaluar nga lirimi i burgut, arriti që të arratiset në Jugosllavi, ku edhe këtu kaloi një kalvar vuajtjesh dhe përndjekjesh. Arrin pas shumë përpjekjesh të shkojë në SHBA në vitin 1962, sapo kishte mbushur 37 vjeç.

Gjatë kësaj kohe nuk qendroi duarkryq, por vazhdoi thellimin e studimeve në Nju-Jork të SHBA dhe në Paris. Në vitin 1977, në moshën 52-vjeçare doktorohet për gjuhë e letërsi franceze. Dha mësim për 25 vjet në gjimnazet amerikane dhe në Universitetin Adelphi si pedagog i jashtëm. Në moshën 66-vjeçare doli në pension. Jeton në SHBA, në Baldwin, me bashkëshorten Diana. Ka dy vajza dhe një djalë.

Sami Repishti, pas daljes në pension, iu kushtua luftës për të drejtat e njeriut, veprimtari që e ndjek edhe sot në SHBA në këtë moshë të thyer, duke qenë pjesëmarrës aktiv i bashkësisë shqiptaro-amerikane. Ka mbajtur lidhje të vazhdueshme me Departamentin e Shtetit dhe Shtëpinë e Bardhë në mbrojtje të problemeve shqiptare. Ka qenë drejtues (1996-1998) i Këshillit Kombëtar Amerikan, i cilësuar si grupi më aktiv për përkrahjen e çështjes shqiptare.

Sami Repishti është i dekoruar nga Qeveria Shqiptare pas përmbysjes së regjimit monist me Medaljen e artë *“Pishtari i Demokracisë”*, me urdhrin *“Naim Frashëri”* i kl.I, me medaljen e artë *“Lidhja Shqiptare e Prizrenit”* (Kosovë).

Këshilli bashkiak i Shkodrës, më vendim nr.59, datë 29.12.2015 vendosi dhënien e titullit vendor të nderit *“Qytetar nderi”* prof. Sami Repishtit me këtë motivacion: *“Për mbrojtjen dhe pasqyrimin e vlerave qytetare dhe demokratike të bashkëqytetarëve tanë të Shkodrës, si studiues, publicist dhe veprimtar i njohur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Me qendresën përballë diktaturës dhe*



mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve të Shkodrës, Shqipërisë, Kosovës e më gjerë, ai është bërë shembull frymëzues për bashkëkohësit e tij.”

Ndërsa Presidenti i Republikës z. Bujar Nishani gjatë qendrimit në SHBA në një ceremoni të zhvilluar në Manhatan, më 24 shtator 2016 ka dekoruar S.Repishtin me *“Kalorës i Urdhrit të Skendërbeut”* me këtë motivacion: *“Me mirënjohje për vuajtjet e sakrificat e parrëfyeshme, përpjekjet mbinjerëzore dhe qendresën stoike ndaj diktaturës*

komuniste. Në nderim të veprimtarisë së palodhur atdhetare për çështjen kombëtare, si dhe në respekt të rolit e të kontributit të çmuar dhënë për dekada me radhë si veprimtar i shquar i të drejtave të njeriut, farkëtues i lidhjeve të gjithanshme shqiptaro-amerikane, duke u shndërruar në një simbol të rrallë e të vyer të shqiptarimit.”

Është përfshirë në FESH.²

Veprimtaria botuese. Sami Repishti njihet si historian, që është një fushë e preferuar e tij, por, megjithatë ai nuk ka mbetur prapa në botimin e dy veprave me karakter biografik “*Pika loti*”, tregime burgu, Shkodër, 1997, 162 faqe dhe “*Nën hijën e Rozafës*” (një libër autobiografik), Tiranë, 2004, 341 f.

Ka botuar gjithashtu “*Dhjetë memorandume. Situata e vështirë e shqiptarëve në Jugosllavi*” (anglisht), 1988; Kosova, 2000, Përshtypje udhëtimi, 2001, si dhe me dhjetëra shkrime për çështjen shqiptare, veçanërisht për Kosovën. Vazhdon edhe sot të botojë në shtypin shkencor dhe periodik në Shqipëri dhe jashtë.

3 FILIP NDOCAJ

Shkrimtari Filip Ndocaj lindi në Gjakovë, më 2 tetor 1914 dhe vdiq në Tiranë në moshën 69-vjeçare, në shtatorin e vitit 1983, i paralizuar prej më shumë se 6 vjetësh.³

Të dy prindërit, e ëma Domenika dhe i jati Ëngjëlli që njihej me shkurtimin Nushi ishin prej Shkodre. Engjëlli qe mësues në Gjakovë, por shpejt u transferua në Shkup, kur Filipi ishte 5 vjeç. Mësimet e para i mori nga i ati. Në Shkup qëndroi rreth 5 vjet, pasi në vitin 1925 familja Ndocaj vendoset në Shkodër, një qytet me tradita kulturore dhe arsimore. Filipi këtu ndoqi gjimnazin klasik të vendlindjes së prindërve, të cilin e kreu në vitin 1933, por pa pasur mundësi të vazhdojë studimet e larta në ndonjë universitet të huaj. Kështu detyrohet të ndjekë rrugën e të jatit dhe të ushtrojë profesionin e mësuesit. Fillimisht shërbeu si mësues në Krumë të Hasit dhe më pas në Pukë, në fshatin Dardhë ku ka pasur kryemësues Migjenin, i cili e orientoi të merrej me poezi, pasi Filipi kishte prirje letrare. Që në atë kohë e adhuronte poetin e rinisë, Migjenin dhe lirikun Gaspër Pali.

Ndonëse vazhdonte detyrën e mësuesit, në vitin 1935 u regjistrua për të ndjekur studimet universitare në Fakultetin e Letërsisë dhe të Filozofisë në Universitetin e Firencës. Por në muajin mars të vitit 1937 e pa të nevojshme për të ndërprerë punën si mësues dhe për të vazhduar studimet e larta, të cilat i përfundoi në vitin 1939. Kthehet në Shqipëri dhe vendoset në Shkodër ku caktohet si mësues i letërsisë në gjimnazin e qytetit të Shkodrës. Aktivizohet në veprimtaritë kulturore të këtij institucioni, duke përgatitur dhe dhënë shfaqje të ndryshme teatrore me studentët e këtij gjimnazi, por duke aktivizuar edhe aktorë të tjerë. Vuri në skenë dramën e H. Ibsenit “*Armiku i Popullit*” dhe më vonë dramën e Fishtës “*Juda Makabeu*”, ndërsa më pas, së bashku me Qemal Dracinin dramën e M.Gorkit “*Bujtina e të Varfërve*”. Gjithashtu shkroi dhe vuri në skenë dramën “*Dje dhe sot*”, të interpretuar nga nxënësit e gjimnazit të Shkodrës.

Në vitin 1941 Filip Ndocaj do të emërohet si mësues letërsie në gjimnazin e Prishtinës.

2.S. Repishti. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Vëll.III, Tiranë, 2009, f.2231.

3.Për jetën dhe veprën, shih: Albert Z.Xholi, *Kur kujtojmë profesorin e rinisë Filip Ndocaj*, (internet, 2 tetor 2014); Po ai, *Filip Ndocaj mbeti profesori i rinisë*, (internet, 28.11.2008), Mitro Çela, *Profesori, shkrimtari Filip Ndocaj*, (internet, 28 .08.2017)

Pa përfunduar Lufta e Dytë Botërore kthehet në Shkodër. Pasi punon 2-3 vjet në gjimnazin e Shkodrës, në vitin 1948 transferohet në Berat, pasi regjimi i kohës vëren tek shkrimtari Filip Ndocaj prirjet për liberalizëm në letërsi.⁴

Në vitin 1951 Filip Ndocaj transferohet në Tiranë, ku shërbeu si mësues i letërsisë në disa shkolla të kryeqytetit.

Në vitin 1961 pranohet si anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë, duke qenë një ndër anëtarët e parë të kësaj organizate. Në vitin 1971 në moshë jo të thyer, pa dëshirën e tij, e nxjerrin në pension. Ndoshta kjo ndikoi që pas pak kohësh shëndeti i tij të përkeqësohej aq sa vitet e fundit u paralizua.

Vdiq në vitin 1983 në një shtëpi të vjetër pranë Shkollës së Kuqe në Tiranë, duke lënë edhe një arkiv personal.

Në vitin 1962 Filip Ndocajt i jepet urdhri "*Naim Frashëri*" i kl.III dhe me rastin e 50-vjetorit të lindjes mësuesit dhe nxënësit e gjimnazit "*Çajupi*" në Tiranë i kremtojnë këtë përvjetor jubileut.



Veprimtaria botuese:

Filip Ndocaj ka lënë trashëgim disa vepra letrare, studime, etj. Së bashku me studiuesin Nasho Jorgaqi mblodhën dhe redaktuan poezitë e poetit Gaspër Pali me titull "*Hyjt mbi greminë*", vjersha, Tiranë, 1959.

Në vitin 1960 ai mblodhi dhe redaktoi veprën e Hil Mosit, që e titulloi "*Zani i atdheut*". Kësaj përmbledhjeje i parapriu një parathënie e gjatë për jetën dhe veprën e Hil Mosit, shkruar nga Filip Ndocaj që u botua nga shtëpia botuese "*Naim Frashëri*".

Një vit më vonë, më 1961, po kjo shtëpi botuese botoi vëllimin e parë të tij me poezi dhe poema, "*Në sytë e Rinisë*" prej 96 faqesh. Vepra tjetër letrare titullohet "*Dashuri dhe urrejtje*" një përmbledhje me novela e botuar 3 vjet më vonë po nga shtëpia botuese "*Naim Frashëri*".

Në vitin 1968 botoi romanin e parë "*Vlaga e dheut*".

Autori shkroi edhe një metodë për të mësuar italishten që u përdor gjatë viteve 1970.

Në vitin 1971 qarkulloi edhe romani tjetër në dy vëllime "*Dielli nën kreshta*" që u kushtohet jetës së malësorëve pukjanë nga cikli "*Nikë-Bujqajt e apripes së keqe*."

Romani është ndarë në tri pjesë. Filip Ndocaj ruajti një dashuri dhe respekt për banorët pukjanë, pasi aty kaloi disa vite të rinisë së hershme.

4.Vladimir Misja, *Profesor Filip Ndocaj, njeriu i vlerave erudite në arsimin shqiptar*, (internet, 22.8.2013)

Ashtu i sëmurë, i shtrirë në një krevat, priste shokët dhe miqtë e tij. Pak ditë para vdekjes, siç dëshmon A. Zholi, në bisedat me shkrimtarin Agim Cerkaç, i thoshte: "*Më vjen keq, o Gim si nuk u shërova, të paktën vetëm për disa ditë që të shkoja edhe një herë në Pukë, të shihja atë vend e atë njerëz... më ka marrë malli*"

Dhe vepra e tij karakterizohet nga një galeri personazhesh: fshatarë, malësorë, druvarë, sharrexhinj, mësues, nxënës, etj. Në vitin 1978 shkrimtari ynë botoi tregimin "*Duke kërkuar lumturinë*".

Filip Ndocaj ka botuar edhe disa shkrime me karakter gjuhësor, si: "*Veçantia e gjuhës dhe Fjalori i Institutit të Shkencave (1954)*" botuar në BISH, Tiranë 1958, nr 2 dhe me 1961, nr.1, dhe nr.2; "*Kostandin Kristoforidhi, "Luftëtari"*", Tiranë, 4 mars, 1962; "*Problem që kërkon zgjidhje të shpejtë*", diskutim rreth artikullit "*Mbi disa antroponime dhe toponime tona*" të A.Varfit, "Mësuesi", Tiranë, 22 shkurt 1963.

Giuseppe Gradilone, *Studi di litteratura Albanese*, Roma, 1960, Etudes sur litteratura Albanese, 1968, II.

Mbi fondin e fjalëve dhe kuptimet e tyre në "Fjalorin e gjuhës shqipe", në "Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", II, Tiranë 1972, f.167-181.

Kreu i parë

Gjuha e përdorur në veprimtarinë krijuese të tre autorëve:

Disa veçori të gjuhës së veprës së A. Pipës, S.Repishit dhe F. Ndocajt

Arshi Pipa

1. Hyrje

E gjithë veprimtaria letrare dhe publicistike e Arshi Pipës është shkruar, kryesisht, në gegërisht. Na duket e arsyeshme që këtë veprimtari ta shohim në dy etapa kryesore: shkrimet e botuara para burgosjes së tij, më 1946 dhe etapa e dytë pas vitit 1956 kur del nga burgu dhe arratiset. Kështu do të shohim se sa ka evoluar gjuha e përdorur nga Pipa gjatë këtyre dy periudhave.

Siç e theksuam më sipër, vepra e parë e botuar e Arshi Pipës është “Lundërtarë” që i përket periudhës së rinisë (1936-1940) dhe botuar në vitin 1944, ku janë përmbledhur vjershat e rinisë (1936-1940), Tiranë, 1944, ndërsa Shtëpia botuese “Plejad” botoi në katër vëllime krijimtarinë e Arshi Pipës. Vëllimi i parë i ribotuar në vitin 2010 nga kjo shtëpi botuese përfshin jo vetëm “Lundërtarë”, por edhe “Libri i dashunisë dhe i fatit”. “Lundërtarët”, që qarkulloi 70 vite më parë, (përfshirë edhe dorëshkrimin “Libri i dashurisë dhe i fatit.”) besojmë se do t’na japin material dhe do t’na shërbejë më pas edhe për krahasim me veprat e mëvonshme të autorit, ndonëse gjysmën e dytë të shekullit XX e ka kaluar në burg ose larg shqipfolësve. Ndryshimet nuk do të jenë të mëdha, pasi ai ishte një njeri me kulturë të gjerë dhe kur e botoi veprën e parë sapo kishte përfunduar Universitetin në Itali që patjetër do ta ketë ndikimin e tij edhe në përgatitjen gjuhësore të përgjithshme, jo thjesht për gjuhën shqipe.

Kur e botoi veprën e parë Arshi Pipa, në vendin tonë gegërishtja kishte përparësi ndaj toskërishtes, pasi Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918) një çerek shekullit para botimit të veprës së Pipës kishte miratuar si bazë për gjuhën e përbashkët shqipe të folmen e Elbasanit, me përmirësimet që mund t’i bëheshin. Edhe vendimi i Qeverisë së Ahmet Zogut i vitit 1923 detyronte që e gjithë administrata dhe shkolla të përdorte elbasanishtes, ndonëse nuk mund të mohohet fakti se edhe në këtë periudhë u përdor toskërishtja. I përmendëm këto dy evenimente pasi Arshi Pipa ecën në gjurmët e tyre. Sa ka qenë koherent për zbatimin e tyre, do të përpiqemi t’i evidentojmë edhe në këtë punim.

Mendimi ynë është se Arshi Pipa nuk ka pasur si qëllim të shkruajë një gegërishte me prirje afruese, por qëllimi i tij i tij ka qenë të përdorë një gegërishte letrare, ndonëse nuk i ka mohuar vlerat e toskërishtes në atë drejtim që ajo i ka. Në një aspekt mund të konsiderohet tedencioz dhe jo tolerant nga njëra anë, por nga ana tjetër, kur vjen në letërsi si përkthyes ka konsiderata të tjera. Në veprën “Lyrika latine”, përkthyer në Sarajevë në vitin 1958 dhe ribotuar nga Shtëpia botuese “Plejad” në vitin 2010, në parathënien e saj, që ai e quan *paraqitje* sqaron se përkthimet e lirikave janë bërë në dy dialekte, që ekzistencën e tyre e quan me fat për shqipen. Gegërishtja me toskërishten përplasen në fushën letrare në mënyrë fatlume. Kështu disa autorë u përkthyen në gegërisht, sipas Pipës, pasi, në mes të tjerash, gegërishtja ka forcën e duhur, kurse disa autorë të tjerë në toskërisht si Virgjili se poezia e tyre shtrihet më mirë në atë dialekt.¹

Ndonëse Arshi Pipa ishte mik dhe shok i ngushtë i Martin Camajt dhe i qëndroi pranë edhe kur vdiq, por kjo miqësi nuk u pasqyrua në gjuhën e shkrimeve të tyre, pasi Camaj shkroi një gegërishte letrare më shumë me prirje afruese, ndërsa Pipa nuk i shkante ndër mend një ide e tillë.

Arshi Pipa ka qenë kundër vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe të vitit 1972, duke i parë vendimet e këtij kuvendi për gjuhën letrare si zgjidhje politike, të cilat do t'i trajtojë në disa shkrime dhe në veçanti në monografinë “*Politika e gjuhës në Shqipërinë socialiste.*”

Veprën “*Lundërtarët*” do ta veçojmë nga veprat e tjera, pasi ajo i përket gjysmës së parë të shekullit XX, kur vendi ynë ishte i pushtuar nga fashistët italianë dhe nazistët gjermanë. Për mendimin tim, gjuha e kësaj periudhe ka veçoritë e veta, pasi zhvillimi i saj varej edhe nga vetë zhvillimi arsimor dhe kulturor i vendit tonë.

Duke ditur se autori ishte poet dhe krijimtaria letrare i përket poezisë, për të parë më mirë veçoritë gjuhësore të kësaj periudhe, kemi shfrytëzuar edhe ndonjë studim të autorit, si ai për Migjenin, botuar në revistën “*Bota e re*” (1945) apo artikuj të tjerë në revistën “*Kritika*” (1944) dhe “*Fryma.*”

2. Për gjuhën e njësuar shqipe

Arshi Pipa problemin për gjuhën njësuar shqipe e ka trajtuar në disa shkrime, si para, ashtu edhe pas përmbysjes së regjimit monist në Shqipëri dhe së fundi në një studim të gjerë në monografinë “*Politika e gjuhës në Shqipërinë socialiste*”, botuar në anglisht në vitin 1989 dhe përkthyer në shqip dhe botuar në vitin 2010 në versionin gegërisht dhe toskërisht.² Autori ishte një adhurues i gegërishtes dhe për të zgjidhjet e dhëna për njësimin e gjuhës letrare në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe ishin të papranueshme. Gjithë pikëpamjet e tij do të pasqyrohen në monografinë e sipërpërmendur “*Politika e gjuhës në Shqipërinë socialiste.*” Por autori në përkthimet e tij të poetëve latin jo gjithnjë i jep në gegërisht. Për autorin, siç e theksuam edhe më sipër, poezia e disa poetëve latin përshtatet më mirë në gegërisht, por për disa të tjerë në toskërisht dhe këtë e realizon në përkthimet e tij, pasi secili dialekt ka veçoritë e tij, njëri mund të jetë më i fuqishëm, tjetri më i këndshëm.

Në veprën e sipërpërmendur, në mes të tjerash, trajton edhe këto çështje:

1. *Tradita letrare gege dhe toske.* E nis me Formulën e pagëzimit të vitit 1462, i pari dokument i shkrimit të shqipes i shkruar në gegërisht, ndjekur nga Perikopeja, ndoshta e shek.XV. Tekstet më të vjetra i përkasin shek.XVI, me Gjon Buzukun që na dha të parin libër shqip, “*Mesharin*”(1555) shkruar në gegërisht me alfabetin latin dhe më pas me *Doktrinën e Kërshterë* të L.Matrëngës të vitit 1592. Buzuku prin traditën gege katolike të Veriut, të ndjekur nga Budi (1618, 1621), Bardhi (1635), Bogdani (1685), Kuvendi i Arbënit (1706), Da Leçe (1716), dhe Kazazi (1743) dhe traditën toske-arbneshë,

1.A.Pipa, *Lyrika latine, vepra 3, Plejad*, Tiranë, 2010, f.10-12.

2. A. Pipa, *Politika e gjuhës në Shqipërinë socialiste*, Tiranë, 2010.

muslimanë dhe ortodoksë, ku secili punonte pavarësisht nga nga njëri-tjetri, si Kodeksi i Kieutit (1737), Variboba (1762), Nezimi rreth vitit 1740 etj. duke përdorur një mozaik alfabetesh, por më pas ata filluan të konvergojnë kur revista “Albania“ e F. Konicës, botonte tekste edhe toskërisht edhe gegërisht.

2. *Njësimi i alfabetit. Kongresi i Manastirit.* Ai miratoi dy alfabete: alfabetin e Stambollit me pesë ndryshime dhe alfabetin mbështetur në atë latin që mbizotëroi në shqipen. Anëtarët e Kongresit të Manastirit ishin patriotë të orientuar nga perëndimi, të cilët e konsideronin njësimin e alfabetit si hap paraprak drejt krijimit të një Shqipërie të pavarur. Sipas A. Pipës, komiteti i drejtuar nga Gj. Fishta u kufizua vetëm në vendosjen e një alfabeti të përbashkët, ndërsa problemin e një gjuhe të përbashkët nuk e diskutoi, pasi, sipas autorit, paraqiste vështirësi lidhur me ndryshimet e mëdha fonologjike në mes të dy dialekteve.

3. *Platforma për afrimin e dy dialekteve. Komisia Letrare e Shkodrës, 1916.* Autori fillimisht jep vlerat e disa anëtarëve më të rëndësishëm të Komisionit Letrare, si Gj. Pekmezi, A. Xhuvani (A. Xh. nuk ka qenë anëtar i KLSH, A. O.), L. Gurakuqi, Gj. Fishta dhe Nd. Mjeda. Kjo komisi miratoi të folmen e Elbasanit si bazë e gjuhës së përbashkët. Për Arshi Pipën ky konvergjim duhej të bëhej shkallë-shkallë, rezultat një kompromisi të arsyeshëm, siç ndodhi me Kongresin e Manastirit. Vendimet e Komisionit Letrare, sipas autorit, patën karakter tendencë-tregues sesa ndonjë natyrë normative. Dhe autori jep disa nga vendimet në fushën fonetike dhe tolerimet që u bënë për hater të afrimit të dialekteve. Ai i kundërshton këto vendime, siç ishte parimi fonetik që për toskët ishte në rregull, por për gegët jo. Ai thekson se zelli patriotik dominoi përmbi rreptësinë shkencore, por nuk u zbatua 100% nga autorët gegë, ndonëse elbasanishtja fitoi terren në zyrat e shtetit dhe ndër shkolla.

4. *Shqipja e njësuar letrare shqipe.* Autori pasi jep situatën gjuhësore gjatë periudhës së pavarësisë deri në vitin 1944, thekson se gjatë këtij intervali 1920-1944 nuk u bë ndonjë përpjekje për të njësuar të dy dialektet (Kujtojmë vendimin e Qeverisë të dt. 23 janar 1923 që udhëzonte që administrata të përdorte si gjuhë zyrtare elbasanishten, A.O.). Autori vë në dukje se pas vitit 1944 shteti i ri monist ndërroi edhe kursin e gjuhës. Kështu në vitin 1952, sipas Arshi Pipës, Lidhja e Shkrimtarëve të Shqipërisë vendosi që të gjitha botimet të dilnin vetëm në toskërisht, ndërsa gegërishtja letrare u ngushtua vetëm në sferën e letërsisë artistike, e cila dalngadalë po humbte terren. Kjo dukuri u vërejt në Orthografinë e gjuhës shqipe të vitit 1956, pasi shkrimtarët gegë, sipas autorit, pushuan së shkruari dialektin e tyre dhe kjo mbeti privilegj i shkrimtarëve të Kosovës dhe i viseve të tjera ku kishte popullsi shqiptare gege. Ngjarjet rodhën në atë mënyrë që në Konsultën e Prishtinës të vitit 1968 vendosën që të përqafonin gjuhën zyrtare shqipe. Sipas Arshi Pipës këtë veprim e bënë për të theksuar kombësinë e tyre shqiptare në formë proteste kundër refuzimit të Federatës Jugosllave për t’i dhënë statusin e republikës. Ky veprim i kosovarëve shënonte triumfin e politikës të ndjekur nga Qeveria e Tiranës. Dhe në Kongresin e Drejtshkrimt të Gjuhës Shqipe të vitit 1972 shpalli “shqipen e njësuar letrare si të vetmen gjuhë letrare“. Ata e pranuan shqipen e njësuar nën parullën një komb-një gjuhë letrare.

5. *Roli drejtues i A.Kostallarit në procesin e shqipes së njësuar letrare.* Për autorin eliminimi i gegërishtes dhe vendosja e toskërishtes në bazë të gjuhës letrare u kushtëzua edhe nga faktorë politikë, pasi drejtuesit e shtetit ishin pothuajse të tërë jugorë. Por, duke u nisur nga tradita e gjatë letrare e gegërishtes, në Kongresin e Drejtshkrimit u bënë disa lëshime në favor të saj, kryesisht përse u përkthet disa veçorive fonologjike geqe. Arshi Pipa ngulmon se gjuha letrare shqipe e njësuar mban vulën e Androkli Kostallarit.

6. *Paraqitja e pikësynimeve.* Autori thekson se kjo monografi synon që të përcaktojë natyrën dhe shkallën e “njësimit” gjuhësor në fjalë.

Fillon me një përshkrim krahasues mes dy dialekteve dhe çështje të tjera lidhur me gegërishten dhe toskërishten.

Sami Repishti

Të tërheq vëmendjen se Repishti me të vërtetë shkruan gegërisht, por në dy veprat e botuara vëmë re një prirje, veçanërisht në veprën e fundit për të përdorur një gegërishte letrare më të moderuar, me prirje afruese me gjuhën e sotme, çka e bën atë që t’i afrohet sa më shumë lexuesit dhe dallimet dialektore të jenë ato më specifiket e së folmes së përdorur.

Të shkruash në gegërisht, nuk mjafton vetëm ta zbatosh normat e saj, por është e domosdoshme në rrethanat e sotme të mos jesh konservator dhe t’u përgjigjesh zhvillimeve të reja gjuhësore, me qëllim, siç është theksuar, që të mos qendrojë i veçuar nga standardi gjuhësor zyrtar. Autori duhet ta ketë pasur një objektiv të tillë, pasi vepra botohej në shekullin XX dhe lexuesi priste të shihte një vepër me vlerë edhe nga pikëpamja gjuhësore. Ai në gegërishten e përdorur nuk përqafoi ato trajta arkaike të gegërishtes, por zgjodhi ato që jo vetëm nuk thellonin ndryshimet në mes gegërishtes e toskërishten nga njëra anë, por nga ana tjetër edhe të mos e humbë fizionominë e këndshme të gegërishtes.

Pas vitit 1990 filloi lëvizja e lirë e qytetarëve, si dhe u rrit shumë emigracioni. Në një shkrim me titull “*Shqipja standarde në Amerikë...*”, botuar në revistën “*Gjuha jonë*”,¹ filologu amerikan Viktor Fridman vë në dukje se në Amerikë, para Luftës së Dytë Botërore pjesa më e madhe e shqiptarëve fliste toskërisht me Fan Nolin dhe Faik Konicën, por pas vitit 1981 kemi më tepër gegërishtfolës me Arshi Pipën dhe në Gjermani me Martin Camajn që vazhduan të kujdesen për gegërishten edhe pas vitit 1972. Fridmani në fund të artikullit shkruan: “*Sfida për shqipen në Amerikë në shekullin XXI do të jetë të ruajë arritjet e Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972 së bashku me zhvillimet moderne.*”² Për autorin nëse merremi vetëm me estetikën dhe shkencën, jashtë politikës, tradita e pasur dydialektore e shqipes ka një vend në kulturën e botës. Fjalori shqip-anglisht i Newmarkut, më 1998 e pasqyron këtë.³

1. Viktor Fridman, *Shqipja standarde në Amerikë: studime shkencore, pedagogjike dhe planifikimi gjuhësor*,

“*Gjuha jonë*”, 2002, nr.3-4, f. 110-112.

2. Po ai, po aty, f.112.

3. Po ai, po aty, f.112.

Çfarë ka ndikuar te S.Repishiti për të përdorur gegërishten në aspektin gjuhësor? Pjesa më e madhe e autorëve që kanë shkruar në gegërisht pas vitit 1916, në shkrimet e tyre janë mbështetur te vendimet e KLSH të Shkodrës. Zgjidhjet e këtij institucioni S.Repishiti dhe të tjerë jo vetëm i zbatuan, por i çuan edhe më tej në veprat që ata botuan. Njëkohësisht ata ishin edhe personalitete të kulturës shqiptare, që donin të venin një gur në piedestalin e gegërishtes letrare. Ai, si dhe disa kolegë të tjerë, hoqën theksin hundor dhe theksat e tjerë, nuk rrafshuan zanoren ë, por e përdorën me kriter, siç do ta vërejmë në kapitullin për dukuritë fonetike në veprën e Repishtit. Paskajoren geqe, autori vazhdon ta përdorë edhe në veprën e fundit “*Nën hijen e Rozafës*”. Siç kanë vërejtur studiuesit, ndoshta nën ndikimin e leximeve, por edhe të dëshirës së tij për të qenë liberal në gjuhë ose rastësi, ndeshim në disa raste që këtë formë të pashtjelluar e ka zëvendësuar me lidhoren, si: *Ky grumbull kockash më bani të qeshë e të qajë njëkohësisht*.(Nën hijen...f.269 etj.) Gjuha letrare ka ecur përpara dhe me të drejtë ne jemi në një stad më të ngritur, në stadin e modernizimit të saj që për ne kupton që ajo të pasurohet qoftë me fjalë të burimit vendës për të zëvendësuar fjalët e huaja dhe të panevojshme, qoftë duke përfshirë edhe pasurinë gjuhësore të autorëve gegë. Akad. Gj.Shkurtaj ka të drejtë kur shkruan: “...normat e çdo gjuhe janë të gjalla e në lëvizje, porse praktikisht po tregohemi të mefshët e të pazotët për t’i shqyrtuar, ashtu siç meritojnë edhe prurjet që mund të mos jenë njësoj me normën drejtshkrimore, por që përbëjnë prirje të përshtatshme ndaj zhvillimit të gjuhës shqipe të sotme.”⁴

Vepra e Repishtit mund të vlerësohet edhe në përpjekjen kodifikuese, si në rrafshin drejtshkrimor, leksikor, fonetik dhe gramatikor. Është një gegërishte letrare e standardizuar që mund të shërbejë për pasurimin e standardit të sotëm. Kjo do të paqyrohet edhe në punimin tonë të doktoratës.

Filip Ndocaj

Krijimtaria letrare dhe botuese e shkrimtarit Filip Ndocajt përfshin një periudhë afërsisht 20-vjeçare prej vitit 1961 kur botoi vëllimin e parë me poezi dhe poema “Në sytë e rinisë” deri në vitin 1978 kur autori ynë botoi tregimin “*Duke kërkuar lumturinë*”. Duke e parë veprimtarinë e tij botuese në rrafshin gjuhësor në përshtatje me temën studimore, do ta ndajmë në dy periudha:

e para fillon me krijimtarinë e botuar para Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972), kur ai i botoi veprat në gegërisht, si “*Në sytë e rinisë*” (1961) , “*Dashuri dhe urrejtje*”(1964), “*Vlaga e dheut*” (1968) “*Dielli në kreshta*”(1971) dhe periudha e dytë pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, kur autori në veprat që shkroi dhe botoi do të zbatojë vendimet e këtij kongresi.

Është për t’u theksuar se Filip Ndocaj nga veprat e para dhe në vazhdim ka ardhur gjithnjë duke e përpunuar dhe zgjedhur gjuhën për ta bërë sa më gjithëpërfshirëse,

4. Gj.Shkurtaj, *Kundërime gjuhësore*, Tiranë, 2006, f.5.

ndonëse e shkruar në gegërisht, por gjithnjë e evoluar, duke iu larguar trajtave të ngushta dialektore. Vërejmë se F.Ndocaj në veprat, që botoi gjatë atyre pesë pesë vjetëve të diskutimit të këtij projektit të drejtshkrimit të vitit 1967, nuk i ka anashkaluar disa veçori të tij, ndonëse nuk kishin marrë formë ligjore, por, kryesisht, brenda kornizës së gegërishtes.

Duke qenë se tema jonë lidhet me gegërishten, siç e theksuam edhe më sipër, ne do të mbështetemi në veprat që janë shkruar në këtë dialekt.

Filip Ndocaj ishte nga Veriu dhe një pjesë të jetës së tij e kaloi në fshatrat e Veriut, kështu në veprat e para vërehet një ndikim dhe përdorim i të folmeve të këtyre zonave, sigurisht me një gjuhë të përpunuar, por me një leksik krahinor që nga vepra në vepër vjen e ngushtohet.

Për këtë qëllim ne jemi mbështetur dhe kemi vjelë material nga dy vepra të Filip Ndocajt: e para i përket rinisë së hershme të autorit “*Në sytë e rinisë*”, e cila është e ndarë në dy pjesë: e para titullohet “*Ngashërimi*” dhe përfshin 7 poezi të shkruara gjatë viteve 1940-1943 dhe pjesa e dytë titullohet “*Sulme dhe andrrim*” që përfshin 17 poezi dhe dy poema të shkruara gjatë viteve 1945-1960 dhe vepra e dytë “*Vlaga e dheut*”, botuar, më 1968, gjithnjë para se të mblidhej Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe dhe një vit pasi ishte botuar projekti i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, por edhe veprës “*Diell nën kreshta*”(1971).

Autori, siç e kemi përmendur më sipër, shkroi dhe botoi vepra dhe studime deri në fund të jetës së tij, por materiali gjuhësor është vjelë, kryesisht, nga këto tri vepra.

Përmbyllje e kreut të parë

Siç e trajtuam deri këtu, veprimtaria letrare e dy autorëve Arshi Pipës dhe Sami Repishtit është shkruar gjithnjë në gegërisht, ndërsa autori i tretë Filip Ndocaj pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe të vitit 1972 veprat që botoi pas këtij kuvendi zbatoi vendimet e tij, gjuhën standarde.

Autorët kur shkruanin në gegërisht zbatonin ato rregulla që miratoi Komisia Letrare Shqipe në Shkodër dhe më pas vendimi i qeverisë së vitit 1923.

Theksojmë se gegërishtja e tre autorëve është mjaft e standardizuar, me ndonjë përjashtim të rrallë. Ajo është e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme edhe nga lexuesi jugor. Kjo vërehet jo vetëm në këtë kapitull, por edhe në krerët e tjerë.

A.Pipa ka qenë një kundërshtar i hapur i zgjidhjeve që bëri Kongresi i Drejtshkrimit i vitit 1972 që mënjanoi gegërishten, por në të njëjtën kohë autori nuk kundërshtoi edhe vlerat e toskërishtes, veçanërisht në përkthimet, të cilat për ndonjë rast, theksonte ai, më shumë i shkonte njërit dialekt ose tjetrit.

Të gjitha mendimet e tij për gjuhën e njësuar autori i paraqet në monografinë “*Politika e gjuhës në Shqipërinë socialiste*”, ku ai shpreh pikëpamjet e tij rreth zgjidhjes që u bë në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe të vitit 1972.

Edhe Sami Repishti, me të vërtetë shkruan në gegërisht, por vepra e dytë “*Nën hijen e Rozafës*” nga pikëpamja gjuhësore është më afër gjuhës standarde, veçoritë dialektore janë më të pakta.

Evoluimet gjuhësore që po ndodhnin në shqipen e sotme, kanë gjetur pasqyrim në një fare shkalle edhe në gegërishte.

Autori në gjithë krijmtarinë e tij u udhëheq , përgjithësisht, që të përdorë trajtat e mbarë shqipes dhe jo ato arkaike, pa “tradhtuar” dialektin që përfaqësonte. Kemi përpjekje kodifikuese nga autori në të gjitha rrafshet gjuhësore.

Ndryshe nga dy autorët e tjerë Filip Ndocaj shkruan në dy dialekte: fillimisht gegërisht e pastaj në standard. Një veçori e gjuhës së autorit është se nga vepra në vepër ka pasur ngritje, duke iu larguar gjithnjë e më shumë trajtave dialektore. Duke qenë se autori një pjesë të jetës së tij e kaloi në veri, do të vërejmë se në veprat e para vihet re ndikimi i së folmes ku ai ka punuar, por nga vepra në vepër dialektalizmat gjithnjë e më shumë qoftë në leksik, por edhe në rrafshet e tjera, vijnë duke u ngushtuar.

Kreu i dytë

Rreth leksikut të veprave të tre autorëve: Pipa, Repishti, Ndocajt

Në këtë kapitull, ashtu si edhe në kapitujt e tjerë në vazhdim, në përputhje me temën e doktoratës, jemi përqendruar në përdorimin e gegërishtes si në rrafshin leksikor, ndërsa në vazhdim edhe në rrafshet e tjera gjuhësore.

Leksiku i gegërishtes që është vjelë nga veprat dhe disa studime të botuara të tre autorëve, i kemi grupuar në këtë mënyrë:

- 1.a. Fjalë, dialektizma-gegizma që i ndeshim në veprën e A. Pipës, S.Repistit dhe F.Ndocajt, disa prej të cilave edhe në Fjalorin gjuhës shqipe të vitit 2006
- 1.b. Leksema, dialektizma-gegizma që i ndeshim në veprën e A. Pipës, S. Repistit dhe F. Ndocajt, por jo në Fjalorin gjuhës shqipe të vitit 2006
- 1.c. Disa krijime të A.Pipës, S. Repistit dhe F.Ndocajt, (Neologizma) ose krijime popullore
- 1.ç. Fjalë të huaja në leksikon e veprës së A.Pipës, S. Repistit dhe F.Ndocajt.
2. Përmbyllje e kreut të dytë

Arshi Pipa

Veprimtaria botuese në gjuhën shqipe e Arshi Pipës, siç e theksuam që në fillim, nuk është e madhe, pasi ai jetoi afro gjysmën e jetës jashtë Shqipërisë.

Është në sistem të autorit që në vazhdimësi të përdorë një leksik të pasur, kryesisht me fjalë të së folmes së vendlindjes, që disa burimin mund ta kenë këtu, por me kalimin e viteve, disa prej tyre, kanë hyrë në fondin aktiv të shqipes, ndërsa disa të tjera mbeten si pasuri leksikore, diku të njohura nga lexuesi përmes letërsisë së shkruar geqe ose përmes kontakteve njerëzore. Disa i ndeshim në Fjalorët e shqipes së sotme, të shënuara jo gjithnjë si fjalë krahinore¹. Edhe në fjalorët krahinorë të “*Bashkimit*”², N. Gazullit³, B.Demës⁴ etj. ndeshen shumë pak. Gjithashtu denduria e fjalëve nuk është gjithnjë e barabartë.

Leksiku, fjalë krahinore, por jo i mbarë shqipes, është vjelë nga veprat “*Lundërtarë*”, “*Libri i dashunisë dhe i fatit*”, “*Libri i burgut*”, “*Rusha*”, si dhe nga artikujt studimorë të periudhës së hershme.

Me interes për t’u theksuar është se shumë fjalë krahinore janë përfshirë në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1980 apo 2006, por shumë pak janë shënuar si krahinorizma. Akad. Jani Thomai thekson se në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe të vitit 1980 nga 40.800 fjalë, 1076 njësi leksiko-semantike janë shënuar si krahinorizma⁵, ndërsa për gjuhëtarin Thanas Feka numri i fjalëve me burim krahinor të përfshira në këtë fjalor është më i madh, po të kemi parasysh se shumë njësi të tilla nuk janë shënuar si krahinorizma⁶.

1. *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006;

2. *Fjalori i “Bashkimit”*, Shkodër, 1908.

3.D. N.Gazulli, *Fjalorth i ri fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipërisë*, Tiranë, 1941.

4. B. Dema, *Fjalori fjalësh të rralla të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2005

5. J.Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001.

6.Th. Feka, *Rreth fjalorëve krahinorë të gjuhës shqipe*, në “Leksikografia shqipe-trashëgimi e perspektivë”,Tiranë, 2004, f.204.

1.a Fjalë, dialektizma-gegizma që i ndeshim në veprën e A.Pipës, S.Repshtit, F.Ndocaj, disa prej të cilave edhe në Fjalorin gjuhës shqipe të vitit 2006

Arshi Pipa

A

Afshoj= lëshon afsh...*Afshonte pëma ime, fryhej ndën kore...*(L.F.109).

Amull = **pellg me ujë të ëmbël**... *Dridhesh n'amull te hija, send i pangjaje...*;
(L.F.108).

B

Bardhullore = **e bardha**...*nder kopshtijet e fëminis, n'agimet bardhullore.* (L.23). E ndeshim edhe te Koliqi, avuj bardhullore, por e ka edhe M.Elezi⁷. Fjalori i 2006-ës e jep bardhëllor – i bardhë, shndritshëm.

Bjerr=**humbas**...*At'herë dhe gjaku i juej jo kot ai birret...* (L.B.20).

Brishtë(i)= **i dobët, i parregullt që thermohet lehtë**...*n'lundra t'brishta si gastare...*
(L.63).

Bzâj =**them, bëj zë**...*ndejun pa lëvizje pa bzâ...*(L.71).

C

Cik = **prek**...*humbshe sa here qi mendja t'cikte nder maje.* (L.F.108).

Cule=**lecka, zhele**...*zbathun kambësh, krejt ndër cule...*(L.B.41).

Currash= **shkëmb**...*Përzi me jone e shushurime gurrash/ n'at gem dallova ca jehona currash...* (L.54).

Ç

Çmerit=**habit**...*Vdesin njerzit me qindra mija/ çmeritun v'rejnë si qeshë pranvera...*
(L.F.133).

Çufërr=**kaçubë, tufë**...*mbas nji çufre drandoflesh...*(R.30).

D

Davarit= **largohet, shpërndahet**... *kur mjegulla ... davaritet...* (L.F. 101).

Dihat=**marr frymë me vështirësi**...*djaloshi letë dihati, fill mandej i fërgulloi qerpiku...*
(R.27).

Dvar= **bjerr, humb**...*Sa shpejt u-dvarë aj parajs lumnije...* (L.25).

F

Farfurit= **vezullon, shkëlqen, ndriçon**...*Na këndojsim. Xhixhillojat farfuritshin...*
(L.64).

Flijë= **flijim, dëshmor** *Do të vijë dita e flijes së fundme...* (L.F.118).

Flokshatorr=**flokë të gjata që bien mbi supe**...*vetullan e flokshatorr shpërnda...*(R.9).

Floknajë= **flokë të shumtë, të dendur. Këtu flokët në përgjithësi**...*thirrja ime çan qiellin, I zhgul floknajen/kufomës së Zotit të vjetër...*(L.F.117).

Foltare= **gojtar**... *Mjeshtrija e rrallë foltare e Nolit asht botnisht i njoftun...* (K.4, 122).

Fshâj= **ofshamë, psherëtij**...*i u-dhimt e fshâni thellë: Oh zemra e eme / si mund t'durojë pafshâ...*(L.10).

Fuli=**një lloj gatimi i ëmbël**...*kur fulinë përpara ke me qitë...*(R.64).

7. M.Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007

G

Gand= rastësisht, pa dashur...*mos janë ata qi zëmren e pa -roje / gand t'a shituene ndërtekje prilli?* (L.39).

Gandoj= lëndoj... *E tue i matë,tue i peshue kështu, veç do t'i gandojë do t'i prishi...* (K.1.3).

Gastare = qelq...*n'lundra t brishta si gastare...*(L.63).

Gem=degë...*ku zogjt pa reshtë cicrojnë prej gemi n'gem...* (L.39).

Gëdhel= mikloj, i bëj lajka...*ktë e nxit atë gëdhel ...*(B.158). E ka Dema.

Gërgas=ngacmoj...*Shpesh e kishin ndrikullat gërgá...*(R.10).

Gufoj=fryhet...*për lamtumirë e tue gufue prej vajit...*(B.169).

Golle= grope, boshllëk, zgavër...*Truni e zëmra janë golle, edhe jeta asht si ata...* (L.58)

Gjethnajë= kunorë e gjetheve të një peme, gjethishtë... *Shpejt do t' bjeri errësina mbi gjethnaje e heshtueme...* (L.80).

Gj

Gjimues= që gjëmon...*ti qi gjimues me zanin ajrin e trandë e peshë i çon tallazet...* (L.72).

H

Handrak=pisllëk...*sidoqi ka krymba, lê mâ handrak...*(L.B.162).

Hir= sjellje e mirë, dashmirësi...*Koha nuk e ka prishë...e ka hijeshue ma tepër, i ka shtue fisnikë e hîr...* (K.4.1, 121).

Hiroshe= me hir, e bukur...*ndër shtrojet qi veshë lmashku i butë, hiroshe shtojzavallja me flok't e farfurishme...*(L.57).

Hirplotë= që ka mjaft bukuri... *te magjia hirplotë ku je ti shembulltyrë...* (L. F.104).

Hov= vrull, lëvizje të shpejta...*vepra e tij... e ndërpreme prej hovesh të flakta për me i shpëtue ktij mjerimi fatal...* (K.3.113).

I

Idhujtari= ai që adhuron idhujt... *Derdhni ju mbi idhujtarin dashuninat e kohnavet qi u -fikën me aq shkëlqime...* (L.65).

Imtaz= imtësisht...*tue u-kumtue imtaz ndër zemrat e atyne qi e ndiejnë...*(K.1,1).

J

Jone= jehonë, melodi, tingull i bukur...*e merr me vehte jonet e nji kange plot dashuni e uzdajë...* (L.41).

K

Kandër=insekt...*veç rrallë nga zukatja e ji kandre...* (L.B.192).

Kemtar=enë kishtare...*e kur kemtarin shkundi prendimi e u derdhi ujnave arin...*(L.B.171).

Këndell-përtërij, gjallëroj, fuqizoj...*vetëm nji ditë ju- dha me këndellë ket nevojë...*(L.B.49).

Këndir= përballoj, ia marr frymën dikujt... *Epshi im âsht gjarpën e-zile nxûna prej tij me këndirë...* (L.F.123).

Kllapi= kur flet përçart nga temperatura...*m'lên ta ndrydhi kujtimin me kllapinë e gjumit...*(L.F.103).

Kotëll=fustan...*e ngelin syt...te goja, te kotlla e bardhë...*(L.B.40).

Kqyr = vështroj shikoj . *Sonte qi un nuk mund ta kqyri veten pa neveritje...* (L.F. 103).

Kryen-ulun = kokulur. *Kryen-ulun vijshe, e zyrtë e pa u-ngutë...* (L.F.107).

Kumi=furrë...*fati i mjerë e kumi der'at ditë...*(R.42).

L

Ledhatare=përkdhelës...*Prej shpresash ledhatare i mjeri u- rrëjta....* (L.10).

Lëvyrë= që të vret sytë...*shpresa qi m'u lëvyren...*(L.B.174). Dema e jep me kuptimin me gërvishtë, me u lodhë shumë nga puna.

L(ë)byrë=i mbulon sytë me një cipë, e verbon; perde syri...*aj rrokë gjithçka i del përpara dhe ma fort çka e lbyrë e ndezë...* (L.F.97).

Lënurë= e bëj fije -fije, kreh, shkriftoj...*Andra, fije lënurë nga një pëllhurë endun me dridhje e shpresa...* (L. F.113).

Ll

Llasa=përkëdhelje e tepëruar, llastim ...*dëshirat me i mashtrua me rrethje lotesh o për me I ndezun me t'zakonshmet llasa...* (L.67).

Llastueshëm= përkëdhelje e tepëruar...*tue u-përkundun llastueshëm mbi vala...*(L.65).

Llomishtë= vend i mbushur me lym...*Ashtu përplasësh ndër llomishta, zhgabë e plagosun...*(L.F.120).

M

Mahis=tall, bëj shaka...*Rushë, moj motër desha me u mahitë...*(R.15).

Mallota= lloj pallto burrash...*dalin me kureshtje nën mallota e valenxa...*(L.B.27).

Mbarsun (e)= e ngarkuar...*Por asht një fakt se poezija fringe u-bâ gjithnji ma e mbarsun me metafizikë.* (F.7-8, 300).

Mëlcon=pezmaton...*Preku me të varrën kur mëlcon...*(R.42).

Mëni=pushoj...*E kur mâ vonë, si mëni flaka e gjama...*(L.B.19).

Mërtisur(i)= i mbuluar, i mshehur me mbulesë, i shtrembëruar...*E mertisun , por jo e harrueme, fëtyra e Fan Nolit po merr në kohën tonë|...* (K.4, 121).

Mjak= kur goja zë lëmashk nga temperatura...*plasun buza e goja zânë me u mjakun...*(R.27) *kryelartët...*(K.4,126).

P

Pallange= fshat i madh...*Asht një rogë dikund mbatânë pallange mbi një sukë...*(R.81).Ka edhe kuptim tjetër.

Pamiradishëm(i)=mirënjohës...*Kush do të gjindet edhe për këtë pun të pamiradishme?* (K.1,2).

Patalok=shesh...*Ngjat pallatit larg sa hidhet guri ish një patalok...*R.40.

Picak= lakuriq...*Due me u çveshun picak, me lbyrë* (L.F.118).

Plleshëm(i)= i bollshëm, pjellor...*gjinjt e plleshëm ku toka nënë e butë kullon ...* (L.F.129).

Porris=fik, shuaj, zbut...*U porit tash burri kur i pá gjakun tue kullue...*(R.43).

Prâj=pushoj...*e nuk prân zogu i dritës...*(L.B.164).

Praroj= shkëlqej...*ku një rreze hane praronte kohë mbas kohe mes gjithnajes...*(L.64).

Puhí= erë e lehtë, fllad...*avull i lânë nga puhija/ varë mbi gjithnaje.* (L.F.108).

R

Rendim= radhit...*Edhe rendimi i ktyne asht bâ mbas një plani...* (K.3, 113).

Rigoj=rrjedh...*I rigoi një lot...*(R.15).

Rimtë(i)= i vërenjtur, i kaltër...*Nuk më trëmbin kupat e rimta të qiellit...* (L.F.117).

Rysun(i)= i sprovuar, i kalitur...*Por ndofta hapi i rysun t'udhizonte pa gabim...* (L.F.105).

Rr

Rrakatë=flas me zhurmë...*e me dashtë , kam mjaft çka me rrakatë...*(R.71).

Rravë=shteg dhish...*tjetër rravë lufta kisht marrë...*(R.38).

Rrekem= përpiqem...*po kot rrekesh me prekë...* (L.F.114).

Rrethekoj=rrethoj...*rrethekue prej flokut kaçurrel...*(R.46). E ka Dema dhe Gazulli

Rrezg=fuqi, turr, zell...*qi ate përfshin me rrezgun e mendimit.*(B.184). E ka edhe Gazulli.

Rrëshqan= zvarë...*Njeri qi ngrelesh rreshqânë gjatë udhvet t' shkreta...*(L.F.105).

S

Skamnor= varfër(1)...*nepër fëtyra të skamnorvet vetvetiu, si me dhunë...*(K.3, 115).

Sh

Shakmizë=grumbull...*Hyjt shakmizë i qëndisshin pëlhurën...*(L.B.184).

Shkim=shuaj, shfaros...*Qe u-shkim e kemit era e avulli...*(L.B.159). E ka Dema, ndërsa Gazulli me kuptim tjetër.

Shkrryej= zvaris...*nisi me u-ligë e s'donte ushqim e shkrryej te dheu...*(L.B.161).

Shkulm=me hove, me rrëmbim...*e derdhet me shkulma hareja...*(L.B.47).

Shpotit=tall, vë në lojë...*si ferishte qi âsht e kam shpotitë...*(R.38).

T

Tandë=pjergull...*Veç sot dij çka mendojshe kur e heshtun/tanden e luleviles...* (L.23).

Tekembramja= ma në fund...*Tekembramja çka ka pa të meta? ...*(K.1. 5).

Ter= zhdruk...*mandej një lot i heshtun qi një fëmën duhet t'a teri...* (L.F.120).

Tërmekshëm= me poterë, me të turullisë...*A s'shef si deti buluron tërmekshëm ...*(L.B.34). E ka Dema dhe Gazulli.

Tollovitun(i)= i çrregullt... *kur shpirti i tollovitun ndër tallazet...*(F.101). Fjalori i 2006-I çrregulluar , ngatërruar.

Turrshëm= vrullshëm...*Shpaloj thirrjen turrshëm n'erë,thirrja ime çan qiellin...* (L. F.117).

V

Vajzuke=vogëlushe...*e matën mirë vajzukën...*(R.65).

Vetmitar= i vetmuar... *Nga dritareja e çelun vijnë jehonat e i' kange vetmitare...*(L.21).

Verim= kaloj verën...*kështu qi njikohsisht me mësimin bahej dhe verim...* (K.3, 112).

Vërtik= vrull, hov, shpjetësi...*naltohet me vërtik shqiponje ...*(K.3,116).

Vigma= britma, klithmë...*Un ndij mallkimin n'zanin tand pa vigma, pa lajka...* (L.67).

Vrragë= gjurmë, vazhdë... *qi la një vrragë të thellë ...*(F.101).

Z

Zdërhall= bëjnë qejf... *ndërsa çimërr e morra ...zdërhallen mbi mue...* (L.B.162).

Zgrip= buzë diçkaje...*ti sillesh nepër zgripa...* (F.114).

Zh

Zharit=djeg...*kur dielli i mesditës zharitë...*(L.B.47).

Zhdryni= heq drynin...*Arkën arre zhdryni andej tue marrë...*(R.64).

Zhgalë=lodhem...*Por dashnija e mërtisun, qi digjet tue u-zhgalë...*(L.B.31).

Zhgreh= të lësh një punë...*âsht mjaft për mue qi ta zhgrehi fluturimin në hapsinë...* (L.B.46).

ZhbËj=shkul me rrënjë, zhdruk...*ta zhbËjmë krajatën qi na bani...*(L.B.53).

Zhele=leckë, njeri pa vlerë...*tue lanun te çdo gjemb një zhele shprese...* (L.F.105).

Zhumhurë= **potere, zhurmë e zgjatur...***Ndini ç'zhumhurë e harmonishme valash!...* (L.66).

Zhur= **zhavor...***ndër anë vagona me zhur e ranë...*(L.B.45).

Sami Repishti

Veprimtaria letrare botuese në gjuhën shqipe e Sami Repishtit veçohet në dy vepra. Edhe ato janë botuar kur autori i kishte mbushur të shtatëdhjetat. Por në veprën “*Pika loti*” – tregime burgu Repishti ka përmbledhur kujtime të jetës së tij të shkruara në kampet e të burgosurve në Kroaci, tetor 1960, korrik-gusht 1961, në kampin e refugjatëve në Jugosllavi, gusht 1961, në Itali në dhjetor 1961, në mars të vitit 1962, në Nju-Jork, në maj 1962, në gusht 1962, në nëntor 1963 dhe në gusht 1977, ndërsa në veprën “*Nën hijen e Rozafës*”, Tiranë, 2004, përshkruan ngjarjet e burgut.

Është në sistem të këtij autori që në vazhdimësi të përdorë një leksik të pasur, kryesisht me fjalë të mbarë shqipes, ndonëse ndeshim edhe pak fjalë dialektore, disa gegizma që kanë hyrë në gjuhën e sotme shqipe.

Leksiku është vjelë nga dy vepra “*Pika loti*” dhe “*Nën hijen e Rozafës*”:

Amë = nënë...*nji kullë ku jetojshin amë e bijë...*(P.L.5) . E ka edhe B.Dema.

B

Boshsi = zbrasësi...*Në boshsinë e krijueme në zemër e shpirt të asaj viktime...*(P.L.62).

C

Crrule=zhele...*e shpejtova ta vesh me crrulat e tij e ta mbulojmë me të miat...*(P.L.66)

Cumrrak= fëmijëi vogël...*Mëson cumrraku me zellin e madh në dritën e kandilit...*(P.L.123). E ka edhe Dema.

Ç

Çjerrun (e)= britmë e keqe që të vret veshët. *Zanet e çjerruna...mbulojshin çdo gjurmë.* (Ro.).

F

Fatmjerë = që nuk ka fat...pak ditë më vonë një tjetër fatmjerë, në moshën mesatare...(Ro.207).

Fshamje = shfrim ...*dhambët që i kërcitshin e fshamjet që nuk mund t'i përmbante...* (Ro.188)

G

Gojëndytë= gojështhurur. Fjalori i 2006 *gojëndyrë...që drejtohej nga një harbut* *gojëndytë...*(Ro.280).

Gulshim= shqetësim, kollë e keqe, astmë...*nuk kishin ndigjue...veçse gulshimert...që ishin rrallue...*(P.L.43). E ka Dema.

Gj

Gjamë=vaj me zë të lartë...*Ndigjova vetëm gjamet e zanin e tij të mbytnun...* (Ro.177).

H

Hukat=nxjerr frymë të ngrohtë...*Fëmijët pa zanë kurrkund vend hukatshin me avull të ngrohtë...*(P.L.121).E ka Dema.

K

Kaploj =e mbuloj krejt...*Atëherë, dëshprimi më kapllonte në një mënyrë mbyhtëse...* (Ro.151).

Katundarí = fshatarësi...Disa e quejshin kryengritjen akt guximtar i një katunderie...(Ro.31).

M

Maramendëse = të habitshme, shumë të madhe...*eci me një shpejtësi marramendëse...*(R.75).

Muçatun (i) = I mufatur, I shprishur...Çdo mëngjes frati e unë shifshim fytyrat e muçatuna...(Ro.219). E ka Dema.

Mveshem= mbështjell...*nji guxim me përmasa mbinjerëzore e mveshej me kuptimin gjysëmhyjnuer...* (Ro.97).

N

Nanlokja= emër përkëdhelës për nënën...*përkrah një nanlokje që I shikonte tue u dridhë nga frika...*(P.L.57).

Ndrydhja = përdredhje. Në fjalorin e 2006 nuk ndeshet si emër...*me gëzimin që sjell lirimi nga ndrydhja...*(Ro.58).

Ndrymë (i)=I mbyllur, i fshur...*ai rrinte istrukun në qoshen e tij, i ndrymë në boten e tij...*(P.97).

P

Përçudnuem (i)-prishja e keqe...*përçudnimi i marrëveshjeve dypalëshe...*(Ro.121).

Plym = plot...*vendi ishte mbushun klym me ushtri...*(P.L.10).

Pyrgu= grumbull ... *Nji rreshter po na shikon nga pyrgu i dheut...*(P.L.86).

Rr

Rreshkun(i)= i thatë, I rreshkur...*e lagte me një shtëllunkë të vogël pambuku buzët e rreshkuna të babes...* (Ro.134).

Rrëshekë=shi me furi...*Binte shi me rrëshekë...*(Ro.126).

Sh

Shejtnoj= shenjtëroj ...*e spjegonte thaniet e një bibletë re që ai shejtnonte pa asnjë dyshim...*(P.L.52).E ka Dema.

Shkimje=shuhen...jo përhumbjen e vet, por për shkimjen e familjes...(P.L.72). E ka Dema dhe Gazulli.

Shkoklim= ë bërit kokrra-kokrra...E jep Repishti si emër...*Atëherë shijova deri në fund shkoklimin e grumbullit...*(Ro.317).

U

Unë=ura e zjarrit... *o Shkodra plakë,e me unën e ndezun në dorën...*(Ro.125).

V

Vdeksor-mortor. Fjalori i vitit 2006 e ka në trajtën vdekjesor...Qemali edhe ai ishte pranë meje,në këtë burg vdeksor...(P.L.39).

Z

Zezuemet (të)=të zezat.Fjalori I 2006 nuk ka si emër...nana e të zezuemet motra..(Ro.2).

Zh

Zharitun (i) I djegur...*entuziazmin e një rinie të zharitun për heroizëm...*(Ro.275)

Filip Ndocaj

Autori Filip Ndocaj gjithnjë kërkon të përdorë në veprën e tij një leksik sa më të pasur që përveç fondit të përgjithshëm, të përfshijë edhe dialektalizma dhe krahinorizma, disa prej të cilave kanë hyrë edhe në fondin aktiv të gjuhës, ndërsa të tjera kanë një shtrirje të kufizuar territoriale. Leksiku është vjelë nga dy veprat “*Në sytë e rinisë*”(1961) dhe “*Vlaga e dheut*” (1968).

Agmia = dritë e lehtë...*kur ze çohet agmia që feskon mbi katund t’fjetun.* (SR. 60). E ka edhe B.Dema.

Amshi = amshim, përjetim *...jeta kur m’dukej amshi’...ulem tash heret n’agim...* (SR. 27).

Argjentore = i argjentë...*kur përmbi vesën argjentore bje të drandofillit...*(SR.20).

Ashti=kocka...*ata ishin ba bujq pa iu pjekë mirë ashti.*(V.1560)

B

Bardhoke = me qime të bardha...*kur më kujtoheshin bardhoket tona kullosave...*(V.62). E ka edhe M.Elezi.

Behi = erdhi pa pritë, pa kujtuar, befaz *...por ia behi Bardhi dhe u larguene...*(SR.43).

Binish = pallto e mirë...*ti shko pa frikë, shko pa binish mkatar!...* (SR.32).

Bisedar = kuvendar... *Tashti Pal Delia ishte ba një bisedar që me ta pasë anda ta ndigjoje...*(V.100). E ka edhe B.Dema.

Bukurezë = xixillonjë *...Jo për ndriçime bukureze në maj ...* (SR.32).

Buqari = bujk...*Kujtova se dikur do të pushojshe, porsì buqari në muzg të ditës...* (SR. 17)

Buzëthatë = buzëtharë...*për t’ja marra nderin nga inatise ai i la buzëthatë* (V.106)

C

Cegëm = acar *...dimnit që shkoi nëpër cegëm të dhetorit* (V.61). E ka M.Elezi.

Cok = shprehje pohimi, nuk pranon mohim...*s’jena me të lanë me shkue cok...*(V.24).

Cuckë = vashëzë...*mirë ke folë, goja të lumtë cucke...*(SR.46).

Cullakoj = zhvesh lakuriq...*se bijnë fletët e pemët e cullakueme ...*(SR.8). E ka edhe M.Elezi.

Cungoj = pres degët e një druri dhe lë trungun...*cungoje rremash e nesër shpërthen...*(V.30).E ka edhe N.Gazulli.

Ç

Çalltis = rropatëm, përpiqem...*Kush s’çalltis për lumtuninë e vet?!* (SR.45).

Çip = bisht, cep...*E mbasi n’atë çip t’malcisë* (SR.49).

Çobani =mjeshtria e çobanit...*nisja kangve t’çobanisë!*(SR.24).

E

Etshoj = i etur...*mashinkat e t’huejit etëshue për gjak !*(SR.7). E ka edhe “Bashkimi”.

F

Fanitet = përhihet...*të shikojnë, të faniten si hije e të afrohen...*(V.52). E ka “Bashkimi”.

Flaurí = fluturimthi...*duhia i merr flaurí...*(SR. 8).Eanë “Bashkimi”, N.Gazulli dhe M.Elezi.

G

Gacëllue = xixëlloj... *Marashi tue gacëllue sytë...* (V.74).

Galdim = **gëzim i madh, gazëllim...***i dukej se gjithë jeta ish valle e zjarrtë galdimi...* (SR.53). E ka edhe B.Dema.

Gdhej = **njeri i trashë...***lart n'atë qiell që del mes gdhëve...* (SR.27). E ka "Bashkimi".

Golle = **grupë, boshllëk, vrimë e madhe...***N'aq terr jeta për ju do kish prap golle...* (SR.60).

Gj

Gjakësi = **armiqësi midis dy familjeve...***me jetue me fitme e gjakësi...* (V.10).

Gjakhuptë = **gjakhupës...** *e kishin vra "me moh" dhe shkoi "gjak-huptë" si thuhej...* (V.51). E përdor Fishta. E ka M.Elezi.

H

Hajnisht = **hajdutërisht...***që kaq hajnisht të la!* (SR.18).

Hurba = **gëllenkë...***dhe nisi ta pinte me hurba...* (V.25).

K

Kafshore = **kafshatë buke...** *Dy miqtë që vëjshin veç për një kafshore...* (SR.91).

Kaploj = **pushtoj...***i mërzitun nga kjo lodhje e madhe që e kishte kaplue...* (V.17) .

Karmë = **mriz, rrëpirë...***n'ato karme rreshkë thasisë...* (SR.49).

Kërcelëj = **kanoset, kërcet...***që renkon llogoresh tue kërcëllye dhambët...* (SR.4).

Kobe = **mallkim ...** *ai mendjet i largon si kobe të harrueme...* (SR. 90).

Kotni = **kotësi, diçka pa vlerë...***kotninë kërkuen të gjoët e jeta mbrapa i la...* (SR.68).

Kukat = **vë kujë...** *Dilni e mos më kukatni kështu si qyqe...* (V.135).

L

Lazdroj = **përkëdhel ...***Si ke nisë me e lazdrue ti, ai s'ka me dalë gja...* (V.28). E ka N.Gazulli.

Luloj = **lulëzon...***nga deg't e pemve që lulojnë petalet bijnë...* (SR. 23).

M

Mahí = **shaka, tallje...***Po, more, s'â mahí me partinë tone...* (V.14).

Meroj = **tmerroj...***boll m'i merove këta bylbylat e mi!* (V.29). E ka M.Elezi.

N

Nusnore = **nuserisht, si për nuse ...***natyren krejt stolisë n' rroba nusnore...* (SR. 22).

O

Ofshama = **rënkim i thellë...***Ai nxori një ofshamë të thellë...* (V.75). E ka B.Dema.

Orëpreme = **orëprerë, fatkeq...***ato orëpreme dhish s'janë kah më shkojnë...* (V.73).

P

Pamort(i) = **i pavdekshëm...***gzo Atdhe, gzo se pranvera e pamort lulzon mbi ty!* (SR.95).

Përvidhem = **largohem nga një vend fshehurazi...***përvidhem nga sheshi n'terr mortise...* (SR. 79)

Pingron = **cicëron...***zani i saj pingron si zana* (SR.92). E ka "Bashkimi".

Plandos = **përplas ...***dersa i plandos m'ndoj vi..* (SR. 8). E ka M.Elezi.

Plima = **tufë, varg...***Shqiponja çeliku n'ajri me plima t'argjenta fluturojnë...* (SR. 77). E ka M.Elezi.

R

Rangë = **punët e përditshme të shtëpisë, detyra...***e mbyllën çikën në rangët e shtëpisë...* (V.105) .

Rr

Rrezim = **shkëlqim...***si ban rrezitja e parë e diellit.* (SR, 20).

Rropos = rrafshoj, përmbys...me një të luejtun qerpiku rropos qiell e dhë... (V.134).
E ka “Bashkimi”.

Sh

Shaterkaz = kazmë...që n'cep t'krahut ka vu një shaterkaz. (SR.84).E ka “Bashkimi”.

Shestoj = shestoj, përcajtoj...duhen shestue e mendue mirë e mirë... (V.46) .

T

Taravole = që ka karakter të fortë, që s'di ç'është frika... t'gjith azgane e taravola shkambin shpejt me e dërmue (SR.48). E ka “Bashkimi”.

Trova = thërmija të mëdha, trashë-...ku dashtnisë s parit iu trova..(SR.27).

Turrem = versulem...E atëherë Pjetri i ishte turrë atij... (V.10). E ka “Bashkimi”.

Tyt = largimi i qenve...Tyt, more teveqel....(V.32) .

V

Vashnore = vajzërore...ruej pra njomsinë vashnore der n'pleqni! (SR.32).

Vdeksore = mortore...Ti larg shtëpisë n'nji dhomë vdeksore... (SR. 18). E ka M.Elezi.

Vegim = agon, mezi e shquaj..si kujton ti nsa si n'vegim, n'pasqyrë... (SR.34). E ka N.Gazulli.

Vigmë = britmë...n'vigmen e jetës... (SR. 4).

Vlagë = lagështirë...Toka dalë vlagë... (V.151).

Vrik = shpejt e shpejt...sa ma parë, që vrik me çue skavatorë...(SR. 48).

Vrriet = kullotë dimërore ...këndojnë brigjet. edhe vrriet edhe ugaret nisin valet... (SR.95).

Z

Zulma = lavdi, famë...zulma mori detin... (SR. 77).

Zh

Zhegit = kam vapë, digjem nga zhegu...e mos me u zhegitë nëpër Tiranë... (V.130).

1.b. Leksema që i ndeshim në veprën e Arshi Pipës, Sami Repishtit, Filip Ndocajt, por jo në Fjalorin e gjuhës shqipes të vitit 2006

Arshi Pipa

A

Amsuem (i)= me erë e këndshme. Lshue flok't e gjatë t'amsuem qi u-mshehin gjinin... (L.65).Fjalori iGazullit dhe fjalori vitit 2006 nuk e kanë.

Aviset= shpellë e madhe (Dema)...tue krisun ndër gjiret e avisevet të nëndheshme... (L.F.121).

B

Banash= kasollë... m'sa hyjnë e dalin pa pushim prej banash e fmi e gra e plaka... (L.40).

Belzhdërvjellët=që është e zhdërvjellët, e shkathët...nji belzhdërvjellët gjatoshë si tue vallzue... (L.B.40).

Brymtë (i) = me brymë...Nandori i brymët qi shkretun natyren... (L.B.174).

Buluritje = pëllitje. Një buluritje kau, një lehje qeni...mandej asht heshtje e thellë. (L.41) Nuk e ndeshim në fjalorë me këtë trajtë, por bulurimë. Kështu e përdor Fishta dhe të tjerë. E t'udha gjama e ulurima vërrima , britma e bulurima . (Fishta, Lahuta...). E ka

edhe B.Dema *bulurimë, za, ushtimë*. Fjalori i vitit 2006 *bulurimë=pëllitje, buçimë dhe buluron*.

Bloror= i blertë, i gjelbërt ...do t'kem mbi krye t'përvajshme një konorë gemash e gjethsh Blororë... (L.10). E ndeshim edhe te Koliqi: *livadhe blerore*, e ka edhe M.Elezi.

Bungajë= pyll me një lloj lisi...Edhe hana e plotë qi mbi bungajë zditte...(R.54).

C

Cërlue-zog shtegtar... një zog i shkruem cërlue ambël çurlikoi si me lajmue... (R.51).

Ç

Çurlikoj=cicëroj...një zog i shkruem cërlue ambël çurlikoi si me lajmue... (R.51). E ka edhe Dema.

D

Danue=djall...vetëm ka, por është lugat, danueRrushin qukë...(R.83).

Diçkahi = diçka, asgjë...krijim prej diçkahi qi nuk kishte kuptim...(F.7-8,301).

Dnesë = me ngashërim...luftari nuk ka mujtë me qindrue ma: ka dnesë për herën e parë...(K.3, 118).

Drom=rrugë...turmën tue kundrue qi vinte dromit...(R.61). E ka edhe Dema.

F

Falisun(i) = i çmendur, jo në rregull. Do tjerë, m'shpotitën, m'quejtën fmi t'falisun.. (L.30).Në fjalorin e vitit 1954 – *i çmendur, i shkalluar*.

Fashë=qetësi... O natë! *E tash kurrjâ s'është mâ në fashë!* (L.43).

Ftisija= sëmundje... Ftisija e përgjumur për do kohë, kish nisë t'i çfaqej atëherë... (K.3, 112).

Fuli=një lloj ushqimi i ëmbël...kur fulinë përpara ke me e qitë...(R.64) . E ka edhe Dema, por me një kuptim tjetër.

G

Grathtë(i)= I ashpër, bajat...por diçka si e grathët dhe e shpërlame...(R.61).E ka edhe Dema, por me një kuptim tjetër.

Gj

Gjallnore = të gjalla ... E tillë ti je që kur sendet të tâna gjallnore binden ndër shkretina e râna...(L.F.129).

H

Hajme(e) = e zbetë, e dobët, delikat ... nga të zbetit e faqeve të hajme... (L.82), Gazulli –payndyrë.

Himtë(i)=ngjyrë hiri, të imta...i harlisin me lojna femnushat e himta hollake... (B.163).

K

Kaçulore= me kaçirubë...zogjt shemërtojnë, laureshat kaçulore...(B.175).

E ka edhe Dema

Kallë(me)= fus, djeg ...shpres'n e fundit n'dhe me e kallë! (L.50).

Kemtar=enë kishe...E kur kemtarin shkundi prendimi...(B.171). E ka edhe Dema.

Krajata= breng, hall, fatkeqësi... zdrypi trishtimi i t'errtave krajata.(L.14).

L

Lafit = luan mendsh...Asht pijaniku i lagjes...ka lafitun... (L.45).

M

Mataroj=rregulloj një punë sidomos shtëpiake...shpinë e prindvet me ta matarue...(R.14) **Mjak= goja prej ethesh të zë lëmashk...plasun buza e goja zânë me u**

mjakun ..(R.27)._Mjagulloj-vesh me mjegull... Me e pa qysh endej rreth kufomës tue mjagullue, tue qa...(B.160) Dema: mjegulloj. Edhe Fjalori i 1954 mjegulloj.

Nj

Njajëzue- njësuar. ... tue njajëzue Zotin me Natyrën... (F.7-8, 305).

M

Mrizoj = çoj bagëtinë në mriz... dergonte me mrizue grigjen bardhoshe...(L.57).

Mungulloj = mbin ... përmbi vorrin u- ndalova, mungullonte prej tij bari... (L.48).

N

Ndajnate= buzë mbrëmjes... Kur befas më rrëmbei ndajnate një ktheter... (L.38).

Ndëni = shtroj, zgjat, pushtoj... Pa zhurmë flatrat e randa i ndëni heshtija...L.14.

Ndryme (e)= e mbyllur , e fshehur ...i rrëjten andrat e ndryme nën lvore...(L.13).

Ngashërej=qaj me dënësë... përpara disa sqenave natyrore ngashërehej...(K.2,44).

Nguti= nxitim i madh... Ndoshta prej nguti nuk janë botue kto kangë ... (K.3.112).

Ngjyeme(e)= që i jep ngjyrë... bukën e përditshme të ngjyeme me gjak... (K.4,123).

Ninëz=bebe e synit...ma shuaj afshin e gjakut, ma fik dritën e ninëzavet, m'i qep

Nusore = të reja... Lule t'bardha qielli reshte/lule t'pastra nusore. (L.46).E ndeshim te disa autorë veriorë në trajtën nusere. Elezi=nusere=nuse e re. Pipa e ka nusore.

P

Pafajni = pafajësi...O pafanija e eme, ti kërkon me m'mbytë ngadalë!... (L.76) E ka Fishta. E jep edhe M.Elezi me këtë kuptim.

Pandishëm(i)= që nuk ndjehet... Njertzija asht si një mal, i pandishëm... (K.3,115).

Pavdarshëm(i)= i pandarshëm... Me pasë mësue mjetin e mënyrën e shprehjes: ky asht lavdi I Pavdarshëm i Faik Konicës....(K.2, 46).

Përdar=perhap, shpërndaj...Shpirt i kulluet qi dashamir përdaresh. ... (B.30).

Përfalem= përshëndetem ...një dallnyshë me t'kuqe 'i gushë e me vashen u përfal. (L.48).

Përunjim(të)= e poshtëroj ... kalorës të cilët të mprojnë të vegjëlit dhe të përunjin i një lloj lisi...Edhe hana e plotë qi mbi bungajë zdritte...(R.54). E ka edhe Bashkimi.

Pëga=fëlliq, ndyj...kah mbarë fisi ynë asht i pëgâmë...(R.74) .E ka edhe Bashkimi.

Përgjasohet = ngjan, krahasohet... Kurgjâ sa "Shqipëria si m'u duk" nuk përgjasohet me "Reisebilder".(K.2,45).

Përgjim = vëzhgim... E nëse një ânkth i vijueshëm e mban në përgjim , një djenjë e thellë e gëzueshme...(L.F. 97).

Plir= përgjak, shkriftoj...Nepër inde pandeha se u plira... (L.F.110).

Poní= respekt... Kujtojmë me poní e adhurim datat e të mëdhejve ...(B.R.5, 51).

R

Ravgim = endje...Mandej ravgimet:hija mbi Gjenevë e Servetit...(L.B.185).

Pluhnizë=pluhur i imtë...me pluhnizë kuqloshe mbas rrebeshi....(R.59). E ka edhe Dema.

Rimtë (i)= i zyrtë...e u mbush me jone qielli i rimtë i frorit...(L:B.179).

P

Patënzonë=i pashpirt, zemërgur...Mëshira e tyne, ahmarrje e patënzonë...(B.183). E ka edhe Dema.

Plir= përgjak...njena plir me gjak, tjetra zharitë.(R.76). E ka edhe Dema.

Prâj = pusho...Tash flejë e pusho. Ke nevojë të prâhesh n'errinat...(L.F.110).

R

Rishmë (i)= I tashëm...*Hanë e rishme te qielli i lamë i muzgut...*(L.B.177).

karriname=naze...*tundin bishtin e gjatë me skarrinane...*(L.B.175). E ka Gazulli.

S

Skutuliq=skutë e vogël...*ktheu si qe ma parë e u skutuliq tines...*(R.67). E ka edhe Dema.

Sh

Shkardh = asgjë...*Të bën shkardh, servil...* (B.R.3, 37).

Shklas = shkel...*qi çdo kambë mund ta shklasë...*(K.4, 129).

Shkrryjej =bëhem pis...*nisi me u-ligë e s'donte ushqim, shkrryjej te dheu...*(L.B.161).

Shtërheret=vend që nuk e rreh era...*kishin çelë mbas murit mbanë shtërheret...*(L.B.180)

Shullâ= vend që e rreh dielli...*elb shullâni e krunde me tërshanë...*(R.13). E ka edhe fjalori i "Bashkimit".

T

Trepetisë=zhduk, tret, ...e sikur n'andërr trepetisë për pak... (L.B.177).

V

Vdirë (e) = e përdalur, e vuajtur ...mërgova edhe un, grua e vdirë nga hyjneshë u bâme lavirë. (L. F.123).

Vrrî=vend ku fshatarët dimërojnë bagëtitë...*Bjeshkë e vrrî kërkova, mal e fushë...*(R.9).

Z

Zdërhall= "lodrojnë" ...ndërsa çimërr e morra brufullojnë e zdërhallen mbi mue pa dhimë...(L.B.162)... E ka edhe Gazulli në kuptimin me kalue kohen me gosti e qejfe.

Zh

Zharit=djeg, përcëllon...*kur dielli i mesditës zharitë...* (L.B.47).

Zhgalë = lodh...*që digjet tue u zhgalë...* (L.B.31).

Zhvillatë=zhvilloj...*kët lâmsh t 'ngatrruem un tue zhvillatë fillin...*(R.23).

Sami Repishti

B

Bojëzim—me ngjyra ... shikova ujin që ndryshoi ngjyrën e rrethet e bojëzimit që zgjanoheshin... (Ro.243).

Bram-bramin tingullim, riprodhim zhurme... *nuk ndigjoj veçse ...bram-bramin e dyerve të randa...*(Ro.156).

Ç

Çapërtis= egërsoj... *ajo ishte çapërtisë nga egërsia e frymës...*(Ro.114).

K

Kocani – cjan i zi... *ngrimë si kocani me krahët rreth e rrotull vetes.* (P.L..31).

F

Feksjet – rrezet e para të agimit... *rreshtoheshim para kazanit të çajit dhe pritshim feksjet e para ta ditës...*(P.L 82).

L

Lamije-lëmë ... me ardhjen e stinës së verës, në lamije...(Ro. 119).

M

Mvesh- ngjesh ... *hedhja e trakteve iu mvesh një grupi tjetër...*(Ro.118).

Mbarsun (i)- I mbushur... *kisha të baj në një hetuesi të mbarsun me mundësitë ...*(Ro.142), si mbiemër nuk e ka Fjalori i vitit 2006.

Mbasbuke- pas buke... *në mbasbuken e asaj mbramje ishin helmue...*(P.L).7.

Muçatun- me u prish në fytyrë...*shifshim fytyrat e muçatuna të të rinjve...*(Ro.219).

N

Ngulmënisht -këmbëngulje...*kishte hedhë bazat e një vetëbesimi të rranjosun ngulmënisht në mendjen e tyre...*(R.221).

Ngurrzoj- ngurtsoj... *mumje të ngurrzue me trashëgje nga një e kalueme...*(P.L.148).

P

Pafajni- pafajësi...*kryenalt shenjt pafajnie për ma shumë se shtatëdhjetë vjet...*(Ro.166).

Pambyllshëm (i)- i përfunduar... *hendeku i hapur.... ishte tashma i pambyllshëm...*(Ro.77).

Pa-shpirtësi (të)- zemërgur... *heshtja e dy viktimave të pa-shpirtësisë...*(Ro.287).

Parapa-parashikoj...*demonstrata po zhvillohej ashtu si nuk ishte parapa...*(Ro.36).

Paravdekjes (të)... *në gramat e thella të paravdekjes ...*(P.L.108).

Pikësoj-ndaloj...*Mehmeti pikësonte shpesh tregimin me dënësia...*(P.L.75).

Sh

Shkimje = shuarje... *nga frika e shkimjes së familjes...*(P.L.73). E ka B.Dema me kuptimin fik dritën.

Shporuem (i) I shpuar nga plumba, I shpartalluar etj- ...*mbi tri kufoma e shporueme prej pumbave...*(P.L.27).

T

Tej-tokësor... e shtypja që ushtrohej...*ishte tej-tokësore...*(Ro.208).

U

Uja-urija...*më grinte barku nga uja e më mardhej trupi...*(P.L.132).

V

Vdeksor- të vdekjes... *në këtë burg vdeksor...*(P.L. 39).

Vishkëmë- fishkem...*Ndihej ma mire, por faqet e kuqe kishin fillue me u veshkë...*(P.L.68).

Zh

Zharitës-137 –përcëllues, djegës...*do të krijonte rreth meje një shkreti zharitëse..*(P.L..137).

Filip Ndocaj

A

Anaku = guri anësor i oxhakut... *koka e tij mbështetej në anakun e maj të të oxhakut..*(V.17). E ka Elezi.

Avizore = humnera...*se nis n'teposhtë rrokollesh avizore.* (SR.32).

B

Berbjekthë = fëmijë të vegjël...*por gjithë këta berbjekthë duen bukë e ushqim me u*

rritë...(V.69)

Bezerë = **gjigant, përbindësh skavatorë e buldozerë, për me e nisë pendën...bezerë!**

Brazni = **boshllëk...mbi kep të majës së zbulueme shastisen sytë n'pamatuni brazniet.** (SR. 86).

Bun = **banesë njëkatëshe me gur... Ma vonë ai ndertoi bun si ai që kemi sot në bjeshkë...** (V. 124). E ka N.Gazulli.

C

Calina = **pushkë të vogla, pisqolla...mbante një depo armësh: dy kobure, dy tri calina...**(V.22).

Cemtë(i) = **i kulluar...Po lumi... ishte ba si ujët e burimeve, i cemtë si zakonisht...**(V.204).

Cergat = **qilim, punuar me lesh dhije...ujdisi postiqet e cergat që mbulojshin ...anët e dhomës...** (V.24).

Cukatë = **me e prekë me sqep...ajo po i largonte pulat që vjedhtas vinin me cukatë kokrrat...**(V.26).

Cytë = **ngacmoj... tri orë rrugë mali larg nga friga cytë!...** (SR.59).

Ç

Çurma = **ushtri kusarësh deti...tufane, dallgë e çurma n'luftë prallore...** (SR. 87).

D

Daj = **gjithmonë, vazhdimisht...pat qenë msue ta ketë daj ngiet...** (SR. 41).

Dalldis = **shastisem pas diçkaje , shpërthen...e atë bylbyl që kangësh ka dalldisë mbi krena t'njerzve ...**(SR. 79). E ka "Bashkimi".

Drau = **zhul, ...do të pastroheshim nga ai drau shekullor I zakoneve...** (V.235).

F

Falanikët = **argat pa pagesë...Kishin ardhun falanikët e vargu i shataxhinjve...**(V.73). E ka N.Gazulli.

Fang = **shesh...e tok me ta u nis për te fangu i çardakut...**(V.29).

Fejtë = **Këndej? ...kanë dalë n'mal me luftue e fejtë ma s'janë tue ra...** (SR. 12).

Fekson = **agon, shkëlqen...kur ze çohet agmia që fekson mbi katund t'fjetun...** (SR. 60).

Ferk = **sapo ka dalë drita, agon...ndriste syni i etun si shejzat n'atë ferk drite...**SR. 60).

Fjugë = **furi, vrull pune...do rrëxojshin shkamb e gurë me atë fjugë të plot zhumhurë...**(SR. 47).

Flegrue = **drite kishte pre hollë...Leka kishte flegrue një vandak pishash.** (V.187).

E ka N.Gazulli.

Fluret = **fluturon? ...lart edhe ma lart po fluret si sputnik...** (SR.55).

G

Gujë = **lloj gune...Kishte veshë një gujë të zezë, të shkurtën si gujë çobaneshash...**(V.223).

H

Hjekakeq = **ai që heq keq... Jena msue hjekakeqë ne por hapni sytë...** (V.11). E ka N.Gazulli.

Hutrojë = **e humbur...bash si plakë hutrojë na u duk ...**(V.271). E ka "Bashkimi".

K

Kah = **këtu...Po ti, çka orën e ligë lyp kah nalt, Zogë...** (V.23).

Kajitja = **gajasje...Fill mbas kësaj u ndigjue kajitja gazmore...** (V.34).

Kalinë = kone, këlysh qeni...*duket se ungron kobshëm një kalinë e mërdhime...* (SR. 3).

Kaltërsiplote = plotësisht e kaltër...*ajo ditë kaltërsiplote...*(V.207)

Kersh = shkëmb...*Janë bij t'atyneve, robnisë që kurr nuk iu përkulën ndër ato kersha e ju...*(SR.91)

Kërthnesë = gjithë gjelbërim e degëzim të dendur.. *t'jesh e kërthnestë që stuhive...* (SR.30). E ka Gazulli.

Kohanike = moshatare... *shoqet e mia që i kam kohanike s'po ma venë veshin.*(V.247). E ka "Bashkimi".

Kokola = misra të vegjël...*me gështeja e copa patatesh e me kokola misri e me çmos...*(V.181).

Kotnishë = Kotsisë?*... largou kotnishë nën hijen e ndo'i tande!*... (SR.31).

Kushdohi = kushdo ... *se edhe bujku e kushdohi duhet të marrë vesh...*(V.128)

L

Lmek = t'u shua? *Por jeta që aq fort ti e dojshe, befas t'u lmek...* (SR.17). E ka "Bashkimi".

Lumnoj = lumturoj...*larg familjes e larg fisit s'ka si lumnon malësori...* (V.38).

Lupanar = njeriu që frekuenton vendet e padëshirueme keq... *lupanar ku knaqen epshet që t'lanë neveri...* (SR.32).

Ll

Llomajë = llomishtë... *zhagitet hapi i saj krejt pa kujdes mje për llomajë...*(SR.16).

M

Maçukaj = shprehje ledhatuese për,fëmijë, buçko,...*Anima , maçukajt e mi as në oborr ...nuk duan me ju lane...*(V.31)

Mertuku (sh') = namë për shaka...*Mbyllnie gojën he ua mbylltë sh'mertuku...* (V.18).

Motnuem(i) = i vjetër. *Përdoret si përcaktor i emrave të frymorëve, por edhe i sendeve*

Konkrete:.. Plak i motnuem, ai s'asht ma i zoti për punë....(V.16)

Ç'janë ata dy si lisa të motnuem...(SR. 39).

Mungulloj = terratis... *bri tij filizat zanë me mungulluem...* (SR. 67). E ka N.Gazulli.

Murtar = murator...*arqitekt t'ri me bashkfishatarë murtarë kah gjithë ndërtojnë...*(SR.89).

Murrtinë = errësirë muzgu...*me dalë murrtinave të mbramjes për me shfrye dufet ...* (SR.14).

N

Nënrasha = peripeci...*kur të jesh i zoti I punës s'i mërzitesh nënrashave të jetës...* (V.36)

P

Paana (të) = të mbathura ...*S'ka një javë që ja preva të reja këmishë e të paana...*(V.31)

Përqyrran = qyrravec...*ju...me i kthye fjalën shpijakut tuej, ju përqyrranat e orës së ligë!*... (V.65).

Pijanik = pijanec...*Pjetri nuk ishte i dhanë , bile i kishte inat pijanikët...* (V.88).

Poravas = banor të lagjes Porav- *Këta poravas nuk dolën haptas kundër Pjetër Ukës...* (V.10)

Poteraxhi = zhurmaxhi, shamatar... *Më në fund u ndigjue zani i....që u gërmushej poteraxhinjve...* (V.18).

Praksoj = **trembem, nuk më zë vendi...***Grigjen tande ku e paske qitë, se mue krejt për besë m'u ka praksue...* (SR.44).

Priftimi = **verdhëza...***Uh, daltë dreqi e ju shiloftë si më jeni ba bash si me pasë priftimin!...*(V.152).

Prishje = **grënia e parë e malësorëve...***s'po di me u ulë këtu me ne për prishje...* (V.68).

Prrallet = **defrehet...***Paj asht kah prrallet me Masjanin e vogël...* (V.69).

R

Rajçuer = **banor I Rajçës...***s'mbet rajçuer pa e vu në tallje...* (V.201)

Roga = **suka mali...***ishte rritë bareshë, tue kullotë grigjen e vet rogave të Strames...* (V.18). E ka N.Gazulli.

Rr

Rrebe = **trill, teke...***shko, Pan, e mos qit rrebe ma knell, ma josh n'vallzime! ...*(SR.10)

Rrgalle = **tokë që i ka ikur dheu nga eruzioni...***shumica e tokëve të kësaj malësie qenë tue u ba rrgalle e rmore mali...*(V.43).

Rrmore = **tokë e shkarë...***ishin rrokullisë si bien ata gurët e rrmores së malit, pa i shtye kush...*(V.178).

Rrozbitë = **shkallim...***Aq qe rrozbitë kësaj herës së fundit, sa ishin dy mendjesh...*(V.36).

Rrufçoj = **tërheq barin me dhëmbë...***Lopët ishin shpërnda bregut tue rrufçue tufa bari...* (V.206).

S

Sallahan = **sorollatem...***por endem sallahan edhe këto ditë...* (V.111).

Sogje = **rojë ...***që na shoqnojnë gjatë gjithë jetës...që na rrinë sogje katundeve tona!...*(V.130).

Sutë = **vajzë e urtë, drenushë...***O Pan pse lshohe sutave ndër pyje pa diell...*(SR.10). E ka "Bashkimi".

Sh

Shkrryey = **zhigat...***plaka e re nuk bahet sado që të lyhet e të shkrryhet...*(V.36).

Shmarrabe = **betim tallje...***Pasha të shmarrabenë, o ti plaku i Nik-Buqajve...*(V.28).

Shpijanik = **I zoti I shtëpisë...***fundi ai ishte shpijaniku Nik Buqajve...*(V.16)

T

Tehri = **shirit...***dukej që andej si një tehri argjendi që thurte fundin e një xhublete...*(V.219). E ka "Bashkimi".

Torishta = **vath...***gjithë kohën e kalonin ndër stane, e sidomos pse torishtat e bagëtive...* (V.254).

Trosha(të) = **thërmim...***barku i tij ja kishte nisë të troshavet bash si ajo stena e motnueme.* (V.65).

Trille = **cicërima të ndryshme...***kangës ja nis bylbyli n'trille shkrue.* (SR.78)

Trupoj = **Kalon rrugë pa rrugë...***morën autobusin për në Korçë, por trupuen mal në mal...* (V. 241). E ka "Bashkimi".

Tutët = **frika...***Qysh lyp besë burri tutësh të njaj baxhie plakë...*(V.28).

U

Unë = **urë zjarri...***Ashtu të pagojë, si unë e zezë që ka rrëshqitë nga stave e druve...*(V.190).

Unji = **tërësisht...** *Shiko: ia gjasojnë kokës sate ba tullac unji!...* (SR. 8).

V

Valige = tokë me lagështirë...*Toka mund të jetë valige sa të thuesh e rrasfshi bash si tepsi ..* (V.44).

Valloi = **I rrethoi rreth e qark**...*çeli tokë buke e livadhe, e valoi me ledhe, i muranat...*(V.124).

Vilagë = **llastar**...*filiza e filiza të njomë , vilagë që ngjien llastar kah qielli...* (V.25). E ka "Bashkimi".

Vrugue = **i nximë nga mendimet**...*Nuk kuptoj ç'mendojnë kështu fytyrë -vrugue!*... (SR.79).

Z

Zanamare = **nga zamare vegël muzikore**...*se pa ty, moj zanamare nuk m'josh jeta si dëshroj*...(SR.27).

Zguer = **bosh, zgavër lisi**...*Rrfeja kur bjen mbi trungun e vjetruem e zguer i zi ai mbetet...* (SR. 67).

Zyl-hava = **këngë e kënduar më zërin më të lartë**...*e dëgjon dhe kështu nis zyl-hava...*(SR.94).

Zh

Zhagit = **zvarit**... - zhagitet hapi i saj krejt pa kujdes mje për llomajë... (SR.16). E ka B.Dema.

Zhagmitë = **hiqem zvarë**... *ishin rritë kot, zhagmitë periferishë* (SR,72).

Zhgote = **e kontrollonte me kujdes**...*Bardhi punën pa fillue, mjetin zhgote e furnizonte...* (SR. 52).

Zhgjeton = **shigjeton** ...*E gjaku që vërshon e mnia që zhgjeton në shekullin tonë*...(SR 80).

1.c.Disa krijime të A.Pipës (Neologjizma), S. Repishtit, F. Ndocaj ose krijime popullore

Arshi Pipa

Autori ka bërë përpjekje për të krijuar fjalë të reja, për të cilat, me sa kemi vëzhguar, nuk i kemi ndeshur më parë. Mendoj se janë krijime të Arshi Pipës.

A

Arnautishte (arnaut+ishte)...*me vue në satire mbeturinat anadollake arnautishte, e largoi Konicën nga ...*(K.2,45).

Artistizoj (artist+izo(j)) ... *tue bâ jeten e tyne poezi, tue e artistizue...* (K.2,43).

B

Belzhdërvjelltë = **me bel të zhdërvjelltë, e shkathët**... *Por një infermjere qi kalon, një belzhdërvjelltë gjatoshe...*(L:B.40).

F

Fatshkretue= **pa fat**...*mue fatzezën tande motër fatshkretue...*(L.B.21)

Flokshatorr=flokë të gjata që bien mbi supa...*Kishte çka me drashtë e pse me qa: vetullan e flokshatorr shpërndá...*(R.9).

K

Krahshpërvjelun=me krah të shpërvjelur...*e ndër vneshtat mbi shpat krahshpërvjeluna vasha faqe kuqe...*(L.B.165)

Kundërvendosun(të) (kundër+të vendosur) = të vendosur kundër ...*mund të jetë te artist dy anë të ndryshme të kundravendosuna...* (K.2, 42).

L

Larkjehues= **që jehon nga larg**...*Zakonisht e mbyti tingulli i ashpër e larkjehues i satires...* (K.2,440).

Lundërthyemi=**shprehje**...*si anija qi vjen për lundërthyemin...* (L.B.45).

M

Migjenike= të Migjenit .../ *që sajonnë lumin e poezis migjenike...*(B.R.3, 34).

Mustaqe-shllungë=**mustaqe si shllungë**...*nuk e due për burr un at hundlesh...mustaqe – shllungë deri në vesh...*(R.63).

P

Pupla-shkruem- (kompozitë: emër + mbiemër foljor)...*me folena zogjsh pupla-shkruem...*(L.81).

Sh

Shpirti-pëllumb-(kompozitë: emër +emër)...*Edhe shpirti-pëllumb asht plagosun...* (K.3, 120).

Shpirti-shqyponjë(kompozitë: emër +emër)...*Shpirti-shqyponjë i ka njimend krahët e thyem...* (K.3,120).

Th

Thoj-këputuna (kompozitë: emër +mbiemër)...*me sodën e enëve , ju duer thoj-këputuna...* (L.F.135).

Vetullshlligë= **gjarpnushë**... Lena, ajo me ustënin në dorë qi i thirri vetullshlligë...(R.61).

Sami Repishti

Një dukuri e autorit S.Repishti është përdorimi dhe krijimi fjalëve të përbëra kryesisht kur gjymtyra e parë është emri **gjysmë**, që i shkruan me një vizë, por edhe së bashku. Disa formime nuk janë të drejta.

B

Bashkëvendasi...*që nuk ishte tjetër, veçse bashkëvendasi...*(Ro.337).

Bashkëkonspirator...*nata ishte bashkëkonspiratore...* (Ro.210).

F

Farmacisti-infermier...*Farmacisti-infermier që kujdesej...*(Ro.179).

Fatmjerë ...*ky legion fatmjerësh...*(Ro.267).

G

Grykmadh ...*e të imponueme nga Olimpi grykmadh ...*(Ro.120).

Gj

Gjithëpushtues...*të kapun në rrjetin gjithëpushtues...* (Ro. 277)

Gjysëmditore *të lodhun nga pagesat gjysëmditore që jepeshin për çdo ditë shiu...*(Ro. 311).

Gjysëm-errësinën...*Në gjysëm-errësinën e oborrit dallova...*(P.L. 72).

Gjysëm-fëminore...*dallova menjëherë një buzëqeshje gjysëm-fëminore...*(P.L. 134).

Gjysëm-hije... *me i shkepë sytë nga kjo gjysëm-hije që flitte në errësinën...*(P.L.116).

Gjysëmilegale...*kishte kalue një jetë gjysëmilegale...*(Ro. 79).

Gjysëm-kufomat *...me premtimin se të nesërmen, na gjysëm-kufomat e urituna...*(P.L.66).

Gjysëmterrën...*lëvizin në gjysëmterrën e banesës sonë...*(P.L.109).

Gjysëmhyjnuer...*e mveshej me kuptimin gjysëmhyjnuer që u japin herojve legjendarë...*
(Ro, 97).

K

Kuvendi-burg *...jashtë në oborin e kuvendit-burg...*(Ro.163).

M

Malsori-babë...*zbret malsori-babë në qytet...*(P.L.123).

Nj

Njeriun-polic...*që zhvishte njeriun-polic nga gjithçka...*(Ro.186).

Njeriun-vlla *...nuk hynte drita e dashunisë për njeriun-vlla ...*(Ro.237).

P

Padronit-pushtet...*e padronit-pushtet që mbante dhunën si të vetmin mjet...*(Ro.247).

Q

Qellim-mira...*përpjkeje qëllim-mira dhe të guximshme...*(Ro.103).

S

Spitali-burg...*kishte largue të gjithë të borgosurit nga spitali-burg...*(P.L.45).

V

Vetëdeklaruem (i) *...nji zot I vetëdeklaruem...* (Ro. 271)

Vetëshkatërrim...*me u hedhë në të pakufishmen, si maniakët e vrapit të vetëshkatërrimit...*(Ro.111).

Viktimë-xhelat...*ballafaqimi i përhershëm viktimë-xhelat përmbante...*(Ro.119).

Vllaut-njeri...*mendon e dëshiron praninë e vllaut-njeri...*(Ro.238).

Voglushi-vlla...*e të thame nga e keqja e mosha, voglushi-vlla tronditej...* (P.L.131).

Filip Ndocaj

Është vështirë të përcaktohet disa krijime a janë të Filip Ndocajt apo krijime popullore. Në fillim të krijimtarisë së autorit, pa pasur përvojën e duhur si shkrimtar vërehen krijimi i disa fjalëve të përbërë që nuk i ndeshim në autorë të tjerë dhe as në krijime popullore. Një dukuri e tillë më këto përmasa bie në veprat e mëvonshme.

Po shënojmë ato fjalë që mendojmë se janë krijime të F.Ndocajt:

F

Flamore =flamur *...si lufta pa zhaurima, pa vigma e pa flamore...* (SR. 5).

Gj

Gjelberoshe=të gjelbërta...*po I ktheheshin në ara gjelbëroshe...*(V. 165).

K

Kafshore=kafshatë ...Dy miqtë që vëjshin veç për një kafshore...(SR, 91).

Kohanik=moshatare...shoqet e mia që i kam kohanike...(V. 247).

L

Lumnon= të jetë i lumtur...se larg...familjes...s'ka si lumnonm malësori...(V. 38).

M

Mendtar= njeri i zgjuar....Fjalë me vend po thue, o Lulash Preka, fjalë mendtari...(V.41)

Meroj= tmerroj....O Zogë...se boll m'I merove klëta bylbylat e mi!...(V. 29).

Murtar =murator...me bashkfshatarë murtarë kah gjith ndërtojnë...(SR. 89).

N

Nusnore=veshje të nuseve... krejt stolisë n'rroba nusnore... (SR. 22).

P

Pijanik= pijanec...Pjetri nuk ishte i dhanë pas pijes, bile i kishte inat pijanikët...(V., 88). Pishare=pishtar... t'bahen pishare n'ballë t'jetës t'ndriçojnë... (SR. 7).

V

Valloi= I rrethoi rreth e qark...çeli tokë buke e livadhe e valloi me ledhe...(V. 124).

Virgjinta= të virgjërta, të pastra... o qenje të virgjinta...(SR. 60). “

Z

Zjarrmori= nxehet shpejt, fig. merr zjarr, nxehesh “ Bile Lulashit... që ishte ma zjarrmori i të katërve... (V.34).

1.c. Fjalë të huaja në leksikun e veprës së A. Pipës, S.Repshitit dhe F.Ndocajt

Arshi Pipa

A

Affluentit=-i begatë, degë lumi (ital) ...tash si një lum i ushqyem prej afluentash të ndryshëm...(L.F.98).

Ajmë= Oh, mjerisht , për fat të keq (ital), (K.4,126) Politikë humanisti ajmë!

E

Elementaritet=thjeshtoj (ital.)...na çojnë gjithherë në një elementaritet primitiv të dheshëm...(K.4, 121).

Emotive= i prekshëm, shumë i ndjeshëm (ital.), Historiani i aftë do të çmojë pra veçanrisht pjesën emotive dhe do të mundohet të kapi ado fije themelore ... (K.4,122).

G

Grazhda=stallë (sllav.), Blegrojnë e dhen e dhi ndër grazhda kcejnë kingjat...(L.40).

Grigjë=tufë dhensh(latin.)

Gj

Gjergjef-i= një kornizë ku qendiset në pëlhurë.(turq.). E ka edhe “Bashkimi”.

H

Huj-i = ves, inade (turq). A mujte me i shkrue një njeri me kto huje?... (K.2,42).

P

Pezëm=acarim pezmatim (sllav). Atëherë në vend qi të ligshtohet, ka marrë pezëm e ka qitun kushtrimin...(K.3,120).

Prozhme= pyll i vogël (sllav), ... *kur binte nata ndër prozhme e ndër e n'çerdhen teme...* (L.37).

Patalok=shesh(sllav).

Piskatë=bërtas (sllav.)...*Çka? Piskati djali si ta ça 'te për midis dikush...* (R.48).

S

Salvoj= ndjek, përsekutoj (ital.) ... *idealet e tija tallen e salvohen...* (B.R.3,41).

Shqot=stuhi (sllav)....*uli vasha kryet me sy për tokë, shqotën qi shpertheu...* (R.45).

Shandan=-mbajtëse qirinjsh(turq). ...*aj ka me u-frue me dritën e kaltër të një shandani* (K.1,3).

Tisi=vel, cipë e hollë (sllav.)...*Veç at'herë iu shkye djaloshit tisi...*(R.46).

Uzdajë= shpresë (sllav.) *N 'zemër uzdaja lén n 'kët gaz pranvere e buzët pëshpërisin : dashuni!*...(L.39).

Veriga=pranga (sllav.) ...*janë liri qi u shpëton verigavet të vijavet të përpikta...* (F.6,301).

Nga kjo analizë e leksikut të veprës së A. Pipës, vëmë re se ka një fjalor relativisht të pasur. Janë shumë fjalë të leksikut autokton dhe jo ma pak dialektizma e krahinorizmave. Analiza që mund t'i bëhet leksikut të veprës së plotë të A. Pipës do të na çojë në rezultate më të sakta.

Sami Repishti

B

Bastisje-hyrje me force në nj shtëpi (turq) . *Nji mesnatë , nji bastisje e papritur e shtëpisë...*(P.L. 9)

Bela=punë që sjell ngatërresa, turq....*s 'na duheshin gja , veçse për bela...*(P.L.118).

Ç

Çardak- pjesë e hapur ku zakonisht priten miq në verë...*të vendosej pranë çardakut të hapun...*(P.L.28).

J

Jatak=-krevat (turq.)...*shtriheshin...mbi disa crrule ë vjetra...që kishin si jatak që vetëm na I quejshim shtratI ...*(P.L 83).

K

Kasaphanë-thertore turq...*ishte nji kasaphanë e dytë...* (Ro.47).

Kasnec –lajmëtar (sll.). *Nji kasnec bërtitte...* (P.L.22). E ka Dema.

Ll

Llom-lym , fundërinë (sll.)...*ishte nji llom I shoqnisë ...*(P.L.82)

O

Ogurzi –fatzi(ogur turq)...*e shikojshim sheshin ogurzi me nji farë shqetësimi...*(Ro.21)

Q

Qorrsokak –rruge pa rruge...*do të shpinte në nji qorrsakak të rrezikshëm...*(Ro.67).

S

Sakatoj (sakat+o) I gjymtë...*edhe me trupat e sakatuem për jetë...* (P.L.18).

Fjalë neolatine

D

Devocion= gatishmëri për të bërë gjithçka për të bashkoljshe me ta dëshirën e devocionin e përbashkët...(Ro.149)

H

Humanitet= njerëzillëk ...*kishin humbë humanitetin e tyre*...(Ro.160).

I

Infiltroj = futem, hyj ...*që ishin infiltrue në Lëvizjen Nacional-Çlirimtare*... (Ro.89).

K

Kompromentoj=njollos emrin e mirë të dikujt, e prishi moralisht...*bante përpjekje mbinjerëzore me i kompromentue*... (Ro.142).

M

Monstruoze = të çuditshme,të shëmtur, të përbindshme...*me e kuptue këtë krijesë monstruoze*...R.151

S

Sublime=I madhërishëm, fisnik, shumë I lartë... *këto caste sublime të ndërgjegjësimit*...(Ro.194).

Filip Ndocaj

Duke qenë se subjekti i krijimeve të F.Ndocaj është marrë nga jeta fshatarëve në veri të Shqipërisë, verehet edhe një ndikim e leksikut të atyre anëve dhe përdorimi i fjalëve të huaja , kryesisht të turqizimave, pasi i përkasin ligjërit të folur, siç do të shihet më poshtë.

A

Amanetqar = e kryen porosinë (ballkanizëm)...*Jam amanetqar I mallit të shetit*... (V.84).

B

Baxhi = plakë, amvise (Orientalizëm)...*qysh lyp besë burri tutësh të njaj baxhie plakë* ... (V.28).

Bidat = shpikje(turq)... *S'ke si qet bidat të ri në katund të vjetër*... (V,14).

Ç

Çajre = mënyrë, mjet(turq)...*po na mbulojnë mizat e s'i gjejma çarje vetes!*...(V.29).

D

Dallash = ters, i keqkupton, gabim (turq.)...*megjithëse nisej nga interesi...gjithkund nuk e kishte dallash!*... (V.210).

G

Gavadare = çobaneshë(sllav)...*o moj çika gavadare*... (SR.25).

L

Log = shesh(sllav.)...*Log pune asht, rrugë nderi e shteg i brishtë...* (SR. 34). E ka N.Gazulli.

F

Frengji = **Vrimë të hapura nëpër bedena**(turq.)...*e mbaj mend , s'ishte porse frengjia same nxjerrë jashtë tytat e pushkëve...*(V.125).

G

Grazhd = **vend në stallë ku i hidhet ushqimi bagëtives**(sllav.)...*ma japin gja me I shujtue e as grazhdin me ua ndrurrue...*(V.25).

Gj

Gjytrim = **I gjymtua, ulok**(turq.)... *se edhe gjymtrimit jeta i duket e kandshme...* (V .23).

H

Hoka = **shaka** (turq.)...*nuk I pëlqente ajo pritja gjithë buzëqeshje dhe hoka...*

Hise = **pjesë** (turq.)...*prandaj edhe ju ka pasë në hise parësia juve. ..*(V.11).

Hasmi = **armiku** (turq.)... *pasha sytë e tu, rini, hasmit kurr s'ja ndajmë poterën..* (SR.94).

I

Ispatë = **dëshmitar** (turq.) ...*se nata s'ka ispatë e ajo si e ka bojën, ka edhe nafakën...*(V.82).

K

Kapaklia = **pushkë e hershme** (turq.)...*mandej te huta e te kapaklia, te calina e rrakelja! ...*(V.162).

M

Mahi = **shaka tallje** (turq.). *Po more, s'â mahi me partinë tone, se çka tha e ban...*(V.14).

P

Pojatë = **shtëpi banimi verore në kollotat** (sllav.)...*vazhdojnë të jetojnë në ato pojjat stëgjyshore...*(V.13).

Poteraxhi = **zhurmexhi, shamator** (sllav.)...*që u gërmushej poterexhinje...*(V.18).

Prozhmë = **pyll I vogël** (sllav.) *Zogë Maxhunia zbriti kah prozhmi për një krah dega të njjoma.*(V.29)

R

Rixha = **lutje** (turq.)... *thaju, mbushu gjelbërime kndo me mue, të kam rixha...* (SR.93).

Rudë = **racë delesh me lesh të butë e të shkurtër** (sllav)...*me grigje ruda do e kish çue në malci...*(SR.85).

S

Sabah = **mëngjes** (turq.)...*se sot nadje shkuen për dru pa ba ferk sabahu e besa do të jenë këputë...*(V.29)

Sojnike = **e fisme**.(turq.) *Moj Margjelë, mori sojnike çika e malcisë kreshnike...*(SR.24).

Stom = **bregore, ledh** (sllav.)...*çka m'ke ndejë, çikë, n'atë stom are...*(SR.24).

Sputnik = **satelit** (rus.)...*lart e ma lart po floret si sputnik...*(SR.55).

T

Teveqel = **mendjelehtë, budalla** (ballkanizëm). *Mos u vë veshin fjalëve të teveqelave...*(V.11).

U

Uzdajë = **shpresë** (turq.) *Kam uzdajë se po , shko e thuej gjyshes Rutë të vijë!* (V.138).

Përmbyllje e kreut të dytë

Leksiku i tre autorëve të përfshirë në doktoratë ka secili veçoritë e veta, pasi kanë shkruar e botuar në kohë të ndryshme, por edhe mjedisi ku ata kanë jetuar ka ndikuar në individualitetin e tyre.

Vepra e këtyre autorëve dallohet në dy aspekte:

e para, me të vërtetë shkruajnë në gegërisht, por duke qenë intelektualë të mirëfilltë, kanë ditur të zgjedhin leksikun në veprën e tyre;

e dyta, ndonëse janë gegë, vërehet sado pak edhe ndikimi nga origjina familjare, pasi, siç dihet, Arshi Pipa, megjithëse ka jetuar në Shkodër dhe nënën e ka pasur nga ky qytet, i ati ka qenë nga jugu.

Filip Ndocaj po ashtu vendlindjen e ka në Gjakovë.

Megjithatë, në këtë aspekt, nuk mund të flasim për një ndikim përcaktues në shkrimet e tyre.

* * *

Arshi Pipa ka një leksik shumë të pasur, ku jo vetëm përdor shumë gegizma, por edhe shumë fjalë që nuk i ndeshim në fjalorin e shqipes së sotme.

Një veçori karakteristike është se çdo krijim që ka botuar autori i përket periudhës para Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe të vitit 1972, ku gegërishtja përdorej gjithandej në shkrime të ndryshme.

Theksojmë se autori ka qenë i ndërgjegjshëm për leksikun e përdorur qofshin fjalë krahinore apo të huaja.

Të dy veprat e botuara, si “*Libri i burgut*” apo “*Rusha*” i shoqëron në fund të veprave me një fjalorth ku shpjegon kuptimin e fjalëve të rralla të përdorura, kryesisht të qytetit të Shkodrës, por edhe të vjela nga fjalori i shoqërisë “Bashkimi”, i N.Gazullit apo edhe Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 1954. Autori gjithashtu jep edhe origjinën e fjalëve të huaja, si nga italishtja, greqishtja, turqishtja, gjermanishtja dhe serbishtja. Sigurisht, duke mos qenë etimolog, disa fjalë mund të kenë edhe interpretime të tjera për rrugën e futjes së tyre në gjuhën shqipe. Neologjizmat e krijuara nga autori janë të pakta, ashtu siç i ka përcaktuar vetë Pipa.

Një punë e tillë, më e gjerë për gjithë fjalorthin vërehet, kryesisht te “*Libri i burgut*”.

Siç do të shihet edhe te dy autorët e tjerë, ndikimi i zhvillimit të gjuhës shqipe, kryesisht gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX ka pasur jehonë edhe te vepra e Arshi Pipës. Ky ndikim do të vërehet edhe te dy autorët e tjerë. Konstatimet tona mund të mos jenë të plota, pasi autori nuk botoi asnjë vepër në gjuhën shqipe pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe.

Një studim që botoi në vitin 1990 në SHBA në gjuhën shqipe është një dëshmi se gegërishtja e tij është e zbutur, e pranueshme dhe e lexueshme.

Këto dukuri vihen re gjatë paraqitjes së leksikut të gegërishtes në veprën e Arshi Pipës.

-Autori përpiket të përdorë një leksik të zgjedhur, duke i dhënë rëndësi përdorimit të sinonimeve në raport me fjalët e mbarë shqipes, gjë që e pasurojnë gjuhën e autorit;

-Kërkon të zgjedhë edhe ato gegizma që për Pipën kanë vlerë dhe mund të bëhen pronë e fjalorit aktiv të gjuhës shqipe;

-Me shumë dëshirë përdor fjalë të rralla të Veriut. Ai nuk mohon çka është e mbarë shqipes, por kërkon ta pasurojë atë, ashtu siç kanë vepruar edhe autorë të tjerë në vazhdimësi që në shekujt e kaluar.

* * *

Sami Repishti ka përdorur një leksik përgjithësisht të mbarë shqipes, gjë që pasqyrohet në dy veprat e botuara “*Pika loti*” dhe “*Nen hijen e Rozafës*”, vepra të shkruara në gegërisht, por të botuara pas ndryshimeve politike që ndodhen në vendin tonë pas viteve ’90 të shekullit të kaluar, ndonëse të shkruara para viteve ’70.

Autori si gegë që ishte, me një qartësi të veçantë ka ditur të dallojë çfarë duhet marrë nga leksiku i mbarë shqipes dhe ai dialektor.

Ndonëse jemi përpjekur të bëjmë një qymtim sa më të saktë të leksikut dialektor të këtyre dy veprave, duke përdorur fjalorë dhe studime të kësaj fushe, nuk pretendojmë që materiali është shterues.

Të ndara në rubrika të veçanta, ne kemi dalluar te vepra e autorit ato fjalë që nuk i ka fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006, por që për mendimin tonë disa mund të përfshihen në fjalorin e gjuhës shqipe si fjalë krahinore që i ndeshim vetëm te Sami Repishti, duke riparë në këtë kënd vështrimi edhe disa neologjizma të autorit.

Është me shumë interes vjelja e materialit dialektor, si burim i pashtershëm për të pasuruar leksikun e gjuhës shqipe.

Duke u mbështetur në të dhënat e akad. J.Thomajt, Fjalori i vitit 1980 ka afërsisht 2.5-3% krahinorizma, shifër shumë e vogël, por siç pohojnë disa gjuhëtarë të tjerë, kjo shifër është më e madhe.

Siç e kemi theksuar vjelja e materialit është përqendruar vetëm te krahinorizmat gege të përdorura.

Është me interes përdorimi i fjalëve të rralla nga autori ose i atyre fjalëve që krijojnë sinonimi me fjalët e mbarë shqipes.

Sigurisht që S.Repishti ka shfrytëzuar edhe Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954 apo edhe fjalorë e studime dialektore të njohura nga ai.

Leksiku krahinor i paraqitur në këtë doktoratë do t’i shërbejë si informacion konkret leksikografëve të ardhshëm të gjuhës shqipe.

Filip Ndocaj përse i përket leksikut ka veçoritë e veta, pasi krijimtaria e tij është shkruar dhe botuar në Shqipëri. Gjithashtu ai ka botuar vepra si para Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe dhe pas Kongresit.

Një veçori tjetër e leksikut të Ndocajt është se ai është ndikuar nga ligjërimi i folur, por që e ka përpunuar të atyre zonave ku ai ka shërbyer.

Gjithashtu Filip Ndocaj ka qenë gjithnjë në kërkim për të përdorur një leksik gjithëpërfshirës, ndonëse mbështetet në leksikun krahinor të zonës që përfaqëson.

Autori duke njohur realitetin shqiptar edhe në fushën e zhvillimit të gjuhës shqipe, nuk ka dashur të jetë konservator në dialektin e përdorur, por është përpjekur që edhe në leksik të mos përdorë pa kriter fjalët krahinore, gjë që vërehet se ai leksik vjen e kufizohet nga vepra në vepër.

Ndonëse ndeshim edhe krahinorizma, që i vërejmë edhe te dy autorët e tjerë, por edhe në dallim prej tyre, përsëri leksiku i veprës së autorit ka fjalë të rralla me vlerë, të cilat mund të zgjidhen dhe disa prej tyre mund të përfshihen në fjalorin e gjuhës shqipe.

Duke qenë se autori është mbështetur edhe në ligjërimin e personazheve, që është një galeri e tërë e pasqyruar në krijimtarinë e tij, ka gjetur vend të zgjedhë atë leksik të pranueshëm edhe nga lexuesi, që vepra të lexohet pa vështirësi.

* * *

Leksiku i përdorur në veprat e tre autorëve (kryesisht gegizmat) i përket gegërishtes letrare që ka vlera, mbasi jo vetëm në leksik, por edhe në trajta gramatikore mund të shfrytëzohet në të mirë të pasurimit të fjalorit dhe të gjuhës shqipe në përgjithësi.

Kreu i tretë

Veçori fonetike të veprës së tre autorëve: Pipa, Repishti, Ndocaj

Këtu do të trajtojmë këto probleme:

- 1.Theksi dhe togjet e zanoreve dhe bashkëtingëlloreve.
- 2.Zanorja ë dhe përdorimet e saj.
- 3.Veçori të tjera fonetike

Gegërishtja pas vitit 1972, me vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, pushoi përdorimin e saj në botimet që qarkullonin në Shqipëri. Ajo zbatohet, kryesisht, në shkrimet e autorëve gegë që jetonin si azilantë politikë në vendet e ndryshme të Europës, si në Itali, Gjermani, Francë etj., por edhe në Amerikën e largët.

Për të gjithë ata që shkruanin në gegërisht, të cilët i përkisnin gjysmës së parë të shekullit XX, qoftë ata të gjysmës së dytë të shek.XX, si: E.Koliqi, A.Pipa, M. Camaj etj. përgjithësisht u udhëhoqën nga zgjidhjet e dhëna nga Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918), si dhe nga vendimi i Qeverisë së asaj kohe të janarit 1923. Por shumë nga këta autorë gegë, ndonëse kanë pasur parasysh këtë vendim, janë orientuar edhe nga evoluimi i gjuhës shqipe, si rezultat i botimeve të shumta letrare dhe shkencore, si dhe i studimeve me karakter gjuhësor. Një dukuri të tillë e kemi vënë re kryesisht tek shkrimtari Martin Camaj, i cili ka edhe një veprimtari të pasur letrare dhe gjuhësore. Ai në raport me autorët e tjerë bashkëkohës qëndron më afër standardit të sotëm, ndonëse shkruan gegërisht, por ka ditur të nuhatë prirjen që kanë disa forma gramatikore të shqipes. Një dukuri të tillë do ta vërejmë edhe në tre autorët tanë në veprat e botuara në shqip, ndonëse jo me të njëjtën peshë, pasi dy autorët Arshi Pipa dhe Sami Repishti botojnë vetëm në gegërisht.

Siç dihet, gegërishtja nuk është kultivuar në Shqipëri, kryesisht pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe për arsye që dihen. Edhe pasuria e saj mbeti e fshehur në “arkiv.” Ajo sot kërkon të dalë nga ajo strofkë 50-vjeçare. Prof. Ardian Marashi shkruan: *”Gegërishtja mundi t’i konservojë ndër mote fjalët e veta të pathëna dhe tash ajo ndodhet e hapur para nesh, si një minierë dikur eksploruar cep më cep, por e dëmtuar rëndë nga mos funksionimi i gjatë; fjalët e çmueshme janë gjithmonë po aty të fshehura nën një tis të hollë ose ndër shtresa pluhuri të patundshme.”*¹ Të gjithë këta autorë gegë, dikush më pak e dikush më shumë, kjo varej nga përgatitja e tyre gjuhësore dhe kulturore, nga predispozicioni i tyre, janë përpjekur për t’i dhënë gegërishtes diçka nga aftësitë e tyre, duke sjellë variacione jo të vogla drejtshkrimore brenda variantit gegë. Një dukuri të tillë e vërejmë edhe te ky kapitull për secilin autor.

1.A.Marashi, *Përftesa poetike të gegërishtes*, në botimin “Martin Camaj – tradita dhe bashkëkohësia”, Shkodër, 1994, f.61.

Arshi Pipa

1.Arshi Pipa shkroi një gegërishte, kryesisht veriperëndimore. Ndonëse jetoj jashtë atdheut rreth gjysmë shekulli, siç e theksuam, duke pasur sens gjuhësor, bukur fort i ndiente zhvillimet gjuhësore në Shqipëri. Në ato vepra të botuara në shqip pas Kongresit të Drejtshkimit të Gjuhës Shqipe, kryesisht përkthime të krijimeve të tij, i shkroi në një gegërishte joarkaike dhe jo të lokalizuar, por gjithnjë deri në një fare mase me prirje afëruese, pa iu largua dialektit të tij.

Ne zgjodhëm dy krijime poetike të Pipës “*Libri i burgut*”, botuar në Romë, italisht në vitin 1958 dhe përkthyer në shqip e botuar në Tiranë në vitin 1994, shoqëruar me një paraqitje, shkruar nga autori në Detroit, më 20 dhjetor 1958, si dhe poemën “*Rusha*”, shkruar në burgun e Burrelit në vitin 1956 dhe e botuar në Mynih në vitin 1968. Në botimin e dytë të Tiranës të vitit 1995 ku ne jemi mbështetur, autori ka bërë disa prekje fonetike, siç e thekson ai vetë në post skriptum.

1Theksi

Gegërishtja që me Komisinë Letrare Shqipe në Shkodër ka evoluar në thjeshtësimin e përdorimit e theksave të ndryshëm në gjuhën shqipe, por te vepra “*Rusha*” Pipa kërkon t’i ruajë ata. Në botimin e dytë të kësaj vepre, autori shkruan : “*Kjo poemë (Rusha, A.O.) ndryshon prej tekstit të 1968-s nga përdorimi i dy shenjave diakritikë karakteristike të gegënishte letrare nga theksi i mprehtë/ / për zanoret e gjata dhe nga theksi hundak / / për nazalitetin e zânorevet. Gjuha e përdorun është një shkoderanishte që i përshtatet kësaj poeme kosovare, rrânjët e së cilës duhen kërkue te gegënishtja e një prelati katolik, Pjetër Bogdani...*”² Theksojmë se F.Agalliu në monografinë për gjuhën e Nolit shkruan se Noli, duke ndjekur shëmbullin e Sami Frashërit përdor theksin, por në një masë të kufizuar. Ai ka ndeshur edhe përdorimin e theksit circonfleks.³

Theksi hundor

Ndonëse bën deklarata të tilla, Pipa nuk është gjithnjë konsekuent në përdorimin e theksave e kryesisht atij hundor, duke mos e ndeshur në shumë fjalë të gegërishtes së përdorur nga autori. Përdor *ê*-në,*î*-në, *â*-në, *û*-në, *y*-në hundore, si:

Libri i burgut: *ngê* 155, *do të gjêjë* 11, *lê* 162, *ndêhen* 174, *e mpîtë* 169, *është* 11, *gjâja* 160, *kalamâ* 151, *sÿ* 72, *u fry* 155, *shtÿn* 176, *vû* 158, *u prû* 213 etj.

Rusha: *gjêj* 9, *tême* 10, *shêmbres* 69, *florÿj* 10, *bînê* 82, *kêrthî* 10, *është* 11, *bâni* 23, *kû* 24, *gjûj* 78 etj.

Theksi i mprehtë. Autori është i ndërgjegjshëm në përdorimin e theksit të mprehtë në fjalët njërrrokëshe, si dhe në fjalët që theksohen në rrokjen fundore, por jo gjithnjë:

Libri i burgut: *ju pré*167, *tue zbé* 175, *pêrdhé* 182, *i pafé* 182, *mushknít* 162, *stolí* 169, *pa mêní* 174, *me i ngjá* 183, *shá* 162, *me jú* 172,

Rusha: *pá* 6, *bregdét* 6, *vllá* 9, *shpêrndá* 9, *kam zí* 11, *endé* 71, *e sáj* 71, *vrá* 36, *verí* 7.

2.A. Pipa, *Rusha*, Tiranë, 1995, f.85.

3. F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Tiranë, 1999, f.34.

Sipas drejtshkrimit të sotëm thuhet se në gjuhën shqipe si rregull nuk përdoret asnjë lloj theksi. Në raste të veçanta, kur konteksti nuk arrin kurrësi të mënjanojë ngatërrimin e kuptimeve ose nuk siguron shqiptimin e drejtë të fjalëve të ndryshme, mund të përdoret theksi i mprehtë (´).⁴

Togjet e zanoreve (ie, ua, ue, ye etj.) dhe të bashkëtingëlloreve (mb, nd, ng, ngj, fsh)

A.Pipa, si autorët e tjerë gegë në shkrimet e tij i shkruan të plota togjet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve, pasi redaktimi i tyre në shkrim është një fazë e kapërcyer, dukuri që i përket së kaluarës. Kjo sot përbën një normë, që pasqyron një qendrueshmëri edhe për gegërishten.

2.Zanorja ë.

Është një problem edhe i drejtshkrimit të sotëm, pasi ka sugjerime për thjeshtësimin në përdorimin e saj. Siç dihet, përdorimi i zanorës ë ka evoluar gjatë historisë së gjuhës sonë, duke pësuar ndryshime në përdorimin e saj si nga autorët gegë, ashtu edhe ata toskë. Dihet që autorët gegë kanë ardhur gjithnjë duke e redaktuar atë.

Edhe Arshi Pipa e ka ndjerë se në disa pozicione ajo duhet të ruhet, diku jo, ndonëse nuk përjashtohen edhe luhatjet, pasi në shumë raste edhe këtu A.Pipa nuk është konsekuent.

Përdorimi i ë-së paratheksore. Ashtu siç vërehet edhe te disa autorë tjerë që shkruajnë në gegërisht, edhe Arshi Pipa e përdor këtë zanore në fjalët e parme, por edhe të prejardhura dhe në ato fjalë kur ajo ndodhet në rrokjen e parë, si:

fëmijë (L.B.163), *gegënishte* (R.5), *mënyrë* (L.B.10), *këshillojnë* (L.B.179), *hollësi* (L.B.9), *tingëllim* (L.B.10) etj.

Këta shembuj vijnë në pajtim me drejtshkrimin e sotëm. Por nuk janë të pakta fjalët që Pipa nuk e përdor ë-në paratheksore, si:

blegrima (L.B.175), *ngushllon* (L.B.167), *hapsinë* (L.B.176), *gjarpnoi* (L.B.179), *i pagzuem* (L.B.180), *prallave* (L.B.185), *puntor* (L.B.193), *ksaj* (R.6) etj.

Si F.Ndocaj edhe Pipa përdor ë-në në fjalën *arësye*. (B.11).

Edhe Pipa në fjalët që dalin me temë në bashkëtingëllore dhe ndiqen nga një prapashtesë që nis me bashkëtingëllore, si në standardin e sotëm përdor zanorën mbështetëse ë, si: *drithësoj* (K.4, 123), por kjo është një dukuri e rrallë. Luhatjet janë të shumta, gjë që tregon se autori nuk është koherent, si:

veçansin (K1,1), *shtegtarin* (R.82), *ndjeksi* (L:B.158) etj.

Përdorimi i ë-së pastheksore.

A.Pipa në veprën e tij nuk ka mbajtur një qendrim të prerë për përdorimin ose mospërdorimin e saj. Kështu, duke mos zbatuar një kriter të caktuar për këtë qëllim, diku e përdor, diku jo.

E përdor në fjalët:

fletësh (L.B.164), *fjalëve* (L.B.11), *Europës* (L.B.193), *rrotës* (L.B.193), *i hajthët* (L.B.164), *malcorëvet* (R.5), *serbëvet* (R.5), *shqiptarëvet* (R.5).

4.Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973, f.70, § 21.

Ashtu siç e rekomandon drejtshkrimi i sotëm, që para fjalëve me prapashtesën –*shëm* dhe –*të* në të gjitha trajtat e mbiemrave të formuar prej tyre, nuk përdoret në asnjë rast zanorën *ë*, dukuri të që e vërejmë edhe te Pipa, përfshirë edhe ndajfoljet, si: *turrshëm* (L.F.117), *termekshëm* (B.34), i *pavdarshëm* (K.2, 46), e *ndritshme* (L.B.15), e *pamundshme* (L.B.9).

Ë-ja pastheksore fundore.

Arshi Pipa këtu është më konsekuent, pasi në shumicën e rasteve e përdor zanorën *ë* në fund të fjalëve, qofshin këto emra në rasta të ndryshme ose në numrin shumës, folje në kohët analitike, në pjesoret e shkurtuara etj.

- në emrat e gjinisë femërore, trajta e shquar, *kokrrizë* (L.B. 165), *historisë* (R.5), *Shqipnisë* (R.5), *hapsinë* (L. B.184).

-në shumësin e disa emrave dhe mbiemrave: *ushtarë* (L.B.9), emra *historikë-gjeografikë* (L.B.11), *shkrimtarë romakë dhe byzantinë*, (R.6), *të krenëve shqiptarë* (R.35).

-në vetën e tretë të së ardhmes apo të lidhores: *do të gjejë* (L.B.11), *t' vijë* kunata (R.10);

-në pjesoret e shkurtuara: (me i) *paraqitë* (L.B.9), (me) *vdekë* (L.B.191), (tue u) *përhapë* (R.6), *lypë* (R.11).

Nuk e përdor *ë*-në fundore në emrat:

robnis (L.B.9), *Shqipnis* (L.B.9), *liris* (L.B.10), *robnin* (L.B.194), *armiq* (L.B.169), *gjithsin* (L.B.184), *syt* (L.B.171), (por *sytë* (R.43).)

Në pajtim edhe me drejtshkrimin e sotëm i shkruan pa *ë* fjalët: *gjithmonë* (L.B.9).

3. Veçori fonetike

Edhe te Pipa dukuritë fonetike me karakter dialektor paraqiten shumë të rudhura, pasi autori ishte një shkrimtar i përgatitur dhe nuk mund të bëhet fjalë për veçori të atilla që mund të veçohen vetëm në të shkruar.

Autori faringalen **h** e buzurizon në **f**, siç e ka e folmja e Shkodrës: *shef* (L.B.9), i *mirënjoftun*, (R.6).

Të tërheq vëmendjen që autori bashkëtingëlloren qiellzore *j* që shërben si prapashtesë trajtëformuese në shumësin e emrave, jo shumë nën ndikimin e drejtshkrimit të kohës, por edhe nga origjina e tij në pak fjalë e kthen në **nj**, dukuri që e ndeshim edhe në ndonjë rast tjetër: *shkambinjsh* (L.B.115), *kufinj* (L.B.89), *u përgjunj* (L.B.157), *fqinj* (L.B.96), *ullinj* (L.B.132), *gjinjt* (B.147), *i shenjtë* (L.B.148).

f/h. Megjithëse jo shpesh Pipa përdor bashkëtingëlloren *f* në vend të faringalen *h* të gjuhës së sotme.

...derisa flamuj tjerë do t' *njofi* bota...(L.B. 119).

* * *

Nga sa trajtuam deri këtu, A.Pipa mund të renditet ndër ata autorë që u përpoq të shkruajë një gegërishte deri diku të njësuar, me një leksik të zgjedhur, me trajta fonetike dhe gramatikore që ndikinin në afrimin ndërdialektor, me një frazë e gjuhë të rrjedhshme dhe të qartë.

* * *

Sami Repishti

2.Sami Repishti jeton në SHBA, por duke u marrë edhe me çështje politike, pas viteve '90, ka vizituar disa herë Shqipërinë dhe Kosovën. Kjo ka bërë që në kontaktet që ka pasur me intelektualë dhe botime të qarkulluara jashtë, por edhe në Shqipëri dhe në trojet e tjera shqiptare, ai është njohur më zhvillimet gjuhësore që kanë ndodhur në vendin tonë. Duke mos pranuar rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe të vitit 1972, ai vazhdon të shkruajë dhe të botojë në gegërisht, por larg skemave arkaike të së folmes krahinore, ndonëse nuk është gjuhëtar. Botimet e tij nuk i përkasin një gegërishte arkaike, përkundrazi nga botimi në botim reflekton në gjetjen e formave sa më të përbashkëta, për të mos krijuar diferenca të atilla me standardin e sotëm. Kjo gegërishte që të marrë vlera, është e domosdoshme që të përdoret, kryesisht nga shkrimtarët me emër dhe nga personalitet të njohura.

Një dukuri të tillë e vërejmë edhe në dy veprat e botuara në shqip nga Sami Repishti. E veçanta e veprës së këtij autori është se ai shkruan dhe boton gegërisht, si kolegu i tij Arshi Pipa, edhe pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972).

* * *

Të shohim se cili është kodi i S.Repistit që të përdorë një gegërishte me prirje afruese në fushën e fonetikës së shqipes.

1.Theksi

Një dukuri e shkrimeve në gegërisht, kryesisht të shekullit XIX dhe gjysmës së parë të shek.XX, me ndonjë përjashtim, është përdorimi i theksit të mprehtë, i theksit hundor dhe dallimi i zanoreve të gjata, kryesisht me anë të dyfishimit. Le t'i drejtohem retrospektivës, duke e parë problemin që te vendimet e Komisionit Letrarez Shqipe në Shkodër (1916-1918), në rregullat e drejtshkrimit të saj, si dhe në vendimin e vitit 1923 të Qeverisë Shqiptare të asaj kohe dhe duke vazhduar me drejtshkrimet e botuara më pas deri në ditët e sotme.

Komisioni Letrarez Shqipe në Shkodër diskutoi dhe hartoi dy variante të drejtshkrimit të gjuhës sonë që i titulloi "*Rregulla mbi orthografinë e gjuhës shqipe të shkrueme*", varianti i parë i përket dt.24.2.1917, ndërsa i dyti dt. tetor 1917. Është një variant më i zgjeruar se i pari, kryesisht te theksi. Ajo pranon se shqipja ka tri gjatësi: të gjata, të mesme dhe të shkurtra, por gjatësia do të shënohet vetëm në librat e gjuhësisë dhe në ato raste kur lejohet, trajtohen në një nen tjetër.¹

1.Rregulla mbi orthografinë gjuhës shqipe të shkrueme"(variant i dytë),të vendosuna prej Komisionit Letrarez, Shkodër, tetor 1917, f.7, neni 9: Për shenjimin e sasisë së gjatë po jepen këto rregulla. Sasija e gjatë do të përfytyrohet me theksën e mprehtë (°) e do të shenjohej:

a-mbi të gjitha ato fjalë që mund të sjellin ndërlirim në kuptim, për shembull: *puntori e puntori, drejtori e drejtori...etj.*

b-mbi rasat gjinore, dhânore e kallzore të numrit veçuer të trajtës së skajume t'emnavet femnorë, e mbi rasën kallzore të skajume t'emnvet mashkullorë, rrâja e të cilvet mbaron me një zânore të gjatë; si edhe mbi rasën emnore të skajume e mbi rasën hjekore e të paskajume të shumorit kur rrokja është prapë e gjatë, për shembull: dhís, dhín, dhít, dhísh...etj.

c-mbi tri vehtjet e shumorit t'auristit të verbavet që mbarojnë me rrokje të gjatë, p.sh. páam, páat, páan páim, pít, pín...etj

Pranohet theksi hundor me kufizime e jepen rregullat se ku duhet të përdoret.² Të mos shkruarit e zanoreve të gjata nga Komisia Letrare Shqipe në Shkodër, si dhe kufizimi i theksit hundor, ishte me rëndësi, pasi nuk merrte parasysh veçoritë krahinore dhe ishte “një hap përpara në përcaktimin e mëtejshëm të sistemit fonologjik të gjuhës letrare shqipe.”³

Kështu vazhdoi deri në vitin 1948, kur u botuar Ortografia e re, e para pas Luftës së Dytë Botërore. Aty thuhet se theksi nuk do të përdoret në shkrim për punë lehtësimi, përveç atij hundor dhe jepen rastet kur do të përdoret ai.⁴ Edhe orthografia e vitit 1951 nuk ka asnjë ndryshim me atë të vitit 1948. Ndërsa orthografia e vitit 1956 nuk e pranon theksin në shkrim, por theksi hundor mund të përdoret për të dalluar një fjalë me shqiptim hundor e me kuptim të ndryshëm, p.sh. *bâj=bëj* për ta dalluar nga *baj* (=bar, bart). Në drejtshkrimin e sotëm të vitit 1973 thuhet se “në shkrimin e gjuhës shqipe, si rregull, nuk përdoret asnjë lloj theksi.”⁵

Paraqitëm shkurtazi se si është dashur të përdoret ose jo theksi në gjuhën shqipe. Jo të gjithë shkrimtarët, publicistët, studiuesit që përdorin gegërishten nuk mbajnë të njëjtin qendrim. Martin Camaj, bashkëkohës i Sami Repishtit nuk e përdor theksin, veç në ndonjë rast të veçantë. Akademik Kolec Topalli, duke u marrë me aspektin gjuhësor të veprës së M. Camaj, shkruan: “Me këto veçori Martin Camaj dha një shembull të qartë se si mund të shkruhet gegërishtja pa theksa e shenja të tjera, duke kapërcyer kështu një vështirësi të ndjeshme të drejtshkrimit të saj.”⁶ Nuk duhet përjashtuar edhe ndikimi që ka pasur Martin Camaj për ata studiues që përdornin në shkrimet e tyre gegërishten dhe konkretisht edhe te Sami Repishti.

S.Repisti në asnjë rast nuk përdor theksin e mprehtë, as atë hundor, as nuk dallon zanoret e gjata me anë të theksimit dhe të dyfishimit, veçori të dallueshme të gegërishtes.

2. Po aty, f.7, neni 11

Për shenjimin e tingllit hundor po jipen këto rregulla: Tinglli hundor do të përfytyrohet me theksën (˘) hundore e do të shenjohe vetëm në këto rase:

a.Mbi të gjitha a-t hundore të gegërishtes, të cilavet në tosknishte u përgjigjet një “ë”, për shembull: gjâ, zâ, âsht etj.

b.Mbi të gjitha zanoret hundore afër të cilavet zhduket disa herë ndë gegërishte shkaku i hundimit (-n) e në tosknishte ndrohet ndë “r”, për shembull : pë (pëni, përi), frë (frëni, frëri)...etj.,

3.B.Beci, *Mbi disa veçori fonetike të të folmeve të gjuhës shqipe në përfaqje me gjuhën letrare*, “Studime filologjike”, 1982, nr.4, f.67.

4.Shih:R.Ismajli, *Drejtshkrimet e shqipes*, Prishtinë, 2005, “Ortografia e gjuhës shqipe,” 1948, *Akcenti*. f.233. Aty shënohet: Për punë lehtësimi, nuk do të përdoret akcenti në shkrim, përveç akcentit hundor.

Akcenti hundor (˘) do të përdoret në gegërishtet vetëm n’ato fjalë ku ka ranë hundorja n

dhe ka lënë shqiptimin hundor, p.sh. zâ, frë, mullî..., me bâ, bâhet, etj....âsht...shtëzë...etj. Nuk do të shkruhet akcenti hundor n’ato trajta emnash e foljesh, ku hundorja e ranë duket prapë, p.sh. zani, freni...hyna etj.Gjithashtu nuk do të shkruhet ky akcent n’ato fjalë emna, mbemna e folje që kanë një bashkëtingëllore mbas hundores, p.sh. anza, komb, vend ...etj. Fjala mâ do të shkruhet me akcent hundor në gegërisht.

5. *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f.70.

6. K.Topalli, *Vepra e Martin Camajit në aspektin gjuhësor*, në “Martin Camaj-tradita dhe bashkëkohësia”, Shkodër, 1994, f. 89.

Togjet e zanoreve (ie, ua, ue, ye etj.) dhe të bashkëtingëlloreve (mb, nd, ng, ngj, fsh)

S. Repishti në botimet e tij i shkruan të plota togjet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve, pasi redaktimi i tyre në shkrim ishte një fazë e kapërcyer, dukuri që i përket së kaluarës, me ndonjë rast të izoluar. Sot në ligjërimin e shkruar të gegërishtes nuk i ndeshim të reduktuara.

2.Zanorja ë.

Le të ndalemi te përdorimi ose mos përdorimi i zanorës **ë**. Është një problem edhe i drejtshkrimit të sotëm, pasi, siç dihet, përdorimi i saj ka evoluar gjatë historisë së gjuhës sonë, duke pësuar ndryshime në shkrimin e zanores **ë** nga autorët gegë dhe toskë, kur nga autorët gegë ka ardhur gjithnjë duke u redaktuar.

Sami Repishti nuk është një autor hermetik, përkundrazi ai e ka ndjerë se në disa pozicione ajo duhet të ruhet, diku jo, ndonëse nuk përjashtohen edhe luhatjet pasi në shumë raste nuk është konsekuent. Theksojmë se autori ynë. “*Nën hijen e Rozafës*” ka treguar më tepër kujdes për eliminimin e mjaft inkonsekuencave që ka pasur në veprën “*Pika loti*”, ndonëse edhe këtu ndeshemi me trajta jo të njësuara.

Përdorimi i ë-së paratheksore. Autori ynë nuk është konsekuent dhe ka lëkundje në përdorimin e saj, pasi, për mendimin tim, ka ndikuar edhe ligjërimi i folur.

E përdor zanoren ë-në paratheksore, në emrat: *shtëpi, fëmijë, vëlla, anëtar, luftëtar, gëzim, madhështi, thjeshtësi*, në foljet: *këputi, pikëson, me qetësue, pësonte, lëkundën, kërcënon, lehtësonte etj.* që janë në pajtim me drejtshkrimin e sotëm dhe jo me ligjërimin e folur të Shkodrës. Mngesa e koherencës vihet re edhe te të njëjtat fjalë, që autori i shkruan në dy mënyra: *vëlla*, por edhe *vlla*.

Por ka edhe shumë fjalë që Repishti nuk e përdor ë-në paratheksore, si: *smundja, vlla, munds, zemrimi, qetsinë, shqetsim, krejtsisht, njerzore, lagшти (P.L.47), qelbsinë (P.L.47), hapsinë etj*

Përdorimi i ë-së pastheksore. S. Repishti në veprën e tij nuk ka mbajtur një qëndrim të prerë për përdorimin ose mospërdorimin e saj. Kështu, duke mos zbatuar ndonjë kriter për këtë qëllim, diku e përdor, diku jo. Ka raste të izoluar që të njëjtën fjalë në të njëjtën faqe e shkruan në dy mënyra, si: *qumështi (R.21), qumshti (R.21), gjithëherë (R.24), gjithherë (R.24)*, gjë që u vërejt edhe në përdorimin e ë-së paratheksore..

Ashtu siç e rekomandon drejtshkrimi i sotëm, para fjalëve me prapashtesën –*shëm* nuk e përdor në asnjë rast zanorën *ë*, si: *i përditshëm, i qëllimshëm, i dukshëm, i sjellshëm*.

Ë-ja fundore. Këtu Repishti është më konsekuent, pasi në shumicën e rasteve e përdor zanorën *ë* në fund të fjalëve, qofshin këto emra në rase të ndryshme ose në numrin shumës, foljet në kohët analitike, në pjesoret e shkurtuara, në përemra etj. si: *djalë, gjumë, breznitë, ilirëve, porositë, naltësitë, historisë, vocrrakëve, ishte mbledhë, me këputë, me falë, me dalë, me u shtypë, tue u dridhë*.

Në pajtim edhe me drejtshkrimin e sotëm i shkruan pa *ë* fjalët: *gjithçka, gjithnjë*, ndonëse nuk është gjithnjë konsikuent.

Vecori fonetike

Grupi vo. Repishti në shkrimet e tij e ruan grupin *vo*, dukuri fonetike e gegërishtes në raport me standardin *va*:

...I largoi nga *votrat* shekullore...(P.L.141).

...Përballë një filozofie jete që kërkonte prej *të vorfnit* me pranue fatin e vet...(P.L.147).

...gjurmat ...i ndjek deri në *vorr*. (P.L.145).

f/h. Një element dallues i gegërishtes është edhe përdorimi bashkëtingëllores *f* në raport me faringalen *h* të gjuhës së sotme. Repishti përparësi i ka dhënë kësaj të fundit, ndonëse ndeshim në veprën që kemi shfrytëzuar të njëjtën fjalë të shkruar në dy mënyra:

...Nuk e *njifsha* veten ma...(P.L.137).

...po ballafaqohesha me një qenie të gjallë që e *njihsha*, që e admirojsha...(P.L.115).

* * *

Nga materiali i trajtuam deri këtu del se S.Repishti mund të renditet ndër ata autorë që shkruajnë një gegërishte mjaft të njësuar, me një leksik të zgjedhur, me trajta fonetike dhe gramatikore që ndikonin në afrimin ndërdialektor, me një frazë e gjuhë të rrjedhshme dhe të qartë. Leximi veprës së këtij autori nuk sjell vështirësi, por lexuesi ndjen se kemi të bëjmë me një gegërishte mjaft të përpunuar afër standardit të sotëm, por duke i qendruar besnik autori dialektit që përfaqëson. Kjo mund të ketë ardhur ndoshta se vepra, megjithëse mund të jetë shkruar vite më parë, por është botuar në vitet e fundit të shekullit të kaluar.

* * *

Filip Ndocaj

Filip Ndocaj përdor një gegërishte me prirje afruese në fushën e fonetikës së shqipes në tri veprat të botuara para Kongresit të Drejtshkrim, pasi F.Ndocaj në veprat që botoi pas këtij tubimi, siç e kemi theksuar më sipër, janë në përputhje me ato vendime që arriti Kongresi i Drejtshkrimit i Gjuhës Shqipe (1972).

1.Theksi

Një dukuri e shkrimeve në gegërisht, kryesisht të gjysmës së dytë shek.XX, me ndonjë përjashtim, është sheshimi i theksave në të shkruar, si dhe i zanoreve të gjata, kryesisht me anë të dyfishimit, që vjen në pajtim me drejtshkrimin e sotëm.¹

Autori nuk përdor asnjë lloj theksi në veprën e vitit 1968, ndërsa në veprën e vitit 1961 ndeshim në ndonjë fjalë të rrallë theksin hundor si *arrnêjve* (SR.27), *m'â shnderue* (SR.18) etj. Ndërsa theksi i mprehtë tepër rrallë e ndeshim në zanoren e theksuar në fund të fjalës, si: *flaurí* (SR.8), *ajrí* (SR.8), *unjí* (SR.88) etj.

1. *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f.70, § 21.

Togjet e zanoreve (ie, ue, ye etj.) dhe të bashkëtingëlloreve(mb, nd, ng etj.)

F.Ndocaj në shkrimet e tij i shkruan të plota, si grupet e zanoreve, ashtu edhe të bashkëtingëlloreve, si : *diell* (SR.14), *duerve* (SR.20), *shndërrue* (SR.18), *fyell* (SR.36), *kambë* (SR.11), *kndue* (SR.32), *shtërngue* (SR.28), pasi redaktimi i tyre në shkrim ishte një fazë e kapërcyer, dukuri që i përket së kaluarës, me ndonjë rast të izoluar.

2.Zanorja ë.

Le të ndalemi te përdorimi ose mos përdorimi i zanorës *ë* në dy veprat e F.Ndocajt. Shkrimi dhe përdorimi i saj ka evoluar gjatë historisë së gjuhës sonë, duke pësuar ndryshime në drejtshkrim nga autorët gegë dhe toskë, kur nga autorët gegë ka ardhur gjithnjë duke u redaktuar, ndonëse ka vepruar edhe ndikimi i gjuhës së sotme . Filip Ndocaj e ka ndjerë se në disa pozicione ajo duhet të ruhet, diku jo, ndonëse nuk përjashtohen edhe luhajat, pasi në shumë raste nuk është konsekuent. Kjo mund të shpjegohet se autorët gegë nuk janë mbështetur në ndonjë kod.

Përdorimi i ë-së paratheksore.

Autori nuk është konsekuent dhe ka lëkundje në përdorimin e saj, pasi, për mendimin tim, ka ndikuar edhe ligjërimi i folur.

E përdor zanoren *ë*-në paratheksore në fjalët, kur ajo shfaqet në fjalët e parme dhe në ato fjalë kur ajo ndodhet në rrokjen e parë, si: *mbështjell* (Sr.8) *mbështetëse* (V.30), *shtëpia* (V.32), *kushërinë* (V.32), *përralla* (V.32), *gëzim* (V.34), *kënaqësi* (V.34). *bujqësisë* (V.45), *lëshoi* (V.10).

Nuk e përdor *ë*-në paratheksore në fjalët: *pikllue* (SR.6), *ngroftsi* (SRr.6), *ftyrat* (SR.7), *numronte* (V.37), *blegrojnë* (SR.40), *pamundsi* (SR.57).

Në fjalët që dalin me temë në bëhkëtingëllore dhe ndiqet nga një prapashtesë që nis me bashkëtingëllore, atëherë autori si në standardin e sotëm përdor zanorën mbështetëse *ë*, si: *gjakësi* (V.10), *bujqësi*, (V.123), *kënaqësi* (SR.33), *malësor* (SR.26). Por vërehen edhe luhajte, gjë që tregon se autori nuk është koherent, si *malsi* (SR.26), *pleqni*, (SR.21) etj., ndonëse shëmbujt nuk janë të shumtë.

E përdor zanoren *ë* edhe në kufi të fjalëve të përbëra a të përngjitura, si: (V.10).

Përdorimi i ë-së pastheksore

F.Ndocaj në veprën e tij nuk ka mbajtur një qëndrim të prerë për përdorimin ose mospërdorimin e *ë*-së pastheksore jofundore. Kështu, duke mos zbatuar ndonjë kriter për këtë qëllim, diku e përdor, diku jo, ndonëse përparësi ka përdorimi i saj. *Fëmijës* (V.32), *kambëve* (V.34), *partizanëve* (V.37), *e njerëzve* (V.52), *bukës* (V.11).

Nuk e përdor te fjala *shelekve* (SR.40).

Ashtu siç e rekomandon drejtshkrimi i sotëm, para fjalëve me prapashtesën –*shëm* nuk e përdor në asnjë rast zanorën *ë*, si: *të çuditshëm* (V.33), *të maparshme* (V.37).

Ë-ja pastheksore fundore.

Këtu F. Ndocaj është më konsekuent, pasi në shumicën e rasteve përdorimin e zanorës *ë* e zbaton në fund të fjalëve, qofshin këto emra në rase të ndryshme ose në numrin shumës, folje në kohët analitike, në pjesoret e shkurtuara etj.

E përdor *ë*-në fundore

- në emrat e gjinisë femërore: *kambë* (V.136), *gjylpanë* (V.136), *fytyrë* (V.134).
- në shumësin e emrave si prapashtesë trajtë formuese: *malësorëve* (V.140), *fotoraporterët* (V.161), *shokëve* (V.65), *komunistëve* (V.14), *partizanëve* (V.37), *katundarëve* (V.56),
- në emrat e gjinisë femërore , trajta e shquar, numë njejës, si : *Shqipninë* (V.36), *robnisë* (SR.65), *bujqësisë* (V.129), *zjarminë*, (V.136).
- në emrat e trajtës së shquar në numrin shumës, si : *sytë* (V.13), *pleqtë* (V.141), *gjitë* (V.155), *turinjtë* (V.161), *djemtë* (V.48), *komshitë* (V.154), por nuk e përdor ë-në në shumësin e disa emrave: *anmiqt* (SR.7), *pleqt* (V.32), *djemt* (V.45), *langojt* (V.34).
- në pjesoret e foljeve në përbërje të kohëve analitike ose të formave të pashtjelluara: *kam nisë* (V.41), *kishin përmbysë* (V.61), *me vjedhë* (V.77), *me ja lanë* (V. 92), *tue i thanë* (V.810, *tue mbytë* (V.89), *pa mbërritë* (V.9).

Nga shembujt e mësipërm vërejmë se edhe F.Ndocaj duke u mbështetur në dialektin që përfaqëson, pranon vetëm pjesoren e shkurtuar.

Në pajtim edhe me drejtshkrimin e sotëm autori i shkruan pa *ë* fjalët: *gjithçka*, *gjithnjë*. *gjithkah* (V141). Ka raste që autori shton ndonjë *ë* në temë që në standardin e sotëm nuk ndodh një dukuri e tillë , si: *arësyetonte* (V.52), *arësye* (V.56), *tregëtari* (V.84), *tradhëtarët* (V.63), *tregëti* (V.77).

Dukuritë fonetike me karakter dialektor paraqiten shumë të rudhura, pasi autori është një shkrimtar i përgatitur dhe nuk mund të bëhet fjalë për veçori të atilla që mund të veçohen vetëm në të shkruar.

Autori faringalen **h** e buzurizon në **f**, siç e ka e folmja e Shkodrës: *shof* (V.152), *Ftof* (V.12), *ngrof* (V.270), *rref* (V.41), *ngref* (V.55), *njof* (V.60), ndonëse ndeshim edhe *ftohtas* (V.66).

Të tërheq vëmendjen që autori bashkëtingëlloren qiellzore *j* që shërben si prapashtesë trajtëformuese në shumësin e emrave, në disa fjalë e kthen në *nj*, nën ndikimin e drejtshkrimit të kohës si: *poteraxhinjve* (V.18), *turinjtë* (V.161), *mullinj* (V.13), *minjsh* (V.36), *kufinjve* (V.39), *të rinjtë* (V.65), *fqinjëve* (V.104), *brinjave* (V.107), *shenj* (V.118). por *langoj* (V.34). *komshitë* (V.108) etj.

Zanoren **o** te grupi **vo/va** që gegët nuk e kthejnë në **a**, edhe te F.Ndocaj vërehet një dukuri e tillë, ndonëse autori nuk është konsekuent pasi në të njëjti vend përdor i përdor të dy trajtat, si atë të standardit, si atë dialektor:

Në heshtje e *varrosin* plakun e *votrës*...(V.197)

* * *

Nga sa trajtuam deri këtu F. Ndocaj mund të renditet ndër ata autorë që shkruajnë një gegërishte mjaft të njësuar, me një leksik të zgjedhur, me trajta fonetike dhe gramatikore që ndikojnë në afrimin ndër dialektor.

Leximi veprës së këtij autori nuk sjell vështirësi. Që me njohjen e parë lexuesi e ndjen se kemi të bëjmë me një gegërishte mjaft të përpunuar dhe të kodifikuar në shumicën e trajtave të ndryshme gjuhësore, afër standardit të sotëm, por duke i qendruar besnik autori dialektit që përfaqëson.

Përmbyllje e kreut të tretë

Dukuritë gjuhësore të veprave të tre autorëve kanë veçori të përbashkëta, pasi shkruajnë në gegërishten veriperëndimore, megjithatë ka raste që në disa dukuri nuk përputhen.

1.Arshi Pipa, ndryshe nga dy autorët e tjerë, përdor gjerësisht si theksin hundor ashtu edhe theksin e mprehtë. Siç e thekuam edhe më sipër, në veprën “Rusha” ai përpiket t’i përlligjë pse i përdor këto dy theksa, Ndonëse kemi të bëjmë me një dukuri, e cila nuk ndeshet në gjuhën e sotme shqipe, megjithatë ai dëshiron që vepra t’u shërbejë gjithë shqiptarëve. Në fjalorthin që boton në fund të veprës, sqaron se për disa fjalë që mund të mos kuptohen nga toskët si gjegjëse ka venë një toskizëm.

Togjet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve nuk i asimilon. Nuk kemi ndeshur ndonjë fjalë ku mund të jetë asimiluar ky tog.

Poblem për dy autorët e parë është përdorimi i zanores ë në pozicione të ndryshme, si paratheksore, pastheksore dhe fundore. Në të gjitha këto përdorime vërehet ndikimi edhe i gjuhës së sotme dhe i drejtshkrimit të saj, por nuk janë të rralla edhe luhatjet. Ngjet që një fjalë e shkruan në dy mënyra: *syt* dhe *sytë*.

Duke e studiuar gjuhën e Pipës, konstatojmë se nga ana e veçorive fonetike autori nuk i ka qendruar gjithnjë besnik të folmes që përfaqëson, por bën përpjekje që të shkruajë për të qenë sa më afër lexuesit që vepra të jetë e kuptueshme jo vetëm për gegët, por edhe për toskët për të cilën ai përpiket t’i realizojë në veprat që boton.

* * *

2.Sami Repishti, ndonëse është në moshë të thyer, vazhdon të botojë, kryesisht artikuj politikë në shtypin e sotëm periodik në Shqipëri. Duke ndjekur botimet në Shqipëri edhe përmes internetit, ai vëren ndryshimet që ndodhin në gjuhën shqipe, ku me disa prej tyre nuk pajtohet,

Autori në veprën e tij në asnjë rast nuk përdor theksa në shkrim, as nuk dallon zanoret e gjata me anë të theksimit dhe dyfishimit të zanoreve, si dhe i shkruan të plota togjet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve, që sot ata gjithnjë shkruhen të plota.

S.Repishti nuk është hermetik në përdorimin e zanores ë në pozicione të ndryshme. Ai e përdor në pozicionin e duhur, por nuk përjashtohen rastet kur autori nuk është konsekuent.

Edhe në këtë rrafsh vepra e dytë “*Nën hijen e Rozafës*” qëndron më lart se e para ku luhatjet janë më të pakta.

Ashtu siç thamë edhe për A.Pipën që të njëjtën fjalë e shkruan në dy mënyra, edhe te S.Repishti vërehet një dukuri e tillë. Kështu shkruan *qumësht*, por edhe *qumsht*.

Kujdes më të madh ka treguar për përdorimin e zanorës ë fundore.

Grupin *vo/va* e përdor në variantin gegë: *vorr*, ndonëse e ndeshim edhe trajtën me brenda një fjalie:

...me shti në një *vorr* me Ukshinin...(V.189)...Në heshtje e *varrosën* plakun e *votrës* (V.197).

Ndërsa bashkëtingëlloren *f* në krahasim me faringalen *h* përparësi i jep kësaj të fundit që është dukuri e gjuhës së sotme shqipe.

Edhe vepra e Sami Repishtit është e pranueshme dhe e lexueshme nga të gjithë shqiptarët.

* * *

3.Filip Ndocaj përse u përket veçorive fonetike qendron deri diku më afër standardit të sotëm, pasi është i ndikuar deri në një fare mase edhe nga mjedisi, ndonëse një pjesë të jetës e ka kaluar në Veri.

Edhe autori ynë nuk përdor asnjë lloj theksi dhe nuk asimilon togjet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve.

Te F.Ndocaj, si te dy autorët e tjerë, përvç rasteve që në përdorimin e zanorës *ë* përputhet me drejtshkrimin e kohës , por vërehen edhe luhatje. Nuk përlijen disa insequenca duke ditur se ai ka qenë mësues gjatë gjithë jetës. Këto luhatje i kemi konstatuar në përdorimin e zanorës *ë* në pozicione të ndryshme. Ngjet edhe një dukuri e tillë që autori shton ndonjë zanore, kur drejtshkrimi i sotëm nuk e rekomandon.

Autori faringalen *h* e buzorizon në *f* siç e ka e folmja e Shkodrës, ndonëse ndeshim edhe përjashtime .

Diçka e veçantë që vërehet te shkrimet e F.Ndocajt është se në disa fjalë qiellzorën *j* e kthen në *nj*, kryesisht në disa emra në numrin shumës, si : *kufinjve, të rinjtë* etj.

F.Ndocaj mund të renditet ndër ata autorë që shkruajnë një gegërishte mjaft të njësuar, me një leksik të zgjedhur, me trajta fonetike dhe gramatikore që ndikonin në një afrim dialektor.

Përgjithësisht kemi të bëjmë me një gegërishte mjaft të përpunuar dhe të kodifikuar, por duke i qendruar besnik dialektit që përdor.

Kreu i katërt

Veçori fjalëformuese në veprat e tre autorëve: Pipa, Repishti, Ndocaj

Në kreun e katërt do të trajtojmë çështje që lidhen me fjalëformimin, duke u bazuar në leksikun e vjelë të autorëve që kemi analizuar.

Do të ndalemi në këto mënyra fjalëformimi:

1. Parashtesimi
2. Prapashtesimi dhe formimet e tjera
3. Formimi me nyjëzim.
4. Kompozimi.
5. Përngjitja

Me interes është edhe përdorimi i mënyrave të ndryshme të fjalëformimit të tre autorëve. Nuk jemi mbështetur në gjithë leksikun e veprës së tyre, por në atë leksik që ne kemi vjelë dhe kemi regjistruar në temën tonë. Qëllimi ynë ka qenë të veçonim jo të gjitha mënyrat që janë përdorur nga autorët në veprat e tyre, pasi ata janë të mbarë shqipes dhe nuk del puna individuale e secilit, por ajo që është pasqyruar kryesisht në gegizmat e pasqyruara në kreun e dytë “*Rreth leksikut në veprat e tre autorëve*”. Sigurisht që të tre autorët kanë një pasuri më të madhe fjalëformuese në leksikun e plotë të veprave të tyre, por kjo nuk na paraqet preferencat e secilit autor në këtë fushë. Ndoshta numri i kufizuar i disa mjeteve fjalëformuese, nuk do të thotë se ata nuk njohin të gjitha mënyrat e fjalëformimit të shqipes, por materiali i vjelë aq ka dhënë. Prandaj konsideratat dhe vlerësimet tona kanë qenë të kushtëzuara nga materiali i paraqitur këtu.

Arshi Pipa

Duke qenë se Arshi Pipa ka një leksik të pasur krahinor, ka përdorur disa mënyra të fjalëformimit, të cilat do t'i analizojmë më poshtë:

1.Parashtesimi është një ndër mënyrat e fjalëformimit të shqipes, por jo më i rëndësishmi. Numri i parashtesave që e ndeshim në leksikun e A. Pipës nuk është i madh, pasi kaq të jep materiali i vjelë.

Parashtesa për- është një ndër më aktivet që përdor Pipa. Kjo parashtesë u ngjitet temave foljore, emërore etj, duke formuar folje ose emra, si:

Përfalem (L.B.15) *përunjim* (R.54), *përgjasohet* (2.45/K), *përvujtun* (i) (L.67), *përnderim* (L:B.167), u-përgjunj (L.B.157).

Parashtesa pa- Është prodhimtare dhe u ngjitet temave mbiemërore dhe u jep fjalëve kuptim mohor, ndonëse në leksikun e veprës së Pipës nuk është shumë aktive, si: *i pandishëm* (K.3, 115).

Parashtesa stër- përdoret pak nga Pipa, vetëm në ndonjë emër farefisi, siç e ndeshim edhe sot, si: *stërgjyshët* (R.7).

Parashtesa **sh-** që paraqitet edhe në dy variante, i jep fjalës kuptim intensiv, si: *shndriti* (R.39).

Ndërsa **parashtesa zh-** u ngjitet temave të tilla që krijojnë antonime, si : *zhdryni* (R.64), *zhbij* (L.B.53).

Të gjithë shembuj janë në pajtim me drejtshkrimin e sotëm.

2.Prapashtesimi është mënyra më prodhimtarja në formimin e pjesëve të ndryshme të ligjeratës, Janë përdorur disa prapashtesa. Kështu mund të shënojmë prapashtesat: *-o, -ore, -or, -nore, -tar, -shëm, -i* etj.

Prapashtesa –o është shumë prodhimtare në shqipen e sotme. Ajo u ngjitet temave emërore, mbiemërore, ndajfoljore dhe foljore etj. dhe formon folje, si:

mrizoj (L.57) *naltohet* (K.3), 116 (*mungulloj* (L.48), *gandoj* (K.1, 3), *afshoj* (L.F.109), *gjason* (K 4, 121).

Prapashtesa –ore (-nore), -(i)zo nga tema të ndryshme formon mbiemra ose folje, si: *nusore* (L.46), *mëkatnore* (L.48), *ujnore* (L.F.122), *gjallnore* (L.F.29), *shqipno* (K.4,129), *kaçulore* (L.B.175), *bardhullore* (L.23), *skamnor* (K.3, 115).

Prapashtesa –isht(ë) që është shumë prodhimtare, paraqitet në veprën e Pipës në tri variante (-ishte, -ishtë, -isht) dhe shërben për të formuar emra që tregojnë vendin ku ndodhet me shumicë objekti që emërtohet nga tema fjalëformuese, si: *llomishtë* (L.F.120), *lëmishte* (L.B.209) ose formon ndajfolje mënyre, si: *besnikisht* (B.R.3,45), *krenarisht* (L.65), *arnautisht* (K.2.45).

Me **prapashtesën –shëm** autori formon ndajfolje nga tema të ndryshme, si: *llastueshëm* (L.65) *vallueshëm* (L.66) *turrshëm* (L.f.117), *termekshëm* (L.B.34), *shungullueshëm* (L.B.182), *mallshëm* (L.B.191), *madhnueshëm* (L.B.182), *përshpirtshëm* (L.B.186).

Prapashtesa –tar(e) është prodhimtare në formimin e emrave dhe të mbiemrave, si: *ngushllimtar* (L.29), *Shprehimtar* (K.4, 122), *Vetmitar* (L.21), *Foltare* (K.4.122), *Idhujtar* (L.B.118.)

Prapashtesa **–nik(e)**, nuk është prodhimtare, pasi kemi pak fjalë me këtë prapashtesë, si: *pijaniku* (L.45), *migjenike* (B.R.3.44). Kështu jo prodhimtare paraqiten edhe prapashtesat: **-najë**, si: *floknejë* (L.F.117), *gjethnajë* (L.80),

Prapashtesa -i(-si) formon emra abstraktë, si: *qetí* (L.17), *fisnikí* (K.4, 121) *veçansí* (K.I.1).

Prapashtesa –im formon pak emra abstraktë: *Verim* (K.3.112), *flakrim* (L.B.156).

Prapashtesa **–ue** është shumë pak produktive. Nga tema foljore formon emra: **-ue** *gjimues* (L.72). Shumë pak produktive paraqiten prapashtesat **-oshe** *Hiroshe* (L.57) **-az** *Imtaz* (K.4), **-ëz** *Ninëz* (l.f.1) etj.

3.Formimi me nyjëzim

Janë disa mbiemra që autori i përdor në vepër me nyjëzim, si: *i përçudun* (L.F.140), *i përgjumun* (K3, 112), *i pavidarshëm*, (K. 2, 26), *i falisun* (l.30), *e burueme* (K.4, 122).

Formimi me parashtesim ose me prapashtesim+nyjëzim

Është një mënyrë jo prodhimtare në formimin e fjalëve. Në veprën e Pipës ndeshim pak fjalë të tillë, si: *i pamort* (LË:B.20), *e ngjyeme* (K.4, 123), *e përvajme* (l.67) (m. e përzier)

4.Kompozimi

Një ndër mënyrat prodhimtare pas prapashtesimit vjen kompozimi, një mënyrë e hershme e krijimit të fjalëve në gjuhën shqipe.

Janë disa struktura që ka përdorur Pipa në formimin e kompozitave, prej të cilave disa janë me burim popullor, si:

Emër + emër:

shpirti-pëllumb (K.3.120), *Mustaqe-shllungë* (R.63), *shpirti-shqyponjë* (K.3.120) ,
buzagaz (B.16), dhemuhuesish (L.B.119).

Emër + folje:

pupla-shkruem (L.81) *thoj-këputuna* (L.f.135) *Kryen-ulun* (L.F.107), *fatshkretue*
(L.B.21), *gurlatue* (L.B.175), *krahshpërvjelun* (L.B.161).

Ndajfolje+emër foljore ose me strukturë tjetër:

miradashës (K.1,42), *larkjehues* (K.2,.444), *mrekullplote* (R.81), *velmëndafsha*
(L.B.170), *hareplote* (L.B.106)

5.Përngjitja

Një ndër mënyrat e fjalëformimit që ka përdorur në vepër Pipa është edhe përngjitja, kryesisht me burim popullor. Nuk janë të shumta fjalët e krijuara sipas kësaj mënyre fjalëformimi, të cilat në shumicën e fjalëve u përkasin pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës, si:

ndajnate (L.38) *tekembramja*, (K.1,5), *diçkahi* (F.7-8,301), *bzâj* (L.71), *gjithnduer*
(R.19), *kotnasikoti*, (L.B.127), *gjithkah* (L:B.129).

Përngjitje + prapashtesim

Është një formim i rrallë te Pipa që të formojë fjalë me këtë mënyrë fjalëformimi, por edhe në shqipen e sotme, duke bashkuar një numëror + një emër i rasës rrjedhore, ku mbaresa –*sh* e ka humbur kuptimin rasor të saj duke u kthyer në një prapashtesë. Kështu te Pipa ndeshim përngjitjen *dykrenësh* (L.B.85).

* * *

Siç shihet Pipa përdor disa mënyra në formimin e fjalëve që ia rrisin vlerën veprës së tij, siç e theksuam, mbështetur jo në të gjithë leksikun e saj, por në ato fjalë që i kemi veçuar në leksikun e autorit.

* * *

Sami Repishti

Me interes është edhe përdorimi i mënyrave të ndryshme të fjalformimit nga Sami Repishti. Si dhe për dy autorët e tjerë F.Ndocaj dhe A.Pipa nuk jemi mbështetur në gjithë leksikun e veprës, por në atë leksik që ne kemi veçuar dhe regjistruar në temën tonë.

Parashtesimi

Është një ndër mënyrat e fjalëformimit të shqipes.Numri i parashtesave që e ndeshim në leksikun e S.Repistit është i vogël.

Parashtesa për- është përdor pak nga Repishti. Kjo parashtesë u ngjitet temave foljore, emërore etj, si:

Përçudnim (Ro.121), *përvujtni* (P.L.109).

Parashtesa pa- u ngjitet temave emërore, mbiemërore dhe foljore, si:

i panjollosun (Ro.106), *pafajni*, (Ro.11), *pandershmëni* (Ro.130), *të pamundësohej*
(Ro.75).

Parashtesa stër- është joprodhimtare, përdoret pak nga Repishti vetëm në ndonjë emër farefisi apo mbiemër siç e ndeshim edhe sot, si:

stërgjyshore (P.L.12).

Parashtesa sh/ç- i jep fjalës kuptim intensiv ose kuptim antonimik, joprodhimtare në shqipen e sotme si:

shkurrajim (Ro.219), *çnjerëzues* (Ro.13), *të çlira* (P.L.128).

Me parashtesën ri-formohen fjalë që emërtojnë një veprim që do të kryhet përsëri, si: *riburgosje* (Ro.19), *i riardhuni* (Ro.43).

Parashtesa tej- . Ka një përdorim të kufizuar dhe zakonisht përdoret në stilin libror:

...zhvillojshin sentimentin fetar që lindte në orë të këtilla *tejtoksore*... (Ro.198).

Parashtesa jo- Edhe kjo në shqipen e sotme nuk është prodhimtare në ligjërimin e shkruar e ndeshim në krijimin e fjalëve me kuptim antonimik:

...më erdhi si një përshpëritje e largët *jotoksore* në veshin tim... (P.L.119).

Prapashtesimi

Është mënyra më prodhimtare në formimin e pjesëve të ndryshme të ligjëratës, duke përdorur disa prapashtesa. Kështu mund të shënojmë prapashtesat: *-o*, *-ore*, *-no*, *-u* etj.

Prapashtesa -o(-ue) është shumë prodhimtare në shqipe që formon folje nga tema të ndryshme, kryesisht nga tema emërore, si:

paqoj (P.L.20), *lëmoj* (Ro.25), *avullohej* (Ro.103), *miklue* (P.L. 29), *hyjnuer* (P.L.84),

Prapashtesa -or(e), u ngjitet temave emërore, mbiemërore etj. si:

rutinore (R.109), *mortore* (P.L.28), *pikësonte* (Ro.75), *hyjnuer* (Ro.84), *engjëllore* (P.L.59).

Prapashtesa -no u ngjitet kryesisht temave emërore, si: *burrnoi* (Ro.49), *shejtnoj* (P.L.52).

Prapashtesa -(ë)so jo aq prodhimtare dhe formon kryesisht folje, si:

mundësonte (Ro.115), *paksue* (Ro.43).

Prapashtesa -(ë)zo ka formuar folje nga tema mbiemërore, si:

ngurrëzue (P.L.113).

Prapashtesa -(ë)si është mjaft prodhimtare dhe u ngjitet kryesisht temave ndajfoljore, si: *bashkësi* (Ro.9), *boshsi* (P.L.62), *egërsi* (P.L.11), *rrumbullaksi* (Ro.35), *vobegsi* (Ro.46), *fëlliçsi* (P.L.40), *mendësi* (Ro.138), por edhe *kryenaltësi* (Ro.16), *zemërligësi* (Ro.147), *pashpirtësinë* (Ro.247).

Me **prapashtesën -shëm** autori formon mbiemra nga tema emërore me nyjëzim dhe prapashtesim, si:

e zhurmshme (P.L.9).

Prapashtesa -inë formon emra nga tema emërore ose ndajfoljore, si : *rruginë* (Ro.17), *mbrapshtina* (Ro.118).

Prapashtesat -im u ngjiten kryesisht temave foljore, **si:**

vegim (Ro.207), *galdim* (P.L.9), *shkoklim* (Ro.317), *ligjësim* (Ro.119), *përçudnim* (Ro.121). *përjetësim* (Ro.125), *dalldim* (R.30), *sakatim* (P.L.145) etj.

Prapashtesa -as është mjaft prodhimtare në formimin e ndajfoljeve, si:

vjedhtas (Ro.9), *ngultas* (Ro.27).

Prapashtesa -ni- U ngjitet temave emërore dhe formon përdori emra:

pafajni (Ro.11), *brezni* (Ro.39).

Prapashtesa -ës, Është produktive në shqipen e sotme, ndonëse Repishti e përdor pak: ndrydhës (Ro.23).

Prapashtesa-ak(e). Nga tema emërore formohen mbiemra, si:

...nji gjeth i këputun nga era e forte *vjeshtak(e)*... (P.L.56).

Prapashtesa -an(e) mjerane (Ro.177).

Prapashtesën je- e ndeshim në pak fjalë te vepra e Repishtit, si:

bastisje (P.L.9), *fshamje* (Ro.188), *feksjet* (P.L.82), *shkimjen* (P.L.72), *ndrydhja* (Ro.58), *dremitja* (Ro.134), *çoroditje* (Ro.168).

Prapashtesa -i. Me këtë prapashtesë formohen emra abstraktë nga tema të ndryshme, ndonëse Repishti e përdor rrallë:

agoní (P.L.111).

Prapashtesa **-ues** ka një përdorim të kufizuar nga Repisht, ndonëse vepron në formimin e emrave dhe të mbiemrave që është bërë e mbarë shqipes dhe mbizotëruese në gegërishte, si: ...për “misionin *qytetnues*” ... (Ro.43).

Formimi me nyjëzim ose me nyjëzim e parashtesim, me nyjëzim dhe prapashtesim ose me nyjëzim përngjyjtje e prapashtesim ose nyjëzim, parashtesim dhe prapashtesim.:

Janë disa mbiemra që autori i përdor në vepër me nyjëzim, si:

i zharitun (Ro.275), *i kurdisun* (Ro.54), *i vetëmbrojtjes* (Ro.145), *i përplotun* (Ro.138), *i patëkeq* (P.L.8), *i thukët* (R.73), *i çjerrun*, *i përcëlluem* (Ro.105), *i njimenditë* (P.L.8), *i pambyllshëm* (Ro.77) .

Formimi me parashtesim ose me prapashtesim+nyjëzim

Është një mënyrë jo prodhimtare në formimin e fjalëve. Në veprën e Repishtit ndeshim pak fjalë të tilla, si:

i pacenë (P.L.8), *e ndryme* (Ro.47), *i panjollë* (P.L.122).

Kompozimi

Repishti ka formuar një numër të konsiderueshëm fjalësh të përbëra, ku njëra nga gjymtyrët, si nga ana kuptimore, ashtu të funksionit, sipas ndonjë gjuhëtari ka marrë tiparet e një ndajstese¹. Përdor dendur fjalët *gjysmë-*, *vetë-*, *bashkë-*, *gjithë-* si :

Me gjymtyrën e parë *gjysëm*:

Gjysëm-kufomat (P.L. 66), *gjysëm-errësinën* (P.L.72), *gjysëm-fëminore* (P.L.134), *gjysëm-hije* (P.L.116), *gjysëmilegale* (Ro. 79), *gjysëmterrën* (P.L.109), *gjysëmhyjnuer* (Ro.97), *gjysëmditore* (R. 311). Siç shihet nga shembujt e mësipërm autori ka formuar emra dhe mbiemra. Një dukurori të tillë e vëmë re edhe në autorët jugorë.

- 1. E. Hysa, *Sindajsthesat dhe vendi i tyre në formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, SF, 1986, nr.2, f.96-97. Autori thekson se “në gjuhën shqipe këto morfema nuk dalin si morfema rrënjore, por vetëm si morfema sherbyese, pra si morfema me funksion fjalëformues...plotësisht të barasvlershme me parashtesat.” Në mes shumë shembujsh sjell edhe: gjithë (gjithëgjuhësor), gjysmë (gjysmë bosht)b vetë (vetëdashje) etj.etj., Për këtë problem janë shfaqur mendime. M.Domi në artikullin “Disa shënime për gjuhën e Petro Nini Luarasi”, botuar në përmbledhjen “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, III, Tiranë, 1989, f.455 shkruan : “Gjejmë formime (fjalë të përbëra, A.O.) me ndajfoljen “bashkë” të kthyer në një masë të mirë në prefiksoid...”

Kështu Noli me fjalën gjysmë ka formuar vetëm mbiemra: *gjysmafetar* etj.²

Me gjymtyrën e parë *bashkë*:

Bashkëvendasi, (Ro.337), ***bashkëkonspirator*** (Ro.210). Me gjymtyrën e parë *vetë*: ***vetëdeklaruem (i)*** (Ro.271), ***vetizolim*** (Ro.87), ***vetëshkatërrim*** (Ro.111), ***vetëvrasës*** (Ro.157), ***vetëkënaqësisë*** (Ro. 292).

Formime të tilla me fjalët bashkë, vetë etj. I ndeshim edhe te autorët jugorë si F.Noli.³

Me gjymtyrën e parë *gjithë*: ***gjithëpushtues*** (Ro. 277).

Jo gjithnjë mendimet e gjuhëtarëve kanë qenë të njëjtë. Ne pajtohemi me mendimin se formime të tilla kanë prirje për të kaluar në sindajshtesa dhe në fazën e sotme mund të paraqiten si elemente kalimtare, por duke qenë se nuk i kalojnë katërcipërisht kushtet për të qenë këto në rolin e një parashtese, mund të trajtohen si fjalë të përbëra me status të veçantë, drejt afiksoideve⁴

Janë disa struktura që ka përdorur Repishti në formimin e kompozitave, prej të cilave disa janë me burim popullor, si:

Emër + emër :

Kuvendi-burg ... (Ro.163), ***viktimë-xhelat***, (Ro.119), ***padronit-pushtet*** (Ro.247), ***voglushi-vlla***, (P.L.131), ***njeriun-vlla***, (Ro.237), ***vllaun-njeri*** (Ro.238), ***farmacisti-infermier***, (Ro.179), ***malsori-babë*** (P.L.123), ***nanlokja*** (P.L.57), ***njeriun-polic*** (Ro.186).

F.Agalliu këto formime i quan gjysmëkompozita, shumica të ashtuquajtura ndajshtimore me strukturë dy emra ose emër e një mbiemër, të cilat autori i kan deshur te vepra e F.Nolit.⁵

ndajfolje + emër:

keqbamës (Ro.11).

emër+folje:

gojëhapët (Ro..26), ***ballëhapët*** (Ro.188), ***zemërplasë*** (Ro.28).

Emër +mbiemër:

krahthata (Ro.338), ***grykmadh*** (Ro.120), ***fatmjerë*** (Ro.207), ***gojëndytë*** (Ro.280).

Përngjitja

Një ndër mënyrat e fjalëformimit që ka përdorur në vepër Repishti, është edhe përngjitja, kryesisht me burim popullor. Nuk janë të shumta fjalët e krijuara sipas kësaj mënyre fjalëformimi, të cilat në shumicën e tyre u përkasin pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës, si: ***mish-mash*** (Ro.36), ***gjithnduerësh*** (Ro.44), ***parapa*** (Ro.36), ***(katërmbëdhjetë)*** (P.L.11).

* * *

Me interes në fushën e fjalëformimit të veprës së S.Repishtit janë përdorimet e shpeshta të të ashtuquajturave siparashtesa që autori gjatë veprës i përdor mjaft shpesh dhe që dallohet nga dy autorët e tjerë.

2. F. Agalliu, *Gjuha e Nolit...* Tiranë, 1999, f.61.

3. Po ai, po aty, f.63.

4. T.Osmani-M.Priku, *Rreth disa tipave të fjalëformimit në publicistikën e sotme në sistemin emëror*, në Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë, dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 2007, nr.26/1, f.240.

5. F.Agalliu, vep. e cit.Po ai, po aty, f.61-62

Filip Ndocaj

Prirjet e çdo shkrimtari në fushën e fjalëformimit nuk janë të njëjta, ndonëse në shqipe vepron me një gamë më të gjërë përdorimi kryesisht i prapashtesimit dhe i fjalëve të përbëra. Te Filip Ndocaj, si dhe në dy autorët e tjerë vërehet e njëjta dukuri. Theksojmë se në botimet e viteve të para të krjimitarisë së autorit vërehet një dëshirë për të krijuar kompozita me vend dhe pa vend, ku shumë prej tyre nuk përdoren në fondin aktiv të gjuhës sonë.

* * *

Parashtesimi

Një ndër mënyrat e fjalëformimit në veprën e F.Ndocaj është parashtesimi që zë një vend jo të rëndësishëm në veprën autorit. Janë disa parashtesa që kanë formuar pjesë të ndryshme të ligjeratës nga tema të ndryshme..

Parashtesa **për-** është më aktivja që formon të njëjtën pjesë të ligjeratës, duke i dhënë fjalës së re një kuptim të ri plotësues ose duke formuar një fjalë të re nga tema emërore, si: *përvidhem*, (Sr.79), *përdhunoj* (Sr.79), *përçafë*, (Sr.84), *përgjakë* (Sr.71) etj.

Parashtesa **sh-** krijon fjalë më kuptim intensiv ose të kundërt, si: *shkrryjej*, *shregull* (Sr.76) *sh(zh)biroj* (Sr.48).

Pa- dhe **stër-**, janë shumë pak aktive. Parashtesa *pa* - u ngjitet temave emërore, veçanërisht emrave abstraktë të cilësisë, si: *padituni* (Sr.59), por *paana* (Sr.31). Në veprën e F.Ndocajt e ndeshim edhe me tema mbiemërore, si: *stërgjyshore* (V.13), i *stërkequn* (V.50).

Numri i parashtesave që përdor autori, është shumë i vogël, pasi ne kemi analizuar jo të gjitha fjalët e përdorura me parashtesa, duke përjashtuar ato që i ndeshim në leksikun e mbarë shqipes.

Prapashtesimi

Formime me prapashtesa është mënyra fjalëformuese më prodhimtarja. Jo vetëm se përdoret një numër i konsiderueshëm prapashtesash, por se me anë të tyre janë formuar pjesë të ndryshme të ligjeratës.

Prapashtesat **-ar**, **-tar(-atar)** shumë prodhimtare në formimin e emrave dhe të mbiemrave, kryesisht nga tema emërore, si: *bisedar* (V.100), *amanetqar* (V.84), *mendtar* (V.41), *murtar* (Sr.89), *pishar* (V.7), *kangatare* (Sr.17).

Prapashtesat **-i**, **-(ësi)**, **-ni** formojnë emra abstraktë, por edhe emra me kuptim përmbledhës, si: *çobani* (Sr.24), *njomsi* (Sr.32), *gjakësi* (V.10), *brazni* (Sr.86), *hasmëni* (V.12), *madhni* (Sr.18), *kotni* (Sr.6

-inë. Kjo prapashtesë formon emra abstraktë, por edhe konkretë: *Zymtinë*, *mjegullinë* (Sr.22), *shpatinë* (Sr.95).

Prapashtesa **-isht(e)** formon emra që tregon vendin ku gjendet me shumicë një emër konkret : *kallmishte* (Sr.95), *misrishte* (Sr.95), por formon edhe ndajfolje mënyre, si *hajnisht*.

-nik(anik). Është një prapashtesë që ka një rreze të vogël përdorimi në formimin e emrave dhe të mbiemrave, si: *Pijanik* (V.88), *Shpijanik* (V.16), *Kohanike* (V.247).

Prapashtesat **-o**, **-llo**, **-no**. E para, formant shumë prodhimtar në sistemin foljor të shqipes së shkruar dhe të folur. Janë formuar folje nga tema emërore ose tema të tjera:

cungoj (V.30), *luloj* (Sr.23), *naltojnë* (Sr.91), *cullakoj* (Sr.8), *meroj* (V.29), *gacëlloj* (V.74), *mungulloj* (Sr.67), *lumnoj* (V.38).

Prapashtesat **-ore -tore, -sore, -nore, -ok(e), -oshe**: Formojnë emra, por kryesisht mbiemra marrëdhënore, si: *kafshore* (Sr.91), *tamthore*, (Sr.18), *argjentore* (Sr.20), *baritore* (Sr.41), *vdeksore* (Sr.18), *nusnore* (Sr.22), *vashnore* (Sr.32), *bardhoke* (V.62), *gjelbëroshe* (V.165). Kjo prapashtesë dhe variantet e saj është mjaft prodhimtare në veprën e autorit, ndonëse disa fjalë nuk kanë hyrë në fondin aktiv të gjuhës shqipe.

-xhi. Prapashtesë turke , e cila ka një përdorim të kufizuar te vepra e Ndocajt: *poteraxhi* (V.18).

Autori përdor edhe disa prapashtesa me kuptim përkëdhelie dhe zvogëlimi, si: *dushkëz* (V.28) *fletëz* (Sr.33), *shtëpizë* (Sr.87), *bukurezë* (Sr.32), *cuckë* (Sr.46).

Formimi me nyjëzim

Një ndër mënyrat me një përdorim më të gjerë është formimi i mbiemrave me nyjëzim nga togu parafjalë +emër, pa+ pjesore e foljes si : i *patokë* (V.14), i *pashpresë* (Sr.14), i *pajehonë* (Sr.14), i *pamort* (Sr.95), i *pajetë* (Sr.65), i *papoezi* (Sr.68), *t'pakëndueme* (Sr.610), *t'pambarueme* (Sr.61), *t' pangrënë* (Sr. 63). Përdorime të rralla ndeshim në formimin e mbiemrave nga pjesorja e foljes me nyjëzim , si: *I motnuem* ose një formim analogjik nga pjesorja: *të kamun*.

Kompozimi

Një veçori në fushën e fjalëformimit të F.Ndocaj është përdorimi i kompozitave të krijuara pa ndonjë kriter gjuhësor të disa fjalëve, duke bashkuar dy emra që kanë njëfarë lidhjeje, por nuk janë kthyer në fjalë të përbëra, vetëm që dallohen prej autorit nga ana drejtshkrimore, duke i shkruar me një vijë në mes ose së bashku që kjo lidhje i afron me kompozitat. Të tilla mund të shënojmë, si *qyteti-kangë* (Sr.66), *dashuni-robni* (Sr.20) .

Ndërsa kemi një numër fjalësh të përbëra të cilat dallohen nga marrëdhëniet në mes gjymtyrëve. Kështu ndeshim kompozita përcaktuese të ndërtuara sipas këtyre strukturave: Emër + emër : *Buzagazin* (Sr.59), *faqe-bakër* (V.145).

Emër + mbiemër ose ndajfolje: *buzëthatë*, (V.106) *Gjakhuptë* (V.51), *Ftyrvrantë* (Sr.77), *Deg'blerë* (Sr.30), *Dashamirë* (V.15), *Orëpreme*, (V.73) *Kaltërsiplotë*, (V.207), *ballëhaptë*, (Sr.7), *Shqipni-shkretën* (Sr.64).

Folje + mbiemër ose ndajfolje : *Hjekakqij* (Sr.73).

Kemi kompozita të tilla ku gjymtyra e parë është një emër në rasën emërore, trajta e pashquar, si: *shtëpi-kulla* (V.13), *flakë-shkëndija* (Sr.66), *luftë-gjaku* (Sr.60) ose jo në emërore, trajta e shquar: *kangën-gjamë* (Sr.3), *forcën -vrull* (Sr.57), *popullit-rob* (Sr.64), *kangës-zjarr* (Sr.92)

Autori përdor edhe krijime të tilla që nuk përlligjen, si: *kamjonash-burgosje* (Sr.7).

Kemi gjithashtu ndonjë rast që ndonjëra prej tyre mund të interpretohet si togfjalësh, por dallohet se gjatë lakimit ndryshon vetëm gjymtyra e parë.

Autori në dy veprat e shfrytëzuara nuk përdor një larmi mjetesh fjalëformuese, ndonëse vërejmë ngritje edhe në këtë rrafsh nga vepra në vepër.Kjo ka qenë e kushtëzuar nga dija e kohës edhe nga vetë përgatitja gjuhësore e autorit. Me kalimin e viteve gjuhësia shqiptare njohu vepra dhe studime me vlerë në rrafshin fjalëformues që ndikuan patjetër te shkrimtarët tanë, gjë që vërehet edhe te autori ynë në veprat e botuara kryesisht pas viteve '70 të shekullit të kaluar.

Përmbledhje e kreut të katërt

Të tre autorët edhe në rrafshin fjalëformues kanë gjëra të përbashkëta dhe dallime. Në nuk kemi analizuar të gjitha mënyrat dhe mjetet fjalëformuese që janë zbatuar në veprat e tre autorëve, pasi nuk i shërbente objektit të doktoratës sonë, por ato mjete gjuhësore që janë zbatuar në gegizmat e përdorura. Sigurisht që ato nuk pasqyrojnë të gjitha mënyrat fjalëformuese që përdoren në gjuhën shqipe. Autorët kanë përdorur edhe neologjizma të sajara sipas përgatitjes së tyre filologjike, disa prej të cilave mund të jenë edhe krijime popullore.

Arshi Pipa, ndër mënyrat më produktive përdor prapashtesimin, që është veçori edhe e gjuhës së sotme shqipe, gjithashtu edhe disa parashtesa të cilat po ashtu janë produktive edhe sot në shqipe.

Kështu prapashtesa *-o* me variantet e saj *-ore (-nore)*, *-zo* nga tema të ndryshme kanë krijuar një numër të konsiderueshëm foljesh apo mbiemrash, si: *afshoj*, *nusore*, *mëkatnore* etj.

Përdor edhe prapashtesa të tjera, të cilat janë prodhimtare në veprën e A. Pipës, por edhe të gjuhës së sotme shqipe, si: *-isht(ë)* që te autori ynë paraqitet me variante *:-ishte*, *-ishtë*, *-isht: lamishte*, *madhnueshëm* etj.

Te vepra e Pipës ndeshim edhe prapashtesa të tjera, si: *-tar(e)*, *-nik(e)*, *-im*, *-i*, *-si* etj.

Ndërsa formimi i fjalëve me parashtesa të tilla, si: *për-*, *pa-*, *stër-*, *zh-* janë të pakta.

Ndër mënyrat fjalëformuese të përdorura nga Arshi Pipa mund të përmendim:

Formim me nyjëzim; formim me parashtesim ose ma prapashtesim plus nyjëzim.

Në mënyrat fjalëformuese një vend të rëndësishëm zë kompozimi.

Ato janë ndërtuar sipas këtyre strukturave: emër + emër, emër + folje, ndajfolje + emër foljor, si dhe ndonjë strukturë tjetër.

Te vepra e Pipës ndeshim edhe fjalë të formuara me përngjitje, por edhe me përngjitje dhe prapashtesim.

Sami Repishti

Parashtesimi është në ndër mënyrat që autori ynë ka përdorur. Janë analizuar këto parashtesa: *për-*, *pa-*, *stër-*, *sh/ç-*, *ri-*, *tej-*, *jo-* me të cilat nga tema të ndryshme janë formuar emra apo mbiemra.

Shumë prodhimtarë paraqitet formimi prapashtesor në veprën e Sami Repishtit. Janë disa prapashtesa që autori ka përdorur, si: *-o*, *-ore*, *-no*, *-ue*, *-inë*, *-im*, *-as*, *ni*, *-ës*, etj. Ato nga tema të ndryshme kanë formuar folje, mbiemra, emra.

Autori përdor edhe mënyra të tjera fjalëformuese, si:

Formimi me nyjëzim; Formime me nyjëzim dhe prapashtesim; Formim me nyjëzim dhe parashtesim; Formim me nyjëzim dhe parashtesim dhe prapashtesim; Formim me nyjëzim, përngjitje dhe prapashtesim.

Kompozimi

Repishti ka formuar një numër të konsiderueshëm fjalësh të përbëra, por të ndërtuara me fjalët: *gjysmë-*, *vetë-*, *bashkë-*, *gjithë-*, ku njëra nga gjymtyrët si nga ana kuptimore, ashtu të funksionit, sipas ndonjë gjuhëtari, ka marrë tiparet e një ndajstese .

Repishti ka përdorur në fjalët e përbëra këto struktura: *emër + emër*, *emër + folje*, *emër + mbiemër*, *ndajfolje + emër*.

Përngjitja

Një ndër mënyrat e fjalëformimit që ka përdorur në vepër Repishti është edhe përngjitja, kryesisht me burim popullor si: *mish-mash*, *gjithnduerësh*.

S.Repistit, siç e theksuam edhe më sipër, përdor të ashtuquajturat siparashtesa që dallohet nga dy autorët e tjerë.

Filip Ndocaj

Edhe F.Ndocaj në fushën e fjalëformimit do të ndjekë atë rrugë si dy autorët e tjerë, por veçohen njëri nga tjetri, mbasi nuk kanë përdorur gjithnjë të njëjtat mënyra të fjalëformimit me të njëjtin intensitet. Shumë pak prodhimtarë paraqitet parashtesimi, ndërsa prapashtesimi zë një vend më të gjerë.

Kemi veçuar këto prapashtesa në formimin e fjalëve nga autori: *-ar*, *-tar (-atar)*, *-i*, *-(ësi)*, *-ni*, *-nik*, *-(unik)*, *-o*, *-llo*, *-no*, *-inë*, *-ore*, *-tore*, *-sore*, *-nore*, *--osh*, *-xh*.

Një mëyrë tjetër e përdorur nga F.Ndocaj është formimi me nyjëzim.

Dihet se pas prapashtesimit formimi i fjalëve të përbëra zë një vend të rëndësishëm edhe te F.Ndocaj.

Kompozimi

F.Ndocaj me të vërtetë ka krijuar një numër të konsiderueshëm kompozitash, por struktura në disa formime të lë për të dëshiruar, pasi ata merren si të tilla vetëm se autori ka përdorur një vijë lidhëse: *qyteti-kangë* (Sr.66), *dashuni-robni* (Sr.20) .

Por ndeshim kompozita përcaktuese të ndërtuara sipas këtyre strukturave:

emër + emër *emër + mbiemër ose ndajfolje*, *folje + mbiemër ose ndajfolje*.

Kemi kompozita të tilla ku gjymtyra e parë është një emër në rasën emërore, trajta e pashquar, ose jo në emërore, trajta e shquar.

Autori përdor edhe krijime të tilla që nuk përlligjen, siç i përmendëm më sipër.

Kemi gjithashtu ndonjë rast që ndonjëra prej tyre mund të interpretohet si togfjalësh, por dallohet se gjatë lakimit ndryshon vetëm gjymtyra e parë.

* * *

Autori në dy veprat që kemi shfrytëzuar, nuk përdor një larmi mjetesh fjalëformuese, ndonëse vërejmë ngritje edhe në këtë rrafsh nga vepra në vepër. Kjo ka qenë e kushtëzuar nga dija e kohës edhe nga vetë përgatitja gjuhësore e autorit. Me kalimin e viteve gjuhësia shqiptare njohu vepra dhe studime me vlerë në rrafshin fjalëformues që ndikuan patjetër të shkrimtarët tanë, gjë që vërehet edhe te autori ynë në veprat e botuara kryesisht pas viteve '70 të shekullit të kaluar.

Kreu i pestë

Tipare morfologjike të veprave të tre autorëve: Pipa, Repishti, Ndocaj

Edhe në rrafshin morfologjik të tre autorët në veprat e shkruara në gegërisht pasqyrojnë veçoritë gjuhësore të së folmes që përfaqësojnë, kryesisht të folmes së gropës së Shkodrës. Ne nga analiza që do t'u bëjmë këtyre dukurive, do të vëmë re se autorët nuk kanë qenë gjithnjë koherent në përdorimin e së njëjtës trajtë në shkrimet e tyre. Kështu ne kemi konstatuar edhe luhatje, ndonëse nuk kanë qenë në një numër të konsiderueshëm.

Edhe në fushën e morfologjisë mund të themi se autorët nuk kanë zgjedhur çdo trajtë që mund të përdorë një grup i vogël përdoruesish gegë, por ato trajta që janë tipike për të folmen e gegërishtes veriperëndimor, një gegërishte letrare, e cila po qendron gjithnjë e më shumë afër gjuhës së sotme.

Sigurisht ne jemi përpjekur, ndoshta jo gjithnjë, që të veçojmë ato trajta që dallohen nga gjuha e sotme letrare, por nuk kemi përjashtuar edhe ata trajta të përdorura të mbarë shqipes.

Metodologjia në këtë aspekt do të jetë e tillë: Çdo kategori gramatikore do të trajtohet për secilin autor, duke shënuar ç'është e gegërishtes dhe ç'është e mbarë gjuhës dhe në fund të këtij sythi do të bëjmë sintezën e tij.

Siç e theksuam edhe më sipër ndryshimet me gjuhën e sotme nuk janë të thella, por janë tipike për gegërishten.

Në gjithë veprimtarinë e tyre autorët janë udhëhequr nga Vendimet e Komisionit Letraro Shqipe në Shkodër (1916-1918) dhe vendimin e qeverisë së vitit 1923, por jo gjithnjë. Ata kanë ndjekur edhe zhvillimet e gjuhës së sotme shqipe, të pasurimit të saj.

Veçoritë morfologjike të veprave të tyre nuk pasqyrojnë gegërishten e gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe gjysmës së parë të shekullit XX, por të viteve të mëvonshme. Ashtu si dialekti vepron mbi gjuhën letrare shqipe, ashtu edhe ajo ka pasur ndikimin e saj mbi dialektin, duke mënjanuar ata trajta tashmë të izoluara që nuk i shërbenin komunikimit në mes përdoruesve të shqipes.

Kështu, siç e kemi shënuar edhe në krerët e mësipërm se gegërishtja e tre autorëve është e lexueshme dhe e pranueshme nga shqipfolësit, pasi ata mënjanuan trajtat nëndialektore dhe përdorin një gegërishte letrare në shumë vise të kodifikuara, që vihet re gjatë gjithë veprës së tyre.

Me të vërtetë ata ecën në gjurmët e paraardhësve, por vepra e tyre është një hap përpara, meqë ata jetuan në një kohë tjetër, kur edhe gegërishtja duhet të ecte në gjurmët e lëvritimit dhe zhvillimit të gjuhës kryesisht për kodifikimin saj në trajtat morfologjike, pa përjashtuar ata sintaksore dhe drejtshkrimore, por gjithnjë me prirje afri ndërdialektor.

Arshi Pipa

Autori ynë edhe në fushën e morfologjisë vazhdon të ruajë traditën, duke shkruar në gegërisht, megjithëse në ndonjë rast ka edhe shkarje nga dialekti që përfaqëson, duke ditur se A.Pipa jo gjithnjë mund të ketë pasur mendjen te gjuha sesa te ngjarjet që përshkruan. Siç e kemi theksuar edhe më parë dy librat që ka botuar me shkrime nga jeta në burg, janë poezi, kurse në prozë nuk kemi ndeshur, pasi krijimet, kryesisht studimore, i ka në anglisht.

Në vitin 1990 A.Pipa së bashku më Anton Logorecin dhe Martin Camajn nxorën në SHBA revistën “Albanica”, nr.1, ku kishte katër rubrika me karakter albanologjik. Numri 2 qarkulloi në vitin 1991 dhe iu kushtua Martin Camajt, një numër me një nivel shumë të mirë, duke qenë se edhe pjesëmarja e artikullshkruesve që më e gjerë. Nr.3-4 u botua në fund të vitit 1992, sapo kishte vdekur A.Logoreci dhe M.Camaj. Për arsye financiare ky organ nuk qarkulloi më.

Është për të ardhur keq se nga Arshi Pipa kemi vetëm një shkrim në gjuhën shqipe, në numrin 1 të kësaj reviste, të titulluar “*Bogdani dhe gjuha shqipe*” prej 18 faqesh, të cilin do ta shfrytëzojmë në punimin tonë. Theksojmë se ky studim është shkruar me një gegërishte të zgjedhur, larg formave arkaike, por jo larg edhe standardit të sotëm. Gjithashtu është një shkrim me vlerë si nga ana studimore, ashtu edhe gjuhësore, siç do ta shohim gjatë analizës së gjuhës së veprës së A.Pipës.

1.Emri

Gjinia e emrit

Pipa dallon kryesisht dy gjini: mashkullore dhe femërore, shumë rrallë edhe gjininë asnjë në pak emra. Disa emra mashkullore ose asnjë që janë përdorur më përpara në trajtë e pashquar, i përdorur pa *ë*-në fundore : *burr, djall, djal, kal* etj.

...je e trim trim e *búrr*...(R.29).

...*Djáll* me njoftë çka dijsa...(R.77).

...Rushë , një nânë un kam e ajo një *djál*...(R.50).

...Peshë mandej e çon, e vën mbi *kál*...(R.26).

Autori në këto emra zanoren e temës e përdorur me theks të mprehtë.

Pipa nuk ka përjashtuar edhe ndonjë emër në gjininë asnjë si: emrat *ujë, lesh, miell* etj. që i përdorur rrallë dhe që shumësin e formojnë me prapashtesën *-na*:

...e doli dielli furfuritën *ujnat* prej rrezatimesh metalike...(L.B.18).

...Rëshqâhej n’*ujna* t’amullta...(L.B.107).

...me grillën e shkrifun te *lesht* e krahnorit...(L.B.46).

...e ngjyen me *miell*t e huej... (L.B.54).

Dygjinisia

Është një dukuri relativisht e vjetër e shqipes që ngjet në emrat e jofrymorëve. Sipas Sh.Demirajt në dialektin e verior kjo duhet të kenë qenë përhapur mirë që në periudhën paraletare të shqipes d.m.th. që përpara shekullit XVI, gjë që dëshmohet nga gjuha e autorëve të vjetër.¹

Kjo dukuri, para se të kthehej në normë, është përdorur edhe ndër disa shkrimtarë jugorë. Kështu Fan Noli, sipas gjuhëtarit F.Agalliu, radhitet ndër ata autorë që ndërrimi i gjinisë në numrin shumë për emrat e gjinisë mashkullore që marrin prapashtesat *-e* dhe *-ra* vjen e ngulitet e bëhet normë përdorimi.²

1. Sh.Demiraj, *Rreth ndërrimit të gjinisë së emrave në numrin shumë, vështruar edhe në përfaqje me rumanishten*, në veprën e autorit “Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe”, Tiranë, 1972, f.56.

2. F.Agalliu, *Gjuha e Nolit*...Tiranë, 1999, f.97.

Ndërsa gjatë gjithë krijimtarisë së A.Pipës, emrat e gjinisë mashkullore, që në shumë marrin prapashtesën *-e*, e cila sot është kthyer normë,³ e marrin mbiemrin-përcaktor në trajtën e gjinisë femërore, por edhe përemrat qoftë para ose pas emrit e ndërrojnë gjininë: Ta kishte shkruajtë auktori kerë libër ndër *kushte të ndryshme...*(L.B.91).

...ndër *pushtimet e njimbanjishme...* (L.B.118).

...struken të mjerat ndër *çerdhet e duken vaj cingrimet e rralla...* (L.B.165).

...tue pushtue *viset malore* të Drinit... (R.6).

...bani *studime të rregullshme* ... (P.112.).

...ndër *kto botime ma të randësishme*. (P.119).

...edhe mergatet tjera për *vendet e veta...* (P.124).

...ndër *mendimet e mija...* (LB.30).

Ndërimi i gjinisë vërehet edhe tek disa emra lëndorë që shumësin e bëjnë me prapashtesën *-na*, e që mbiemrin e duan të gjinisë femërore:⁴

Rëshqahej *n'ujna t'amullta* (L.B.107).

Dukuria e dygjinisë, ndryshe nga ligjërimi i folur i gegërishtes, në krijimet e A.Pipës nuk vepron në emrat e gjinisë mashkullore me prapashtesën *-a*.

...Me Bogdanin metrika shqipe bân *hapat e parë...*(P.117).

... kanë *elementa* të përbashkët... (R.6).

Sami Repishti.

S.Repishti në veprat dhe në krijimtarinë e tij publicistike e botuar pas vitit 1972 përdori përsëri gegërishten. Ne kemi vërejtur se gegërishtja e tij edhe në rrafshin morfologjik nuk është me tipare të theksuara dialektore. Ajo paraqitet mjaft e zbutur, por duke ruajtur dallimet kryesore në mes dy dialekteve. Kështu kemi, siç e theksuam edhe më sipër, një gegërishte letrare me prirje afruese me gjuhën standarde. Një veprim i tillë, ndoshta nuk ka qenë i ndërgjegjshëm, por i ndikuar nga vetë shqipfolësit dhe nga trysnia e gjuhës zyrtare që vepron jo drejtpërdrejt në shkrimet e autorëve të sipërpërmendur. Kjo ka bërë që ndryshimet në disa forma gramatikore dhe fonetike janë të papërfillshme.

Le të ndalemi në ato dukuri morfologjike që i përkasin gegërishtes, por që i kemi konstatuar te vepra "*Pika loti*"(1997) e S.Repishtit, që është vepra e tij e parë, e shkruar 25 vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972, por jo rrallë edhe te vepra "*Nën hijen e Rozafës*."(2004).

³Drejtskrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1973, f.110-111; Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë, 1976, f.11-13, 50-51.

⁴Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002, f. 92.

Emri

Dygjinisia

Është një dukuri e gegërishtes që vërehet te disa autorë veriorë, siç e theksuam më sipër, por si dukuri është hershme që e ndeshim që në veprën e parë të gjuhës shqipe “Meshari” i Gjon Buzukut i vitit 1555 dhe që vazhdon edhe në shekujt e mëvonshëm dhe u përhap në shkrimet e disa autorëve jugorë.¹

E ligjëruar dygjinisia është pranuar edhe në ortografinë e gjuhës shqipe të vitit 1956 në emrat e gjinisë mashkullore që në shumës dalin me prapashtesat *-e, -a, -ra*.² Në Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe të botuara në vitin 1973 ajo pranohet si normë drejtshkrimore. Aty shenohet se mbiemrat të cilët përcaktojnë emrat mashkullore në shumësin me prapashtesën *-e*, në numrin shumës përdoren në trajtën e gjinisë femërore, si dhe emrat mashkullore dhe asnjansës me *-ra*.

Edhe Sami Repishti zbaton një rregull të tillë, me ndonjë përjashtim të rrallë. Emrat e gjinisë mashkullore në bashkëvjajtje me mbiemra apo përemra ndërrimin e gjinisë në shumës e ndeshim kur marrin prapashtesën *-e*, dhe kështu intergrohen në gjininë femërore si:

Oborret e gjelbra nuk më flasin ma ashtu si dje... (P.L.128).

...fati i kishte hedhë në *vende të hueja*... (P.L.140).

...të ndërtimit të një asenali të tmerrshëm për *krime të reja* e përherë më shumë... (P.L.143).

...pashë studentët që formojshin *batalionet vullnetare*... (P.L.150).

...premtimet *gënjeshtare*...tingëllonin në veshët tanë... (P.L.151).

...*Instiktet e këqija* nuk kanë mungue asnjherë. (P.L.144).

...kishin kushtëzue *veprimet e mia* gjatë atyne vjetve... (P.L.19).

...do të kalojshin shpejt *këto çaste* lumtunie të plotë për te... (P.L.16).

Por siç e theksuam, autori nuk është gjithnjë koherent, pasi kemi ndeshur edhe raste kur nuk vepron ky fenomen;

...*Këta kujtime* po më mbulojshin njëni pas tjetrit... (P.L.129).

...që fitohen në bankat e shkollave dhe randësinë e *horizonteve të rij*... (P.L. 8).

...U detyruan të punojnë pastrim...dhe mirëmbajtje të *puseve skeptikë*... (P.L.141)

...grupi i studentëve nga *të tre burgjet* e Shqipnisë... (Ro.205).

...Zemrën e nanës sime *ata vorre* e kishin fitur njëherë e përgjithmonë. (P.L.7)

1. Sh. Demiraj, *Rreth ndërrimit të gjinisë së emrave në numrin shumës në gjuhën shqipe, vështruar edhe në përfaqje me rumanishten*, në veprën e autorit “Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe”, Tiranë, 1972, f.65. Autori e konsideron këtë dukuri relativisht të vjetër e përfutuar që në periudhën paraletare të shqipes, por koha e zanafilles së saj për mungesë dokumentesh më të vjetra, nuk mund të përcaktohet më tej.

2. Shih : R.Ismajli, *Drejtshkrimet e shqipes*, Prishtinë, 2005, f.291

Por S.Repishiti nuk e përshtat numërorin me emrin, gjë që vërehet në një fjalë të përngjitur, por edhe në ndonjë rast tjetër që numërori tre përdoret me emra të gjinisë femërore:

...nga ai mësova se në tre kryeqytetet e fuqive aleate...(Ro.71)

...Tre orë e gjysëm ma vonë hymë në stacion...(Ro.68).

...Trupat e tyne i mbulonte një flamur *tren gjyresh* italian. (Ro.41).

Repishti e ngushton këtë dukuri, duke e përdorur vetëm në një grup emrash, e pikërisht në emrat e gjinisë mashkullore që në shumës marrin prapashtesën *-e*, dhe që e rekomandon edhe drejtshkrimi i gjuhës standarde.³

Gegërishtja e shtrin edhe më tej këtë dukuri, duke e zbatuar edhe në shumësin me *-a*, gjë që, siç e theksuam më sipër, në shkrimet e S.Repishitit nuk vërehet ndërrimi i gjinisë në shumësin e emrave me këtë prapashtesë:

...pashë vëllaun që u kthye me *hapa të shpejtë*...(P.L.134).

...një kasolle me dërrasa kompensate , *kartona të trashë* e disa tabakë plastikë...(P.L.128).

Por ndeshim edhe raste të izoluara, kur shumësi del me *-a*, ndërsa përcaktori mbimërd përdoret në gjininë femërore dhe mbiemri tjetër që duhet të përshtatet me emrin është në gjininë mashkullore:

...*Shenjat e para* të një papajtueshmënie me gjendjen e krijueme ishin *të qartë*. (Ro.43).

Filip Ndocaj

Emri

Gjinia

F.Ndocaj dallon dy gjini: gjini mashkullore dhe femërore, por për ndonjë emër edhe gjininë asnjëse, duke e përdorur herë në gjininë mashkullore, herë në gjininë asnjëse:

... s'shtijmë në gojë pije tjetër veç **ujit**... (D.162).

...I qiti **ujë** faqeve...(D.162).

...në do me u flladitë me këta **ujë** kroni... (D.153).

... **ujët** tue value , gufoi jashtë...(D.131).

... ra te '**ujët** e mirë...(D.130).

...vërshon **ujët** e saj...(V.).

...e kështu gjithnjë...deri sa *ujt*' e vise...(SR.8)

...Nuk kemi ardhë këtu me lanë **kryet**...(D.326).

3. *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f.110-111

Dygjinisia

Ashtu si dy autorët e tjerë ndërrimin e gjinisë e ndeshim tek emrat e gjinisë mashkullore, të cilët kalojnë në gjininë femërore kryesisht kur marrin prapashtesën **-e**. Ndërrimi i gjinisë vihet re me ndryshimin e gjinisë së fjalëve përcaktuese, të cilat tek F. Ndocaj mund të jenë përemra dëftorë, pronorë dhe të pacaktuar.p.sh.

...**ligjet e zakonet e tjera pratiarkale**... (D. 98).

...me **këto mendime** i kujtohet Lulash Preka... (D. 99).

...si e kishte zakon **këso rastesh**... (D.123).

...Plaku, i ngulun në **paragykimet e veta**... (D. 142);

...me **këto dyshime** ra te kulla e vjetër e u ngjit të hynte... (D. 152).

...kur më thanë se punoje në **këto pyje**... (D.157).

...Me **këso mendimesh** ai hangri drekën... (D. 258).

...kanë ecur goxha mbi planin dhe **parashikimet tona**... (D. 263).

...na jep të dhëna të çmueshme për **studimet tona**... (D.263).

...tue sjellë nëpër tru gjithë **ato mendimet**... (D. 267).

...malësia e malësorët me gjithë **ato ndryshime**... (V. 40).

...megjithëse **këto vitet** e fundit s'i ndiente shije... (V.53);

...shumë ma tepër se **këto vitet** e fundit... (V. 234).

...përfituen shumë prej **mësimeve të tija**" (V. 240).

Në raste të tjera fjalët përcaktuese mund të jenë mbiemra:

...a pak **sugjerime** dhe **racionalizime të vlefshme** bajnë të rinjtë... (D.123).

...**ambientet** tipike të Shkodrës...(D. f.51).

...a pak **sugjerime** dhe **racionalizime** të vlefshme bajnë të rinjtë...(D.123).

... mësimit janë të lodhshme e **katundet** e hapëta...(D. 187).

...ndikonte aq shumë në lidhjen e tij me **gjurmimet** shkencore... (D.190).

...e lanë Palin me **mendime të shumta** të zbriste kah kulla e vjetër... (D.152).

...Pse nuk provon të vazhdosh **studimet e ndërprera**?... (D.158).

...nuk ishte gjetë në **mendime** kaq **të zymta**, kaq **tronditëse**... (D.259).

...të lidhun ngushtë me **zakone të vjetra** e **paragykime prapanike**" (V.12).

...kishte sjellë "**bidate**" të reja në katund të vjetër... (V. 17).

...për **botëkuptimet e vjetra** që kishin mbetë... (V. 239).

...u nënshtrohen **zakoneve të vjetra**... (V. 267).

...nxirrte si **ankime të shqetësuese**. (V. 275).

...**paragykimet e parimet** fetare që qëndronin... (D.191).

Si raste të izoluar ndeshim dygjinisinë në shumësin me prapashtesën **-a**:

...I thanë të përgatitën **dokumentat shkollore**...(D. f.41).

2. Shumësi i emrave dhe kategoria gramatikore e rasës

Arshi Pipa

Me interes është shumësi i emrave të vepra e Arshi Pipës, veçanërisht i gjinisë mashkullore, pasi edhe në gjuhën e sotme është shumë i larmishëm.

Shumësi i emrave të gjinisë mashkullore

Shumësi me prapashtesën -e.

Kjo prapashtesë vepron kryesisht në shumësin e emrave abstraktë, ashtu edhe në emrat konkretë, prandaj do t'i grupojmë:

-Shumësi me prapashtesën *-e* në formimin e emrave të vendeve etj., si:

...*vendet më të përshtatshme* për me mbajtë ditare...(L.B.9).

...zile dhensh gjegjeshin ndër kope *shpateve*...(R.59) .

në emrat abstraktë dhe konkretë të parmë:

...na e venë ndër veshë e n'gojë e der në *turpe*...(L.B.51).

...kët libër ndër *kushte të ndryshme* prej atyne ndër të cilat jetoi...(L.B.9).

...të mos ishte vetëm një seri kronologjike *faktesh* të jetës...(L.B.10).

...Mbi pusa, gdhendun n'gur, *mure* avullije...(L.B.43).

Kjo dukuri vepron më shumë në emrat abstraktë me prapashtesën –im:

...E ma nuk ndjellë ndër *mendimet e mija*...(L.B.30).

...që të gjithë veshtojshin tretun ndër *kujtime t'ambla* qi ato zgjojshin...(L.B.191).

...Prani Bora e bjerrun ndër *kujtimet*... (R.20).

Vinte e buk'ra qi me frymë e sh'ndoshi/ herë mbas here për *mjekime* varre...(R.28).

...që merret me studimin e *shkrimeve* ...(P.106).

...ndër kto *botime* më të rëndësishmet janë...(P.119).

E bëjnë shumësin me prapashtesën –e edhe ato emra që në shumës pësojnë ndryshime fonetike:

...Në çastin kur po vëhem me i paraqitë lexuesit kto *vargje*...(L.B.9).

...Qysh lindi një libër ndër *burgjet*...(L.B.10).

...Ti vuetjje , si *rreziqe* durove simbas stinës... (L.B.6).

Pipa shumësin e emrit kuadër e bën me prapashtesën –e:

...ku zhvillohet ndër *kuadre* të ndryshme...(L.B.11).

Ndërsa drejtshkrimi i sotëm rekomandon që shumësi i emrit *element* kur nuk përfaqëson frymor merr prapashtesën *-e*, dukuri që nuk e vërejmë te Pipa , i cili e rrafshon këtë dukuri, duke e përdorur këtë shumës vetëm me prapashtesën *-ë*:

...mbi të cilin spikasin ata *elementë* të lyrikës....(L.B.11) .

Edhe në raste të tjera qoftë frymorë ose jo shumësin tashti e bën me prapashtesën –a:

...O shembull i *elementave* / o motër dashunije!...(L.B.108).

Të gjithë këto emra që marrin në shumës prapashtesën –e integrohen në gjininë femërore.

Shumësi me -ë

Si dhe te autorët që po analizojmë, ky shumës është shumë produktiv dhe vepron në një kategori të caktuar emrash e konkretisht:

Në emrat e frymorëve që tregojnë banorët e një vendi:

Shqiptarëve (P.123), *serbëve* (P.123), *hungarezëvet* (P.108), *kosovarët* (P.124), *bullgarë, grekë, rusë* (L.B.77).

-në emrat e frymorëve me prapashtesat *ent, tor, ar, tar* etj.

Elementë (L.B.11), *studentëve* (P.121), *fajtorët*... (L.B.60), *shkollarë, tregtarë, zyrtarë* (L.B.201), *ushtarë*... (L.B.9), *auktorëve*...

-në emrat me fundoret r, n, k, t etj.:

...dëshmorë, gjerdanë, dyrekë, shokë, lotë, oficerë, xhelatët.

Siç vërehet nga materiali i vjelë, A.Pipa nuk ndjek traditën gege, por në shumësin e disa emrave përdor trajtën e mbarë shqipes, ndonëse jo pa luhatje, si: *studentë, oficerë, milionë*, por edhe *lotë*.

Por në shumësin e ndonjë emri vërehen edhe luhatje. Siç e shenuam më sipër shumësi i fjalëve *element, student* përdoret me prapashtesën –ë, por e ndeshim edhe me prapashtesën –a, dukuri dialektore:

...O shembull *i elementave*, o motër dashunije! (L.B.108),

...shqipja dhe rumanishtja kanë *elementa* të përbashkët në gramatikë dhe leksik...(R.6).

...kush janë e çka lypin *studenta*, puntorë...(L.B.193).

Nuk janë të rralla që disa emra i përdor autori në shumës pa prapashtesën –ë qofshin emra të gjinisë mashkullore, qofshin të gjinisë femërore:

qerpikve (L.B.83), *gurve* (L.B.172), *flokve* (L.B.83).

Shumësi me –a

Ndonëse shumësi me prapashtesën –a vepron më shumë në gegërishten se në toskërishten në emrat e tri gjinive, në veprat e A.Pipës e ndeshim më shumë si trajtë e mbarë shqipes dhe jo krahinore, ndonëse do të vërejmë edhe trajta dialektore dhe të dyzuara. E marrin këtë prapashtesë emrat:

Kamjona (L.B.45), *pusa* (L.B.43), me shkundun *mandat* bademlij...(L.B.43), *xhahila* (L.B.56), *shqelma* (L.B.63) *spijuna* (L.B.74).

...e me ngarkue *vagonat* me dhé...(L.B.46):

...varun për shpatullash e mbi maje *gishtash*...(L.B.51).

...queji veç *komunista*... (L.B. 56).

...ju *kriminela*, ju duhet me ju varë...(L.B.39).

... për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe botimin e *libravet* shqip...(P.118).

Ndryshe nga standardi, edhe shumësin e fjalëve: *kontinent, majmun, sapun, kamjon, grusht* autori e bën me prapashtesën –a,:

...E prej pësë *kontinentave* ku ka besnik mizori...(L.B.156).

...njerzit i bante soj me *majmunat*!...(L.B.59)

...mandat e zez qi nuk i hiqej gjurma me dy *sapuna*... (L.B.44).

...mbi xhelatët e popullit, *xhahila*...(L.B.56).

...zbrazen *kamjona* me gurë... (L.B.45).

...shtërngon ndër *grushta*... (L.B.46).

...tanda ndër oborre mbi *pusa* gdhenun n’gur... (L.B.43).

Por Pipa nuk është gjithnjë konsekuent, pasi për emrin pus ndeshim edhe shumësin me –e:

...Vijshin kafet me poçat e djersitun uji *pusesh*...(L.B.44).

Është një dysi drejtshkrimore e përdorur nga autori, ndonëse norma e sotme pranon vetëm shumësin me prapashtesën –e.

Shumësi me -na

Janë pak emra të tri gjinive, konkretë ose abstraktë që e bëjnë shumësin me –na:

...ndër *qiellna* t’lira zhgrehë...(L.B.52).

...e doli dielli e farfuritën *ujnat*...(L.B.18).

...Poema u shkruajt ndër *kohna* të ndryshme...(L.B.199)

...rrjedhin prej mushemas mbi *krena* e shtroje...(L.B.63).

...ndër t'gjitha *kohnat* endër t'gjitha vendet...(L.B.59).

...na futej deri n' *eshtnat* e krahnorit...(L.B.70).

...e stepa qenë *dëshmina* janë e prova...(L.B.71).

...Kulshedra e re me *lakminat* e vjetr...(L.B. 23).

Disa prej këtyre emrave të gjinisë femërore nga A.Pipa përdoren edhe me ngarkesë stilistikore.

Shumësi me -j

Standardi i sotëm kërkon që të ruhet *nj*-ja në trup dhe në fund të fjalës, në trajtat e shumësit të emrave mashkullorë që mbarojnë me zanore të theksuar ose me *-ua* me ndonjë përjashtim, si shumësi i fjalës *kufij*, *kalamaj*. Në veprën e Pipajt ka luhatje, ndonëse mbizotëruese është prapashtesa *-j*, pasi autori shkruan në gegërisht. Ky shumësi ka ngjallur diskutime, të cilat janë pasqyruar në disa shkrime të botuara në shtypin shkencor.¹

Në standardin e sotëm emrat mashkullorë që dalin me *-i, -e, -o, -a* ose *-u* të theksuar e formojnë shumësin me prapashtesën *-nj*, por ndryshe nga dy autorët e tjerë, te Pipa vërehen luhatje, duke i përdorur për disa emra dy trajta, si:

...Nevoja është nana ime/qi n'gjak m'randon e n' *gjij*....(L.B.90).

...thehet te beli e hovin *gjinjt* e paktë...(L.B.83)

...Shqipnija e sotme mbrenda *kufijvet* të vet...(R.6).

... e t'mbetunve qi ie fshajnë përtej *kufinjve*...(L.B.15).

Theksojmë se trajtën me prapashtesën *-nj* te emri *kufij* Pipa e përdor më dendur se trajtën me *-j*.

Shumësin e fjalës *kalama* e përdor me prapashtesën *-nj*, ndryshe nga standardi i sotëm që normë ka prapashtesën *-j*. Ndeshim më rrallë edhe trajtën me *-j* :

...mandej u-qas ndaj shtrojeve ku flëshin *dy kalamanjt*... (L.B.16).

...krisshin qerre rrugave , te sheshi lueshin *kalamâj* ...(R. 59).

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për emrat: *çilimi, ulli, hu, kushëri, kallli, bri* etj. që autori ka pëlqyer trajtën e shumësit me prapashtesën *-nj*:

...e ndreqe , e mbruze...Por s ka hare pa *çiliminj!*...(L.B.132).

...i thonte e ama: Martoju u bir ! me grunë e *ullinj* plot është hambari...(L.B.132).

...sa tjerë me shqelma ose me *hunj* u-mbytën...(L.B.72).

...qi syt si gurra i rrodhën për shokët e *kushrinjt*...(L.B.58).

...valavisin *kallinj* puhinat...(L.B.46).

...Jehuen tre *brinj* pre pyrgut...(L.B.169).

...nji çel e mshel llozash viganë e *drynj-sh* ...(L.B. 156).

1.M. Çeliku, *Probleme të diskutueshme rreth Drejtshkrimit të gjuhës shqipe të vitit 1973*,

në Seminari XVII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Tiranë, 1995, f 217; E.Hysa, *Rreth prirjeve për formimin e shumësit të disa emrave*, në Seminari XX, ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 2002, f.301-302; A.Haxhi-T.Osmani, *Forma të shumësit në rrafshin e planifikimit gjuhësor të shqipes*, në "Shqipja në etapën e sotme:Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit", Tiranë,2011, f.164-172.

Për shumësin e emrave *bari, hero, flori, gju, thua, teneqexhi, fatkeq* etj., Pipa përdor prapashtesën *-j*:

...e një rrunxe me zane fëminore *barijsh*...(L.B.75).

...ai piu me shokët barabar *heroj*... (L.B.169).

...në kanavetë me *florij* ia kumi tri kuletë...(R.10).

...s'foli djali e n' *gjûj* ra tue u lutun...(R.78).

...lakmin e fqinjve, *thojt* e tyne...(L.B.119).

...ata qi deri dje mbajshin kapistra, *teneqexhi*...(L.B.51).

... e vdesin *fatkëqijt* aty te praku...(L.B.71).

Edhe në emrat që në standardin e sotëm e formojnë shumësin me prapashtesën *-enj*, te vepra e Pipajt përdoren dy trajta:

...Hyn një roje. *Shkopinj*...(L.B.63)

...kah thirreshin barijt mbi *shkâmbij* shullâheshin...(R.59).

...ku shpërthejnë prej *shkambinjsh* gurrat e shpeshta...(L.B.115).

...dhe ndër *kopshinjet* qi përgjumte zhegu...(L.B.43).

...për shokët e *kushrinjt*, për farefisnin... (L.B.58).

Por shumësin e fjalës drapër, Pipa përdor *drapinj*...(L.B.46).

Shumësi i emrave me ndërrim tingujsh dhe me ndërrim tingujsh dhe prapashtesë

Pipa, ashtu si në standardin e sotëm, në shumësin me ndërrim tingujsh në emrat e gjinisë mashkullore, në shumicën e rasteve, ka përputhje.

E ndeshim në qiellzorizimin e bashëtingëlloreve prapagjuhore *k* dhe *q* në *g* dhe *gj* e konkretisht:

...prej një kopeje, dimnit, *ujqish* t'unshëm...(L.B.19)

...me djers e njomun *pleqsh*...(L.B.19).

...në vorr i ban t'amshuem ku *bujq* e mbretën...(L.B.148).

...shtypun qysh ishin nga *turqit*...(P.118).

...punën ndërmjet nesh na me e pleqnue bashkë me *miq* e dashamirë bashkue...(R.39).

...kokrrat e grezta *zogj* mâ shpesh ndaj tyne shifen tue ardhë... (L.B.42).

Ndërrim i tingullit *k* në *q* dhe *g* në *gj* + prapashtesë:

...Por mbasi kto vargje janë të parat *vargje*...(P.117)

...Qysh lindi një libër në *burgje*-t...(L.B.10).

...t'i fali stina, o fatlume, ajo qi *trungje* e degë...(L.B.48).

...ti vuetje, ti *rreziqe* durove...(L.B.60).

...dridheshin dy buzë sa mbi *mustaqe*...(R.25).

Jo gjithnjë autori është koherent, se krahas ndërrimit të tingujve, përdor edhe prapashtesën *-ë* në të njëjtën faqe, duke mos e palatizuar grykoren *k*:

...dhe si coftina i kallin ndër *hendekë*...(L.B.71).

Shumësi i emrave me qiellzorizimin e bashkëtingëllores ll në j të emrave me fundoret

ull, yll, all, ell:

...përpara u nis me atë hov qi *popuj*-t virgjën kanë...(L.B.117).

...mbajtun ndezë për *shekuj* historijet...(L.B.54).

...aktet e *apostuj*-vet...(P.115).

...ndër gjithë *kapituj*-t e saj... (P.117).

E marrin prapashtesën -j edhe këtu emrat: *shembull*/ j, *grumbull*/ j, *mashkull*/j, *tempull*/j, *engjull*/j, *tingull*/j, *shekull*/j

...Nji llampë mbi kodër kufitare ndezet me *hyj*-t e polit... (L.B.29).

...ndërsye mbi ne posi *çakaj*-t ...(L.B.68).

...A mundet ajo, vall, me u-zhgulun *dej*-sh...(L.B. 22).

Shumësi i emrave me ndërrimin r në j

Janë pak emra që shumësin e bëjnë me këtë ndërrim dhe që shfaqen pak te shkrimet e Pipës:

...flamuri i Skanderbegut do t'valvitet derisa *flamu*j tjerë do t'njofi bota... (L.B.119)

...Lavdi *bij*-ve t'atdheut i i ndejen mproje...(L.B.15).

Shumësi i emrave që nuk e ndryshojnë temën në numrin shumë

Kemi një grup emrash të gjinisë mashkullore dhe femërore që shumësin e bëjnë si njëjës:

Janë emra të gjinisë mashkullore një- ose dyrrokësh që mbarojnë me bashkëtingëllore ose me togzanor:

...ua hodhën *klyshve*... (L.B.22).

...Njikohësisht do t'ishte krahazue gjuha e Bogdanit me atë të *paraardhësve* të tij...(P.121)

...Mbas aq *muejsh* errsine...(L.B.41).

Kjo dukuri shfaqet më dendur te emrat e gjinisë femërore, kryesisht në ata që mbarojnë me *ë* ose *e* të patheksuar, me *i* të theksuar etj, si:

...Te *buzët* tua jeta ngazëllon...(L.B.47).

...*Rranjët* e thella jetës ja diktuem...(L.B.78).

...dhetërrrokshin e *kângëve* kreshnike boshnjake...(R.86).

...pa njohje të mirë të *gjuhëvet* të kulturës së kohës...(P.112).

...i falë flija e *shqiseve* t'randa...(L.B.31).

Nuk ndërrojnë temën në shumë edhe këto emra:*foshnjët*, *manushaqet*, *rrezevet luleve*, *ushtritë* etj.

Disa shumësa të veçantë:

Te vepra e Pipës ndeshim në disa raste emra që e formojnë shumësin duke pësuar disa ndryshime në përbërjen tingullore. Gjithashtu ka emra që shumësi i tyre del me dy trajta, siç është rasti i fjalës kalë: *kuaj* që është në normë dhe *kual* dialektore :

...ushtarë me *kuaj* kalojshin...(L.B.96).

...hingllimi i *kualve*...(L.B.133).

Për evolucionin e këtij shumësi në disa variante Sh.Demiraj e ka bërë objekt të një studimi të botuar në revistën “Studime filologjike”.¹ Për autorin varianti me fundoren *j* (*kuaj*) është relativisht më i ri se varianti me *l* (*kual*).²

Si në standardin e sotëm shumësin e emrave derë e dorë autori e bën *dyer* dhe *duer* që Cipoja e quan shumësi i thyer (pluralis fractus).³

Shumësi i shquar.

Autori nuk është konsekuent në përdorimin e shumësit të shquar.

Kështu emrat që zanoren fundore e kanë të theksuar, nën ndikimin e ligjëritit gojor shumësin e shquar e bëjnë vetëm me mbaresë, pa ë-në fundore.

miqt (L.B.59), *anmiqt* (L.B.68), *thojt* (L. B.110), *gjetht* (L.B.174), *gjindt* (R.42) etj.

Vërehen edhe luhatje, pasi të njëjtën fjalë në shumës e paraqet me dy trajta: *syt* (L.B. 32) dhe *sytë* (R.45)

Marrin mbarsën –t edhe ata emra që nuk theksohen në rrokjen e fundit:

Prisavet (P. 112), *besnikët* (P.116), *kosovarët* (P.126), *shkollarëvet* (P.124), *vepravet* (P. 12), *serbët* (R.39).

Rënia e treguesit të shquarsisë në shumës

Kjo dukuri vihet re edhe te A. Pipa, por vetëm me një ndryshim . Në vitet e fundit të krijmtarisë në shqip, siç është një studim i botuar në vitin 1990, autori jo vetën që nuk është konsekuent, por vërehet prirja që të mos bëjë dallimin në numrin shumës në mes të shquarës e të pashquarës

Lavdi *bijve t’atdheut*...(L.B.15).

Emri *bijve* i rasës dhanore është në trajtën e shquar pasi ndiqet nga përcaktori i rasës gjinore , përkatësisht i shquar. Të kësaj trajte janë edhe emrat:

...Prej *kreshtave t’Olympit* ...(L.B.108)

...Prej *brigjeve t’Korfuzit*... (L.B.168)

...fije aty kam endë prej *flokëvet t’mij* R.33

Emri *flokëvet* është i shquar nga prania e mbaresës –t, por edhe pse shoqërohet me përemrin pronor.

...por edhe për shtieelimin e *disa emnave* historikë-gjeografikë...(L.B.11).

Emri i rasës gjinore trajtohet i trajtës së pashquar numri shumës, sepse shoqërohet me përemrin e pacaktuar disa.

...E prej *pesë kontinentave* ku ka *besnikë*...(L.B. 156).

1. Sh. Demiraj, *Rreth shumësit të emrit kalë*, “Studime filologjike”, 1973, nr.3, f.77-82.

2. Po ai, po aty , f.79.

3. K.Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949, f. 56.

Emri kontinentave merret në trajtë të pashquar, meqë shoqërohet me numëror “sepse së pari numërori përdoret në ato kontekste ku bëhet fjalë për sende që përmenden për herë të parë dhe së dyti kur shoqërohet nga një numëror, emri tregon një pjesë të një klase sendesh.¹

Siç e theksuam më sipër, Pipa pothuajse nuk e dallon trajtën e pashquar nga e shquara në numrin shumës, gjë që vërehet në shkrimet publicistike, duke njëjtësuar mbaresën *-t* për të dy trajtat:

...Dhe disa “fjalë plaka” të Bogdanit vijnë prej ktyne *vepravet...* (P.112).

...Fonetika dhe morfologjia e Bogdanit ndryshon prej atyne të *prisavet...*(P.112).

...paraqitun më kambë rrethue prej bustavet të nandë *sibylavet* tjera...(P.116).

...Nji tipar ... i Bodanit është njohja e tij e shumë *gjuhëvet* të hueja...(P.117).

...Kur *rojevet* u tekej me u-zbavitun...(L.B.66).

Emri kur shoqërohet me përemrat dëftorë, të pacaktuar (shumë, pak, disa etj) , numëror etj.duhet të përdoret rregullisht në trajtën e pashquar dhe jo me mbaresën *-t*, siç ngjet në rastin tonë².

Edhe përemrin lidhor i cili në shumës, në rasat e zhdrejta e përdor me mbaresën *-t*, ndryshe nga standardi i sotëm:

...disa prej të *cilavet* kanë trajta të të folmevet qendrore...(P.114).

...shumica e të *cilavet* shprehin koncepte abstrakte...(P.115).

Por siç thekson prof. Sh.Demiraj kundërvënja trajtë e pashquar – trajtë e shquar nuk është zhdukur, veçse dallimi ndërmjet tyre bëhet me tregues të jashtëm të rrafshit sintaksor, duke qenë se trajta e shquar dallohet nga e pashquara nëpërmjet mungesës së ndonjë përcaktori të paravendosur.³

Haplologjia

Pipa, si dhe dy autorët e tjerë e përdor haplologjinë, që ka të bëjë me rënien e njëres prej dy rrokjeve të njëjta të një fjale.Duhet të zotërosh mirë gjuhën që të mos veprojnë në shkrimet e artikujshkruesve, prandaj vërehen luhatje të kësaj dukurie me karakter fonetik, kryesisht në përdorimin e saj d.m.th. të rënies së njëres mbaresë e konkretisht *-je*, që, siç e dimë në shqipe vepron në emrat e lakimit të tretë që mbarojnë me *e* patheksuar⁴ :

...Nji djalosh përmbas *dritorje...*(L.B.20).

Po shënojmë ato pak raste kur është përdorur alomorfi *-je*:

...me turpin e nji *heshtjeje* trathtare ! (L.B.116)

...duhet të ketë disa cilësi : forcë *shprehjeje...* (P.107).

...në luftën e vet kundër çdo trajte *shtypjeje* qi cenon dinjitetin njerzuer...(L.B. 214)

1.Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 2002, f.131-132.

2. Sh.Demiraj, *Rreth kategorisë së shquarsisë e të pashquarsisë në gjuhën shqipe*, “Studime filologjike”, 1969, nr.4.

3. Sh.Demiraj, *Prurjet kryesore në strukturën morfologjike të gjuhës së sotme letrare shqipe*, “Studime filologjike”, 1984, nr.4, f.72.

4.Shih:K.Topalli, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f.376

Rreth përdorimit të rasave

Përgjithësisht të tre autorët përdorin sistemin e rasave të gjuhës së sotme shqipe. Mund të ketë ndonjë veçori¹, të cilën do ta evidentojmë më poshtë.

Arshi Pipa parapëlqen përdorimin e togfjalëshit emër + emër në rrjedhore me mbaresën – *sh*. Këto togfjalësha po t'i krahasojmë me togfjalëshin emër + emër në rrjedhore me mbaresën –*ve* kanë një përdorim më të dendur. Fillimisht po i ilustruojmë me mbaresën –*sh* e pastaj me –*ve*:

- ...grumbuj *hijesh*... (L.B.27).
- ...erë *tingujsh* ... (L.B.30).
- ...fyej *barijsh*... (L.B.39).
- ...krisma *shulash* ... (L.B.27).
- ...gërhatje *rojesh* ... (L.B.28).
- ...derë *pleqsh*... (R.11).
- ...zile *dhensh*... (R.51).
- ...nji çufre *drandofillesh*... (R.30).
- ...listë *fjalësh*... (P.111).
- ...seri *shkrimesh* (P.115).

Ky shumës, sipas prof.Sh.Demirajt, gjithnjë e më shumë ka një përdorim të kufizuar, ndonëse në shqipen e sotme letrare ruan gjallërinë e përdorimit vetëm në togfjalësh të tipit *lule dhensh*, ku funksioni përcaktor është karakteristik për rasën gjinore dhe jo për rrjedhoren.²

Ky togfjalësh emër + emër në rrjedhore vepron edhe në numrin njëjës:

- Mbramje *prilli* (L.B.9)
- ... bomba *dore*... (L.B.21).
- ... shekuj *historije*... (L.B.54).
- ... pluhun *balte* ... (L.B.33).
- ... mëngjez *maji* (L.B.30).

Karakteristikë është edhe analitizmi, shoqëruar me parafjalë që është një dukuri e gjuhës së sotme shqipe:

- ...Dojshe ti *prej malesh*... (L.B. 33).
- ...nën qepallë e *mbas qerpikve*... (L.B.83).
- ...Rrallë buza *prej gishtave*... (L.B.107).
- ...për pakë *prej rrezeve*... (L.B.109).
- ... si tash *prej valave* ... (L.B.109).
- ...*Larg prindsh e shokësh* ... (L.B.131)
- ... *prej brigjeve*... (L.B.16.)
- ... vijnë *prej ktyne vepravet*... (P.112).
- ...të konfliktit *mes dy gjuhëvet*... (P.121).

1. F.Agalliu, *Sa rasa ka në gjuhën shqipe*, në botimin e autorit “Çështjetë morfologjisë së gjuhës

sotme shqipe, Tiranë, 1988, 114-127; Gramatika e gjuhës shqipe, 1, 2002, f.105-111.

2.Sh.Demiraj, *Prurjet kryesore në strukturën morfologjike të gjuhës së sotme letrare shqipe*, “Studime filologjike”, 1984, nr.4, f.72

Emrin *krye* e përdor drejt me ndonjë përjashtim .Kështu rasën emërore dhe kallëzore e përdor në trajtën e shquar me mbaresën *-t*:

...kurse Rasha tash e parë *te kryet*...(R.27).

...kam ndigjue se Rasha po martohet/tha tue e pyet, ajo uli *kryet*...(R.60).

...shtatin lis e *kryet* me i prekë në tra...(R.9).

...mbi *kryet* e trupin e njomë të djalit ...(L.B.134).

...andaj kur *kryet* e lodhun...(L.B.88).

Por autori në rrjedhore e lakon si një emër të gjinisë femërore:

...me një vilë ndër duer qi e hoq prej *kreje*...(R.61)

Ndërsa në numrin shumës e bën :

...nji send i përbindshëm dy *krenësh*...(L.B.85).

Emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me zanore të theksuar në njëjës in e pashquar, në trajtën e shquar marrin mbaresën *-s* në rasat e zhdrejta, ndërsa në kallëzore *-n*, ndonëse vihen re edhe luhatje, duke përdorur edhe mbaresën *-së* :

Shoqnis, historis, liris, folen, Italis, mushemas 63, *brohoris* 43.

teshat e *nusisë* ...(R.64) etj.

Te Arshi Pipa emrat e gjinisë femërore që dalin me zanore të theksuar në rasën gjinore dhe dhanore të pashquar, por edhe në rrjedhore marrin alomorfin *-je* :

.. e kësaj *ushtrije* ...(L.B.9).

...libër *poezije*... (L.B.11).

...I lidhun melodije, e nji bote *lumnije*, kësaj *dashunije*,

...nji të dridhun *mrekullije*...

...mbas nji *çinije*, mure *avullije* .

Edhe në emrat që në rasën emërore të pashquar dalin me zanoren *i* të theksuar, marrin alomorfin *-ja*:

Lumnija, Shqipnija, pasunija, puntorija L.B.64 *tepsija, komshija, uriya* 10, *lirija* 11 etj.

Autori në studimin për Bogdanin përdor trajtën me mbaresën *-a* në trajtën e shquar:

Ditunia, 115, vështirësia 119, *Maqedhonia* 120, *diplomacia* 123, *shoqnia* 124

Sami Repishti

Shumësi i emrave të gjinisë mashkullore

Shumësi i emrave në gjuhën shqipe është mjaft i pasur dhe i larmishëm, siç e theksuam ai i gjinisë mashkullore, kryesisht në përdorimin e mjaft prapashtesa formëformuese. Është një kategori leksiko-gramatikore që e kanë të gjithë emrat, duke veçuar ata emra që përdoren vetëm në numrin njëjës apo vetëm në numrin shumës. Përdorimi i një emri në numrin njëjës apo në shumës lidhet me konceptimin sasior të sendeve ose të nocioneve që emërtohen me anë të këtij apo atij emri. Kjo kategori gramatikore është studiuar si në rrafshin sinkronik, ashtu edhe diakronik, që nga G.Majeri e në vazhdim.

Është i larmishëm ky shumës nga denduria e prapashtesave që përdoren si në formimin e kësaj kategorie gramatikore në ligjërimet popullore, ashtu edhe në standardin e sotëm.

Edhe te S.Repishti vërehet një dukuri e tillë, me një veçori që nuk përdor gjithnjë trajtat dialektore, por disa prej tyre janë në përputhje me standardin e sotëm.

Shumësin gjuha shqipe e formon me prapashtesa trajtëformuese, me anë të ndërrimit të tingujve, si dhe duke mos ndryshuar temën në numrin shumë. Theksojmë se në veprën “*Pika loti*” nuk e kemi ndeshur të gjitha trajtat e shumësit që vërehen në ligjërimin e folur dhe të shkruar.

Shumësi me -e

Janë një numër i konsiderueshëm emrash të gjinisë mashkullore, të cilët në shumë marrin prapashtesën –e. Janë emra abstraktë të prejardhur me prapashtesën –im:

Veprim-e, kujtim-e, rrozullim-e, besim-e, betim-e, predikim-e, ushqim-e etj. , si dhe emrat konkretë që dalin me fundoret *d, l, m, n, p, rr, s, t*:

Katunde, vende, male, çorape, oborre, fise, shtete etj.

Autori nuk bën dallimin e emrit *frut*, kur është konkret, e kur është abstrakt, duke përdorur vetëm trajtën *fryte*, ndryshe nga standardi i sotëm , i cili shumësin e kësaj fjale e dallon kur është konkret e bën *fruta*, kur është abstrakt frytet e punës:

Shumësinë emrit *grusht* e përdor në dy trajta: e para e prapashtesën –e që është në pajtim me drejtshkrimin e sotëm, e dyta dialektore me prapashtesën –a, si:

...shajshin, kërcënojshin me *grushte* një armik të padukshëm...(Ro.34).

...Përsëri thirrje, betime, shamje e *grushta* të ngritun...(Ro.35)

Shumësin e fjalës *fshat* e bën me prapashtesën -e dhe jo si në standard me –ra:

...Tregojshin se si qëndronte gjendja në *fshatet* tona...(Ro.31).

Shumësin e fjalës *rojë* e bën me prapashtesën -e dhe jo si në standard:

...Jashtë ndigjoheshin zanët e *rojeve* të armatosuna...(P.L.200)

Theksojmë se edhe të Repishti këto emra në shumë marrin përcaktorin mbiemër të gjinisë

femërore me ndonjë përjashtim.

Shumësi me –a

E bëjnë shumësin me –a ata emra të gjinisë mashkullore që mbarojnë me bashkëtingëllore, ndonjëri prej tyre në standardin e sotëm ekziston si dysi drejtshkrimore me prapashtesat –a/-e, *a/ërinj*, por te vepra e Repishti nuk vërehet ndikimi i dialektit apo varianteve letrare të mëparshme në përdorimin e dy trajtave për të njëjtën fjalë. Në veprën e autorit ndeshim vetëm trajtën me prapashtesën -a: *xhama, gishta*. Ndërsa emra të tjerë njërrrokësh ose dyrrrokësh përdoren vetëm në një trajtë në shumë: *hapa, shqelma, qypa, kartona, krahina* etj.

E bajnë shumësin me -a edhe emrat me prejardhje të huaj: *eksploziv-a*.

Në ndryshim me standardin e sotëm, duke i qendruar besnik dialektit që përdor, shumësin e fjalës oficerë e ndeshim edhe me prapashtesën –a : *oficera*, por edhe me -ë:

...pamë një grup *oficerësh*...(P.L.43).

Ndonëse në të folmen e Shkodrës fjala *student* e bën shumësin me -a, te Repishti e ndeshim si në standard me prapashtesën -ë: *studentë*:

...kaluan ushtarët pa oficerë, *studentët* pa komandantë...(P.L.150).

Shumësi me -ë.

E marrin këtë prapashtesë vetëm emrat e gjinisë mashkullore, kryesisht emra frymorësh , por edhe jofrymorë. Te vepra e S.Repishitit kjo prapashtesë është shumë prodhimtare. E ndeshim në këto raste:

-në emrat që tregojnë banorët e një vendi , si: *rumunë, bullgarë, gjermanë, lumjanë,*
- në emrat e frymorëve me prapashtesat –ar, tar,k, -ist, -ent, -el: *ushtarë, kundërshtarë, ushtarakë, dëshmitarë, bashkëpunëtorë, profesorë, tradhtarë, komunistë, korrieristë, propongadistë, humanistë, idealistë, individualist, police, agjentë, elementë.*

Por të njëjtën fjalë e përdor me dy prapashtesa: *kriminelë* (P.L.117) dhe *kriminela* (P.L.f.44).

-Emrat me fundoret k, m, t, d: *fishekë, jetimë, profetë, individë.*

Ndonëse janë njërrrokësh e formojnë shumësin me prapashtesën –ë: *lotë,* por edhe *lot, gurë etj.*

Autori nuk ndjek traditën gege që për disa fjalë përdoret shumësi me **-a**, por në përputhje me standardin përdor shumësin me **-ë**, siç e theksuam më sipër: *ish-studentë* universteti . Emrin *balkon* autori e shkruan herë me *l* dhe herë me *ll*, Shumësin e kësaj fjale Repishti e bën me prapashtesën **-ë**:

...*Balkonët* e disa shtëpive kishin lule e flamuj...(Ro.29).

Edhe emri *prind*, ndryshe nga norma, shumësin e bën me prapashtesën **-ë**:

...për strehimin e dhanun “ilegalëve” *prindë* e familjarë...(Ro.98).

Shumësi me –j

Ky shumës në standardin e sotëm vepron si përjashtim për dy emra *kufi-j. kalama-j*. Në rastet e tjera si normë mbetet shumësi me prapashtesën –nj, që sot ndeshemi edhe me mendime, që janë kundër një zgjidhjeje të tillë, duke kërkuar që të kthehet në normë shumësi me –j¹ Studimi i veçorive gjuhësore të dialekteve si prurje të rëndësishme për pasurimin e gjuhës e në veçanti të gegërishtes do të luante një rol të rëndësishëm për zhvillimin e standardit gjuhësor të shqipes, i cili ka nevojë të pasurohet më tej. Me përmirësimet që mund t’i bëhen drejtshkrimit të shqipes mund të realizojnë një afrim sa më racional, shkencor dhe objektiv të ligjërimit të folur me atë të shkruar.²

Repishti ndjek traditën gege, duke përdorur prapashtesën –j në të gjithë emrat mashkulorë që mbarojnë me zanore të theksuar: *kallij, kushërij, gjuj, heroj, flori, grumbuj, shkopij,* por edhe *gjujzue* 109, *shejë* 109 etj. Por ndeshim edhe si raste të izoluar shumësin me prapashtesën –nj:

...ju shkulën ...thonjtë e duerve...(Ro.339).

1.M.Çeliku, *Probleme të diskutueshme rreth Drejtshkrimit të gjuhës shqipe të vitit 1973*, në “Seminari XV për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Tiranë, 1965, f.217; E.Hysa, *Rreth prirjeve në formimin e shumësit të disa emrave*, në “Seminari XX për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Prishtinë,2002, f.301-302; A.Haxhi-T.Osmani, *Forma të shumësit në rrafshin e planifikimit gjuhësor të shqipes*, në “Shqipja në etapën e sotme:Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”,

Tiranë, 2011, f.164-172.

2.A.Haxhi-T.Osmani, art. i cit. f.172.

Prapashtesën –nj e ndeshim edhe në ndonjë toponim: *Malit të Ullinjve* (P.L.13).
Shumësin e emrit *flamur* e bën me ndërrimin r/j *flamuj*:
...Balkonët e disa shtëpive kishin lule e *flamuj*. ..(Ro.29).

Shumësi me ndërrime tingujsh

Ky shumë vepron edhe në gegërishte si në gjuhën standarde, e konkretisht :

-Qiellzorizim i bashkëtingëllores fundore grykore -k në qiellzorën -q: *mik/miq, anmik/anmiq, bujk.bujq*.

- qiellzorizim + prapashtesën -e : *burg/burgje, oxhak/oxhaqe, park/parqe, hendek/hendeqe*.

Ndonëse dalin me grykorën k, nuk e qiellzorizojnë atë në q si shembujt e mësipërm, por marrin prapashtesën –ë: *shokë, fishekë*, duke mos u zbatuar rregullat e qiellzorizimit, pasi lidhet me kohën kur është formuar ky shumë.

Shumësi i emrave që nuk e ndryshojnë temën në numrin shumë.

Janë më shumë emra të gjinisë femërore që nuk e ndryshojnë temën në numrin shumë dhe e kanë të njëjtë me njëjës¹, si:

-Emrat e gjinisë femërore që në numrin njëjës mbarojnë me -ë:

kohë, punë, javë, buzë, pemë, kambë etj.

- Emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me e dhe je të patheksuar:

çerdhe, lule, fitore, përpjekje, vuezjtje, ngjarje, skamje, lëvizje etj.

-Emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me i të theksuar:

shkreti, cilësi, shoqani, qeli, mundsi, vështirsi etj.

Emri i gjinisë mashkullore *sy* e bën shumësin si njëjës *sy*, ndërsa emri *lot* që në standardin e sotëm e bën shumësin si njëjës *lot*, Repishti e përdor me prapashtesën –ë, por nuk është konsekuent, pasi ndeshim edhe raste që shumësin e këtij emri e bën si njëjës:

...do të ketë vjatue me *lotë* të ngrohtë...(P.L.13).

...më kanë kushtue shumë ditë të dhimbshme e shumë *lot* të hidhun...(P.L.152).

Shumësi i shquar

Emrat që në numrin njëjës të pashquar përfundojnë me zanore të theksuar, shumësin e bëjnë duke marrë mbaresën -të, po me këtë mbaresë e bëjnë shumësin e shquar edhe emrat që mbarojnë me bahkëtingëllore, por theksohen në rrokjen e fundit:

mrekullitë (50), *herojtë* (91), *florijtë* (91), *çatitë* (121), *shkretitë* P.L.7, *miqtë*, *djemtë* etj. por edhe këtu vërehen lëkundje, si:

...nana e të gjithë *fëmijt* ngriheshin në kambë...(Ro.25).

...se jemi *bijt* e tij të denjë...(Ro.35), *miqtë, djemtë*, ndërsa emrat që mbarojnë me dy bashkëtingëllore ose me –ëz, -s, -ër marrin alomorfin –it : *njerzit, mësuesit, prindërit* etj.

1.F.Agalliu, *Rreth kategorisë së numrit të emrave në gjuhën shqipe*, në botimin e autorit “Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë, 1988, f.133 ; *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, Tiranë, 2002, f.96-98; *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë, 1976, f. 13-36

Vërejmë si raste të izoluara që ndonjë emër i gjinisë femërore me zanoren *i* të theksuar shumësin e pashquar e bën me prapashtesën *ja*, trajtë e ngushtë dialektore, ndërsa shumësin e shquar me mbaresën *-t*:

...nga mbështetja e bishtit të lopatës që mbushte *kutijat* e masës së caktueme...(Ro.251).

Emrat e tjerë të gjinisë mashkullore apo femërore marrin mbaresën *-t*:

detyrat P.L.9, *gurët* P.L.15, *krahët* P.L.10, *armët* P.L.10, *lëvizjet* P.L.9 etj.

Autori nuk është konsekuent, pasi përdor trajtën *bujqët* që është shumë dialektore:

...Kudo shiheshin njerëz në punë të ndryshme, sidomos *bujqët*...(Ro.68).

Rënia e treguesit të shquarsisë në shumës

Në shekullin XX u vu re një prirje që në gjuhën e shkruar të kthehet në normë morfologjike dhe drejtshkrimore rënia e treguesit të shquarsisë në numrin shumë të rasës gjinore dhe dhanore dhe si rrjedhojë edhe të rrjedhës, kur ajo është analogjike me dhanoren. Kështu njëjtësohen këto rase në të shquarën shumë me të pashquarën dhe trajta me *-vet* nuk përfshihet në normë dhe sot nuk kryen ndonjë funksion të veçantë¹, si: Si luftëtar i rezistencës, ai kërkoi ndihmën e *shokëve të luftës*...(P.L.58).

Emri i rasës gjinore *i shokëve* etj. është në trajtën e shquar, pasi ndiqet nga një përcaktor i kësaj rase që e bën emrin të caktuar, përkatësisht të shquar.

...vapa e madhe e *fushave* të Shqipnisë...(P.L.80).

Në pritje të *hollësive* të tregimit...(P.L.40).

Shkretia e vërtetë asht ajo e *zemrave* tona...(P.L.128).

...larg nga absurditeti i *fjalëve* dhe *gjesteve* të tyne...(P.L.13).

...në qendër të *kujtimeve* të mia...(P.L.39).

Emri e *zemrave* etj. është i shquar, pasi ndiqet nga një përemër pronor. Kështu shquarsia e emrit kushtësohet nga kuptimi i pronorit, që e tregon atë të caktuar, përkatësisht të shquar.

...cili do të ishte fati i *bashkatdhetarëve të mi*... (P.L.141)

Si në shëmbullin e mësipërm emri i bashkatdhetarëve është i shquar pasi ndiqet nga një përemër pronor.

Nana ishte dobësue shumë gjatë këtyne vujtjeve e të *muejve* të fundit...(P.L.13).

Të dy emrat në shumë ndiqen nga përcaktori të fundit. Ky mbiemër shenon një send të vetëm, prandaj është i shquar.

...ma vonë na tregonte largimin tij prej *shokëve të parë*...(P.L.36).

...po përpiqesha me mundim me u përmbajtë mbas *lotëve të parë*... (P.L.43)

Emri *i shokëve* etj. merret i shquar, pasi ndiqet nga një mbiemër prejnumëror, në rastin tonë prej mbiemrit të parë.

Strukë në një qoshe të dhomës në mes të *dy shokëve* që më dukej...(P.L.48)

Emri *shokëve* merret i shquar se paraprihet nga numërori i nyjzuar të dy.

...ai gëzonte simpatinë e të *gjithë shokëve*...(Ro.210).

1. Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 2002 f.131-132.

Emri i të gjithë *shokëve* merret e shquar pasi paraprihet nga përemri i pacaktuar të gjithë. Të shquar janë dhe emrat me parafjalët:
...*përpara syve* (P.L.52), *drejt kodrave* (P.L.26), *rrotull kufijve* (P.L.1.24), *rreth nesh* (P.L.100), *shtëllunga flokësh* (P.L.130).

Haplologjia

Haplologjia, siç e theksuam më sipër, është një dukuri me karakter fonetik që ka lidhje me rënien e njëres prej dy rrokjeve të njëjta të një fjale. Kjo dukuri në veprën e Sami Repishtit ka lëkundje. Po shënojmë rastet kur përdoret alomorfi *-je*:

...mbas kësaj *ngjarjeje*... (Ro.40).
...Në këtë agoni *pritjeje*... (P.L.111),
... grahëm *vdekjeje*... (P.L.60).
...asnji mundësi *arratisjeje*... (P.L.80).
...Shtyllë *mbështetjeje*... (P.L.85),
... kojshi *lagjeje* ... (P.L.139)
...rrugë me emna pemësh pyjore si shejë *mirënjohjeje*... (P.L.128).
...Poe hollësitë e plota të asaj *ngjarjeje*... (P.L.25).
...I denuem për tentativë *arratisjeje*... (Ro.208).

Në shembujt e mëposhtëm nuk e kemi ndeshur alomorfin *-je*:
Zani i dramës së asaj *mbramje* ishte zani i botës... (P.L.33).
...Mbas një *heshtje* të gjatë ... (P.L.20),
...prodhimi i ri i kësaj *lëvizje* të çoroditun... (P.L.152)
...shembuj përbuzës të një *shtypje* të pamëshirë... (P.L.147).
...humbjen e një *shoqnieje*... (P.L.90).
...aureole *shejtnie*... (Ro.339).
...ishte pa *asnji lidhje*... (P.L.10)

Rreth përdorimit të rasave.

Repishti i përdor drejt rasat e emrit me ndonjë përjashtim. Kështu emrin *vëlla* e shquan me mbaresën *-u*: *vllau*, gjinore – dhanore *vllaut*, kallëzoren e përdor shpesh me dy trajta : *vllaun* (126), por edhe *vllanë* (126).

Përdor dendur togfjalëshin emër + emër në rrjedhore të pashquar shumë, formën origjinale të kësaj rase me mbaresën *-sh*:

...*magaziner landësh* (P.L.59), *nji rresht rregullash* (P.L.81) , *emna pemësh* (P.L.128), *nji vaster pushkësh* (P.L.6), *nji grup oficerësh* (P.L.43), *varg zemrash* (P.L.62), *grumbull feudalësh*... (P.L.149), ...*nji grup mjeranësh*... (Ro.336), *grumbuj nxanësisish* ... (Ro.34), *nji delegacion zyrtarësh*... (Ro.256).

Autori përdor edhe trajtën e dhanores për rrjedhore që në gjuhën e sotme e ndeshim shpesh , si:

Para *syve* që s' shihnin qartë ... (P.L.127).

...i qindra *familjeve* tjera...(P.L.50).

Repishti shpesh përdor gjinoren në shumës si përcaktor me **-ve**:

...me kuptue prejardhjen *e vujtjeve të tija*... (P.L.51).

...porsa kisha fillue mbartjen *e gurëve e tullave* në korriz...(P.L.59).

...bukuria *e bjeshkëve* të blerueme...(P.L.63).

Te S. Repishti emrat e gjinisë femërore që dalin me zanore të theksuar, në rasat gjinore dhe dhanore të pashquar marrin mbaresën **-e** si në gjuhën standarde, si:

...Me një ndjenjë *krenarie* (P.L.86),

...edhe mbramë ishin burim *kënaqësie* ... (P.L.128),

...pa asnjë arsye, si dhe i një lloj *tragjedi*...(P.L.23).

...një mungesë të theksueme *dashunie*...(Ro.6).

...Vetëm ideja e një *mundësie* të tillë...Ro.331).

Ndërsa në rasën emërore të shquar marrin mbaresën **-a**:

Uria, Shqipnia, lavdia, madhështia, thjeshtësia, vazhdimësia...(Ro.331).

Si raste të izoluara ndeshim edhe ndonjë emër që autori e redukton *j-në* e temës duke vazhduar me mbaresën **-a**: *fëmia*, ndonëse përdor trajtën e rregullt dhe në trajtën e pashquar pa *ë-në* fundore:

...*Fëmijë* që luajshin si lozin *fëmia* e nana...(P.L.18).

... e ata e shohin veten si *fëmij* jetimë...(Ro.250).

Autori emrin e pashquar *përgjigje* që mbaron me **-e** të patheksuar e shquan me mbaresën **-a** që bie në kundërshtim me normën letrare në vend të alomorfit *-ja* :

...ë një gjamë moti ishte *përgjegja* jonë...(Ro.35).

Repishti ndryshe nga Pipa emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me zanore të theksuar në njëjës in e shquar, në rasat gjinore dhanore marrin mbaresë *së* dhe në kallëzore mbaresën *në*:

lirisë (Ro.341), *shoqnisë* (Ro.336), *vazhdimësisë* (Ro. 334), *çmendinë*, (Ro.335), vetminë (Ro.332), *brendinë* (Ro.331).

Filip Ndocaj

Shumësi i emrave të gjinisë mashkullore

1 Shumësi me prapashtesën -e.

Kjo prapashtesë vepron si në shumësin e emrave konkretë, si: *kalldrëme, fidane, gjethe* etj., ashtu edhe në emrat abstraktë, si: *mundime, paragjykime, mendime* etj. Me këtë prapashtesë mund ta formojnë shumësin emrat që tregojnë vende:

...çelin sytë këtu nalt në *stanet* tona... (D. 114).

...të masë ritmin e zbritjeve nëpër *lugje*...(D.105)

...e njohin deri gurt e *kalldrëmeve*... (D. 135).

-Përdoret tek emrat konkretë ose abstraktë të pammë:

...i tregonte *hallet* e çobanisë... (D. 110).

...me dy *gjethet* e lisit në xhaketë... (D. 118).

...*Fidanet* e ri, më kupton, brigadier... (D. 119).

...ishte ba zot *fateve* të veta” (V.39).

...disa *turpe* duhen mbulue sa ma shumë... (V.104).

...e *pallate* n'qiell gjithkund... (SR. 85).

Kjo dukuri vepron më shumë në emrat abstraktë me prapashtesën *-im*:

...me njimijë *mundime* plaku mezi u ngjit... (V. 12).

...knaqej me *mendimet* e *kujtimet* e veta... (D. 9).

-E bëjnë shumësin me prapashtesën *-e* edhe ato emra që në shumës pësojnë ndërrime fonetike:

...*oxhaqe* të shumta veneciane... (D. 7).

...nga të gjithë *oxhaqet* dilnin shtëllunga të dendura tymi të zi... (D. II, 10);

...kam ba *budallallëqe* boll... (D. 150).

Shumësi me -ë

Tek F. Ndocaj ky shumës është shumë produktiv që vepron në një kategori të caktuar emrash e konkretisht:

-Në emrat e frymorëve që tregojnë banorët e një vendi:

...sa respekt kishin *katundarët* kur ky u shkonte nëpër shtëpia... (D.127).

...po dorëzohen bash si lopët *italianët* e garnizoneve... (D. 227).

...çau rrethimin e *gjermanëve* e u hapi udhë shokëve... (V.62).

-Në emrat e frymorëve me prapashtesat *ent, or, tor, ar, tar*:

...*Studentët* i ken në punë tash... (D. 136).

...vendas apo te ardhun, *punëtorë* apo mëditës... (D. 92).

...sa i njoh unë *tregëtarët*, të gjithë janë luga e ferrit... (V. 77).

...me *bashkfshatarë* murtarë kah gjithë ndërtojnë... (SR. 89).

-Autori i ndikuar nga shqipja e sotme shumësin e emrit *mollë* e bën si njëjësi:

...e po të krijonin brigjeve të drinit sa ma shumë pemishte me *mollë*... (V.240).

Shumësi me -a

-Ky shumës vepron në emrat njërrrokësh:

...zbulonte lehtë te këta *tipa* të romanit.. (D.51).

...ua kishin grumbullue *gjyshat* e baballarët... (D. 201).

...Ti kërkon *trupa* për dërrasë... (D. 102).

...Këta *nipa* e *stërnipa* edhe kur bisedojnë... (V. 16).

Shumësi me -na

-Edhe ky shumës është veçori e dialektit të Veriut. E ndeshim në këto emra:

... të ndiqte...lëvizjen e *mallnave* e si bahej tregtia... (D. 59).

...disa *kushrina* dhe një pakicë shoqesh... (D. 101).

...*Urdhnat* e pyjores ai.. (D. 104).

Shumësi me -nj/-j

-E përdor shumësin me prapashtesën *-nj*. kryesisht në ata emra që mbarojnë me zanoren *-i* të theksuar, veçori e gjuhës standarde dhe jo e të folmeve të Veriut, ndonëse autori është gegë dhe shkruan në gegërisht:

...sa herë që takonte çobenj e *barinj*... (D. 104).

...po në ata *mullinj* bluejnë secila shtëpi... (V. 13).

...asht pastrue hagre pësh e *minjsh*... (V. 36).

...u bani me shenjë disa të *rinjve*... (V. 93).

...se s'frikësohen *arinjtë* e pyllit... (D. 28).

-F. Ndocaj nuk është gjithmonë konsekuent me shumësin e emrit *kufi*, pasi e përdor në dy trajta: *kufinj* dhe *kufij*, ndërsa emrin *kalama* e përdor me prapashtesën *-j* siç rekomandon drejtshkrimi i sotëm: ...ngujue brenda *kufinjve* të fshatit... (V.39).

...Mos u shty tepër përtej *kufijve*... (D. 56).

...sikur banin garë, si *kalamaj*... (D. 124).

-Prapashtesën *-j* e marrin edhe emrat që mbarojnë me zanore të theksuar a tog zanor. Disa prej tyre marrin edhe prapashtesë:

...e kishin andej nga lefja e *langojve*... (V.33).

...rrethue me karma e *përroje*... (D. 98).

Shumësi i emrave me ndërrim tingujsh dhe me ndërrim tingujsh dhe prapashtesë

-Me ndërrim tingujsh k~q; ll~j, g~gj: *mik~miq, murg~murgj, plak~pleq, bujk~bujq* etj.:

...ja kishin kurdisë *armiqtë* e vet personalë... (D.160).

...e sulmonin si *ujqit* arinë... (D.163).

...jeni mbyllë në këtë Akripë si *pleq*... (D. 152).

...se s'jeni tue ardhë *krushq*... (D. 271).

...për *bujq* s'i kanë shokët në malësi... (V. 45).

...nga manastiri i *murgjve*, vinte vajtimi i violinës ... (D. 76).

...i ka të gjithë *zogjtë* nën krahë ... (V. 68).

...*gjaqe* e hakmarrje... (V.166).

-Shumësi i emrit mashkull ka luhatje. Nganjëherë del vetëm me ndërrimin e bashkëtingëllores ll~j e nganjëherë shoqërohet edhe me ndërrim zanor:

...gjithë ata *mashkuj* e... njaja Smajl" (D. 156).

...baheshin gjithsejt njizet e tre *meshkuj*... (V. 51);

-Me ndërrimin ll~j e krijojnë shumësin edhe këto emra:

...kishte tretë sytë kah qielli gjithë *hyj*... (D.76).

...veç kso kangësh *popujt* kndofshin... (SR.95).

...fletë e *kapituj* të tanë që s'i pëlqenin" (D.52).

...ata *djajtë* e vegjël, që i pat përpara ... (D.52).

Me ndërrim tingujsh dhe prapashtesë

-Janë disa emra të gjinisë mashkullore që shumësin e bëjnë me ndërrim tingujsh dhe prapashtesë:

...*hendek~hendeqe*...

...digjeshin rreth e rrotull me qindra nëpër alltarët e *parmaklleqet* e tyne... (D. 81).

...po të krijonin *brigjeve* të Drinit sa ma shumë pemishte... (V. 240).

Shumësi i emrave me ndërrimin r në j:

Populli marshon nën *flamujt* kuq e zi... (SR. 7).

Shumësi i emrave që nuk e ndryshojnë temën në numrin shumës

-Kemi një grup emrash të gjinisë mashkullore dhe femërore që shumësin e bëjnë si njëjës:

...sikur nusëronte, me *sytë* gjysëm mshelë.. (D. 61).

...as tash që jeni dy *shtëpi*?... (D. 156).

...pastaj ja nisën *këngët* partizane... (D. 165).

...për një sahat me matë *kambët*... (D. 157).
...*Rrugët* malore vlojshin nga maqina... (D. 103).
...*punët* e mira bahen shpejt... (D. 112).

Shumësa dialektorë:

-Autori, duke qenë se shkruan në gegërisht, do të ruajë edhe disa trajta dialektore, ndonëse në standard përdoren me prapashtesën -ë:
...pa ushtarë e *oficera* italianë... (D. 235).
...vendas apo të ardhun, punëtorë apo mëditës, nga *shofer*a apo nga malësorë, që kalojnë sado rrallë nëpër pyje... (D. 92).
...në malësi janë *mësues*a shkolle e bile kanë hy në rrogë... (V. 76).
...i rrethuem nga *ballista* e gjermanë...(V.62).
...si ata *ahat* e pyllit që ngjiten përpjetë...(V.164).

Disa shumësa të veçantë:

-Prapashtesa -**ër** na del më shumë si shumë artistik, me konatacion të veçantë: *idiotër*:
... se janë *idiotër* të patentuar” (D. 119).
-Autori nuk është konsekuent edhe në përdorimin e shumës të emrit *djalë*, duke përdorur dy trajta:
Pesë *djelm* kishte pasë Lulash Preka... (V.47).
...Ja kishin lanë *djemtë*... (V. 48).

Rënia e tregesit të shquarsisë në numrin shumë

-Në shqipen e sotme standard trajtat me -**vet** në gjinore, dhanore e rrjedhore shumë janë njëjtësuar me shumëin e pashquar duke u shkruar me mbaresën -**ve**, pasi trajta me -**vet** nuk kryen ndonjë funksion të caktuar:
...si rrypinë gjelbërimi ndërmjet *pyjeve* të bjeshkës... (V. 22).
...mbyllun mbrenda katër *mureve* të asaj kullës së zezë... (V.. 34).
...me pushkë kundër *anmiqve* të popullit... (V. 63)
...po Tuçi iu drejtue *motrave* të Gjelës..(V.135) ?
...m’u pat përcëllue prej *flakëve*... (V.. 99).
...shoqnonte ujin gjatë *hullive*... (V. 152).
...Pan pse lshohe *sutave*” (SR. f. 10).
...e kemi edhe një gotë *mbrëmjeve*... (D.127).
...në luftën kundër *koncepteve* të vjetra... (D.191).
...larg *komoditeteve* të jetës... (D.191);
...rreth *fjalëve* të djalit...(V.128)
...Me ua pi gjakun, atyne *ferishteve* të shkreta..” (D. 18).
...se disa *dembelave* si ata të tre... (D.149).
...i qiti ujë *faqeve*, e madej i dha të pinte...(D. 153).
...s’i mërzhitesh *neshtrashave* të jetës... (V. 36).
...nderohej prej *vendasve* e të *largtëve*... (V. 37).

Rreth përdorimit të rasave

-Edhe F. Ndocaj parapëlqen përdorimin e togfjalëshit emër + emër në rrjedhore me mbaresën –sh p.sh. *grue dallaveresh, ambient fanatikësh, erë deposh, ngushticë malesh, kuvend burrash, punëtorë rrugash, krahë burrash, dritë llambash, lëvizje maqinash, tufë dhensh* etj.

-Këto togfjalësha kanë një përdorim të caktuar, ata i ndeshim si trajta sintetike, ndonëse sot analitizmi ka fituar përparësi, po t'i krahasojmë me togfjalëshin emër + emër në rrjedhore me mbaresën –ve.

...dukej tamam si ndonjë fëmijë zotnish... (D.II, 249).

...shikonte atë tufë dhish... (D.107).

...dukej zhurmë moknash të topituna... (D.134)

...ajo vazhdimësi katundesh... (V. 9).

...vazhdonin të vinin vaje fëmijësh... (V.17).

...të gjithë burra armësh... (V. 22).

...ishin shumica ose bari delesh... (D.115).

...merret një hulli bimësh... (V. 115).

...ma mirë se me djelm malesh... (V.159).

...dërgoi fidana pemësh dhe hardhish... (V.180).

...si gojë floçkash a lubish të lumit” (V.217).

-Por autori nën ndikimin e ligjërimit të folur të zonës përdor rrjedhoren me mbaresën –sh të pa shoqëruar me parafjalë, pasi nuk i paraprin një emër, por një folje ose një mbiemër prejfoljor :

Tuçi ...iu afrue e, tue lëmue krahësh i tha plakës... (V.140).

Plaku i lidhatoi flokësh... (V.29).

Donte t'ua hiqte kambësh nuseve e grave... (V.35).

...i dalun bagëtish...

...e randueme rrotash të mbrapme me zinxhirë... (D. 62).

..e fryma hyn dritoresh... (SR. 4).

...si u shkruftue gjymtyrësh... (V. 26).

...tani sikur ishte tue e ndezë mollëzash faqeve ... (V.223).

Çuni po të kishte qenë i papenguem duersh... (V.225).

-Togfjalëshi emër+emër në rrjedhore të pashquar ndeshet edhe në numrin njëjës:

...Ndoshta ajo murge shtëpie e kishte shikue... (D.80).

...megjithëse natë e shkurtër vere... (V. 17).

...me nderue një babë dëshmori... (V. 197).

...mbanin erë pishë... (D. 320).

...duen të shkëputen nga ajo copë toke... (D.327)

Rrjedhorja paraprihet me parafjalë, si: prej, drejt, para, ndaj, përbrij, faqe, rreth etj. :

...e kishin largue prej grigjes... (V.18).

...para detyrimesh shnjerezore” (D. 77).

...La kovën përbrij pusit... (D.78).

...ku dikur shtrihej shtëpia prej druni... (V. 30).

...u shtrënguan fare pranë plakut... (V. 33).

Fill mbas martese u mbyll ne atë shtëpi-kullë (D.9).

...tek e pa vajzën që po digjej flakë prej ethesh... (V.132).

...me anë ndërmjetsish, lypin besë... (V.109).

...ta turpnonte faqe qarkomandantit... (D. 133).

...rreth tokës kishte qenë... (V.158).

...edhe në jetën jashtë pune... (D.167).

-Edhe parafjala për kur paraprin emra që shënojnë pjesë trupi përdoret me emra të rasës rrjedhore:

...po na del për hundësh edhe ai grimë qejf që bamë... (D. 63).

...thue se me e kapë për hunde i dilte shpirti” (D.118).

-Edhe rasat e tjera, si emërorja, gjinorja dhe kallëzorja përdoren me parafjalë:

Haplologjia

-Kjo dukuri me karakter fonetik vërehet edhe te vepra e Filip Ndocajt, por autori nuk është gjithnjë e prerë, pasi diku alomorfi **-je** përdoret që është mbizotërues, diku jo:

...mes gjith asaj *potereje* të fëmijëve...(V.17).

...i ndryshkun e i pluhnuem i asj *lagjeje* të lanëme... (D. 6).

...si shenjë kënaqësie e *pritjeje*...(V.33).

...e mbas kësaj *thirrjeje*...(V.34).

...nji atmosferë *vdekjeje*...(V.172).

...në raste *sëmundjeje* dhe fatkeqësie (V.168).

...I dukej vetja si në mes një *ahishteje*...(V.154).

-Ngjet që të njëjtën fjalë, duke mos qenë konsekuent ta ndeshim të përdoret në dy trajta:

...Po atëherë shtëpiaku i *asaj familje*, Masjan Gjura...(V.11).

...Njeni prej po *asaj familjeje* lëshoi atëherë parullën...(V.10).

...vendosën që kësaj *grindje* t’i venin kapak...(V.146).

Mbiemri

Arshi Pipa

Në veprën e Pipës ndeshim si mbiemrat cilësorë me një dhe pa një, si dhe mbiemrat marrëdhënorë:

...dëshirë e drejtë e natyrshme, e ligjëshme...(P. 124).

...por i thjeshtë ish vorri...(R.40).

...nji belzhdërvjelltë *gjatoshë* si tue vallzue...(L.B.40).

...e ty floknajen...*zeshkane*...(L.B.48)

...E disa emnave *historikë-gjeografikë* ... (L.B.11).

...për zhdukjen e gegënishtes *letrare*...(P.122).

Shkallët e mbiemrit

Gjuha shqipe ndryshe nga gjuhët sllave, gjermanike, romane perëndimore, greqishtja për ndërtimin e shkallëve të mbiemrit nuk përdor forma sintetike, por analitike. Edhe te A.Pipa vërehet një dukuri e tillë, pasi për të dy shkallët e mbiemrit, forma e ndërtimit të tyre është gjithnjë analitike.

Nga vjelja e materialit konstatojmë se ai përdor shkallët krahasore dhe sipërore. Nuk mund të themi asgjë në veçanti për shkallën pohore, pasi mbiemrat cilësorë që pohojnë tiparin e sendit ose praninë e tij në vepër ndeshim një numër të konsiderueshëm. Duke qenë se për disa autorë, si E.Hysa e ndonjë tjetër, ajo mund të quhet kështu vetëm në mënyrë konvencionale.¹ Ndërsa për studiuesin A.Dhrimo që është marrë ekskluzivisht me mbiemrin, shkalla pohore do kuptuar si shkallë bazë e krahasimit. Për autorin “*mbiemri në shkallën pohore, pra vetëm përmend thjesht tiparin e një sendi gramatikor pa treguar shkallën...dhe pa bërë ndonjë krahasim të këtij tipari...me po këtë tipar te sendet e tjera...*”²

A.Pipa shkallën krahasore e përdor si krahasore të sipërisë relative dhe absolute, si dhe krahasore e ultësisë.

Shkalla krahasore e sipërisë relative

Ajo tregon se cilësia te sendi i dhënë është në një shkallë më të lartë sesa te një send tjetër ose tek i njëjti send në rrethana të tjera.³

Ajo është ndërtuar sipas këtyre skemave në veprën e Pipës:

a.Mbiemër në shkallën pohore + pjesëzën ndajfoljore më:

...E *mâ e bukur* shëndritë kur dielli i mesditës zharitë... (L.B.47).

...xhamadani vinte tue iu fry, gjâ *mâ e mirë* nuk kish me u pa me sy...(Ro.10).

...ajo dëshirë *mâ e fortë* i ngjallej...(L.B.132).

...nuk thom se jemi *mâ të mirë* se bota...(L.B.117).

b.Ndajfolje përforcuese + mbiemër në shkallën krahasore të sipërisë relative:

...kotlla e bardhë qi duket *edhe mâ e bardhë* nga flokët...(L.B.40).

...çka asht *edhe mâ e randsishme*, pa origjinalitet...(P.L.112).

... *edhe mâ e theksueme* te emrat foljorë...(P.L.113).

Shkalla krahasore e sipërisë absolute

Kjo shkallë e mbiemrit tregon se cilësia e dhënë te një send a disa sende të një grupi homogjen është në shkallën më të lartë. Këtu vihen përballë pjesa me të tërën e synuar si grup⁴.

...për shkrimtarin *ma të madh* të periudhës së hershme të letërsisë shqipe...(P.L.119).

...Ngjatje vonë *mâ i lashti* zën me thanë...(R.22).

...Cila t’jetë ajo *mâ e reja* e shtëpisë...(R.65).

...Letërsia si pjesa *mâ e madhe* e dijes...(P.L.107).

...*mâ i urti* ka fajet e veta...(L.B.42).

...në politikë fiton *mâ i forti*, jo *mâ i drejti*...(P.L.123).

1.E.Hysa, *Mbi shkallët gramatikore dhe mjetet e shprehjes së tyre në gjuhën shqipe*, Konferenca e dytë e studimeve albanologjike, III, Tiranë, 1969, f.226.

2.A. Dhrimo, *Shkallëzimi i mbiemrave*, në botimin e autorit “Për shqipen dhe shqiptarët”, I, Tiranë, 2008, f.89.

3. *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 2002, f.175.

4.Po ai, po aty, f.177.

Shkalla krahasore e ultësisë

Kjo shkallë tregon se cilësia te sendi i dhënë është në një shkallë më të ulët sesa një send tjetër, ose te i njëjti send në rrethana të tjera.⁵

Autori e ndërton me dy skema:

Lokucioni ma pak + mbiemër në shkallën pohore:

...Përgjegjja e markoviq-it:” Janë *mâ pak të rrezikshme*...(P.L.123?).

Lokucionin pak ma + mbiemrin në shkallën pohore:

... Thom se vllau do t’jetë *pak mâ mikpritës* se sa motra...(R.36).

Shkalla sipërore

Kjo shkallë si shkalla krahasore jo vetëm që është analitike, por ndërtohet me mjete leksikore.

Ajo tregon se cilësia e dhënë është në një shkallë shumë të lartë jashtë çdo krahasimi.⁶

a.Pipa e ndërton këtë shkallë me ndajfoljet mjaft, fort, jashtëzakonisht etj.:

...a s’është sot *mjaft e vorfën?*... (L.B.16).

...dhe se gabimet e shtypit janë *jashtëzakonisht të shpeshta*... (P.L.119).

b. Mbiemër në shkallën pohore + ndajfolje sasive :

...Fuqi *e madhe fort* është , thonë, taljani...(L.B.16).

c.Ndajfolje sasive +mbiemër në shkallën pohore:

...ishte e bukura tejet Svetlana...(R.52).

Sami Repishti

Mbiemri

Repishti si dy autorët e tjerë përdor si mbiemrat mr një dhe pa një, ashtu edhe mbiemrat cilësorë dhe marrëdhëniorë, siç shihet në shembujt e mëposhtëm:

...fëtyra e tij u ndrit me një buzëqeshje *të gjanë, të plotë e të ambël*...(P.L.129).

...në dorën tjetër mbante një torbë *të vogël* me crrulet *vetjake*...(P.L.131).

...nga varësja e rrobave mori një shall *të leshtë*...(P.L.133).

...kishte marrë një pamje *të akullt*...(P.L.13).

...ajo fëtyrë nane përherë *engjellore*...(P.L.13).

...në këtë skaj të harruem të rruzullit *tokësor*...(Ro.255)

Shkallët e mbiemrit.

Autori përdor si shkallën krahasore, ashtu edhe atë sipërore.

Shkalla krahasore e sipërisë relative

Këtë shkallë e ndërton sipas kësaj skeme:

pjesëza ma +mbiemër në shkallën pohore:

...fshamjet e studentit u banë *ma të rralla e më të thekshme*...(P.L.44).

...Por prania e tyne... i bante ata *ma të mëdhaj*, se pesha e secilit në vete...(Ro.101).

5. Po ai, po aty, f.178.

6.Po ai, po aty, f.178-179

Nga konteksti kuptohet se është e njohur gjymtyra e dytë e krahasimit, prandaj nuk e shpreh. Edhe në shembujt në vazhdim vërehet e njëjta dukuri:

...Përgatitja psikologjike e terrenit sot nuk lejon me shpresue për ditë *ma të mira*. (P.L.143);

... Dhe mjet *ma i mirë* me ndryshue këtë gjendje ...është konsiderue lufta. (P.L.144).

-Repishti e përdor këtë shkallë të shoqëruar me ndajfolje të ndryshme përforcuese, duke krijuar një skemë të tillë:

ndajfolje përforcuese + mbiemër në shkallën krasore të sipërisë relative:

...Çdo ditë e ma tepër po bahesha *edhe ma i heshtun*. (P.L.19).

...Ditët që kalojshin baheshin *edhe ma të vështira* nga gjendja ekonomike...(Ro.87).

...nji jete mbyhtëse e monotone *shumë ma e keqe* se ajo e fermerit amerikan...34

Shkalla krahasore e sipërisë absolute

Mbiemri në këtë shkallë vë përballë pjesën me të tërën dhe emri që përcaktohet nga mbiemri është në trajtën e shquar::

...njerëzimi po përjeton, ndoshta tragjikomedinë *ma të madhe* të historisë së tij.147

... Mu në qendër të Europës ... asht zhvillua masakra *ma e madhe*, me viktimat ma të shumta e prap asht folë për qytetnim. (P.L.144).

...Megjithatë po jetojsha çastin *ma të ndritshëm* të jetës sime...(Ro.330)

...Ishte forma *ma e naltë* e kohezionit shoqnor të qytetarisë shkodrane...(Ro.26).

Siç shihet mbiemri i madh përdoret në shumës një trajtë dialektore.

Shkalla sipërore

Këtë shkallë e ndërton me ndajfoljet e sasisë *shumë, tejet, mjaft, jashtëzakonisht* etj. si dhe me disa ndajfolje të tjera përforcuese, si: *thellësisht, tmerrësisht* etj.

...Kemi hy në një suazë nga e cila asht *shumë e vështirë* të dalim... (P.L.88).

...kur kishte diçka *tejet të randsishme* me tregue...(P.L.114).

...dy sy gjithherë të qeshun e bajshin *shumë tërheqëse*...(P.L.122).

... sot jam vetëm, *tmerrësisht i vetëm*... (P.L.127).

...sidomos melodia e kangëve *thellësisht melankolike*...(P.L.133).

...për nanën time përpjestime të pakufishme tej njerzore...(P.L.7):

Filip Ndocaj

Mbiemri

Ndocaj në veprën e tij përdor si mbiemrat cilësorë me nyje dhe pa nyje, si dhe mbiemrat marrëdhëniorë:

...por ishin melodi *të reja*... (D.77).

...nga shtresat *e vorfëna* të popullit... (D.85).

...një varg rrapash *të motnuem*...(D.137).

...E ajo **violinë** *vetmitare*, që rënkonte me tinguj melankolikë... (D. 76.).

... mes atyne dy duerve *të njoma, të freskëta, burrnore*... (D.106)...

...dukej ma shumë stan *i madh* bjeshke...(D.112).

...kishin ndërte shtëpi *të re* guri e *dykatëshe*...(D..98).

...kishte shpëtue nga vdekja *e sigurtë*...(D..120)

...se trupat *e parë* janë baza e ngarkesës... (D.126).

...nuk ke mësuar nga klasa *punëtore*...(D.167).
...ndoshta ishte ajo fytyrë e *zbehtë, e hequn*... (D.187).
...ekipet e brigadat *kulturale* e merrnin me vete... (D.190).
...je djalë *i mirë, i sjellshëm e i ndershëm*... (D.195).
...vërshon ujët e sa të *argjentë* Valbona, lumi i Gashit... (V. 9).
...në katin e *sipërm* të kullës... (V. 15).
...me ngjitë shkallët e *jashtme*...(V.83)

Shkallët e mbiemrit

F.Ndocaj në vepren e tij përdor si shkallën krahasore me nënndarjet e saj, ashtu edhe shkallën sipërore.

Siç dihet në shqipe kategorinë gramatikore të shkallës është analitike ndryshe nga disa gjuhë të tjera europiane që e kanë edhe sintetike.

Kështu shkalla krahasore e mbiemrit , cilësia e tij krahasohet me një cilësi tjetër ose me vetveten..

Shkalla krahasore e barazisë.

Këtu kemi të bëjmë me një cilësi që është e njëjtë për të dy krahet e krahasimit:

E ajo ishte krenare për atë shoqëues *aq fanatik*...(D. 44).

...Ishte *sa bujar aq edhe besnik*... (D. 111).

...në mes të një kolektivi *aq të larmishëm*...(V. 199).

...e jo që ti je e re, je *aq e re*... (D. 317).

...i dhanun me shpirt mbas profesionit të vet *aq humunitar*... (D.347).

... qe dukë një orë *aq e mërzitshme, aq e randë*... (D. 355).

Shkalla krahasore e sipërisë relative

Kjo shkallë tregon se cilësia te sendi i dhënë është në një shkallë më të lartë se cilësia te një send tjetër etj.

Ndërtohet sipas këtyre skemave:

a.Mbiemër në shkallën pohore + pjesëzën ndajfoljore *ma*:

E ti gjente *ma të rinj* se i kishte dërgue.. (D. 44).

...me kujdesin *ma të madh* uli filxhanin... (V. 26).

...nuses *ma të re* të shtëpisë... (V. 18).

...për gjanë *ma të vogël*, e pyesni... (V. 6).

b.Ndajfolje përforcuese + mbiemër në shkallën krahasore të sipërisë relative:

...dëshmi e të kaluemes *edhe ma të zezë*... (V. 13).

...tue vëshruet *edhe ma të voglën* lëvizje...(D.316).

...do të baheshe *edhe ma e mirë* se ishe...(D. 317).

...edhe ai *ma i humbuni* shikonte se...(V.64).

Shkalla krahasore e sipërisë absolute

Tregon se cilësia e dhënë tek një emër është në një shkallë më të lartë se grupi ku bën pjesë:

...megjithëse ishte “shahiri” *ma i madhi* i qytetit...(D. 78).

...trimi *ma i fortë*, ma kollaj se me ble një kalë... (D. 85).

...janë elementi *më i padëshiruar* i fshtatit... (D.120).

...zu kaptijat *ma të fortat...* (D.129).
 ...do të doja të kisha një mësuese *ma të paaftë* në profesionin e mësuesit... (D. II, 257).
 ...me *ma të sprovuemit* e parkut ishte bashkue... (D.78).
 ...të betohem që edhe reaksionari *ma i keqi* nuk saboton...(D.119).
 ...tregohej *ma i zgjuet* e *ma i shkathët...* (V.. 28).
 ...si *ma fatbardhi* i malësisë” (V. 20).
 -Theksojmë se po qe se mbiemri përdoret si epitete dhe emri është në trajtë të shquar, mbiemri merret në shkallën krahasore të sipërisë absolute.

Shkalla sipërore

Tregon se cilësia e dhënë është në shkallën më të lartë jashtë çdo krahasimi:

Kur lexonte disa gjykime si **tepër ekskluzive...** (D 51.).
 ...po qëndronte *krejt i mërzitun...* (V. 17).
 ...jeni edhe *mjaft të lezetçëm...* (D..86);
 ... Ke *plotësisht të drejtë* me më thane kështu... (D.105).
 ... Në fillim dukej *tepër e randë...* (D. 326).
 ...Ishte i zellshëm dhe *shumë i kujdesshëm...*(D. 327).
 ...ato biseda *fare intime...* (D. 349).

-Në kuptimin e kësaj shkalë përdoren edhe disa emra me kuptim të fytyruar që emërtojnë një tipar karakteristik të këtyre emrave që e kanë në shkallë shumë të lartë¹:
 ...Atë ka lanë kamba e dora , por mendjen e ka *akull* e gjumin *brisk...*(V.16).
 ...disa nuse e gra të reja të katundit që me të e kishin mjalte. (V.144).
 -Këto emra mund të përdoren në bashkëvjajtje me mbiemrat, duke u ndajfoljësuar:
 ...kishte një shytë *akull të re...* (D. .131).
 ...Ishte *dyllë i verdhë* e s’bante vër me gojë... (D. 82)
 ...po degëdisëj braznish avisore të etherit, *pupul e lehtë* në pamatuninë e qiejve... (D.76).
 ...kroni *akull i ftohtë* ku asht pushimi i parë... (D.130)
 -Autori, ndonëse rrallë e përdorë këtë shkallë me përsëritjen e mbiemrit:
 ...i kishte dhënë një puthje *të ftohtë, të ftohtë* ...(D. 335).

* * *

4.Përemrat, llojet, veçoritë

Përemrat, siç dihen, janë fjalë treguese, që nuk shprehin koncepte. Në pikëpamje morfologjike dhe sintaksore ata nuk janë fjalë homogjene, por përkundrazi i karakterizon heterogjiniteti.Sipas kuptimit në shqipe kemi 7 përemra, disa prej të cilëve do t'i përshkruajmë më poshtë sesi shfaqen në veprat e tre autorët, ndonëse dallimet me shqipen e sotme standarde nuk janë thelbësore.

1.Gramatika e gjuhës shqipe, 1, Tiranë, 2002, f.179

Arshi Pipa

Përemrat vetorë

Përemrat vetorë si fjalë treguese tregojnë veta të ndryshme. Kanë dy numra, ndërsa veta e tretë paraqitet me dy gjini, mashkullore dhe femërore. Konkretisht:

Veta e parë: *un, na*, veta e dytë: *ti, ju*, veta e tretë: *aj/ai /, ajo, ata, ato*.

Përemrat vetorë përdoren me trajta me trajta të shkurtra në rasën dhanore dhe kallëzore, si:

...që s *më* di dhe që s *e* dij...(L.B.123).

... kanë zakon me *i* gjuejtë me gurë... (R.82).

...t'*u* dalim zot kufinjve...(L.B.119).

...besë e nder *i* kemi bashkë... (L.B.127).

...Lena at'herë kërceu e *i* erdh përbri...(R.61).

...Se *t'*ka joshë me dhel... (R.77).

-Ndeshim edhe trajtat e bashkuara të çdo vete në rasën dhanore dhe kallëzore me trajtën e shkurtër të rasës kallëzore njëjës dhe shumës të vetës së tretë, si:

...kush at gjâ s *ta* ven ty barrë...(L.B.21).

...e poplat vigane *ua* fërflon...(L.B.19).

...kështu që sundimtari nuk din kah me *ja* mbajtë ...(P.119).

...ndoshta dorën ti *ia* ke drejtue...(R.78).

...ti ma fale at jetë qi sot *ma* more...(R.79).

-Si rast të izoluar te vepra e Pipës kemi ndeshur që trajta e shkurtër e rasë dhanore shumës *u* i referohet një emri të rasës rrjedhore shumës:

...prej bredhave coptue ndër brraka gjaku, e ushtarve t'bindun fjalë *u* foli *burrash*...(L.B.19).

-Përemrat e vetës së tretë njëjës dhe shumës rase kallëzore dhe rrjedhore përdoren dendur pa a-nistore, por gjithnjë të shoqëruara me parafjalë.

Rasa kallëzore dhe rrjedhore: *me tê* (=ate), *prej tij* (=atij) (L.B.101), *ndaj tij*, *mbas saj* (asaj) (L.B.29), *mbi ta* (=ata)L.B.16, *me to* (=me ato) (L.B.164), *ndaj tyne* (=atyne) ... (L.B.42).

- Si raste të izoluar përdor edhe trajtën e vjetër të rrjedhores pa a-në nistore:

...na bijt e tyne zgafullue prej si (=asi), (R.51).

...Por ndodh sa herë qi njeni *sinh* (=asish) nuk tundet...(L.B.65).

-Trajatat e shkurtra mund të bashkohen edhe me fomantin e formës joveprore *u*:

...Rushës *iu* kujtue 27, at'herë tue *iu* avitë... (R.15)

...Kjo ndodhi se atij *iu* desh me zgjedhë ...(P.111).

...qi *iu* ngjit tyt eti...(R.55).

-Trajatat e bashkuara qofshin këto edhe me lidhoren ose me të ardhmen, autori i shkruan pa apostrof si në gjuhën e sotme, ndonëse ka edhe raste të izoluar, kryesisht në publicistikën e fundit që i apostrofon:

...*ta* shifsha ndonjiherë...(L.B.9).

...*ta* merr mendja (R.69).

...do *ta* shof një copë herë ...(R.69).

...u la në sheshin e Prishtinës që *t'a* hajshin qëjt. (P.118).

...censura i vuni kusht *t'a* përkthente italisht librin...(P.110).

...*T'a zamë se vepra e tij të ishte ribotue...*(P.120).

-Nëse trajta e shkurtër ose formanti i lidhore *të* bashkohet me trajtën e shkurtër *i*, atëherë autori i apostrofon si në standard:

...Si *t'i* binte kush në topuz ... (43)

...kush din *t'i* njehë sa sojesh ... (L.B.44)

-Trajta e bashkuar e përemrit vektor *ia* (*i+e* ose *i+i*) dhe *iu* nga Arshi Pipa shkruhet me trajtën *ja* dhe *ju* te *Libri i burgut* dhe në shkrimin e vitit 1990:

... e *ja* diftojshin puntoris me gisht (L.B.66).

...*ja* mardhi shtatin... (L.B.18).

...*ja* njihni shpejt natyren... (L.53).

...*t'ja* kthej un kombit tim... (L.B.111).

...Lene *t'*shkojë e mbarë *ju* dhashtë... (L.B.21).

Ndërsa në librin "Rusha" Pipa këto trajta i shkruan me *ia* dhe *iu*:

...dorën *ia* mbërtheu te byleziku... (R.25).

... i ruejtun je çdo kobi po *t'ia* falish kuj... (R.32).

...nuk ka ndër ju qi vetë *t'ia* nisi... (R.11).

...e qysh sytë ajo me tmerr *ia* kalli... (R.51).

Përemri vetvetor

Tregon personin i cili e kryen veprimin ose e pëson. Dy janë përemrat vetvetorë që i ndeshim te Pipa, ashtu si në gjuhën e sotme: *vete* dhe *vetvete*:

...E quen *veten* maqedhonas... (P.120).

Shej nuk due prej teje e kam me *vete*... (33).

...Por s kemi arsye pse ta poshtnojmë *vetveten*... (L.B.117).

-Autori mbështetur në ligjërimin e folur dhe në traditën shkrimore geqe, si dhe dy autorët e tjerë

përemrin vetvetor *vete* e përdor pa faringalen *h* në trup të fjalë, ashtu si do ta ndeshim edhe në disa autorë jugorë, si në veprën e Nolit, por jo tek të gjithë jugorët.¹

Fjala *vetë* në gegërishte e ndeshim më shumë në ligjërimin e folur. Përdoret me vlerën e një përemri përcaktues, identifikues. Ai përforcon kryesisht një përemër vektor në veta të ndryshme, por mund të përdoret edhe në vend të përemrit vektor.

...kur u- mëzitën *vetë* tue u rrahë, tue fshikun... (L.B.68).

...Apor je *vetë* i dashuni... (L.B.109).

...*vetë* s'jam veç një fëmën... (R.29).

...ka të bajë me *vetë* Bogdanin... (L.P.120).

...kur ra Shqipnija kushtrimi *vetë* i ngjalljes e i shëlbimit... (L.B.20).

¹Shih: F.Agalliu, *Gjuha e Nolit*, Tiranë, 1999, f.42.

...shortin e dhimbës *vetë* me dashje e zgjodha...(L.B.33).
 ...ti u-hodhe m'kape , m'qite por *vetë* nuk dole ma... (L.B.60).
 ...ai *vetë* tash trimit i ven mbi parzëm medalje ari...(L.B.133).
 ...asht dora e burrit *vetë* ...(R.21).
 ...*vetë* ajo e drejtoi e i rroku kokën... (R.78).
 ...ani e dij se kuj ia jap un *vetë*...R.10
 ...un *vetë* kam ecë z bathë...(L.B.202).

Përemrat dëftorë

Tregojnë sende apo frymorë që ndodhen afër ose larg folësit. Përemrat *ky, kjo, këta, këto* janë ato që përdoren në gjuhën e sotme. E veçanta në shkrimet e Pipës, përgjithësisht me përjashtim të rasteve të izoluar, i ndeshim pa zanoren *ë* në trup të fjalës: *Kta, kto, ktij, ksaj* etj. Ndeshim edhe dy trajta në të njëjtën rasë, por me përparësi trajta pa *ë* në trup të fjalës: *kët, ktij, ksaj kta* , por rrallë: *këtë, këtij, kësaj, këta, këtyne* etj. Shumë rrallë përdor përemrat dëftorë e tillë etj.

Përemrat pronorë

Tregojnë se sendi i dëftuar i përket një vete të caktuar. Shqipja është e pasur me përemrat pronorë, ku përfshihet edhe përemri pronor vetvetor *i vet*. Ata përdoren më vete ose në bashkëvajtje me emrat. Edhe përsa i përket topikës, ata i ndeshim kryesisht pas emrave që përcaktojnë, por në bashkëvajtje me emrat e farefisnisë ata paravendosën.

Pasqyra e përemrave pronorë sipas vetave numrit dhe gjinisë që pasqyrohen në veprën e Pipës:

Veta e parë				Veta e dytë			
Njëjës		Shumës		Njëjës		Shumës	
M	F	M	F	M	F	M	F
<i>im</i>	<i>ime</i>	<i>e mij</i>	<i>e mija</i>	<i>yt</i>	<i>jote</i>	<i>e tu</i>	?
<i>ynë</i>	<i>jonë</i>	<i>tanë</i>	<i>tona</i>	<i>i juej</i>	<i>e juej</i>	<u><i>e tue</i></u> <i>tuej</i>	<i>tua/tueja</i>

Veta e tretë				
Njëjës				Shumës
M		F		M-F
<i>i tij</i>		<i>e tij</i>		<i>e tija</i>
<i>i saj</i>	<i>i vet</i>	<i>e saj</i>	<i>e vet</i>	<i>e saja</i>
<i>i tyne</i>		<i>e tyne</i>		<i>e tynja</i>
				<i>e veta</i>

Autori, ndonëse bën përpjekje për të qenë sa më afër përdorimit të drejtë të përemrave pronorë

në pajtim me gjuhën e sotme shqipe, përsëri vërehen luhajtje, ndonëse nuk janë pasqyruar në vepër të gjitha format e lakimit.

Përemri pronor në disa raste përdoret edhe me nyje të përparme jo në pajtim me përdorimin e sotëm ose ngjet e kundërta që përdoret pa nyjë, kur ajo e do ose nuk përputhet me gjininë e pronës:

...At'herë dhe gjaku *i juej* jo kot ai birret...(L.B.20).

...der n'Çamëri Shqipnija është gjithë *e jona* ...(L.B.23).

...E puthi prangat për gërshetat *tua*...(L.B.45).

...Aty mes shoqeve *tua* tue rendë...(L.B.47).

Gjithashtu përemri i vetës së parë shumë përdoret me trajtën me j: *e mij* dhe *e mija*, ndryshe nga standardi i sotëm. Shumë i paqartë është në përdorimin e përemrit pronor të vetës së dytë numri shumë. Ndërsa përemrat e vetës së tretë shumë të gjinisë mashkullore dhe femërore përdoret me mbaresën -a: *e tija*, *e saja*.

Theksojm se gjata lakim në rase të ndryshme shfaqen trajtat dialektore të të folmeve të gropës së Shkodrës.

Përemrat pronorë në bashkëvajtje me emra farefisnie

Autori ynë në mjaft raste përdor përemrat pronorë në bashkëvajtje me emra farefisnie.

Përemri i vetës së parë njëjës, gjini mashkullore nuk ka asnjë ndryshim me standardin e sotëm (*im vlla*), ndërsa për gjininë femërore përdoret trajta *em amë*.

Përemri i vetës së dytë njëjës, gjini mashkullore, rase emërore nuk ka asnjë ndryshim me standardin, por në rasën gjinore dhe dhanore e jep në trajtën *tyt* e jo në trajtën *tët* siç e kemi në standard.

Ndërsa për gjininë femërore ndryshimi me standardin vërehet në rasën gjinore dhe dhanore pasi autori e jep në trajtën geqe *sate* me e fundore *sate motre*, pasi në gjuhën e sotme përdoret trajta *sat motre*.

Përemrat pyetës , lidhorë dhe të pacaktuar

Janë ata përemra, por jo të gjithë që përdoren në shqipen e sotme, ndonëse kemi ndeshur disa përemra që kanë ndonjë ndryshim fonetik ose janë veçori e gegërishtes.

Kështu përemrin lidhor që autori e përdor në trajtën geqe me *i* dhe jo me *ë*.

...nuk ka ndër ju *qi* vetë t'ja nisi ...(R.11).

Por në studimin e vitit 1990 Pipa tashti përfaqon trajtën e mbarë shqipes që:

...por për njerëz të kulturuem që dinë ç'është letërsia e që e çmojnë atë...P.106.

Përdor jo rrallë përemrin *çka*:

Dordhomel, kumarë, *çka* je kah thue? (R.10).

Çka thatë në këtë tekst , është në njënen anë...(P.108).

Ndër përemrat shumë i pasur paraqitet në shqipe përemri i pacaktuar, gjë që vërehet edhe në veprën e Pipës, duke përdorur edhe ndonjë përemër që e ndeshim kryesisht në gegërishten, si:

Njeni zien **do** barna...(L.B.64).

.Shkoi *do* kohë djaloshi...(R.27)

Sami Repishti

Përemrat

Përemrat vetorë

Përemrat vetorë përdoren si në standardin e sotëm, me përjashtim të vetës së parë shumës që përdor trajtën *na*:

...Tek **na** nga një ditë në tjetrën formohej ideja e luftës për liri...(Ro.21).

...siç e mendojshim *na* fëmijët...(P.L.8).

...hendeqet e hapuna e ta mbylluna nga *na* (Ro.254)

Përsa i përket lakimit të përemrit vetor *ai, ajo, ata, ato* autori përdor në rasën kallëzore dhe rrjedhore trajtat pa a-në nistore, shoqëruar gjithnjë me parafjalë të këtyre rasave, si:

Shumë prej tyne, bashkë me ta... (P.L.127),

...me ndërsye kundër saj... (P.L.149). etj.

Autori nuk është konsekuent. Trajtën atë pa a-në nistore e përdor herë me *e* dhe herë me *ë* fundore:

...pushonte ndejë *mbi te*... (P.L.131).

...sa ma shumë kjo rritej, aq ma shumë ai afrohej *me te*...(P.L.6).

... si familjarizohet polemi *me të* dhe ruhet...(P.L.145).

Duke ditur se sintetizmi është një dukuri e shqipes, ne e vërejmë këtë edhe në përdorimin e përemrave vetorë nga autori, duke mos përdorur parafjalë:

...Shumë *nesh* nuk laheshin para ngranies së darkës...(P. L.22).

...nana nuk mund të ndahej *nesh*...(P.L.16).

Jo në pajtim me drejtshkrimin e sotëm, trajtë e bashkuar e apostrofon.

...Si *t'a* gjykoj këtë masë...(Ro.167).

Përemrat vetvetorë

Ashtu si në standardin e sotëm, Sami Repishti si përemra vetvetorë përdor: **vete** dhe **vetvete** në rasën kallëzore dhe rrjedhore të shoqëruara me parafjalë ose jo:

...me sigurie jetesën për *vete* dhe për familjet e tyne...(P.L.9).

...ai e ndien *veten* të lirë...(P.L.33)

...duhet ta ketë pa *veten* me shpatulla për mur...(P.L.11).

...në ato ditë ishte në *vetvete* një rrezik...(P.L.10).

...e na mbështjellte pranë *vetes* me një gjest mbrojtës...(P.L.7).

Theksojmë se edhe Sami Repishti përdor përemrin **vetë** me vlerën e një përemri përcaktues të çdo *vete*, veçori kryesisht e të folmeve dialektore:

...e falenderova ...se edhe unë *vetë* po dridhesha...(P.L.25).

...plaku *vetë* nuk ishte lejue me ushtrua...(P.L.30).

Përemrat dëftorë

Si përemra dëftorë ne veprën e autorit shërbejnë *ky, ai, i këtillë* me kategoritë përkatëse, ndonëse nuk i kemi ndeshur të gjitha trajtat, si dhe rasat e gjinitë. Pa i specifikuar të gjitha trajtat, pasi siç e theksuam nuk i kemi ndeshur, po shënojmë disa prej tyre:

...me shpresën e madhe se *kësaj* radhe nuk do të kishte lajme të këqija...(P.L.22).

...në këtë *bindje karrë* nuk u lëkundën...(P.L.7).

... *këta* të mjerë spjegimin e së ardhmes...(P.L.25).

...po hollësitë e plota të *asaj* ngjarjeje...(P.L.25).

...ato ditë Qemali ishte për mue një vlla...P.L.39

...dhe si *i këtillë* humba lirinë...(P.L.11).

...mund të prodhonte fitore të *këtilla* kulturore dhe artistike...(P.L.37).

Përemrat pronorë

Autori jo gjithnjë i përdor drejt përemrat pronorë.

Për vetën e parë vërejmë që Repishti nuk është konsekuent, pasi diku përemrin e përdor pa një të përparme siç e ka drejtshkrimi i sotëm, diku, por rrallë, me një që është një formë dialektore e ligjërimit të folur:

...vllai im u skuq në *fëtyrë*...(P. 135).

...ku ishte dhe ku po shkonte *vendlindja ime* (P.L.142), por edhe:

... pak ma vonë mora vesh...se gjendej ...*shok i imi nga Luma*...(P.L.141).

Mos përshtatja në gjini e pronës me pronarin:

... sepse në një vend të vorfën si *qyteti jonë*...(P.L.129).

...dhe atij i *dukej se arsyetimi jonë*...(P.L.123).

...sepse në atë zbulohet, në formë fiktive *fati jonë*... (P.L.34).

...I mbajtun mbi supet tona me turne *grupi jonë* e shpëtoi nga...(Ro.210).

...që ruheshin nga *zemërimi jonë*... (Ro.211).

Por autori përdor edhe trajtën e drejtë gjuhësore duke e përshtatur në gjini pronarin me pronën:

...Atdheu ynë u quejt i lirë...(Ro.29).

Vazhdon edhe me përemrat e tjerë pronorë, duke mos u përshtatur gjinia e pronës me pronarin: ...që varet mbi *krenat tonë* si shpata e Demokleut...(P.L.143).

Gjithashtu nuk është i saktë në përdorimin e rasave gjatë lakimit .Kështu përdor kallëzoren për dhanoren, si:

... zbulimi i *botës tande* në vend të *botës sate*... (P.L.135)

Në veten e tretë shumës gjinia femërore përdor trajtat *vajzat e tija, vuajtjet e tija*.

Repishti si në standard, por që është veçori e gegërishtes në vetën e tretë përdor përemrin vetvetor *i/e vet* kur i referohet kryefjalës:

..I tepërm në *Shtëpi të vet*, barrë për fëmijët e vet, i padëshirueshëm në *vend të vet*, i harruem prej *shokëve të vet*...(P.30).

Kur përemrin pronor e përdor të emëruar dhe shërben si pjesë e kallëzuesit emëror, ose përcaktorë kallëzuesorë e shoqëron me “një”, si:

...e bota *ishte e jona*...(P.L.130).

... Fatkeqësi e madhe *kjo e jona*...(P.L.24)

...në këtë botë që ose asht *e jona* ose nuk asht fare...(P.L.128), ndikim i ligjërimit të folur.

Edhe kur autori nuk përdor përemrin pronor, por e emërzon atë e shoqëron me nyjë :
 ... Duket se u friksue nga *nji ndërhyrje e imja*...(P.L.135-136).
 ...Ti je largue nga frika, sepse sot , kjo përpjekje e *jona* asht një luftë e ashpër...(Ro.60).
 Në këtë rast autori e përdor emrin të pashquar , ndërsa pronori emërzohet me nyjë përpara.¹
 Në rastin kur e përdor emrin të shquar përemrin nuk e shoqëron me nyjë:
 ...as nuk frikësohem nga sakrificat qëkërkon përpjekja *jonë*...(Ro.60).
 Në bashkëvjajtje me emrat e farefisnisë përemrat pronorë të vetës së parë i paravendosen emrit:
 ...*im* vlla ndiqte pa ia da sytë...(P.L.129).
 Përemrat e tjerë mbeten si në standardin e sotëm të shqipes.

* * *

Përemrat e tjerë janë në përputhje me trajtat e mbarë shqipes, ndonëse ndeshemi edhe me gabime.

Përemrat lidhorë

Si përemër lidhor përdor trajtën **që**, pra jo trajtën dialektore, si dhe **çka, i cili** me kategoritë përkatëse:

...Në shtëpinë e babes *që* ajo vizitonte shpesh (P.L.7).
 ...me etjen e madhe të udhëtarit *që* kërkon viset e panjohuna...(Ro.66).
 ...Lili ke humbë *çka* asht e jotja...(Ro.62).
 Si përemra lidhorë të pacaktuar kemi ndeshur kryesisht. përemrin *çka*:
 ...*Çka* na ngrohte në atë mbramje... ishte origjina e shkrimtarit...(P.L.34).
 ...*Çka kishte pa ...e kishte revoltue ideali që premtonte*...(P.L.36).

Përemrat e pacaktuar.

Shumica e këtyre përemrash të pacaktuar i ndeshim edhe në standardin e sotëm.
 Autori gjithnjë si numëror apo përemër i pacaktuar ose në përbërjen e një përemri të pacaktuar apo të një ndajfoljeje përdor trajtën *nji*:
 ...ulun mbi prakun e një ure të vogël, *nji* prej atyne urave...(P.L.29).
 ...*asnji* fjalë keqardhje, *asnji* gjest pendimi...(P.L.22).
 ...trishtimi që nuk i ndahej *asnjiherë* ... (P.L.16).
 .., ma këputi shpirtin njikohësisht... (P.L.20).
 ...U ngrita *menjiherë*...(P.L.20).

Mund të sjellim ndonjë rast të veçantë. Autori nuk e përdor drejt përemrin e pacaktuar tjetër përsa i përket gjinisë:
 ...por edhe qindra *familjeve tjera*... (P.L.50).

1.Gramatika e gjuhës shqipe, 1, Tiranë, 2002, f.242, shën.b; shih edhe: Gj.Shkurtaç, *T'i përdorim drejt përemrat pronorë*, "Gjuha jonë", 1981, nr.1, f.89-93

Filip Ndocaj

Përemrat

Përemrat vetorë

Janë po ato trajta që i ndeshim, kryesisht, në gjuhën standarde, duke pasqyruar veçoritë fonetike të dialektit që përfaqëson:

...lum *unë* për grue që kam...(D. 282).

...me lanë kokën për *mue*... (D., 295).

...me marrë mend prej *meje*... (D. 272).

...Për *ne* shoferët rrugët janë... (D. 356).

...ashtu si thu *ti* ashtu...(D. 292).

...do të ketë ndonjë gjë për *ty*... (D. 296).

-Edhe te vepra e F.Ndocajt përemrat vetorë të vetës së tretë njëjës dhe shumës, në rasën kallëzore dhe rrjedhore përdoren edhe pa *a-në* nistore, të shoqëruar gjithnjë me parafjalë, ashtu siç e ndeshim edhe te dy autorët e tjerë:

...mund të fliste ndonjë fjalë *me të*...(D.316).

... Të merrte forcë prej *tij*...(D. 85).

...nuk besonin se do të kthehej *me ta*...(D.274).

-Theksojmë se përemrin e rasës kallëzore, veta e tretë njëjës përdor trajtën *të* dhe trajtën *te*, pa bërë dallim se kur duhet të përdoret e para apo e dyta :

...shtroi muhabetin me *të*...(V.41).

...s'kishin lanë gja pa thanë për *të*...(V.167).

...Ai e ndjente se në *te* po rilindte ajo...(V.166).

Të jetojë asnjë dekim pa *te*...(V.54).

Uni tallej me *te*...(V.202).

Foli me *te* ... (V.205).

...erdha veç me *të*...(V.23).

-Autori përdor dendur trajtat e shkurta apo të bashkuara si fjalë enklitike me folje të mënyrës urdhërore :

...*Qitma* mue një kafe (D. 283).

...*largomu*, se s'ka mbetë gja në *mue*... (D.317)

-Theksojmë se në botimet para Kongresit të Drejtshkrimit trajtat e bashkuara (*i+e* dhe *i+i*) i shkruan gjithandej jo me *ia*, por me *ja*:

...nuk *ja* merrte mendimin” (V.f.64).

...e një djersë e ftohtë *ja* mbuloi trupin... (D.282).

...ndërsa *ja* shkante dorën mbi ballin e njomun... (D. f.291).

...kishin pasë durim t'*ja* ndigjon fjalën...(V.35).

...ju dha *ta* afronte pranë... (D.320).

-Nuk janë të rralla rastet që trajtat e shkurtra janë të bashkuara ose jo me formante foljore.Në këtë rast po të bashkohen *i+u* shkruhen me *i+u=iu* si në standard, ashtu edhe me formante të tjera:

...e gjithë ambëlsi *iu* suell së resë...(V.24).

...Se si fjala qiti fjalën e plaku *iu* drejtue...(V.41).

...se i kam dy fjalë të idhta me *t'i* thanë... (D.151).

...pse të *të* copëtohet zemra edhe ma keq... (D.293).

...ju mos *m'u* bishnoni... (D.311).

...ata që s'kishin durue t'u hynte i huaji e *t'ua* nxinte faqen...(V.37).

Përemrat vetvetorë

Janë po ata përemra vetvetorë si në standard : *vete vetja, vetvete vetvetja*, por kryesisht kemi ndeshur përdorimin e tyre në rasën kallëzore e më pak në rasën emërore::

...e afronte nga *vetja* gjithë miqësi”... (D. f.334).

I dukej *vetja* kundrejt qytetarëve...(V.200).

...e gjente *veten* mirë...(V.198).

...S'e ndez kurrë për *vete*... (D.297).

...ai ka marrë përsipër me i ba *veten*... (D.69).

...Frroku ankohej me *veten*... (D. 291).

...atij që kishte dashtë ma shumë se *vetëveten*...(D.318).

...të kontrollojmë më mirë *vetëveten*... (D. 344).

U zemërua me *vetëveten* që kurdoherë...(V.207).

-Si autorët e tjerë gegë, edhe F.Ndocaj përdor dendur përemrin *vetë* me vlerën e një përemri përcaktues, identifikues:

Çuni *vetë* kishe veprue kështu...(V.234).

...ja kishte gjetë ai *vetë*, të bukur si drita...(V.18).

Përemrat dëftorë

Autori është i ndikuar nga gjuha e sotme, prandaj ndeshim , kryesisht ata përemra që përdoren në standardin e sotëm. Përdor këta përemrë dëftorë:

Ky, kjo, këta, këto, ai, ajo, ata, ato, i tillë, e tillë, të tillë, të tilla:

...banie gati bukën edhe për *këtë* burrë... (V.72);

...ka ardhë te *kjo* kulla jonë... (D. 282)

...si *kjo* kam marrë pjesë qindra herë... (D. 304).

Këta shokë të rinj partie...(V.13).

...nuk të njeh ma kush në *këto* ana... (D. 155);

...e dinte se në darka *të tilla* do të pihej...D. 296);

...Në mes *të asaj* zhegore vetëm gjinkallat e kishin fjalën... (D.15);

-Autori përdor edhe trajtat e vjetra të rasës rrjedhore, krahas ato që sot i kemi normë:

... Kur ndëgjonte *këso* llafesh...” (D. 85).

...*asish* që s'duen të shohin mirë... (D.100.).

...Kanë kaluar bukur disa vjet prej *aso* kohe...(V.12).

Përemrat pronorë

F.Ndocaj është nën ndikimin e gjuhës së sotme. Ndonëse përemri pronor është mjaft i larmishëm, autori ynë në dy vetat e para ndjek standardin, por duke ruajtur veçoritë fonetike të gegërishtes edhe në ato raste kur në ligjërimin e folur nuk kemi përshtatje në gjini të pronës dhe pronarit, si:

Katundit tuej (V.11), *miken tande* (SR. 6), ndër *shtëptë tueja* (V.86): *gazi yt* (SR. 14) , *shteti ynë* (V.11), *ligji ynë* (V.11).

-Theksojmë se këta përemra i përdor pa të ashtuquajturën nyjë e përparme:

shoku im (SR.5), *mikja jote* (SR. 5), *malësia jonë* (V.102).

-Përdorim më të shpeshtë kanë përemrat e vetës së tretë e në veçanti përemri *i vet* në bashkëvjajtje me emrin ose i emëruar.

...me gjithëse në katund *të vetin* e në....(V.85).

...kur të bahej edhe ajo mësuese me klasën *e vet...* (V.236).

-Përemrin pronor të vetës së tretë, numri shumës si për gjininë mashkullore, ashtu edhe femërore e bën në trajtën *e tija* dhe *e saja*, kur prona është në numrin shumës në gjininë femërore edhe gjatë paradigmes së përemrit jo si në standard:

...i qe dukë sikur shi në atë çast, nën *kambët e saja...*(V.18)

...krahët mbi një hon , qi hapej te *rranjët e tija...*V.30)

...për të mbështetë *mendimet e tija...*(V.126).

... kishte ndie zanin e *ndjenjave të tija...*(V.200).

-Autori ndjek parimin që pronomi vetvetor të përdoret kur i referohet kryefjalës së fjalisë:

Ai shikonte *punën e vet...*(V.199).

Ai kurr nuk kishte analizue *ndjenjat e veta...*(V.200).

...djali ishte mësue me të dhe e mbante si të *shtëpisë së vet...*(V.201).

-Ndocaj nuk arrin gjithnjë të bëjë dallimin në përdorimin e përemrit *i vet* që i referohet kryefjalës dhe *i tij* çdo gjymtyre të fjalisë:

...Habitë mbas këtyne punëve, Çuni e kishte harrue Lulë Gjeloshen *e andrrimet e tija...*(V.217).

...E Tuçi niste atëhetë t'i fliste për *andërrimet e tij...*(V.234).

...Dikur Tuç Pali i thoshte Çunit se çdo njeri ka *andërrimet e veta...*(V.233).

-Autori nuk është konsekuent edhe në përdorimin e *ë*-së paratheksore që te njëjta fjalë (and(ë)rrimet) herë e përdor, herë jo.

Përemrat pyetës

F.Ndocaj, krahas përemrëve pyetës që i ndeshim në gjuhën e sotme shqipe, përdor edhe trajta dialektore. Këta janë përemrat pyetës që i ndeshim në veprën e autorit:

Ça? kush? Se? çka?cili? ç? p.sh.

... t'i tregonte *ça* kishte ndodhë... (D.82).

...*Kush* po i mbron, more... (D. 218).

...porse *me se* merret, si jeton.. (D.135).

...t'u tregonte *cili* ishte oxhaku i tyne...(V.35).

...*Çka* jeni tue më ba kështu... (D. 317).

...ishte kujtue se me *kë* ndodhej... (D.334).

...nuk të tha se *cila* ishte... (D. 334).

...*Ç* ishte ajo ndjenjë e re...D. 334).

Përemrat lidhorë

Autori përdor si përemrat lidhorë të caktuar, ashtu edhe lidhorë të pacaktuar. Kemi ndeshur këta përemra lidhorë të caktuar: *që, i cili, çka*:

...ju afrue doktor Ferdiut *që* zbriste nga e para...(D.300).

...për ato motra e atë gjyshe *që* ishte në ditët e fundit...(D. 318).

...se *i cilës familje asht, ku e ka shtëpinë...* (D.135).

...gjegjet më marri burrin *të cilit* i ka ikë grueja... (D.322).

...të takohej me të fejuemen e Lirakut, për *të cilën* kishte një letër" (D.274).

...i dukej randim për **çka** hante e pinte... (D.189).
 ...nuk dinte **çka** të thoshte... (D. 300).
 Si lidhorë të pacaktuar në veprën e F.Ndocajt përdoren: *ç, kush, sa:*
 ...**ç**'lind prej micet, gjuen mi... (D. 272).
 ...të blente **ç**'të donte...(V.144).
 ...**Kush** pyet, nuk tret... (D.. 335).
 ...Me **sa** mora vesh, asht puna që të organizoni aksione...(V.158).

Përemrat e pacaktuar

-Vepra e Ndocajt është e pasur me këto përemra të pacaktuar, ndonjëri përdoret vetëm në të folmet e Veriut, si: *do, çkado, gjithsekuj, sa*, si dhe : *kush,, shumë, diçka* etj.:

...të tjerat ishin **do** bibuce... (D.89).
 ...me shtrua rrafsh **çkado** ...(SR.3).
 ...Fjalë bote, **sekush** thonte të vetën... (D.100).
 ...ja ka lidhë rreskun **g gjithsekuja...** (D.130).
 ...u kishte ra me heqë e me u lodhë bashkë me **sa** të tjerë...(V.178)
 ...të tha **kush** se do të shkoj... (D. 296).
 ...ajo ankohej se kishte **shumë** pengesa... (V. 244).
 ...sikur **diçka** e shtyni të hynte në dhomën e Gjergjit... (D.78).
 ...Di **gjëkafshë** zotrote". (D. 117).
 ...tue i sjellë **lloj lloj** peshqeqesh... (D. 158).
 ...me ja ba për hajre **kurrkuj...** (D. 143).
 ...**çdo** punë e mbramjes mbaroi... (D. 282).
 ...Beqoja i habiti **të gjithë...** (D. 311).
 -Autori nuk është gjithnjë konsekuent, pasi të njëjtin përemër e shkruan herë me vizë lidhëse në mes, herë i shkruan pa vizë lidhëse ose në dy-tri trajta p.sh.:
 ...jetojmë të lumtun me **njani tjetrin...** (D. 98).
 ...për t'u takue me **njeni-tjetrin** " (D. 297).
 ...mund gjejmë **ndoj** breg kah **ndonji** dhë i ri...(SR.6).
 ...nëpër errësinë a duket **ndonjë** dritë! (SR.14).

Folja

Mënyra dëftore

Kjo mënyrë që shpreh modalitetin e vërtetësisë, është më e pasura në kohët foljore. Është e vetmja mënyrë që ka tri kohë. Me ndarjet e tyre, veçanërisht e shkuara ka pesë nëndarje dhe e ardhmja katër. Siç shihet, gjuha shqipe është e pasur me forma foljore, kryesisht koha e shkuar. Koha e tashme e mënyrës dëftore tregon kryerjen e një veprimi që përfshin edhe çastin e ligjërimit. Por në rrethana të tjera ajo përdoret edhe në kuptimin e së shkuarës dhe të ardhmes.¹

Në veprën e tre autorëve ndryshimet gjuhësore me të sotmen nuk janë të shumta, por vërejmë edhe raste të izoluara.

Arshi Pipa

5.Koha e tashme

Koha e tashme tregon kryerjen e në veprimi, duke përfshirë edhe çastin e ligjërimit².

Të shohim si paraqiten foljet e kësaj kohe sipas zgjedhimeve.

-Foljet e zgjedhimit të parë (Sipas klasifikimit të zgjedhimeve të Gramatikës së gjuhës shqipe, 1, 2002) ashtu si në standard marrin mbarestat -j, -n, -n: *mendoj, shikoj, harroj, shperblej* etj.

-Në këtë zgjedhim Pipa, duke u mbështetur në të folmen që përfaqëson, përfshin edhe ata folje të cilat dalin me temë në zanore, që në shqipen e sotme përfshihen në zgjedhimin e tretë, pasi në tri vetat e njëjësit të kohës së tashme marrin mbarestat zero, ndërsa autori i përdor me mbarestaten -j, si në ligjërimitin e gegërishtes: *dij, din, din, pij, pin, pin*

...ani *dij* se kuj ia jap un vetë...(R.10).

...ndigjo , nuk *din* çka thur...(R.31).

...kështu sundimtari nuk *din* kah me ja mbajtë...(P.119).

-Foljet, që dalin me temë në bashkëtingëllore, nuk marrin mbarestat në tri vetat e njëjësit:

...unë qes 43, ai pret 63...

Folja *jam* zgjedhohet si në standard, vetëm me ndonjë ndryshim të vogël:

jam , je, është...

Folja *them* në kohën e tashme përdoret në trajtën *thom*³, që nuk është në normën e sotme, por dialektore:

... dhe murit, Mujo, *thom* me krye s i bihet ...(L.B.16)

Forma joveprorë e kësaj foljeje formohet nga kjo temë: *thohet* :

.. Por ktu një gja le t' *thohet*... (L.B.88).

Por edhe forma joveprorë e kësaj foljeje formohet nga tema e kohës së tashme. *Thohet* ?

Por Pipa evolon në shkrimet e fundit dhe e përdor këtë folje si në gjuhën e sotme:

¹Shih: *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, Tiranë, 2002, f.179.

²*Përcaktimet e kuptimeve themelore të kohëve të mënyrës dëftore janë marrë nga teksti "Gramatika e gjuhës shqipe", Tiranë, I, 2002.*

³ F.Agalliu, *Gjuha e Nolit*...Tiranë, 1999, f.107. Autori shkruan: "*Folja them...në shkrimet e fundit (të F.Nolit, A.O.) përdoret gjithnjë me trajtat thom...thomi ashtu si në ndonjë të folme edhe sot.*"

...Libri përmban një dëshmi të këtij, shkruar me 1 tetor 1684, në të cilën *thuhet*...(P.108).
-Folja *dua* përdoret *due, don, don* po kështu edhe folja e parregullt *rri: rri, rrin, rrin*.
Të gjitha mbaresat e kohës së tashme të numrit shumëz përputhen me mbaresat e standardit të sotëm:... *qeshni* (L.B.43), *i qitni* (L.B.53), *shigjetojnë* (L.B.164) *njifni, shifni* (L.B.53)
Forma joveprore ndërtohet me ato mbaresat si në standard:
hahet, 86, shitet 16 fâhet (L.B.73).

Koha e shkuar

E pakryera

I përket kohës së shkuar. Tregon një veprim në zhvillim e sipër në një çast të caktuar të së shkuarës. E pakryera nëpër dialekte dhe të folmet e ndryshme të shqipës ka një larmi të madhe formash.⁴ Pipa ashtu si edhe Repishti përdorin mbaresat e së pakryerës që i përkasin gegërishtes e konkretisht: *-jsha, -jshe, (n)te, -shim, -jshi, -shin*:
Androjsha, rrojsha, shifsha, dijshe 30, dojshe 33, rrijshim 19, pijshim, dijshim 74, thitheshin 66, dojshin 59, mblidheshin, shkumbojshin 43, bijshin etj.
Edhe e pakryera e foljes *them* në dallim nga standardi *thosha, thoshe, thoshte* bën :
thojsha, thojshë, thonte:
...At'herë i lum ja *thojshë kangës*... (L.B.151).
.. *Ma thonte zemra e ngrata*...(L.B.59).
...i *thonte* e ama: *martoju, o bir*...(L.B.132).
-Folja *dal* në të pakryerën zanoren e temës e kthen në *e: delsha, delshë, delte* e jo si në standard *dilja, dilje, dilte*:
...qi s i *delte* për goje (L.B.91).
Por edhe këtu autori nuk është gjithnjë konsekuent, pasi vërehen edhe raste të izoluara që përputhen me standardin e sotëm.

E pakryera e foljeve me t/s

Foljet që përfshihen në zgjedhimin e dytë me temë më *-t*, por edhe me *-s*, siç dihet, këshillohet trajta me *-t*, por në të pakryerën, veta e tretë njëjës bashkëtingëlloren *t* e kthejnë në *s* dhe marrin mbaresën *-te*, me përjashtim të foljeve që në temë kanë *t*. Ata nuk e ndërrojnë në *s* bashkëtingëlloren *t* të temës (*heshte*).⁵
Në veprën e Pipës të gjitha foljet me temë në *t/s* nuk e ndërrojnë *t* në *s*, por autori i përdor të gjitha me *t* :
...ku e *pritte* flota... (L.B.170) ...bora...*ndritte* mbi Gramoz...(L.B.66) ...zifti *ngjifte*...(L.B.66), ...e *ngitte*...(L.B.66), ku ta *qitte*... (L.B.97), ...i *dihatte* gjini... (R..50), ...edhe hana...*zditte* (R.54). E *flitte* bullgarishten.. 118, ...*përkutte* Kosovës...123
Forma joveprore ndërtohet me ato mbaresat si në standard:
dridhej 16, dergjej 168, ndihej 180, coptohej 103, perplasej 105, shkruhej 117, futeshim.
Por te Pipa ndeshim edhe si raste të izoluara në ndikimin e së folmes së gegërishtes, që në formën joveprore, përveç mbaresave të kësaj kohe, përdoret edhe formantin *u* :

4. Shih: E.Hysa, *Rreth përdorimit të së pakryerës së dëftores në gjuhën shqipe*, "Studime filologjike", 1975, nr.3, 101.

5. Shih: *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë, 1976, f.129-130

...Nën çarçafat qi mezi *u mbajshin* kindin djem e burra... (L.B.44).
Si rast të izoluara kemi ndeshur të pakryerën të ndërtuar nga e pakryera e foljes ndihmëse jam që i paraprin përcjellores:
...*Ishte tue mbarue*. (L.B. 203).

E kryera e thjeshtë

Është formë e kohës së shkuar që tregon një veprim të përfunduar. Mund të përdoret edhe në kuptimin e së ardhmes.

Autori përdor të njëjtat mbaresa si në standard, me ndonjë ndryshim dhe me ndonjë luhatje.

Foljet e zgjedhimit të parë dhe të dytë në tri vetat e njëjësit marrin mbaresën *-a, -e, i* ose *u*:

Shikova, rrita, shestova, deshta ... (L.B.53) etj.

Ndërsa foljet e parregullta *jam, shoh, lë, thom* e ndonjë tjetër në vetën e parë të kësaj kohe marrin mbaresën *-shë*:

Qeshë, lashë, pashë, thashë.

Në vetën e tretë marrin mbaresën *-i* foljet:

botoi, rishikoi, rregulloi, gjëmoi, mendoj, hapi, thirri, njofti etj.

Marrin mbaresën *u* ato folje tema e të cilave del me temë në zanoret e theksuara *a, e, i*, ose me bashkëtingëlloret *k, g, h*. Pipa nuk është konsekuent, pasi diku përdor mbaresën *-u*, diku mbaresën *-i* :

lau (L.B.186), *piu* (L.B.63), *ndjeu* (L.B.95), *shkelqeu* (L.B.172), *preku*. (R.42), *rrahu* (R.13), *ngrohu* (L.B.116).

Por autori përdor edhe mbaresën *-i* :

...*preki* me të varrën... (R.42).

...asht mjaft për mue qi ta *zhgrehi*... (L.B.46).

...me përbuzje ja *flaki* mjerimit... (L.B.48)

Në foljet me fundoret *r, rr, l, ll* ngjet ndërrimi *je* në *o* dhe *a* në *o* :

mbolli, nxori, mori, por në shumës dhe në formën joveprore zanoren e temës e zberthen në diftong : *muer, u suell, u nxuer*

Një trajtë dialektore është përdorimi i vetës së tretë numri njëjës me mbaresën *u*, kur në standard nuk ndodh një dukuri e tillë, ndoshta një formim analogjik me foljet që marrin mbaresën *u*:

..qi kur burrin *pau*... (R.60).

Pau kuajt ma municione... (R.98).

E populli qi i *pau* u-dynd prej pllaje... (L.B.172):

...se *pau* rishtas më kambë... (L.B.170).

-Por kemi ndeshur edhe folje që në vetën e tretë njëjës në të kryerën e thjeshtë nuk marrin mbaresë:

...*erdh* hingllima e trembun e nji kali... (R.33) .

..Lena at'herë kërceu e *i erdh* përbri... (R.61).

-Forma joveprore përdoret me formantin *u*, të cilën autori e ndan foljen me vizë:

u- ngjita, u-qas, u-hodhën, u-duk, u-suell, u- jetue, u-shkruejt

-Si raste të izoluara folja *shkruaj* përdoret nga autori *u-shkruejt*:

...Prandej "*Libri i burgut*" *u-shkruejt* në varg... (L.B.10).

-Një dukuri e tillë vihet re dhe në format e pashtjelluara të formës joveprore:

Tjerët e mendojnë veç si *me u-mshehun...*(L.B.18).
...kur vetë ke *me m'u-qasë...*(L.B.33).

Kohët e përbëra

E kryera

E kryera e mënyrës dëftore është kohë analitike e kohës së shkuar. Tregon një veprim të përfunduar, që nuk i ka këputur lidhjet me çastin e ligjërit. Ndërtohet, duke i paravendosur pjesores së shkurtuar të gegërishtes foljen ndihmëse *kam* për vepron dhe *jam* për jovepron, si: *ka qitë, kam rrahë e shoshitë* (P. 121), *ka shkue* (P.110), *ka marrë* (P.121), *kemi pa* (L.B.73),

...*âsht persekutue* (P.120)...*âsht lânë* (P.120)...*ashtë dashtë* (P.113), *janë përkëthye*.

âNuk kemi ndeshur përdorimin e së kryerës së mbipërbëre.

Më se e kryera:

Tregon një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës, si:

Kishte shkue, kishte vû, kish ardhë, kishin kuptue, Ishte botue (P118), *ishte mendue* (P.113)

...*Foli sikur të kishte bâ një gafë..*(R.60).

E kryera e tejshkuar:

Tregon një veprim të përfunduar para një çasti të së shkuarës. Në këtë kuptim është sinonimike me më së të kryerën. Ka një përdorim të kufizuar.

...Se mbasi *pat lulzue* tue dehun rreth hapsinën, do t'i për të dita...(L.B.88).

...pleqtë diftojnë, n'ato lamije një kështjellë *pât qënë* qi një termet *pat rrafshue* për tokë...(R.81).

...nuk dihet, por vendi ktu i *pat ngjitë...*(L.B.160).

...mbi grumbullin e plehut ku e *patën hjedhë* n'oborr...(L.B.160).

Siç shihet nga shembujt folja ndihmëse *kam* në vetën tretë njëjës është përdorur *pat* e jo *pati* si në standard, ndonëse si folje jondihmëse në shkrimet e fundit del *pati*, ndonëse në ndonjë rast e ndeshim pa mbaresën –i:

...Zgjidhja e tij e shkodranishtes nuk *pati* karakter krahinor...(P.122).

...në kryq qi *pat* prej fatit...(L.B.104).

Kjo s'don me thënë se Bogdani *pat* prirje heretike. (P.117)

...e ku *pat* tanda e *pat* bashkina...(L.B.50).

Si raste të izoluara kemi ndeshur edhe ndonjë folje në të kryerës së tejshkuar të mbipërbëre, dukuri që nuk kemi konstatuar në kohët e tjera analitike :

...*pat qënë varë* në mandin e burgut...(L.B.199).

...im vëllá *pat qënë burgosë* nga auktoritetet...(L.B.200).

Koha e ardhme

Përdorimi i disa kohëve të foljes është i kushtëzuar edhe nga gjinia e tregimit. Kështu ngjet edhe me të ardhmen ku disa prej formave kohore kanë një përdorim më të shpeshtë, siç shihet nga materiali që kemi vjelë. Pipa ndjek standardin e sotëm në përdorimin e së ardhmes, por duke ruajtur format gege. Përdor dy konstrukte, si do të

trajtohet më poshtë, i pari është mbizotërues, ndërsa i dyti ka një përdorim më të kufizuar.

E ardhmja

Tregon një veprim që pritet të kryhet pas çastit të ligjërit.

Konstrukti i parë ndërtohet duke i paravendosur formantin *do* formave vetore të kohës së tashme të mënyrës lidhore:

...Lexuesi *do të gjëjë* në “shënime”...(L.B.11).

...*Do të shohim* tash si e trajton Bogdani gjuhën si shprehje poetike... (P.115).

...*do t' vijë*, *do t' vijë* një ditë ora e shqiptarit! (L.B.23).

Kjo e ardhme shoqërohet edhe me trajta të shkurtra të përemrit vetor që trajtën *ta* e përdor fillimisht me apostrof, ndërsa në shkrimet e vona pa apostrof:

...Por *do t'i kujtoj*, mbasi përmend...nji epizod...(L.B.10).

...I kërkohet ndjesë lexuesit për mundimin që *do t'i jap* ksisoj...(L.B.10).

...Dhe shpejt pushteti ju ai *do t'ju falë*.(L.B.68)...

...andej kur kryet e lodhun kah toka *do ta shtrijë* dy herë fatlume grueja... (L.B.88)

...kur ajo *do ta njohë* ... (L.B.32).

...*do t'a selisë* atë metrikë në letërsinë shqipe...(P.117).

Por autori në vetën e tretë njëjës në foljet që dalin me bashkëtingëllore përdor edhe mbaresën *i*, veçori dialektore e të folmeve të veriut :

...mos druej : një ditë *do t'ndjehi*...(L.B.94).

...derisa flamuj tjerë *do t'njofi bota*...(L.B.119).

Konstrukti i dytë ndërtohet nga folja ndihmëse *kam* që i paravendoset formës së pashtjelluar të gegërishtes të tipit *me punue*:

...Por çka Rusha , Zot, tash *ká me thânë?* (R.12).

...po kështu...*ká me mbetë* tri ditë e tri netë në zemrën e dheut...(P.116).

...e radha jote nesër *ka me qenë*...(L.B.68).

Forma joveprore formohet me formantin *u* që ndahet me vizë nga folja:

...që i shpalle dheut një ditë *ka me u-shpërblye*... (L.B.34).

...Gjëji burrë e shpejt *ká me u ngushllue* ...R.10

Këto dy konstrukte përsa i përket përdorimit, ndonëse përgjithësisht kanë të njëjtin kuptim, por dallohen në mes tyre, pasi e dyta ka një nuancë detyrimi që përjashton mundësinë e mosrealizimit.

Për prof. Sh.Demirajn forma e tipit *kam me ba* e ka hunbur nuancën e detyrimit, ndërsa forma e tipit *kam për të bërë* (këtë formë A.Pipa nuk e përdor, shën. ynë) e ruan në një farë mëse këtë nuancë . Kjo do lidhur me moshën relativisht të re të përdorimit të saj në vlerën e së ardhmes.⁶

Autori duke iu referuar një shkrimi të tij të botuar në revistën “Studime filologjike”, 1969, nr.2, (f.57 , shën. 175) theksonte se forma e së ardhmes e tipit *kam për të bërë* dhe ajo e tipit *kam me ba* janë përfutuar nga gramatikalizimi i togfjalëshave kallëzuesorë korrespondues me nuancë detyrimi.⁷

5. Sh.Demiraj, *Rreth formave të së ardhmes në gjuhën shqipe*, “Studime filologjike”, 1970, nr.3, f.71.

6. Po ai , po aty, f.71 , shën. 9.

E ardhmja e përparme

Është një formë kohore që ka një përdorim të kufizuar në kuptimin e saj themelor për të treguar një veprim që pritet të kryhet në të ardhmen para një veprimi tjetër.

Ndërtohet duke i paravendosur formantin *do* formave vetore të së kryerës së mënyrës lidhore:

... *do të ketë dijtë* diçka kur i kërkoi Bogdanit...P.116

...*do të ketë nxânë*, thom, edhe turqisht...P.118

Siç shihet janë trajta të mbarë shqipes, por e veçanta ngjet në pjesoren e foljes që të folmet geqe e përdorin të shkurtuar.

E ardhmja e së shkuarës

Tregon një veprim që pritej të kryhej pas një çasti të caktuar të së shkuarës.

Ndërtohet nga formanti *do* plus të pakryerën e foljes të mënyrës lidhore. Është homonimike me të tashmen e kushtores, po të vërtetohet një kusht.

...Dhe ky libër u-nis bash me qëllim qi të delte ai nga burgjet prej të cilave un ndofta nuk *do të delsha*...(L.B.9).

... kur drita shterri: *mâ do t' dhimbshin*...(L.B.72).

E ardhmja e përparme e së shkuarës

Tregon një veprim që mund të jetë kryer para një çasti të caktuar të së shkuarës. Edhe kjo është homonimike me të kryerën e kushtores, po të vërtetohet një kusht.

Ndërtohet nga *do+* më se të kryerën e mënyrës lidhore:

...kosovarët nuk *do t' i kishin ra* askuj e nuk *do të kishin* ndjellë dyshime, mbasi lavrimi i gjuhës është një e drejtë elementare njerëzore...(P.123).

...Nga studimi i veprës *do të kishte dalë* në dritë methota e Bogdanit për krijimin e gjuhës letrare...(P.121).

...Ky ribotim *do të ishte ba* tekst shkollë për mësimin e gjuhës shqipe në shkollat e nalta, tue vleftë njikohsisht edhe për mësimin e stylistikës në saje të kapitullit mbi gjuhën figurative...(P.121).

...Njikohësisht *do t' ishte krahazue* gjuha e Bogdanit me atë të parardhësve të tij...(P.121).

...Manevra e tyne *do të kishte dështue*... (P.121).

Mënyra habitore

Kjo mënyrë ka ngjallur diskutime dhe është parë si në rrafshin diakronik, ashtu edhe në rrafshin sinkronik¹. Në një shkrim të E.Lafes për disa trajta të habitores shpreh mendimin se zgjidhja më e drejtë do të ishte të flisnim për trajta habitore të disa kohëve të mënyrës dëftore, lidhore e eventualisht kushtore dhe jo për mënyra habitore e lidhore-habitore². Pas argumentimit që i bën pranisë së kësaj mënyre në shqipe, prof. Sh.Demiraj shpreh mendimin se veçimi i formave kohore të habitores në një mënyrë më vete është plotësisht i përligjur.³

1.Sh.Demiraj, *Habitorja dhe mosha e saj*, SF.1971, nr. 3, f. 31-48.

2.E.Lafe, *Mbi habitoren dhe disa trajta të saj*, SF.1975, nr.2, f. 151.

3.Sh.Demiraj, *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, SF, 1977, nr.3, f. 104.

Kjo mënyrë sot përfshihet në gjashtë mënyrat e shtjelluara të foljes. Përmes kësaj mënyre shprehet modaliteti i vërtetësisë ku folësi shpreh ndjenjën e habitës për një veprim të papritur që është kryer në të shkuarën ose që kryhet në çastin e ligjërimin.

Koha e tashme

Kjo kohë është ndërtuar nga pjesorja e shkurtër e foljes, së cilës i prapangjitet folja ndihmëse *kam* për vepron dhe *jam* për formën joveprore. Pipa e përdor rrallë këtë mënyrë që kushtëzohet edhe nga lloji i zhanrit që përdor.

...Ti s'ë *ditke* ? bani çika... (R.48).

...Fort po e *drashke* Zogën , bre falkue...(R.72).

...nuse e e motër çift.A s' *ma diftoke*? (R.72).

...Por me çshof, s'i *paske* buz't e holla...(R.72).

...*Qenka* gjallë levendi? (R.38).

Po kuptoj , ua *bëkeni* ju armiqve...(R.72)

E pakryera

Shpreh habinë, dyshimin, mospajtimin etj. të folësit për një veprim të caktuar që vazhdonte ende në një çast të caktuar të së shkuarës . Është ndërtuar duke i prapangjitur pjesores se shkurtuar të foljes, ndihmësen *kam* në të pakryeren, por që ka pësuar disa ndryshime fonetike. Kjo trajtë ka marrë kuptimin e një ndajshese.

E kryera

Kjo kohë përdoret për të shprehur habinë, dyshimin, mospajtimin etj. të folësit për një veprim të përfunduar, që nuk i ka këputur lidhjet me çastin e ligjërimin. Ndërtohet nga pjesorja e shkurtuar e foljes që i paravendoset folja ndihmëse *kam* në të tashmen e habitores. Si edhe për rastet tjera bëhet fjalë gjithnjë për pjesoret e shkurtuara të gegërishtes.

T' *paska shkelë* dikund qi i mbajke mllef...(R.38).

...Njeni tjetrinbesën *paskan dhanë*...(R.12).

...kur *qenka shëndoshur* kështu?...(L.B.204).

Më së e kryer

Kjo kohë përdoret për të shprehur habinë, dyshimin, mospajtimin etj. të folësit për një veprim që është përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës.

Ndërtohet nga pjesorja e shkurtuar e foljes duke i paravendosur foljen ndihmëse *kam* në të pakryerën e habitores dhe për formën joveprore *jam* në të pakryerën e habitores.

Sami Repishti

Mënyra dëftore

Koha e tashme

Foljet e zgjedhimit të parë (sipas klasifikimit të zgjedhimeve të *Gramatikë e gjuhës shqipe*, 1, 2002), ashtu si në standard marrin mbaresën –j: *ruej, shkaktoj, dëshiroj*, ndërsa foljet e zgjedhimit të dytë që dalin me temë në bashkëtingëllore në tri vetat e njëjësit nuk marrin mbaresa: *qesh, shkel* etj.

Foljet e zgjedhimit të tretë që dalin me temë në zanore, Sami Repishti i përfshin në zgjedhimin e parë, veçori e së folmes së Shkodrës: *dij, din, din, dijmë, dini, dinjë*.

Folja za(zë) në vetën e parë nuk merr mbaresë, ndërsa në shumës, veta e parë dhe e tretë merr mbaresat, -jmë, -jnë: *zajmë, zajnë*.

Folja jam zgjedhohet kështu: *jam, je, asht, jemi-jena, jeni, janë*.

Koha e shkuar

E pakryera

Ka një temë me të tashmen për shumë folje. Mbasesa që përdoren janë dialektore:

-jsha, jshe, (n)te –shim –jshi, -shin:

sjellsha, shihsha, luftojsha, shikojsha, shtypte, hyjshim, rrijshin, mbajshin.

Foljet , të cilat në vetën e dytë shumës pësojnë ndryshime fonetike dhe shërbejnë si temë e së pakryeres, edhe te S. Repishti ndodh një dukuri e tillë, por marrin mbasesat që përdoren në gegërishte, si:

hiqsha, njihsha etj.

Në të pakryerën , veta e tretë njëjës Repishti edhe në ato folje që në të pakryerën dalin me s/t në veprën “*Pika loti*” marrin mbaresën tt, ndërsa të vepra “*Nën hijen e Rozafës*” shkruhen me st:

...na forconte kambët dhe krahët për një punë që *zgjaste* që nga lindja e diellit...(Ro.200).

...*Fliste* me ngadalë, por me një bindje...(Ro.208) .

Foljet që pësojnë ndryshime fonetike në standardin e sotëm, në veprën e Repishtit nuk ndodh një fakt i tillë:

delte, lente, merrte, zente etj.

Luhatjet, duke iu afruar standardit të sotëm, vërehen te vepra “*Nën hijen e Rozafës*”, ndonëse nuk mënjahen edhe trajtat dialektore, si:

...me sulmue cilindo që u *dilte* përpara...(Ro.31).

...Por kur rasti e *sjellte* që një student...(Ro.63).

Edhe folja dal në të pakryerën përdoret me ndërrimin e/i, por jo gjithnjë , pasi në një faqe dalin dy trajta, si:

...sa herë që para meje *dilte* figura... (Ro.57).

...Megjithatë rrethi i shokëve me *delte* përpara me fuqi...(Ro.57).

Folja them në të pakryerën vetë e parë dhe e tretë përdor trajta dialektore :

...Nuk do të vdes, *thojsha* me vete...(Ro.153).

...*Thonte* se u zu rob dhe e dërguen në Romë...(Ro.20).

Por edhe këtu nuk është konsekuent, pasi ndeshim si raste të izoluara trajtat letrare thosha dhe thoshte:

...Mos harro, *thosha* me *vetë*...(P.L.137).

...Mandej përmbahemi kur mësuesi na *thoshte* se këtu...(Ro.21).

Folja rrjedh nuk pëson ndonjë ndryshim fonetik në shumës, ndryshe nga standardi:

...Ndërsa ditët *rrjedhnin* të qeta në dukje...R.59

Forma joveprore ndërtohet me ato mbaresa që i ka standardi i sotëm:

Qesheshim (Ro.337), *rrokullisej* (Ro.337), *shihej* (P.6), *ankohej* (P.7), *shtrihej* (P.8)

E pakryera e foljeve me t/s

Foljet që në vetën e parë të së tashmes dalin me temë me *t* ose me *s*, në standardin e sotëm përparësi i jepet trajtës me *-t*, por mbetet si dysi drejtshkrimore.

Për trajtat e vetës së tretë njëjës të së pakryerës dëftore e tjerë, në përputhje me shqiptimin e sotëm letrar do të shkruhen me *-st* dhe jo me *-tt*.

Në veprën e Sami Repishtit nuk vërehet ky ndërrim, por shkruhen të gjitha foljet me *-tt*, si ato që në temë kanë *-t*, si: *shkundtte*, *humbtte*, *mposhte*, ashtu edhe ato që e ndërrojnë *t-në* në *s*: si:

zbritte, *përsëritte*, *pyette*, *ndritte*, *flitte*, *pritte* etj.

...Vetëm “autoriteti” *heshtte* e kërkonte heshtje, edhe nga ne...(Ro.37).

Por autori nuk është gjithnjë konsekuent, ndoshta si raste të izoluara ndeshim të pakryerën, veta e tretë me *s*, pasi e ndeshim kryesisht te folja flas, por edhe te ndonjë folje tjetër:

...plaka e mjerë as *fliste*, as shihte ma...(P.60).

...*fliste* me ngadalë, por me bindje... (R.208).

...na forconte kambët dhe krahët për një punë qi *zgjaste* që nga lindja e diellit...(R.200).

E kryera e thjeshtë.

Autori përdor të njëjtat mbaresa në të kryerën e thjeshtë si në standard, me ndonjë përjashtim

...e *kënaqa* kureshtjen e tyne...(Ro.73).

...me një situatë kritike në një vend të huej më *ngriti* shpirtnisht....(Ro.72).

...*u ngrita*, nuk përshëndeta njeri, e *dola* nga dhoma...(Ro.52).

Edhe në vetën e tretë përdor mbaresën *-i*: *ndihmoi*, *shkakttoi*. Për disa folje të parregullta përdor mbaresën *-shë*: *thashë*, *pashë*, *lashë*.

Foljet që dalin me zanore të theksuar ose me *k*, *g*, *h*, në vetën tretë marrin mbaresën *-u*:

...Demonstrata *shpërtheu* ashtu si ishte caktue...(Ro.50).

...Kthimi në Shqipëri *ngrohu* vatrën familjare...(Ro.73).

...Ishte një pamje që më *preku* në zemër...(Ro.102).

Në shumës janë po ato mbaresa si në standard:

...Të gjithë *heshtëm*...(Ro.51).

...e *gjetën* më vonë një “pensione”...(Ro.69).

...peshë e kontradiktave që më *ndoqën* kamba-kambës...(Ro.56).

Folja arrij bëhet nga autori në të kryerën e thjeshtë në trajtën *arrija* dhe jo *arrita* si në standard:

...përfundimet që *arrija* mbas një kohe të gjatë...(Ro.56).

Folja marr edhe në të kryerën e thjeshtë nuk e ndryshon temën: *morra*, *nxorra*, por jo gjithnjë pasi ndeshim edhe trajtën *mora*, *nxora*:

...Shkodra nuk e *mori* veten përsëri...(Ro.47).

...e nxori nga çanta një paketë letrash...(Ro.51).

Folja mbështjell në të kryerën e thjeshtë nuk e mbledh togun *-je-* por merr vetëm mbaresën:

...e mbështjelli mirë rreth e rrotull qafës...(P.L.133).

S.Repishiti formën joveprore e ndërton me formantin *u*:

...Britania Madhe *u ba* selia jon e shenjtë...(Ro.48).

...Turma *u shpërnda*...(Ro.50).

Kohët e përbëra

E kryera

E ndeshin në veprën e autorit në përputhje me standardin e sotëm, por duke ruajtur pjesoren e shkurtuar të gegërishtes ose trajtat dialektore të foljes ndihmëse kam dhe jam kur përdoren të tilla:

...që *kanë mbushë* plot e përplot një vend...(P.152), jam përpjekë, asht shpresue,

...*Kemi hy* në një suazë nga e cila asht shumë e vështirë të dalim....(P. 88).

Përdorim të rrallë ka e kryera e mbipërbërë në veprën e Repishtit:

...-Fatkeqsi , më ndërpreu ai. *Kam pasë shpresue* se breznia ime do të ishte e fundit...(Ro.39).

Më se kryera

Kjo kohë përse e përket ndërtimit nuk ka ndonjë ndryshim me standardin e sotëm , përveç pjesores së shkurtuar..Vetë gjinia e tregimit kërkon përdorimin e kohës së shkuar, kryesisht të më së të kryerës.

...me marrë nanëloken, por *kishte gjetë* pengime...(P.60).

...*kambëngulja* në kauzën që *kishte humbë* kuptimin...(Ro.337).

...me gjithë lëkundjet që *kisha pësue* që në ditët e para...(Ro.212).

Repishti i përdor rrallë kohët e mbipërbëra në të kryerën apo në më se të kryerën:

... Marku jetonte ...në një dhomë që *kishte pasë zanë* qysh në vogli... (P.L.59).

Forma joveprore:

...që *ishin lidhë* në mënyrë të pazgjidhshme...(Ro.336).

...*ishite krijue* një mënyrë jetese....(Ro.211).

E kryera e tejshkuar

Kjo trajtë kohore në veprën e S.Repishtit ose nuk përdoret fare, ose tepër rrallë.Sot sipas prof. Sh.Demiraj, prirja për thjeshtëtimin e paradigmave foljore po vepron në mënjanimin e dy formave kohore të së shkuarës relative: kisha punuar - pata punuar. Kjo e dyta po përdoret gjithnjë e më rrallë.¹

1.Sh.Demiraj, *Prurjet kryesore në strukturën morfologjike të gjuhës së sotme letrare shqipe*, "Studime filologjike", 1984, nr.4, f.75.

Koha e ardhme

E ardhmja

Përdorimi i disa kohëve të foljeve është i kushtëzuar nga gjinia e tregimit. Kështu ngjet edhe me të ardhmen ku disa prej formave kohore kanë një përdorim më të shpeshtë, si në matarialin që kemi vjelë.

Repishti ndjek standardin e sotëm në përdorimin e së ardhmes, por duke ruajtur format geqe. Për të ardhmen në vepër, ashtu si në gjuhën e sotme përdor dy konstrukte: i pari që është mbizotërues në standard që formohet nga do + të tashmen e lidhore, e ndeshim edhe në veprën e Repishtit: *do të ndihmoj* (P.131), *do të shikoj*

Konstrukti i dytë që në gegërisht nuk ka një përdorim të kufizuar, ndërtohet nga folja ndihmëse *kam* që i paravendoset formës së pashtjelluar të gegërishtes të tipit *me punue*: ...o pafajsi e kryqzeme që *kam me të kujtue* edhe në vorr...(P.L.139).

...për këtë viktimë që e dinte se *ka me vdekë*... (P.L.115).

...para vllaut që *ka me mbetë* krejt vetëm...(P.L.137)

Këto dy konstrukte përsa i përket përdorimit, ndonëse përgjithësisht kanë të njëjtin kuptim, përsëri dallohen në mes tyre, pasi e dyta shoqërohet me një nuancë detyrimi.

Eardhmja e përparme

Në ligjërimin e shkruar përdoret rrallë. Është ndërtuar nga folja ndihmëse *kam* në të ardhmen që i paravendoset pjesores së foljes.

...*d o të ketë vajtue ...e do të ketë mallkue* fatin e vet... (P.L.17).

...sa here *do të ketë shkue* e shkreta... (P.L.13).

...se çfarë mallkimi të merituem *do të ketë lëshuar* ajo viktimë...(P.L.138).

...krejt vetëm *do të ketë vajtue* me lotë...(P.13).

Është theksuar se kjo e ardhme në gjuhën shqipe përdoret shumë rrallë në kuptimin e së ardhmes së përparme për të treguar një veprim që pritet të kryhet në të ardhmen para një veprimi tjetër, por më shumë shpreh veprime të së shkuarës.

Eardhmja e së shkuarës

E ardhmja e së shkuarës ndërtohet duke i paravendoset formantin do të pakryerës së mënyrës lidhore:

...vendi im nuk qe në gjendje ...që *do të sillte* katastrofën ma të madhe në historinë e tij...(P.L.148).

...me eliminimin e vuetjes e shfrytëzimit nga bota e re që *do të lindtte*...(P.L.36).

...Kur ma vonë, mësuesi tha se *do të ndërpritshim mësimin*...(Ro.27).

Edhe kjo si e ardhmja ka një konstrukt të dytë që ndërtohet nga e pakryera e foljes ndihmëse *kam* që i paravendoset paskajores së foljes geqe:

...e nuk mujsha me bindë veten se ai *kishte me vdekë*...(P.L.116).

E ardhmja e përparme e së shkuarës.

Ndërtohet nga folja ndihmëse *kam* në të ardhmen e së shkuarës, e cila i paravendoset pjesores së foljes:

...E vetmja bërthamë që ndoshta *do të kishte pasë* mundësi me pegue ortekun...ishin intelektualët...(P.L.149).

Asnji fjalë nuk *do të kishte pasë* efektin magjik të kësaj shprehjeje...(Ro.50).

Si e ardhmja e së shkuarës, ashtu edhe ajo e së ardhmes së përparme të së shkuarës janë homonimike me mënyrën kushtore.

Mënyra habitore

Në veprën e Repishtit ndeshim shumë pak folje në habitore dhe jo në të gjitha trajtat kohore :

...E na mendojshim sa i egër *paska qenë* ky “turku”...(Ro.23).

... Qemali *paska helmue* veten...(P.L.42)

Filip Ndocaj

Mënyra dëftore

Siç e theksuam, kjo mënyrë që shpreh modalitetin e vërtetësisë, është më e pasur me kohë foljore, veçanërisht e shkuara që ka pesë nëndarje dhe e ardhmja katër.

Koha e tashme .

Tregon kryerjen e në veprimi, duke përfshirë edhe çastin e ligjëritimit.

Të shohim si paraqiten foljet e kësaj kohe sipas zgjedhimeve.

Foljet e zgjedhimit të parë (Sipas klasifikimit të zgjedhimeve të Gramatikës së gjuhës shqipe,1, 2002) ashtu si në standard marrin mbaresat *-j, -n, -n: shikoj, harroj, shkoj, etj.* Por foljet e zgjedhimit të tretë, që mbarojnë me temë në zanore, ashtu si në gegërishte, te vepra e Ndocaj marrin mbaresat *-j, -n, -n :*

...që s’i njof as s’i *dij*...(V.84).

Të gjitha mbaresat e kohës së tashme të numrit shumës përputhen me mbaresat e standardit të sotëm:... *qeshni, i qitni etj*

Forma joveprore edhe ajo ndërtohet me ato mbaresa, si në standard:

Ka raste të rralla kur forma joveprore del pa mbaresë:

...pse s’*përpiqe* për vete?” (=përpiqesh -D. 247)

Përdor edhe një formë analitike, ndërtuar nga folja ndihmëse jam +përcjelloren geqe:

... *jemi tue hjedhë, jemi tue u lodhë.*

...*jemi tue hjedhë* kokrrat...s’*je tue i vallzue*...(SR.11).

...*asht tue m’u tha*...(SR. 11).

E pakryera

I përket kohës së shkuar. E pakryera, siç e theksuam, nëpër dialekte dhe të folmet e ndryshme të shqipes ka një larmi të madhe formash. Janë këto mbaresa që i përkasin gegërishtes e konkretisht: *-jsha, -jshe, (n)te, -shim, -jshi, -shin:*

Formën joveprore e ndërton me ato mbaresa të standardit të sotëm:

... si kur *vishej* në fustane të modës.. (D. 62)

Si e tashmja, ashtu edhe e pakryera përdoret me pjesëzën po:

Pastaj ai *po kapej, po mbështetej* në të.

Disa folje që pësojnë ndryshime fonetike në standard, këtë dukuri e ndeshim edhe te F.Ndocaj:

...e sikur i *dilte* si në vegim...(V.207)

...me lloj-lloj parullash *mbillnin* panik...(V.209).

Folja *them* në vetën e tretë të së pakryerës përdoret në dy trajta: *thoshte* trajtë e standardit dhe *thonte* jo e standardit:

...E Çuni qeshej me kushëririn dhe i *thoshte*...(V.233).

..e tue pohue për çdo fjalë që ajo i *thonte*...(V.228).

Foljet që dalin në temë me *t/s* autori i përdor me *t*, megjithatë nuk është konsekuent, pasi të njëjtën fjalë e përdor edhe me *-t* edhe me *-s*:

Bimët e misrit i *vaditnin* rranjë për rranjë...(V.115),

E e *pyetnin* a mos ishte edhe ai martuem (V.200).

...i ktheu nga katundi dhe i la të *kullotnin* bregut.(V.205).

..dhe si i futi të *kullosnin* në një rrypinë toke...(V.206)

E kryera e thjeshtë

Është formë e kohës së shkuar që tregon një veprim të përfunduar.

Autori përdor të njëjtat mbaresa si në standard, me ndonjë ndryshim dhe me ndonjë luhatje.

Foljet e zgjedhimit të parë dhe të dytë në tri vetat e njëjësit marrin mbaresën *-a, -e, i* ose *u*:

Shikova, rrita, etj.

...si *lau* filxhanin në kusinë e vogël... (V. 26).

...po plakut nuk i *pëlqeu* ky arësyetimi...(V.45).

Veta e tretë e numrit njëjës del edhe me mbaresën *-i*, po edhe me mbaresë zero:

...iu ba zemra mal kur *ndigjoi* përgjigjen” (V. 28)

Erdh dadoja në dhomën e ndryeme dhe i *tregoi*... (D. 43).

...Kur i *erdh* radha që një kurs fillies” (D. 230).

Si rast të izoluar kemi ndeshur një trajtë të ngushtë dialektore që në vetën e tretë merr mbaresën *-ni*:

...*shtrini* kambët e tue u mbështetë...(V.49).

Forma joveprore përdoret me formantin *u*:

...e mbështolli si çallmë dhe *u ngrit*... (V. 26).

...të gjithë *u larguen*... (V.198).

...Ganxhja *u nxi* dhe *u ba* helm e vrer.. (D. 97).

Kohët e përbëra

E kryera

E kryera e mënyrës dëftore është kohë analitike e kohës së shkuar. Tregon një veprim të përfunduar, që nuk i ka këputur lidhjet me çastin e ligjërimit.

Ndërtohet, duke i paravendosur pjesores së shkurtuar të gegërishtes foljen ndihmëse *kam* për vepronën dhe *jam* për jovepronën,

...unë të *kam thanë* edhe një herë... (D. 97).

...Unë e *kam pleqnue* edhe me katund... (D. 114).

...e *ka grumbullue* era katër-pesë metër... (D.21).

Forma joveprore:

...*asht ba* ma i parë ndër ne... (D. 111).

Përdoren edhe trajta të mbipërbëra:

...prandej edhe ju *ka pasë ra* në hise parësia juve... (V. 11).

...*s'kanë qenë mësue* me punue... (V. 1).

Më se e kryera:

Edhe kjo i përket të së shkurës.

Ndërtohet, duke i paravendosur pjesores së shkurtuar të gegërishtes foljen ndihmëse *kam* në të pakryerën për veproren dhe *jam* në të pakryerën për joveproren.,

Del edhe me formën e plotë me mbaresë, por herë-herë del edhe në formë të shkurtuar:

...mësuesi i shkollës, që s'ë *kish qasë* në shkollë... (D.123).

...Mos ja *kishte kurdisë* ai Beqir Mustafaj... (D. 123).

Filip Ndocaj foljen *kam* në të pakryerën e përdor në dy variante *kishte* dhe *kish*. Për këtë rast, edhe siç e kemi theksuar edhe te autorët e e mësipërm, prof. Sh. Demiraj, kur një formë gramatikore në sistemin foljor ende përdoret me dy variante, këshillon që me përshtatshme është të ngrihet në normë trajta me mbaresë. Kështu të përdoret *kishte* dhe jo *kish*.¹

Drandja i kishte diftue se zotnia..(D.. 82).

... sa bukur *ishte rrue togeri*" (D.180).

E kryera e tejshkuar:

Tregon një veprim të përfunduar para një çasti të së shkuarës. Nuk ka ndonjë përdorim. Forma veprorë ndërtohet duke i paravendosur pjesores së shkurtuar të foljes ndihmësen *kam* në të kryerën e thjeshtë dhe *jam* në të kryerën e thjeshtë për formën joveprore. Theksojmë se ndihmësja *kam* në të kryerën e thjeshtë del në vetën e tretë pa mbaresë, po ashtu edhe kur nuk është ndihmëse, duke përjashtuar luhatjet:

...që i *pat vu* në sy...(V.62).

...*pat dalë* pa e rritë mirë trupin...(104).

...*pat mbetë* i verdhë si dylli...(V.100).

...*Pat qenë* dimën i madh...(V.62).

...*pat mbetë* i pabllokuem nga bora" (D.18).

...e *patën çue* të lidhun... (V.18).

...*Pat* më këtë grue një vajzë...(V.50).

...Lula s'pat çka të bante tjetër...(V.31).

Por përfitimin ma të madh e pati kur vizitoi...(V.238).

Forma joveprore:

...Vetëm dyqani i bukës *qe hapun*... (D.17).

Vokri... *qe martue* pa iu djersitë ende mustaku...(V.19)

...Ndonëse rrallë ndeshet edhe një e kryer e tejshkuar e mbipërbërë që shoqërohet me paskajoren gege e tipit *me punue*:

Por dembelët e katundit që *patën qenë mësue* me shkue kohën me kangët...(V.179).

¹Sh.Demiraj, *Prirjet kryesore...*f.75.

E ardhmja

E ardhmja tregon një veprim që pritet të kryhet pas çastit të ligjëritimit.

Edhe F.Ndocajt përdor dy konstrukte, si do të trajtohet më poshtë, i pari është mbizotërues, ndërsa i dyti ka një përdorim më të kufizuar.

Konstrukti i parë ndërtohet duke i paravendosur formantin *do* formave vetore të kohës së tashme të mënyrës lidhore: *Do të bahem, do ta harroj,*

...edhe unë *do të bahem* si të tjerat... (D. 72).

...*do të zbres* në kryezi... (D.187).

...nuk *do të bajnë* pa e pyetë... (V. 16).

...*do ta mbaj* pra unë deri sa të focohet...(D.302).

Konstrukti i dytë ndërtohet nga folja ndihmëse *kam* që i paravendoset formës së pashtjelluar të gegërishtes të tipit *me punue*:

...*kanë për ta mbulue*, si të forcohen... (V. 25).

Këto dy konstrukte përsa i përket përdorimit, ndonëse përgjithësisht kanë të njëjtin kuptim, por dallohen në mes tyre, pasi e dyta ka një nuancë detyrimi që përjashton mundësinë e mosrealizimit.

Në veprën e Filip Ndocajt kemi ndeshur edhe trajtën pa formantin *të* që përbën shkelje të normës: *do baj*

E ardhmja e së shkuarës

Tregon një veprim që pritej të kryhej pas një çasti të caktuar të së shkuarës.

Ndërtohet nga formanti *do* plus të pakryerën e foljes të mënyrës lidhore. Është homonimike me të tashmen e kushtores, po të vërtetohet një kusht: *do të ngrihej, do ta plakte, do të flijonte,*

...*do të ngrihej* ndonjë flim ere... (D.76).

...që *do ta ndrynte* e *do ta plakte* para kohe” (D. 101).

Del edhe pa formantin të: *do mbeteshin, do ishte, do jepte, do dilte*:

...*do mbeteshin* të shitun..

Krahaso brenda të njëjtës fjali:

...*do të hapeshin* e *do dilte* fytyra e tmerrueme e Gjergjit...(D.108).

E ardhmja e përparme dhe ajo e përparme e së shkuarës ka një përdorim tepër të rrallë.

Mënyra habitore

Kjo mënyrë sot përfshihet në gjashtë mënyrat e shtjelluara të foljes, pasi sipas Sh. Demirajt veçimi i formave kohore në një mënyrë më vete është plotësisht i përligjur.

Koha e tashme

Kjo kohë është ndërtuar nga pjesorja e shkurtër e foljes, së cilës i prapangjitet folja ndihmëse *kam* për veproren dhe formantin *u* për formën joveprore.

... po a *kujtoke* se djelt e qyteteve..” (D.87).

...se unë e *paskam* menden me të qitë shpie... (D. 97).

Forma joveprore:

...*u bake*...

E kryera

Është kohë analitike.Ndërtohet nga pjesorja e foljes që i paravendoset folja *kam* në të tashmen e habitores dhe jam në të tashmen e habitores. Si edhe për rastet tjera bëhet fjalë gjithnjë për pjesoret e shkurtuara të gegërishtes:

... *paski zgjedhë* ma fikanin e katundit... (D. 114).

... se bash malli më *paska marrë* për ty” (D.142).

...po ky Marash Gjoni si *paska ndryshue*...(V.94).

...*paske marrë* kaq huj... (D.111).

...s’ja *paska nisë* deri tash” (D..154).

Joveprore:

...Po ti, Tefë, a s’*qenke nisë*, a? (D. II).

...të *qenka lagë* baruti... (D.118).

...e kaq fort *qenka plakë*” (D.155).

Arshi Pipa

6.Mënyra lidhore

Është një mënyrë e trashëguar e gjuhës shqipe. Shpreh modalitetin e mundësisë, por në disa përdorime shpreh modalitetin e dëshirës ose të detyrimit . Karakteristikë është formanti *të* që i paravendoset foljes. Për emërtimin e saj nga studiues shqiptarë dhe të huaj ka emërtime jo të njëjta.¹ Sh.Demiraj e quan formant i paravendosur dhe i është njohur funksioni i dallimit të mënyrës.

Koha e tashme.

Tregon një veprim, kryerjen e të cilit folësi e paraqet si të mundshëm a të dëshirueshëm. Folja e mënyrës lidhore mund të shoqërohet edhe me foljen me vlerë modale *mund*, *duhet* dhe *lë*:

...nxansit *t’i bjerë* mësuesi e le *t’u thotë*...(L.B.58).

...kush din *t’i njehë* sa sojesh? ...(L.B.44).

...por jo *ta qitshin* fare për nën tokët...(L.B.53).

...un nuk *mund t’i tregoj* lexuesit sadoqë dëshiroj..(L.B. 10).

...qi s *mund t’arrihet* prej gjithkuj është ferri...(L.B.72).

...O lemeri qi goja s *mund ta thotë* ...(L.B.72).

..Le *të ketë* ndër mend lexuesi vetëm një hollësi...(L.B.9).

Në vetën e tretë përdor mbaresën *-(j)ë*:

...Lene *t’ shkojë*...e mbara ju dhashtë...(L.B.21).

Pipa për të shprehë mohimin i paravendosë pjesëzën *mos*, që i paraprin foljes së mënyrës lidhore, e cila në standardin e sotëm vihet në mes formantit *të* dhe foljes, por e ndeshim në ndonjë rast edhe para formantit *të* dhe foljes.

... por jo deri në atë masë sa *mos ta lājë* ..(L.B.42).

...qi un *mos të delsha* gjallë nga burgjet...(L.B.9).

...ai u- dënue *të mos delte*...(L.B.210).

¹Shih: F.Agalliu, *Mënyra lidhore në gjuhën shqipe, në botimin e autorit* “Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe,

Tiranë, 1988, f.11-12.

Forma joveprore përdoret nga autori me ato mbaresa që përdoren në standard:
...Ai asht i lutun *qi të hidhet* në “Shënimet”...(L.B.11).
...Lexuesi asht i lutun... *të këshillohet* me “Fjalorthin”...(L.B.11).
...*të shkrythet e t’pordhoset* si lavirë...(L.B.54).

Koha e shkuar

E pakryera

Tregon një veprim të mundshëm të së shkuarës.

E dallon nga e pakryera e dëftores vetëm formanti *të* që i paravendoset foljes, si dhe mbaresat dialektore të gegërishtes:

...Mendoj se gjindem në Amerikë, në një vend të cilin asqë andërojsha, kur shkruiejsha kto vargje, *ta shifsha* ndonjiherë...(L.B.9).

...nuk lejonte auktorin *qi ta ngarkonte* me hollësi...(L.B.11).

...*qi t’ishte* ky libër dëshmi e jetës së burgut...(L.B.9).

E pakryera e formës joveprore ndërtohet me ato mbaresa të së pakryerës joveprore të mënyrës dëftore të gegërishtes:

...sikur *të përshkruheshin*, do të përbâjshin një tregim aventurioz...(L.B.10).

Edhe e pakryera mund të shoqërohet me foljen modale *mund, duhet* dhe foljen *lë*:

...nuk *mund të bante* ndryshe...(L.B.9).

...një realitet psikik *qi mund të venitej* ose të birrej me kalimin e kohës...L.B.10...

...Dhe kjo *duhej t’u ngjiste*...(L.B.59).

...*le t’ishin*, *t’ishin* pus ku drita shterri...(L.B.72).

...ajo traditë nuk *mund të gjente* pëlqimin e saj...(P.117).

...gjâ që *mund të bâhej* në Shqipni mbas themelimit t’Universitetit të Tiranës...(P.12).

E kryera

Tregon një veprim që mund të jetë kryer para çastit të ligjërimin, me të cilin nuk i ka këputur lidhjet.

Ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të kohës së tashme të mënyrës lidhore të foljes ndihmëse *kam*, ndërsa për foljet në formën joveprore foljen ndihmëse *jam*:

..kahdo që *t’i ketë marrë* prania e tyne në gjuhën e tij flet për një koncept...(P.115).

Shoqërohet edhe me foljen *mund* dhe *duhet*:

...Kjo *duhet të ketë pasë* interesa letrare...(P.108).

...të cilat *duhen të jenë nxjerrë* prej libravet...(P.109).

Më se e kryera

Tregon një veprim që mund të jetë kryer para një çasti të së shkuarës.

Ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të së pakryerës të mënyrës lidhore të foljes ndihmëse *kam*, ndërsa për foljet në formën joveprore foljen ndihmëse *jam* në të pakryerën:

...*Ta kishte shkruajtë* auktori kët libër ndër kushte të ndryshme...(L.B.9).

Mënyra kushtore

Edhe për këtë mënyrë ka diskutime, kryesisht për modalitetin dhe përcaktimin kohor të formave të kushtores, për marrëdhëniet e saj me kohën e ardhshme në të shkuarën dhe për vendin që zë në sistemin foljor.¹ Pra çështja paraqitet më e ndëlikuar se diskutimi për mënyrën habitore. Për Sh.Demiraj më i pranueshëm nga ana teorike dhe praktike paraqitet trajtimi i të gjitha këtyre formave me pjesëzën *do* si forma të kohës së ardhme që në përdorime të caktuara (kontekste) kanë marrë kuptimin modal të mundshmërisë (*do të punoja, do të kisha punuar*) dhe të supozimit (*do të kem punuar, do të kisha punuar*), si dhe koha e ardhme e foljeve kam e jam: *do të ketë, do të jetë*.² Duke qenë se kohët e kushtores janë homonimike me të ardhmen në të shkuarën janë trajtuar marrëdhëniet e mënyrës kushtore të foljes me të ardhmen në të shkuarën të mënyrës dëftore, pasi ky raport është një nga problemet më të rëndësishme të kësaj mënyre.³ Pavarësisht nga diskutimet kushtorja është pranuar në sistemin e mënyrave të gjuhës shqipe.

Koha e tashme

Tregon një veprim që mund të ishte kryer në të shkuarën, po të ishte vërtetuar një kusht i dhënë. Siç e theksuam më parë është homonimike me të ardhmen e së shkuarës të mënyrës dëftore:

...sikur të përshkruheshin, *do të përballshin* një tregim aventuresk...(L.B.10).

Koha e shkuar

E kryera

Tregon një veprim që mund të ishte kryer në të shkuarën, po të vërtetohej një kusht i dhënë. Edhe kjo formë kohore është homonimike me ardhmën e përparme të së shkuarës të mënyrës dëftore:

...ta kishte shkruajtë auktori kët libër ndër kushte të ndryshme prej atyne ndër të cilat jetoi, ai *do të kishte pëlqye* prozën...(L.B.9).

Mënyra dëshirore

Përmes kësaj mënyre shprehet modaliteti i dëshirës në formë urimi ose mallkimi.

Koha e tashme

Shpreh dëshirën e folësit në formë urimi ose mallkimi.

Ndërtohet duke i shtuar pjesores së foljes mbaresat vetore: *-a, - , të, -im, -i, -in* dhe sipas foljeve prapashtesat trajtëformuese *-fsh-, -sh-* ose *-ç*:

1. N.Topalli, *Mënyra kushtore e foljes në gjuhën shqipe*, SF, 1982, nr.4, f.90.

2.Sh.Demiraj, *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1977, nr.3, f. 1.10.

3.Shih : N.Topalli , art i cituar, f.100-105.

Lene t'shkojë e mbarë ju *dhashtë*. *Ktheftë* me nder...(L.B.21).

...*Qoftë* e mallkueme fara qi aty hidhet...(L.B.23).

...N'e *paqsha* një qepë, një mollë!...(L.B.162).

...dhimbë do t'kishe , zemër n'*paç* krahnuer ...(R.37).

...Ti *qofsh* me nder...(R.29).

...Zoti m'*ndjeftë* pse vras kê don me m'vra...(R.75).

Forma joveprore ndërtohet duke i paravendosur pjesëzën **u**:

...Mos *u thashtë* prej qiellit...(R.31).

...Shuej fatzi e zeza gojë t'*u thaftë*! /

...Fal ndaj teje s'kam, m'*u bâftë* hata! (R.75).

Koha e shkuar

E kryera

E kryera mund të shprehë dëshirën e folësit në formë urimi ose mallkimi për veprime të së shkuarës. Ndërtohet duke i paravendosur pjesores së shkurtuar të foljes format vetore të së tashmes së dëshirores të foljes ndihmëse *kam* për formën veprorë dhe *jam* për formën joveprorë:

...mos druej, dhe *qoftë mallkue* ...(R.37).

...e u *baftë* si *qoftë gjykue*...(R.39):

Mënyra urdhërore

Përmes kësaj mënyre shprehet modaliteti i dëshirës në formë urdhri, kërkese, këshille, lutjeje **etj.** Ka vetëm vetën e dytë njëjës dhe shumës. Veta e dytë e shumësin përkon me vetën e dytë të shumësit të kohës së tashme të mënyrës dëftore që dallohen vetëm nga intoncioni:

...*qitni* benë...! (L.B.53).

Disa folje në mënyrën urdhërore të vetës së dytë njëjës përkrijnë me vetën e dytë të dëftores, që u përkasin atyre foljeve që dalin e temë në bashkëtingëllore:

...O luftë , o vdekje *zgjidh e merr*...(L.B.55).

Disa folje të zgjedhimit të parë në vetën e dytë ose të parregullta dalin me mbaresën *-j*.

Mund të shoqërohen edhe me trajta të shkurtra :

...Libri i urrejtjes: *quaj-e* me këtë emën...(L.B.55).

...*mundoj-i* deh! (L.B.58).

... deh *shuej-i* por jo me mort...(L.B.58).

...*thuej* ma mirë yt shoq...(R.77).

...ma fort se veten *duej-e* të vërtetën...(L.B.34).

...*lëj* gjallë e për gëzep...(L.B.58).

Ndërsa disa folje të tjera që pasqyrojnë ndryshime fonetike në vetën e dytë shumës të kohës së tashme të mënyrës dëftore, ata pasqyrohen edhe në urdhërore, ndonëse në shumicën e rasteve shoqërohen edhe me trajta të shkurtra të përemrit vector si trajta enklitike:

... *njifni* shpejt natyrën...!(L.B.53)

...Por *sille* fletën...(L.B.72),

...*shifi* ndaj kanalit...(L.B. 65),

Formën joveprorë e ndërton me formantin *u* në fund të foljes. Ngjet edhe një dukuri që foljeve të vetës së dytë njëjës që mbarojnë me zanore dhe ndiqen nga një trajtë e shkurtër, autori ndryshe nga standardi nuk i shton një *-j-* për lehtësi shqiptimi:

...*Dridhnju...mbi frona...!* (L.B.52).

...*Bânu* gati për tri ditë, për tri ditë shkon ngjeti...(R.73).

...*shporrmu* syshë...(R.78).

...*lutju* Perendisë se ke shumë mëkate...(R.78).

...*Puthe* trollin...(R.78).

...*mendou* mirë përpara...(R.29).

...Kërcëllon dhambët e çeliktë...*Shikoe!...*(L.B.84).

Kur folja në urdhërore përdoret me kuptim mohor ajo i paravendoset foljes duke u shoqëruar edhe me pjesëzën mos që ndahet me vizë: ,

...*Mos u -çuditni ...!* (L.B.58).

...ti fol e *mos u-druej*...(L.B.34).

Sami Repishti

Mënyra lidhore

Folja në mënyrën lidhore shpreh kryesisht modalitetin e mundësisë, por sigurisht në një përdorim më të kufizuar edhe modalitetin e dëshirës ose të detyrimit. Dallohet nga mënyrat e tjera nga formanti të që i paravendoset foljes.

Koha e tashmja

Folja në këtë kohë tregon një veprim, kryerja e të cilit paraqitet si i mundshëm apo i dëshirueshëm.

Si temë për formimin e saj shërben ajo e së tashmes së mënyrës dëftore me përjashtim të foljes kam e jam:

...*Fillova të kujtoj* skena familjare...(Ro.330).

...*po të raportosh* në komandë... (Ro.209).

. Ndryshimet fonetike që ndodhin për disa folje të mënyrës dëftore në vetën e dytë dhe të tretë shumës, si ndërrim zanoreje ose ndërrimin *s/t* nuk pasqyrohen në mënyrën lidhore: të zajë, të mbizotnojë (Ro.213).

Kur ndryshimet fonetike ndodhin në vetën e dytë shumës, të mënyrës dëftore, ajo shërben si temë e vetës së dytë shumës të mënyrës lidhore:

Folja *flas* në veprën “*Nën hijen e Rozafës*” përdoret në përputhje me standardin:

...para prefekturës kërkues nga “autoriteti” të *fliste*...(Ro.36).

...e në heshtje pritshin që folësi të *dilte* nga kjo situatë...(Ro.55).

Autori në vetën e dytë njëjës përdor mbaresat e standardit *-(ë)sh* dhe për vetën e tretë - *ë/jë*:

...ose duhet të *bësh* normën...(Ro. 201).

...asht e tmershme të *mendojsh*...(P.L.28).

...lutet dhe shpreson *t'i kalojë* ditët e fundit...(P.L.9).

Folja e mënyrës lidhore mund të shoqërohet me foljet modale *mund, duhet* dhe foljen *le*:

...janë kulmet ma të nalta që *mund të arrijë* çdo qenie e lirë...(Ro.334).

...*duhet ta marr* me vete, të paktën jena së bashku... (P.L.60).

...bashkë me ju studentë të dashtun, *le t'i tregojmë* popullit tone...(Ro.35).

...*le të digjet* flakë çdo pëllëmbë e tokës sonë nën kambët e okupatorit...(Ro.54).
Forma joveprore e së tashmes së lidhore formohet me anë mbaresash si të dëftores:
...kur desha *të ngrihem* , ai filloi...(Ro.201).
...*Të ngrihet* në kambë shoku që e ka sjellë këtu!...(Ro.52).
Edhe autori përdor foljet që shprehin mënyrën e veprimit, si filloi:
...atmosfera *filloi të ndryshojë*...(Ro.54).

Koha e shkuar

E pakryera

Tregon një veprim të mundshëm të së shkuarës. Është e njëjtë me të pakryerën e dëftores që dallohet prej saj vetëm nga formanti *të*.

...Nuk dijsa çka *të shkruiej*...(R.63).

...e në heshtje pritshin që folësi *të dilte* nga kjo situatë...(Ro.55).

Autori ka lëkundje në përdorimin e atyre foljeve që në standard pësojnë ndërrime fonetike. Kështu ndeshim të njëjtën folje të shkruhet me dy trajta , e para pa ndryshime fonetike, ndërsa e dyta si në standard, si:

...e qëllim që *të hjedhte* turkun jashtë tokave tona arbnore...(Ro.23).

...und të quhej gjithçka , *të hidhte* çdo parullë që dëshironte...(Ro.208).

Edhe foljë *lë* të pakryerën e lidhore bën me një trajtë dialektore:

...u largova pa dëshirë *ta lejsha* vetëm e me shpresën...(Ro.95).

Edhe në të pakryerën folja e mënyrës lidhore mund të shoqërohet me foljet modale *duhet* dhe *mund*.

Formën joveprore e formon me ato mbaresa të dëftores:

...në formën e saj ma të egër *mund të quhej* gjithçka...(Ro.208).

...efekti psikologjik, ...nuk *mund të llogaritej*...(Ro.209).

...Jobi biblik *duhet të ishte* një nanë...(P.L.14).

... e gjithë mendja e fuqia ime *duhej të përqendoheshin* në mbijetesën...(P.L.15).

... kur *desha të ngrihesha*, ai filloi...(Ro. 201).

Autori, ashtu si në standard pjesëzën mohuese e vë në mes formantit të dhe foljes:

...të gjitha dritoret që *të mos shihej* drita...(P.L.6).

...shiheshin dritat akoma të ndezuna...që premtonte *të mos ishte* larg...(Ro.68).

Forma joveprore ndërtohet me ato mbaresa që formohet e pakryera e dëftores:

...Kuptova që nuk mund *t'i nënshtrohesha* verbënisht një bashkësie...(Ro.56).

E kryera

Tregon një veprim që mund të jetë para çastit të ligjërit, ashtu si mënyra dëftore që nuk i ka këputur lidhjet me çastin e ligjërit. Ndërtohet me foljen *kam* në kohën tashme të mënyrës lidhore për formën veprare dhe foljen *jam* në kohën e tashme të mënyrës lidhore për formën

jo veprare që i paravendosen pjesores së shkurtuar të gegërishtes të foljes:

...pa dyshim *duhet të ketë kalue* nëpër të njëjtat shtigje...(P.L.15).

...*duhet të jetë ankue* për vujtjet që nuk i meritoi...(P.L.14).

...në vetmi *duhet të ketë mendue* , pa dyshim...(P.L.79).

Më së kryera

Tregon një veprim që mund të jetë para çasti të caktuar të së shkuarës. Ndërtohet me foljen *kam* në kohën e pakryer të mënyrës lidhore për formën veprare dhe foljen *jam* në

kohën e pakryer të mënyrës lidhore për formën joveprore që i paravendosen pjesores së shkurtuar të gegërishtes të foljes:

...ai më shikoi me habitje...sikur *të ishte sulmue* papritmas ...(Ro.50).

Mënyra kushtore

Mënyra kushtore është përdorur në dy kohë:

E tashmja është homonimike me të ardhmen e së shkuarës të mënyrën dëftore, por gjithnjë të shoqëruar me një kusht. Por autori ka dhënë një pasazh të tillë, ku pas periudhës me fjali kushtore vijnë disa fjali bashkërenditëse, duke mos e përsëritur kushtin, por është mjaftuar të shënojë vetëm një herë.

...Oh, sikur të kisha frymën e poetit, *do t'i mblidhsha* me kujdes të gjitha fjalët...o voglushi im, e *do t'i përpunojsha* në vargje të qëndisuna për mrekulli. *Do të shkojsha* mandej te argjendari mjeshtrë e *do t'i lutesha* me i gdhenë si petale florini të lidhun në vargje e gërshetue për bukuri. *Do ta merrsha* atëherë atë relike tejet mjeshtrorë e do ta varsha mbi gjoksin tim, *do ta mbështetsha* mbi zemrën time, e sa herë që kujtimi ngjethës i vuetjtjeve tuaja të pafund, o vlla, e malli që më këputi do të më lodhshin aq shumë sa të ma kërrusshin kokën mbi parzmin plot dhimbje, *do të lexojsha* me sy të përlotun ato vargje të qëndisuna, *do të përshpëritsha* me afshin e zemrës së zhuritun emnin tand, e do të përpiqesha me gjetë ngushëllim në atë mal dashunie që kam për ty, o vëll,... (P.L.138).

...Shpesh here mendojsha se çka *do të thonte* ai, sikur të mund të fliste sot për mënyrën e vdekjes së tij...(Ro.84).

Koha e shkuar

E kryera

Është homonimike me të ardhmen e përparme të së shkuarës, gjithnjë shoqëruar me një kusht. si:

...Sigurisht *që do të kisha fjetë* menjëherë, sikur të mos kishte kenë të ftohtit...(P.L.74).

...Sikur ta kishte ditë se fati i saj *do të kishte kenë* ai që asht sot. (P.L.9).

Mënyra dëshirore

Koha e tashmja

Formohet nga tema e së kryerës së thjeshtë ose nga pjesorja me anë të prapashtesave trajtëformuese *-fsh-*, *-sh-* duke marrë mbaresat: *-a*, *-*, *-të*, *-im*, *-i*, *-in* për formën veprorë, ndërsa formën joveprore e formon me pjesëzën *u*.

U shoftë emni i tij përjetë ...(P.L.110)

... *u bafitë* vullneta e Tenzot! (P.L.112)

Koha e shkuar

E kryera

Formohet duke i paravendosur pjesores së foljes foljen ndihmëse *kam* në dëshirore dhe për formën joveprore foljen ndihmëse *jam* në dëshirore që i paravendoset pjesores së shkurtuar të gegërishtes të foljes.

...*qoftë bekue* errësina e natës...(P.L.66).
 Në veprën e Repishtit mënyra dëshirore përdoret pak..
 Mënyra urdhërore
 Vetë natyra e tregimit të veprave të Sami Repishtit bën që foljet në mënyrën urdhërore të përdoren rrallë.
 Edhe në ato raste kur i ndeshim të tilla janë në pajtim me gjuhën e sotme shqipe.
 Në vetën e dytë njëjës folja në urdhërore del pa mbaresë se me mbaresë:
 ...*Qëndro*, më tha...(P.L.84)
 ...*mos qaj më*...(P.L.131).
 Ndërsa në vetën e dytë shumës folja dallohet nga intonacioni:
 ...*mbani* sytë ta hymja...(P.L.100).
 Nuk janë të rralla rastet kur folja është në urdhërore, numri njëjës trajta e shkurtër vihet në fund:
 ...*nxjerre* të vërtetën në shesh...(P.L.119):
 Por kur folja është në trajtën mohore trajta e shkurtër vihet në mes pjesës dhe foljes:
 ...*mos ma merrni*...(P.L.60).
 ...*mos e leni* vetëm...(P.L.61).
 Formani **u** i formës joveprore edhe ky vihet në fund kur folja është në numrin njëjës:
Ulu! (P.L.55).
Afrohu! (P.L.94).

Filip Ndocaj

Mënyra lidhore

Siç e theksuam më sipër është një mënyrë e trashëguar e gjuhës shqipe. Karakteristikë është formanti *të* që i paravendoset foljes.

Koha e tashme.

Tregon një veprim, kryerjen e të cilit folësi e paraqet si të mundshëm a të dëshirueshëm. Folja e mënyrës lidhore mund të shoqërohet edhe me foljen me vlerë modale *mund*, *duhet* dhe *lë*:

të bëjmë, të acarojmë, të fitojë, të takojsh p.sh.
 ...*sekretari i prefekturës e porositëte të manovronte, të përmbahej*... (D.125).
 ...*por të bëjmë punënë tonë*... (D. 133).
 ...*“ka qef të fitojë kohë*... (D.133).

E pakryera

Tregon një veprim të mundshëm të së shkuarës. E dallon nga e pakryera e dëftores vetëm formanti *të* që i paravendoset foljes, si dhe mbaresat dialektore të gegërishtes: *të nisej, të përmbahej, të manovronte, të prishej, të dilshin*, p.sh.

... *i kishte dhanë vetëm tri ditë afat të nisej përjashta shtetit*... (D. 82).
 ...*të dilshin prej kullës së bajraktarit*... (D. 181).
 E pakryera edhe këtu nganjëherë del me formantin –j:
 ...*si të dojshin* me e porositë të mos bante..” (D. 130)

...ma mirë të mbajtshim Binak Alushin... (D. 184).

...të ndalojshin cilindro që të zihej në afërsi të kufinit... (D. 157).

Në veprën e F.Ndocajt ndeshim edhe struktura të tilla që folja që shpreh vazhdimin e veprimit përdoret në të pakryerën dhe ndiqet nga dy folje në të pakryerën e lidhore në formën joveprore:

...ishte turp që fshatarësia të vazhdonte të varej e t'i bahej peshë depove të grumbullimit...(V.55).

Pjesëza e mohimit si në standard vihet në mes formantit *të* dhe foljes, ashtu edhe trajtat e shkurtra a të përbëra të përemrit vetor:

...e të mos i lenin ma të vepronin...(V.168).

...të mos u zinte trupi vend asnjherë (V.35).

Kishin pasë durim t'ja dëgjonin fjalët...(V.35).

Donte t'ua hiqte këmbësh nuseve...(V.35).

Por ndeshim të përdoret e ashtuquajtura lidhore-habitore:

...e provat i kishin ikë si të mos qenkëshin. (V.145).

E kryera

Ndonëse në mbarë shqipen ka një përdorim, në veprën e F.Ndocajt ajo ndeshet jo shumë shpesh:

Ky besim më mba gjallë e më mëson të kem shpresë...(V.46).

Më se e kryera

Ka një përdorim shumë të rrallë në veprën e F.Ndocajt:

Eh po të mos i kishte rrëzue pushka e hasmit...(V.36)

Një trajtë nëndialektore me përdorim të kufizuar, si rast i izoluar është formimii formës joveprore në më se të kryerën jo me me foljen *jam* në të pakryerën e lidhore, por me foljen *jam* në të kryerën e thjeshtë, dukuri që e ndeshim edhe në të pakryerën e lidhore:

...s'vonoj e një armë gjahu ushtoi, si të qe zbrazë fare afër fëmijëve...(V.34)

...sepse toka e thame shkrumb e thithte si të qe sfungjer...(V.152).

Mënyra kushtore

Edhe për këtë mënyrë ka diskutime, kryesisht për modalitetin dhe përcaktimin kohor të formave të kushtores.¹ Pra çështja paraqitet më e ndërlikuar se diskutimi për mënyrën habitore. Pavarësisht nga diskutimet kushtorja është pranuar në sistemin e mënyrave të gjuhës shqipe.

Koha e tashme

Tregon një veprim që mund të ishte kryer në të shkuarën, po të ishte vërtetuar një kusht i dhënë. Siç e theksuam më parë është homonimike me të ardhmen e së shkuarës të mënyrës dëftore:

Koha e tashme e kushtores ndeshet jo rrallë në veprën e F.Ndocajt, kryesisht në fjali të përbëra ku fjalia kushtore ndërtohet kryesisht me lidhëzën nënrenditëse *po, në qoftë se*, por në shembujt që kemi ndeshur edhe me lidhëzën *në*:

...mbasi e dinte se *po* të ngrihej *do ta shoqnonin* daljen e saj...(D. 283).

...Në qoftë se baba Frrok edhe kësaj here *do të përpiqej* ta kthente te ajo shtëpi e çnjerëzume, ajo *do t'i binte* në besë.. (D.287).

E kryera

Tregon një veprim që mund të ishte kryer në të shkuarën, po të vërtetohej një kusht i dhënë. Edhe kjo formë kohore është homonimike me ardhmën e përparme të së shkuarës të mënyrës dëftore.

E kryera pothuajse nuk përdoret. Rastet me foljet e kësaj mënyre janë të rralla.

Mënyra dëshirore

Përmes kësaj mënyre shprehet modaliteti i dëshirës në formë urimi ose mallkimi.

Koha e tashme

Shpreh dëshirën e folësit në formë urimi ose mallkimi.

Ndërtohet duke i shtuar pjesores së foljes mbaresat vetore: *-a, - , të, -im, -i, -in* dhe sipas foljeve prapashtesat trajtëformuese *-fsh-, -sh-* ose *-ç*:

Dalsh, vofsh, ardhsh, (të) paça, pafsha, vazhdoftë, kJosh, koftë, dalsh, ardhsh, paç, paste, koftë, baftë, plaç, kjoftë, medoftë p.sh.

Vofsh shëndosh e *ardhsh* shëndosh (D.5).

...ty të *nderoftë* Zoti... (D.14)

...na jemi na e ata si *qofshin vofshin*..(D. 98)

.. *Paç* e *dhaç*... (D.130).

... të *pastë* nana jote ty... (D. 99).

Forma joveprore ndërtohet me formantin *u*:

... në *u bafsh* ti me ma pasë jetën në dorë... (D. 83).

...*U trashigofshin, gëzofshin* shoqi shojnë...(D. 107).

E kryera

E kryera mund të shprehë dëshirën e folësit në formë urimi ose mallkimi për veprime të së shkuarës. Ndërtohet duke i pararendosur pjesores së foljes format vetore të së tashmes së dëshirores të foljes ndihmëse *kam* për formën veprorë dhe *jam* për formën joveprore ...i *kofshna falë*... (D. 130).

...u *pastë lanë* baftin... (V.198);

.

Mënyra urdhërore

Me anë kësaj mënyre shprehet modaliteti i dëshirës në formë urdhri, kërkese, këshille, lutjeje etj. Ka vetëm vetën e dytë njëjës dhe shumës. Veta e dytë e shumësin përkon me vetën e dytë të shumësit të kohës së tashme të mënyrës dëftore që dallohen vetëm nga intonacioni:

...*shto* mandej tre të tjerë...(V.51).

...Ti *studjo, shkruaj* edhe pa libra mos *rri*. ;

...*Pushoni* ju them, të përfundoj... (D.138).

...*Rregullo* veten ti...(D. 148).

F.Ndocaj për ndërtimin e formës joveprore të kësaj mënyre nuk është konsekuent, pasi përdor si trajta dialektore, ashtu edhe të standardit të sotëm me *h* ose *j* antihiatizuese, si:

... Çohu, babo! Çohu dhe shtriju...(V..23).
 ...tregoju lluksin e njerëzit..” (D.101).
 ... e shtroju punës...(V.234)
 ...Qeshju, qeshju se s’keni ça me folë” (D.. 201)
 Kur folja është në vetën e dytë të urdhërores trajta e shkurtër ose e përbërë vihet në fund të saj , kur është në numrin shumës vihen në mes temës dhe mbaresës E njëjta dukuri ngjet edhe me formantin *u* të formës joveprore:
 ...Atëherë **theje** korrizin...(V.234)
 ... Shko e *hiqmu* sysh një dekok e ma parë” (D. 83).
 ...Merri more, edhe për katër...(D.87).
 ...Por ndejë te votra , **erru** e **zbardhu** ...(V.40).

7.Rreth formave të pashtjelluara në veprën e autorëve : Pipa, Repishti, Ndocaj

Arshi Pipa

Pipa në krijimtarinë e hershme dhe më pas përdor ato forma të pashtjelluara që i ndeshim në dialektin gegë. Analiza jonë është përqendruar në veprat “Lundërtarë” (1944), “Libri i dashunis dhe i fatit” (dorëshkrim, botuar në Tiranë në vitin 2010) dhe artikujt e botuara në revistat e kohës gjatë viteve 1944-1945, si “Kritika”(1944), “Fryma” (1944, “Bota e re” (1945).

Në fillim të këtij materiali do të paraqesim një statistikë për përdorimin e formave të pashtjelluara në veprën “Libri i burgut” (Tiranë 1994) të vjela në 100 faqet e para (f. 9-109) dhe të një studimi të Pipës në gjuhën shqipe të titulluar “Bogdani dhe gjuha shqipe” prej 18 faqesh, botuar në revistën “Albanica”, nr.1, 1990 botuar në SHBA.

Nga “Libri i burgut” kemi nxjerrë këtë statistikë për 100 faqet e para të këtij botimi: Janë përdorur 188 folje të pashtjelluara dhe konkretisht:

1. Trajtën *me punue* e kemi ndeshur në 97 folje;
2. Trajtën *për me punue* e kemi ndeshur në 10 folje;
3. Trajtën *pa punue* e kemi ndeshur në 11 folje;
4. Trajtën tue punue e kemi ndeshur në 70 folje;

Nuk kemi shënuar përdorimin e pjesores, si dhe konstruktin e së ardhmes kam + pakajoren *me ba*.


Ndërsa nga studimi ”Bogdani dhe gjuha shqipe” prej 18 faqesh, janë përdorur 103 folje të pashtjelluara, ku kemi nxjerrë këtë statistikë:

1. Trajtën *me punue* e kemi ndeshur në 42 folje;
2. Trajtën *për me punue* e kemi ndeshur në 21 folje;
3. Trajtën *pa punue* e kemi ndeshur në 3 folje;
4. Trajtën tue punue e kemi ndeshur në 37 folje;


Nuk kemi shënuar përdorimin e pjesores, si dhe konstruktin e së ardhmes kam + pakajoren *me ba*.

* * *

“Libri i burgut”



Në punimin “Bogdani dhe gjuha shqipe”



Pjesorja

Pipa edhe përsa i përket formave të pashtjelluara i qendron besnik dialektit që përfaqëson, por duhet theksuar se jo ligjërimit të folur, por atij të shkruar, ku patjetër ka pasur ndikimin e vet Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918), me ato vendime që mori. Kështu kjo Komisi, në mes të tjerash, rekomandonte të shkruhen të plota grupet

e zanoreve *ie,ue, ye*, ashtu siç janë “në dialektin tosknisht e në disa dialekte gegnishte.”(Laimet e Komisis Letrare Shqipe në Shkodër, 1918, nr. 1. f. 12, paragraf 5), prandaj edhe Pipa këto pjesore që sot përfshihen në zgjedhimin e parë, togjet e zanoreve do të shkruante të plota, si: *shikue, tregue, dallue, gjykue, prodhue, afrue, kthye* etj.

Por foljet e këtij zgjedhimi, por që i përkasin një klase tjetër që të kryeren e thjeshtë dalin me temë të zgjeruar, pjesoren e përdorin të shkurtuar: *ba, hy* etj. Kështu e bëjnë pjesoren edhe foljet: *përfshi, , shfry, bre, ndi*, dhe foljet e parregullta: *pa, vu*.

Foljet që dalin me temë në bashkëtingëllore, Pipa ashtu si në të folmet gege përdor pjesoren e shkurtuar me *ë*, si: *çuditë, përmbushë, shkarravitë, mbledhë, heshtë, njoftë, kqyrë, veshë, pritë zhgulë, sjellë, mbyllë, mbështjellë* (por edhe *mbështjellun*) etj.

Disa nga foljet që janë përfshirë në foljet e parregullta supletive apo ato josupletive, përdoren me prapashtesën trajtëformuese – në: *dhanë, thanë, qenë, lanë* etj..

Si raste të izoluara ndeshim pjesoret me –*un*: *prekun, mbajtun, virrun, ngrajtun, nisun*. Por në poezi, që është një dukuri pothuajse e zakonshme e Pipës, ndeshim trajtën me –*un*, kur në prozë i përdor me –*ë*: *bujtun, ardhun, shndritun, ngjitur, rritun, flladitun, vozitun, ramun, dalun, ngjallun* etj.

Paskajorja

Lidhur me format e pashtjelluara, te krijimtaria e Arshi Pipës ndeshim disa trajta të përdorimit të paskajores. Trajektorja për përdorimin më të dendur i përket paskajores së tipit *me punue*, por ndeshim edhe trajtat *për me punue, për të punue, me një status më të kufizuar*.

Paskajorja e tipit *me punue*, që kryen shumë funksione sintaktike, është formë shumë e vjetër, që sipas Shaban Demirajt, gegërishtja e ka përdorur shumë kohë para Gjon Buzukut e në gegërishte kjo paskajore kryen edhe shumë funksione të lidhore. Ajo është një dukuri e gjallë dhe vepruese në ligjërimin e folur, por që transmetohet edhe në të shkruar në shkrimet në gegërisht dhe pasqyrohet qartë edhe te Pipa, p.sh.

Me folë e mos me përfundue, me u-sjellë rrotull tue pretendue *me hy* në mes, *me trokitë*, pa hy mbrendë, te dyert e misterit. (F.7-8, 299).

...ku kishte shkue *me ndrrue* klimë. (K.3,112).

...Ndryshej nuk do të kishte mujtë *me vijue studimet* (K.3.117).

Por te vepra e Pipës vihet re se ai evoluon edhe përsa i përket këtyre trajtave.

Trajtën mohore e ndërton me pjesëzën mohuese *mos*, duke e vendosur përpara paskajores:

Mos me u-betua ma për Krisht e Muhamet, por për Shqipni. (K.4,123).

Me përdorime të rralla ndeshim edhe një trajtë të mbipërbërë të kësaj paskajoreje:

Me pasë orientue problemin ...kah një studim i ri... (F.7-8, 305).

Me pasë mësue mjetin e mënyrat e shprehjes (K.2, 46).

...njef fatin e vet para se *me pasë jetue deri në fund*. (K.3,113).

Pipa, në një fjali të shkurtër apo në një periudhë përdor radhazi disa paskajore me funksione të ndryshme sintaktike, si:

Me folë pa gjykue, *me çmue!* (K.1,5).

Ai kufizohet *me vëzhgue, me matë, me bâ prova*.(K.1, 3).

Dhe nuk asht pra *për t'u- çuditë* se si Bergsoni arriti në fund *me e quejtë* krijimin e botës qëllim, por që të manifestohet dashunija hyjnore..(F.7-8, 304.)

...*me dashtë* për andjen, *me bâ tjerët me dashtë, me krijue* për andjen, *me*

pa tjerët tue krijue... (F.7-8, 304) .

Ndër funksionet më të rëndomta të kësaj paskajoreje është përdorimi në fjalitë kryefjalore, kundrinore, qëllimore, kohore etj. kryesisht për fjalinë kryefjalore, shoqëruar me foljet *jam*, *duhet*, *asht e nevoja*, *asht dashtë* etj., me folje jokalimtare, joveprore, si *shkoj*, *kthehet*, *kufizohet* etj. p.sh.:

...detyra e kritikut asht *me dallue* të mirat e të këqijat e veprës...(K.1,1.)

Tash duhet *me pasë* sidomos shije... (K.1,2).

Asht e domosdoshme *me dijtë* ma parë *me u-orientue*...(K.1, 4)

... i ishte dashtë *me kalue* në seminar... (K.3, 117)

E atëherë asht nevoja *me i dlië*... (K.1,2.)

Fillon *me njoftë* ku gjindet... (K.3,115.)

...por asht e tmerrshme *me vrejte* se si mundimet e tija...dështojnë...(K.3,119.)

...Aj i kërcnohet *me i rá* grusht në zemër...(K.3, 115).

...Kan dijtë *me përfitue nga rahatia e jetës*...(K.2, 45)

Paskajorja *me punue* ka përparësi ndaj trajtave të tjera. Pipa nuk e anashkalon përdorimin e mënyrës lidhore në vend të kësaj paskajoreje, të shoqëruar me foljen modale mund (në kohën e tashme, por edhe në kohët e tjera) që është ndër përdorimet më të shpeshta:

...Ajo mund të *prodhojë* vepra madhështore... (K.1,1).

...Do të mund t'ecim kështu me siguri...(K.1, 4)

me foljen duhet:

...Por duhet të *shënojmë* se kritika letrare nuk asht si çdo kritikë tjetër...(K.1,2.)

...Njeriu duhet të *zhduket* për t'ardhë mbinjeriu... (K.3,116.)

Lidhores mund t'i paraprijnë edhe folje kalimtare dhe jokalimtare :

...ashtu si vetëm ai *dinte të shante*... (K.2.41).

...Kam ardhur të shoh miqt e vjetër e të *përpiqem të fitonj* miq të rinj...(K.4,125.)

...Në Pukë aj *kishte dashtë të shkonte* për arsye të shëndetit të tij të dobtë...(K.3,112.)

...Ftisija e përgjumun për do kohë *kish nisë t'i çfaqej* atëherë... (K.3,112.)

Theksojmë se Pipa lidhoren e shoqëron në shumicën e rasteve edhe me foljen modale *due*:

...Atje është një lypës i vogël qi nuk *don të vdesë urije*... (B.R.,36)

...Odon të *mbahet jeta*...(B.R.42.)

Dhe në veprën e Pipës këto përdorime nuk janë të rralla, përkundrazi. Autori ynë nuk është konsekuent në përdorimin e një trajte të caktuar. Kështu foljen *due* e shoqëron edhe me paskajore:

...me jetue *don më thanë me u ndeshkue* pá bâ faj...(L. F.136).

... Nuk *due me pá* nder sytë e botës... (L.F.117).

...Na nuk duem me thanë ase filozofija e Bergsonit asht vetëm një maskë poezije... (F.7-8, 304).

...*don me fjetë një gjúm nëndhes*. (L.F.140).

Janë të qarta përdorimet e paskajores në fjalitë qëllimore, kur në gjuhën e sotme janë zëvendësuar me lidhoren:

...Kozali pritet *me dalë* prej kishës... (R.73).

Pjesëzën mos për lidhoren e përdor para foljes:

Me gjithkëtë asht vështirë me kuptua...*që të mos drejtohet kah kurnji send*. (F.7-8,302).

Forma tjetër e paskajores është tipi *për me punue* që është një kontinim i dy formave të pashtjelluara, por e përdorur jo shpesh në gegërishten veriore, ndonëse në krijimtarinë e Pipës një formë e tillë nuk është e rrallë. E ndeshim te krijimtaria e autorit tonë në disa përdorime:

...Migjeni vinte në Torino *për me u regjistru*e në Fakultetin e Letërsisë... (K.3,112).

...*Për me gjy*kue veprat e dështueme nuk asht fort nevoja *për me pasë* cilsitë veçanta... (K.1,2).

...aj kishte tashti kohë e mundësi *për me punue* me ngê në fushën e letravet... (K.2,44).

Pipa, ka raste që brenda një periudhe i përdor të dy trajtat e paskajores, duke i dhënë përparësi herë njerës e herë tjetrës:

...Kishte fitue një burse dikur, dhe *për me e r*uejtë, i ishte dashtë *me kal*ue në seminar, ndryshe nuk do të kishte mujtë *me v*ijue studimet. ..(K.2,117).

...Në rasën e parë duhej *me pasë* sidomos fund, themel, *për me u-mbështetë* me siguri: hapësinë, horizont *për me përfsh*ë gjithë veprën; masë *për me kqyrë* drejtë e saktë...(K.1,2).

Pjesëzën e mohimit *mos* e vë para paskajores me *me* :

...Bota sjell kryet mënjane *për mos me i pá* kto qenje të mjera të neverituna.(K.3,114).

...u vendos n' Amerikë *për mos me luejtë* ma...(K.2, 44).

Paskajorja e tipit *për të punue* që në shqipen është e vonë dhe në shumë raste është sinonimike me mënyrën lidhore në disa funksione të kësaj të fundit, nuk ka ndonjë përdorim të gjerë nga autori. Atë e ndeshim në disa funksione sintaksore, si :

... Krahasoni Nolin që bahet prift *për t' u shërbye* bashkatdhetarvet të vet... (K.2,42).

... Ishte një burrë i pashëm, me një shëndet *për t' i pasë* zilí...(K.2,42).

... Dhe çka asht *për t' u shënu*e, kjo vepër është ende e pambledhun e tana...(B.R.5, 51).

Por A. Pipa brenda një periudhe përdor disa herë këtë trajtë, si:

...Me të pasion që shkroi *për të ngr*ejtun e *për të ngushllue* skamnorët e të mjerët, me atë pasion ai mësoi në shkollën e katundit *për të ndritun* errsinën e mendjes së trashigueme

prej shekujsh robnije. (B.R.3, 34).

Si me kritikue, kur mungon materiali *për t' u- kritikue*? (K.1,3)

Një veçori tjetër dalluese është përdorimi i shpeshtë i së ardhmes, me konstruktin *kam+paskajore* duke u ndikuar edhe nga ligjërimi i folur i gegërishtes, që është përdorim mjaft i shpeshtë i tij, si:

...*Keni me gjetë* te kjo e dyta këtë paragraf. (B.R. 3, 34).

...Nuk ka me heshtë pra. (K.3,115).

...Vallen , gazmendin kush ka me na i ndezë? (L.14).

Ndeshim edhe konstruktin e dytë *kam + formën me për të*, si:

... ka për të lindun edhe të tjerë kalorës si ay...(K.4,126).

Autori duket e ka ndjerë, si dhe i ndikuar ndoshta edhe nga shkrimtarët bashkëkohës që të përdorë, sado rrallë edhe të ardhmen *do+lidhore*, formë gjithnjë e më shumë po bëhej mbizotëruese për të dy dialektet dhe në ndonjë rast duke hequr formantin të-:

...*E tue i matë, tue i peshue kështu, veç do t' i gandojë, do t' i prishi: do t' i profanojë*... (K.1, 3).

Pipa në disa raste kryesisht në fjali të thjeshta, por edhe në vijin përdor këtë të ardhme:

Do të mund t' ecim kështu me siguri. (K.1, 4).

Do t' a vijojmë traditën e do t' a rikrijomë simbas rasës. (K.1, 4).

Do të marrim andej parimet, kriteret me të cilat *do të gjykojmë* prodhimin e kohës(K.1, 4).

Forma mohore

Autori përdor edhe formën e pashtjelluar mohore me formantin *pa*, e cila ka një përdorim të kufizuar, si:

...Vargjet e lira mbetën kështu *pa u botue* (K.3,112).

...t'a luftojë të tinë, *pa vënë* ndër ballë një vulë të madhe prej "tradhtari.. (K.4,124).

Te shkrimet e Pipës ndeshim edhe një trajtë të mbipërbërë:

...nuk shkatrron *pa pasë ndërtue* ma parë.(K.1,5).

Përcjellorja

Vihet re ndikimi i dialektit që përfaqëson duke e përdorur përcjelloren me formantin *tue*., ...qi grumbullohet mbi trajtat e saja, *tue* ja *veshë*, *tue* ja *mashtue*...(K.4,121).

Edhe tek kjo formë në stilin e autorit vihet re rreshtimi e së njëjtës formë të pashtjelluar: ...*për me edukue* popullin, *tue ndezë* ndjenjën kombtare, *tue afrue* zemrat me fjalën e butë të fés, *tue zgjue* dashunin humanitare.(K.4,121).

Edhe te përcjellorja ndeshim një trajtë të mbipërbërë:

Fén (ortodokse) aj e njëjte mirë, *tue pasë krye* seminarin e Manastirit... (K.3,117).

Nga materiali i mësipërm vëmë re se Pipa shkruan në gegërishte, por larg skemave të ngushta dialektore, në raste të veçanta ndeshim edhe trajta të mbidialektore, ndoshta mund të ketë ndikuar edhe prejardhja familjare, pasi i ati ishte nga jugu.


Sami Repishti

Siç e kemi theksuar më sipër, përveç shkrimeve publicistike, S.Repishti botoi edhe dy vepra me karakter bibliografik: *Pika loti* (1997) dhe *Nën hijën e Rizafës* 2004. Ne volëm nga vepra *Pika loti* 100 faqet e para për të parë përdorimin e trajtave të ndryshme të formave të pashtjelluara dhe na rezultoi kjo statistikë:

Janë përdorur 404 folje të pashtjelluara dhe konkretisht:

1. Trajtën *me punue* e kemi ndeshur në 243 folje;
2. Trajtën *për me punue* e kemi ndeshur në 5 folje;
3. Trajtën *për të punue* e kemi ndeshur në 3 folje;
4. Trajtën *pa punue* e kemi ndeshur në 68 folje;
5. Trajtën *tue punue* e kemi ndeshur në 82 folje;
6. Trajtën *me të larë* e kemi ndeshur në 3 folje.

Siç shihet nga kjo statistikë , autori i ka dhënë shumë përparësi paskajores së tipit me *punue* në krahasim me format e tjera të pashtjelluara.



1.Pjesorja

Edhe S.Repishti e përdor shumë rrallë pjesoren si gjymtyrë fjalie. Po shënojmë disa raste që i ndeshim në ato 100 faqe:

Lugati, veshë me të kuqe si flaka përcëllues...(P.L.30).

...*nji rresht barakash të mëdha rrethue* me rrogoza kënete...(P.L..81).

...*Lodhë* nga ecja...(P.L.30).

...ishin rrasë mbrendë, *ngushtue* e *shtërngue* si sardelet në kuti...(P.L82).

...*Ngujue* në vend, atij iu dukte sikur po e ndigjonte...(P.L.53).

...Ku u bashkuan fshamjet e tija me aton të tjerëve *shtrue* ma parë... (P.L.67).

...Ashtu ishte mësue të gjithë jetën e vet *kalue* në katund... (P.L.97). etj.

Repishti përdor dendur ndërtimet folje modale *duhet* +*pjesore*:

...Por kjo nuk *duhet kuptue* si sinjal i fundit të tyre... (P.L.88).

...Sasia e baltës që *duhej nxjerrë* ishte e caktueme... (P.L.65).

...Mehmeti po *duhej zhdukë*.../ (P.L.75).

Prapashtesat e pjesores janë ato që i ndeshim në gegërisht, pra pjesoret e shkurtuara, por togun zanor *ue* dhe *ye* nuk e redakton në *u, y*, por e shkruan të plotë: *mendue, shikue, kujtue, kthye* etj.

Foljet që dalin me temë në bashkëtingëllore, si dhe ato folje që dalin me temë në *l, ll, r, rr* dhe që në të kryerën e thjeshtë pësojnë ndryshime fonetike, e bëjnë pjesoren me prapashtesën *-ë*, si: *shfaqë, bindë, veshë, qitë, folë, dalë, sjellë, marrë, nxjerrë*, por kur përdoren si mbiemra marrin prapashtesën *-un*: *e marrun, të dalun, i ardhun* etj.

Një pjesore e shkurtuar përdoret edhe në ato folje që dalin me temë në zanore: *pa, përpi, hy, ra, ba, vu, nda*.

Pjesoren me *-në* e marrin kryesisht foljet e parregullta: *thanë, lanë, dhanë* etj.

2.Paskajorja

Edhe te S.Repshti forma e pashtjelluar mbizotëruese është trajta *me punue*, që në gegërishte përdoret në shumë funksione sintaktike, gjë që nuk ndodh me zëvendësuesit e saj. Në ligjërimin e folur sot kjo trajtë është mjaft e gjallë në gegërishten, si:

...ai shpresonte *me ndihmue* prindët...(P.L.26).

...*nana plakë kishte kundërshtue me hy* mbrenda...(P.L.30).

...Nuk pata guxim *me pyetë*...(P.L.40).

Formën joveprore e ndërton me pjesëzën *u*, ashtu si autorët e tjerë dhe standardi i sotëm:

...ata nuk na dhanë as kohë *me u veshë*...(P.L.10).

E vërteta e gjendjes së atëhershme *m'u sqarue* pak nga pak...(P.L.8).

...*atë mbramje nuk ishin kthye në shtëpi me u ngrysë* së bashku me të tjerët...(P.L.27).

Mohimin kjo formë e shpreh me pjesëzën *mos* që i paravendoset kësaj trajte:

...*mos me lejue* shkatërrimin e plangut e të shtëpisë...(P.L.13).

...me një dëshirë të theksueme *mos me ra* përsëri në pellgun e asaj jete pa kuptim.(P.L.39).

...ishte i vendosun *mos me e pranue* ma gjatë...(P.L.50).

Autori përdor dy paskajore të bashkërenditura:

...shkojshin e vijshin për punë *me u përshëndetë e me folë*...(P.L.85).

...po e mësojshin *me vretë e me kuptue* prejardhjen...(P.L.51).

...*Me e dashtë e me e ruejtë* asht e vetmja rrugë nderi...(Ro.39)

Repishti përdor edhe dy paskajore, por e para është trajtë mohore e pashtjelluar:

...U vesh , mori armët në krah *pa kërkue me i ngjeshë* si duhet...(P.L.53).

...Folëm *pa dijtë me ndalue*... (P.L.59).

Nuk janë të rralla përdorimet e foljeve modale *mund* në formë të pashtjelluar ose foljen *due, filloj* + foljen në paskajore , si:

...ata që kërkojnë bileta *pa mujtë me i gjetë*...(P.L.35).

...Rrijshin në shesh *pa mujtë me lëvizë*...(P.L.40).

...Menjëherë më mbuloi një ndjenjë gëzimi e *pa mujtë me u ulë*...(P.L.72).

...e mandej sikur *me dashtë me thye* monotoninë e heshtjes... (P.L.16).

...bujku i thjeshtë rrudhte ballin... si *me dashtë me largue* me shprehjen e fytyrës...(P.L.41).

... mbase here si *me dashtë me na sigurue* se ai ishte ende...(P.L.67).

...*Kola kishte fillue me përcaktue* vijat kryesore...(P.L.57).

...*qysh atë ditë fytyra e tij sikur filloi me u përshkue* nga një rreze gëzimi...(P.L.69).

Por...filloi me ngulë kambë s kishte nevojë...(P.L.71).

Dy format e pashtjelluara për *me la* dhe **për të la** në veprën e S.Repishtit përdoret rrallë.

Në100 faqe kemi ndeshur pesë raste të përdorimit të trajtës me *për me*, si:

...*me mbijetue për me mbajtë* gjallë shpresat...(P.L.15).

...E **për me plotsue** ma mirë kuadrin e mendimeve të veta...(P.L.88).

...*për me mshehë* këmishën...(P.L.93).

...pa bukë, pa ujë, pa rrobe *për me fjetë*...(P.L.95).

...me gjetë fuqi e fjalë të mjaftueshme *për me u shprehë*. (P.L.104).

Ndërsa rajtën me *për të* kemi ndeshur tri raste:

...që i siguron se biri dhe bija kanë vdekë *për të shpëtue* të tjerët...(P.L.62).

...këshillii frontit ishte sa *për të thënë*...(P.L.101).

...I hedh një sy derës së hekurt **për t'u sigurue** se nuk ka njeri...(P.L.102).

Përcjellorja

Edhe te S.Repishti, pas paskajores, përcjellorja përdoret më shpesh se format e tjera të pashtjelluara. Ndërtohet me pjesëzën *tue* para pjesores, si:

Atëherë plaka më lëshoi e *tue hapë* krahët me një gjest lutës...(P.L.61).

Përsëri na vëzhdojshim punën në heshtje e *tue shikue* me bishtin e synit...(P.L.65).

...që ai, *tue arnue* këmishën...(P.L.98).

Mohimin kjo formë e shpreh me pjesëzën *mos*, që vendoset para pjesëzës *tue*:

...na ndajshin në grupe të veçanta e *tue mos* na *lejue* me u ulë në shesh...(P.L.65).

Formën joveprore si gjithë autorët gegë e përdor me pjesëzën *u*, si:

...spjgoi ai *tue u mendue* pak... (P.L.100).

...Qemali thashë me vete *tue u dridhë*... (P.L.41).

...lexoi disa nga ata e *tue iu drejtue* Markut,e pyeti: (P.L.54).

1. **Forma mohore**

Forma mohore, e ndërtuar me pjesëzën *pa* ka përdorim jo të paktë:

...*qante me lot gëzimi kur pa* e *lajmue* u gjeta përballë saj e motrave... (P.L.15).

...*mbështeta kryet për murin e ftohtë... pa shqiptue* as edhe një fjalë... (P.L.42).

...ma vonë u duk para portës *pa prue* përgjigje...(P.L.53).

Edhe kjo formë e pashtjelluar, trajtën mohore e ndërton me pjesëzën *u*:

...ai kalonte nga një ditë në tjetrën *pa ndryshime* dhe si *pa u kujtue* për kohën...(P.L.64)

...që kundërshtonte *pa u shfajsue* nënshtrimin *pa kusht*...(P.L.19).

2. **Me të ardhur.**

Është trajtë shumë e kufizuar që përdoret nga S.Repishti.

...Në mëngjes, *me të dalun* të dritës, nisemi...(P.L.64).


...*me të kalue*...na ndajshin në grupe të veçanta...(P.L.65).

Filip Ndocaj

Janë dy vepra të F.Ndocajt “*Në sytë e rinisë*” dhe “*Vlaga e dheut*” që paraqesin interes në përdorimin e formave të pashtjelluara të gegërishtes. Për të parë intensitetin e tyre ne volëm 100 faqet e para të veprës “*Vlaga e dheut*” dhe na rezultoi kjo statistikë në përdorimin e tyre (nuk përjashtojmë ndonjë gabim në numrim, pasi është bërë në mënyrë mekanike):

Nga 404 folje të pashtjelluara gjendja paraqitet e tillë:

1. Trajtën *me punue* e ndeshim në 188 folje;
2. Trajtën *për me punue* e ndeshim në 16 folje;
3. Trajtën *për të punue* e ndeshim në 2 folje;
4. Trajtën *pa punue* e ndeshim në 39 folje;
5. Trajtën *tue punue* e ndeshim në 135 folje;
6. Trajtën *me të ardhun* e ndeshim në 5 folje.
7. Filip Ndocaj “*Vlaga e dheut*”



Pjesorja

Përdorimi i saj si gjymtyrë fjalie është i rrallë. Por prapashtesat që formojnë pjesoren jo të gjitha janë të njëjta me standardin e sotëm.

Pjesorja në veprën e F.Ndocajt paraqitet e tillë:

Pjesorja me prapashtesën *ue*, e cila në ligjërimin e folur në shumicën e rasteve është reduktuar në *ū*. E marrin këtë prapashtesë foljet që në standard dalin me temë në zanore ose grup zanorësh, si:

mbulue, rrethue, lëshue, shikue etj. Një pjesore të shkurtuar del edhe në ato folje që dalin me zanore, përveç *o-së*, si: *ba, nda, ra, pa, përtëri* etj.

Foljet që dalin me temë në bashkëtingëllore marrin prapashtesën *-ë*, si: *lidhë, hapë ndjekë* etj. Këtë prapashtesë e marrin edhe foljet që dalin me temë në *l, ll, r, rr* dhe në të kryerën e thjeshtë pësojnë ndryshime fonetike si: *përcjellë, nxjerrë, sjellë, marrë*.

Pjesoren me *-në* e ndeshim kryesisht në folje të parregullta, si: *thanë, dhanë, lanë* etj.

Paskajorja

Është forma e më e përdorur në shkrimet geqe, veçanërisht trajta *me + pjesore*. Ajo edhe në veprën e Filip Ndocajt kryen shumë funksione që e bëjnë të domosdoshme përdorimin e saj në shkrimet në gegërisht. Nga statistika që dhamë në fillim, ajo zë 46.5% të formave të pashtjelluara që janë ndeshur në ato faqe që kemi vjelë. Ndonëse në disa raste ajo është zëvendësuar me mënyrën lidhore ose me formën e pashtjelluar me *për me* ose *përtë*, përsëri mbetet trajta dominuese e gegërishtes. Kjo ruhet e gjallë edhe sot në ligjërimin e folur si gegizëm.

Po japim disa shëmbuj për ilustrim të kësaj trajte:

Dikur, të thonte mendja se s' del gja *me e ndryshue* malësorin...(V.37).

...jam i zoti *me shkue* edhe pa ndihmën e askujt... (V.53).

...s'po asht tue u ndjekë turku që *me dalë* konakut tem kështu në muzg të ditës...(V.60).

Shkrimtari përdor edhe dy paskajore në vijim, ndonëse e para është një folje modale ose një folje që shënon fillimin e veprimit:

...se ishte mplakë aq sa *mos me mujtë me ecë* pa ndihmën e tjetërkujt... (V.54).

...u kishte ngelë turpi te dera, sepse *s'kishin mujtë me i vra*... (V.61).

...*kanë nisë me u shtue* më thotë mendja...(V.69).

...*kishin nisë me rrethue* një pjesë të prozhmit...(V.54).

Ose autori përdor duke bashkërenditur dy paskajore, por në ndonjë rast e para nuk përdoret në të njëjtën trajtë:

...kena qitë xeken *me shkue e me punue* atje me tat Palin tem... (V.73).

...mana, boll faqe e zezë asht *me shkue e m'u ba* rrogtar,,qoftë edhe i shtetit...(V.121).

...duhet *me dale e me fitue* kahmos...(V.74).

...të tjerët po pritnin që të fillonte ai për *me nisë me hangër*...(V.63).

Edhe te F.Ndocaj, ndonëse rrallë, përdoret një paskajore e mbipërbërë e konsideruar si kohë e kryer:

...*helmohej tamam si me i pasë vdekë* vëllau...(V.87).

...falej si mos *me pasë ndodhë* kurrnga e keqe...(V.109).

... *e me pasë kenë* një kohë tjetër...(V.117).

...Tamam si *me ma pasë dijtë* mendimin...(D.12),

Trajtën mohore ndërton me pjesëzën mohuese *mos*, duke e vendosur përpara pjesores.

Kjo paskajore për formën joveprore përdor formantin *u*, që e vendos në mes formantit *me* dhe *pjesores*, dukuri që zbatohet edhe në përdorimin e trajtave të shkurtra apo të përbëra:

...Pjetër Uka *me u shtye* gjatë e gjatë me mue...(V.41).

...ka bukur do kohë që ma do zemra *me u shprazë* me ty...(V.41).

...bash topat e Nemces *me ja shprazë* tu veshi...(V.29).

...të bëhet i aftë *me i shërbye* popullit në çdo sektor. (V.45).

Paskajorja e tipit *me punue* shërben për të ndërtuar një konstrukt të dytë të së ardhmes plus format vetore të kohës së tashme të foljes ndihmëse *kam*:

U desht mjaft kohë në fushë e *ka me u dashtë* disa kohë edhe këtu në këtë malësinë tonë...(V.44).

...ai *s'ka me dalë* gja, *ka me u ba* e zeza e vetëvetes... (V.28).

...që ta sigurojnë bukën në vend e *kanë me të tregue* se...(V.114).

Paskajores së tipit me **me** mund t'i paraprijë forma e pashtjelluar e përcjellores së gegërishtes të foljes modale *mund* + foljen ndihmëse *jam*:

Unë babo, *s'jam tue mujtë me qindrue kështu në kambë*...(V.125).

Nuk janë të rralla kur paskajores gege i prin folja modale *duhet*:

...*duhet me ecë* me kohën...(V.122).

...ashtu si *duhet me kenë* sot...(V.124).

Paskajorja e tipit për me ba

Në shkrimet në gegërisht ndeshim edhe tipin e paskajores të ndërtuar nga formanti **për me** + *pjesoren* e foljes. Ka një përdorim të kufizuar, gjë që shihet nga statistika. Në 404 folje të pashtjelluara vetëm 16 i ndeshim me këtë trajtë:

...e *për me ulë* fjalët kishte vazhdue, ... (V.11).

...u ka ra të dalin prej katundit *për me punue* ngado nëpër atdheun tonë...(V.14).

Formën joveprore e ndërton me pjesëzën *u*, gjithashtu edhe trajtën mohore e ndërton me pjesëzën *mos*. Kur i përdor të dyja në një folje, atëherë pranë pjesores vihet pjesëza *u* : Bujqajt e rinj po largoheshin shtëpie *për mos me u kthye* ma... (V.74). Kjo trajtë shoqërohet edhe me trajta të shkurtra që vendoset gjithnjë para pjesores: E veç punëtorë rrugash...*për me e fitue* bukën gjithsesi...(V.42). ...*për me ja ndezë* zjarrin aty pranë dyqanit...(V.86).

Paskajorja e tipit për të ba

Kjo trajtë ka një përdorim pak më shpeshtë se trajta e mësipërm dhe në shumë raste edhe te F.Ndocajt është sinonimike me mënyrën lidhore: ...*për ta vdekë* me anë turturash në Gestapo...(V.19). Ai asht ba copë *për të rregullue* punët...(V.12). ...mbasi ky kishte ra në mulli *për të blue*, u ndal aty ta priste...(V.40). ...ofshante...*si për të largue* kujtimin e tij...(V.51). Formën joveprore edhe kjo trajtë e ndërton me pjesëza *u*: Tue ngjitë shkallët *për t'u kthye* rishtas në kullë...(V.17). ...ku kishin shuma gojë *për t'u ushqye*...(V.40). Trajtën mohore e ndërton me pjesëzën mohuese *mos*, si: ...se kur ishte Pjetër uka , s'bante kryq *për të mos i dhanë* shkak grindjes midis atij e rinisë...(V.68). Edhe me këtë trajtë ndërtohet një konstrukt tjetër i së ardhmes: folja *kam+foljen e kësaj trajte*: ...që ngjiten llastar kah qielli e që *kanë për ta mbulue* si... të rriten edhe pak... (V.25).

Përcjellorja

Përcjellorja është forma e pashtjelluar e përdorur pas paskajores në veprën e F.Ndocajt.Si përqindje sipas statistikave të paraqitura në hyrje të trajtimit të formave të pashtjelluara, na rezulton se kjo formë është përdorur 33.4%. Edhe në veprën e F.Ndocajt , si në mbarë gegërishten, përcjellorja ndërtohet me formantin *tue + pjesoren e shkurtuar* të foljes: ...I dhimte shpirti *tue shikue* ashtu...(V.107). ...Por *tue rrotullua* sytë majtas e djathtas...(V.82). Përdor autori edhe një formë të mbipërbërë, e cila konsiderohet kohë e kryer, në kundërvënje me kohë e tashme: ...*Tue pasë pa* se qysh i silleshin ata...(V.106). ...qoftë edhe *tue pasë arësye* nuk kishte kontrollue veten...(V.56). Formën joveprore e ndërton më pjesëzën *u*, ndërsa mohimin e shpreh me pjesëzën *mos*: ...e *tue u nda* prej tij e prej të tjerëve...(V.11). ...por *tue u dhanë* këshilla si dorëjashtë. (V.6). Unë aspak mirë s'po veproka *tue mos sqarue* mbi çdo gja që don me dijtë...(V.42). Nuk janë të rralla përdorimet e përcjellores të paraprirë nga folja ndihmëse *jam* ose *isha* në vlerën kuptimore të kohës së tashme ose të pakryerës së mënyrës dëftore për të treguar një veprim që është në zhvillim e sipër, ose folja *jam* në të kryerën si: ...Ti po thue se tokat tona *janë tue shkue* dam...(V.43). ...mendon për ne e ajo *asht tue punue* për fatbardhësinë tonë...(V.46). ...kurrë s'i hiqte librat nga dora , edhe kur të gjithë *ishin tue bisedue*...(V.121).

...kjo ikje nga malësia *ishte tue vazhdue* së tepërmi...(V.38).
...për dy pash tokë *kanë qenë tue u mbytë*...(V.89).
Kjo trajtë e përcjellores mund t'i paraprihet paskajores gege me **me**:
...Unë bab-o, s'*jam tue mujtë me qindrue* ma kështu në kambë...(V.125).

Forma mohore

Forma e pasjtjelluar mohore e ndërtuar me formantin *pa* ka një përdorim jo të rendomtë në veprën e autorit. Ajo zë afro 10% të formave të pashtjellura sipas statistikës së dhënë në hyrje:

...dy orë kambësore *pa mbërritë* te katundi Firëz...(V.9).
...që pllambë toke të mos na ngelë *pa mbjellë* e bile tash që u rritën fëmija...(V.39).
Si të gjitha format e pashtjelluara, edhe kjo e ndërton formën joveprore me pjesëzën *u*:
...dhe ndihmojnë *pa u kursye* për të çue ma andej punën...(V.13).
Pjetri mirë e ka, kur të thotë se *pa u ba kooperativë s'kemi si e vemë për fije bujqësinë*...(V.44).
Edhe kjo trajtë ka një formë të mbipërbërë:
...pse u çove sot prej sofrës *pa u pasë ulë* ende mirë. ..(V.23).
...derisa Cube Sokolja, *pa i pasë mbushë* djali ende të pesëmbëdhetat,i bani gostinë e armës.(V.107)

Me të ardhur

Me të ardhur formë tjetër e pshtjelluar që në pak raste e përdor edhe F.Ndocaj:...ishin vonue e nxitonin të arrinin Rajën....që të nesërmen *me të zbardhë* dita.(V.60).
Vokrrri ishte rrenue aq shumë **sa me te thanë** mendja se nuk ishte ma as për vete(V.62).

8.Foljet ndihmëse dhe gjysmë ndihmëse Foljet modale

Foljet modale *mund, do, duhet* në kohët të ndryshme të mënyrës dëfore, kohë të thjeshta e të përbëra, të shoqëruara me folje në mënyrën lidhore ose edhe pjesore:

...me sa *mund t'i ikim* vetvetes... (D.73).
... **don** të eci mbas rektimave të zemrës... (D.77).
...*Donte ta pyeste* a donte ujë të freskët.. (D.78).
...*duhej t'ja kishte shtypë* kokën... (D.82).
...menjëherë *nisëshin t'ja qajshin* hallin... (D.84).
...i kishte futë në borxhe të atilla, sa që *s'do të mund t'ja lajshin* asnjëherë..." (D.126).
...*Donte të bante* si një bashkëfshatar i tij... (D.126).
...me atë dyqan të vogël ku *kishte nisë të fitonte*... (D. 126).
...populli *ka nisë të reagojë*... (D.178.).
...për të *mund të thuhet* se e njohin.. (D. 135).
...donte t'i thoshte se s'*mund të tregonte* asgja... (D.161).
...mbasditja *kishte nisë të ulej*... (D.76).
...të mendonte kah **duhej ecë** ma tej" (D. 80)

Foljet modale mund të jenë në lidhore, por folja që e ndjek në ndonjë rast nuk është në lidhore, por në dëftore:

...nesër të mund ikte nga ajo komune... (D.126).

Folja modale mund të ndiqet edhe nga një formë e pashtjelluar, kryesisht paskajore gege: *mundë me dëgjue, due me thanë, nisa me u ba, kish nisë me vu, filluem me u ba, kisin nisë me punue, kishte nisë me mbushë, kishte nisë t'i urrente* p.sh.

...Drandja s'kishte mundë me dëgjue... (D.82).

...Po due me thanë se ai bajarkatari ynë.. (D.112).

...A doni me ardhë atje ku jemi tue heqë borën? ” (D.14).

...në rrugën ma të keqe ka nisë me u shtrue... (D.135).

Foljet që tregojnë mënyrën e kryerjes së veprimit, fillimin, vazhdimin dhe rritjen progresive të ndjekur nga një folje në lidhore ose edhe formë e pashtjelluar:

...Gjergji *filloi të harrohej* dhe nisi dëshira... (D. 96).

... e mori veten e *erdh e u ba* ma e bukur... (D.102).

...E *vazhdonte të rrinte* ashtu si leshko... (D.126).

...ja *nisën me vjedhë* me të dyja duert... (D.160).

... në burg *nisa me u ba* ashik... (D. 189).

Me te ...*kish nisë me u vu* për fije... (D.198).

...*Filluen me u ba* të modës... (D. 201).

...*kishin nisë me punue* një derë hekuri... (D. 251).

9.Përmbyllje e kreut të pestë

Pjesa më e madhe e doktoraturës i përket trajtimit të veçorive dhe kategorive gramatikore të pjesëve të ligjeratës të vërejtura në veprat e tre autorëve. Edhe në këtë rrafsh gjuha e veprës së tyre është gegërishtja, por për mendimin tim është edhe mjaft e standardizuar, ndonëse autorët nuk kanë qenë gjithnjë koherent në përdorimin e së njëjtës trajtë morfologjike.

Në këtë kapitull janë përshkruar ato veçori dhe kategori gramatikore të pjesëve të ndryshme të ligjeratës që i ndeshim në gegërishten e autorëve, por duke mos përjashtuar ato raste që i ndeshim edhe në standardin e sotëm, dukuri të cilat vërtojnë se gegërishtja e kohës sonë me standardin e sotëm nuk janë larg njëri-tjetrit. Këto dukuri i vërejmë pothuajse në të gjitha pjesët e ligjeratës, por dallimi qëndron kryesisht në përdorimin e formave të pashtjelluara, ndonëse ndeshim edhe pak raste të zëvendësimit të paskajores gege me mënyrën lidhore.

Dukuritë e tjera i kemi evidentuar gjatë trajtimit të secilës pjesë të ligjeratës. -Tek emri, të tre autorët kanë përdorur dygjinisinë, një dukuri e gegërishtes, që emrat e gjinisë mashkullore, numri shumës, tema e të cilëve del me prapashtesën *-e* dhe *-ra* përdoren si emra të gjinisë femërore që është në pajtim me normën drejtshkrimore të sotme. Në raste tepër të izoluara vepron edhe në shumësin e gjinisë mashkullore me prapashtesën *-a*.

-Shumësi i emrave është i larmishëm ku ndeshim trajta dialektore, por edhe të mbarë shqipes. Kështu në përdorimin e shumësit nuk janë gjithnjë koherent, pasi ngjet që të njëjtën fjalë në shumës nga i njëjti autor të jepet me dy trajta: *elementë/elementa* ose *studentë/studenta* etj.

- Nuk i qendrojnë besnik dialektit që përfaqësojnë kryesisht në përdorimin e prapashtesë *j*, kur e njëjta fjalë përdoret me prapashtesën *nj*: *kufij/kufinj*.
 - Në përdorimin e haplogjisë ka luhatje, gjatë veprës së tre autorëve diku përdoret , diku jo.
 - Rënia e treguesit të shquarsisë në rasat e zhdrejta në numrin shumë të që në standardin e sotëm është kthyer në normë, në veprën e autorëve zbatohet. Por Arshi Pipa në studimin për Bogdanin. Botuar në SHBA, më 1990 ka luhatje, pasi ndeshim edhe trajtën me *-vet*.
 - Autorët përdorin ato shkallë të mbiemrit që i ndeshim si strukturë edhe në gjuhën e sotme , duke përjashtuar trajtat gege të fjalëve, kryesisht formantin *ma*.
 - Ndonëse përdoren kryesisht ata përemra që ndeshim edhe në gjuhën e sotme, por vërejmë edhe gegizma, veçanërisht në përemrat pronorë, në drejtshkrimin e tyre etj. të cilët janë përshkruar për secilin përemër dhe autor veçorinë e tyre.
 - Vend më të gjërë i është kushtuar foljes, që është analizuar sipas mënyrave dhe kohëve, duke veçuar si trajtat dialektore që nuk janë të shumta dhe ato të mbarë shqipes, por duke u ndaluar edhe në disa dukuri të diskutueshme si foljet që dalin me temë në zanore, si: *pi*, *di* etj. e tek autorët përdoren me mbaresë, të foljeve në vetën e parë me *t/s.*, përdorimi i kohëve të mbipërbëra etj.
 - Në kohën e tashme autori përdor ato mbaresa si në standard, por në zgjedhimin e pare përfshin edhe ato folje që dalin me temë në zanore dhe në gjuhën e sotme përfshihen në zgjedhimin e tretë: unë *pij*, *dij* etj.
 - E pakryera formohet me anë mbaresash dialektore të gegërishtes. Janë shënuar edhe ato folje që nuk përputhen me standardin e sotëm.
 - Në të kryerën e thjeshtë përdoren po ato mbaresa si në mbarë shqipen, por në vetën e tretë vërehen luhatje në përdorimin e mbaresës *-i* dhe *-u*.
 - Kohët e përbëra janë formuar me foljet ndihmëse *kam* dhe *jam plus pjesoren e shkurtuar* të goljeve gege.Ndihmësja *kam* në formimin e së kryrës së tejshkuar përdoret në trajtën *pat* dhe jo *pati*, ndonëse vërehen edhe luhatje (*pat shkue*).
 - E ardhmja ndërtohet me dy konstrukte: i pari si në standard : *do të filloj*, rrallë edhe pa *të*: *do filloj*.Ndeshim edhe folje në të ardhmen në vetën e tretë njëjës që përdoret me mbaresë:*do të njohi*, veçori e të folmeve të Veriut. Konstrukti i dytë si në standard, por me paskajoren e gegërishtes.
 - Format e tjera të së ardhmes ndërtohen nga trajtat gege të formave të pashtjelluara.
 - Habitorja , ndonëse përdoret rrallë e nuk i ndeshim të gjitha format kohore te të tre autorët, kohët e përbëra ndërtohet me pjesoren e shkurtuar të gegërishtes.
 - Lidhorja përdoret gjerësisht në veprat e tre autorëve me formantin *të*. Në trajtën mohore ndeshim dy struktura: formanti *të*, pjesëza e mohimit *mos* dhe *folja* (*të mos punojë*), ndërsa struktura e dytë që përdoret më rrallë: pjesëza e mohimit *mos*, formanti *të* dhe *folja* (*mos të punojë*), ndikim i ligjërimit të folur të gegërishtes.
 - Janë përshkruar se si paraqitet mënyra kushtore me kohët e saj dhe mënyra urdhërore.
 - Janë evidentuar edhe edhe ato folje të veçanta në mënyra të ndryshme, sipas autorëve, që nuk përputhen me standardin, por janë trajta dialektore.
- Mbyllet ky kapitull me përdorimin e formave të pashtjelluara të foljes, të veçuara për secilin autor.
- Trajtimi më i gjerë i përket paskajores gege, pasi autorët, duke shkruar gegërisht kjo formë e pashtjelluar, karakteristikë e këtij dialekti fitonte përparësi

Kreu i gjashtë

Pjesët e pandryeshueshme të ligjeratës

1.Ndajfolja, veçoritë

Arshi Pipa

Në dy veprat në shqip të Arshi Pipës ndeshim në përdorimin e shumë ndajfoljeve dialektore, pa përjashtuar edhe ata ta mbarë shqipes.

Kështu nga libri “*Rusha*” kemi ndeshur , në mes të tjerash këto ndajfolje, më pak të parme(disa me konversion), por më shumë të prejardhura, përngjitje dhe lokucione si:

Tej (51), *veç* (110), *vrik* (105), *kah* (126), *çurg* (104), *thekshëm* (41), *idhshëm* (45), *rryeshëm* (51), *etshëm* (117), *rreptas* (56), *mbytas* (62), *kundruell* (60), *gand* (91), *ksajt* (95), *ngjeti*, (98), *letas* (108), *shqenisht* (50), *mrekullisht* (105), *ksisoj* (65), *kurnji* (11), *gjithheresh* (11), *përtej* (13), *përnjimend* (15), *mandejna* (47), *përtejna* (75), *dikund* (81), *kurmâ* (105), *kotnasikoti* (127), *gjithkah* (129), *njasisoj* (53) ,*përspjeti* (55) , *ndokund* (44), *gjithnduer* (92), *rreth e përçark* (89) etj.

Nga libri i burgut:

Lik (43), *prap* (67), *thik* (67), *mandej* (85), *veç* (28), *rrotull* (39), *kundrejt* (76), *rrafsh* (78), *shkrrye* (51), *kusarisht* (84), *përmbropa* (87), *kondend* (176), *tërthuer* (185), *tevona* (42), *tërposhtë* (56), *mbatanë* (43), *gjithaq* (59), *asqi* (9), *ksisoji* (17), *anekand* (156), *dikund* (49), *pergjithanë* (100), *kaherë* (172), *animirë* (142) etj.

Sami Repishti

Përgjithësisht në veprën e Sami Repishtit ndeshim, kryesisht ato ndajfolje që janë të mbarë shqipes, pa përjashtuar edhe disa krahinore Më të përhapura janë ndajfoljet e përngjitura. Ndonëse ndeshim edhe ndajfolje të parme dhe të prejardhura dhe lokucione, si:

Prap (P.L.9), *krejt* (P.L.12), *mandej* (P.L.12), *keqas* (P.L.125), *qartësisht* (P.L.10), *fortësisht* (P.L. 13), *intelektualisht* (Ro, 263), *thjeshtësisht* (Ro. 305) *përmbrenda* (P.L.17), *krejtësisht* (P.L.23), *shpeshherë* (Ro.266), *lëmueshëm* (Ro, 261) *përherë* (P.L.12), *tashma* (P.L.107). E ndeshim edhe trajtën *tashmë* (Ro.263, ndoshta luhatje), *kurrkund* (P.L.121), *menjiherë* (Ro, 278), *nganjiherë* (Ro, 278); *gjithëherë* (Ro.306), *veçse* (P.L.38), *herë pas here* (P.L.107), *rishtas* (Ro. 257), *gjithkah* (Ro. 311), *kambadoras* (Ro.328), *ngultas* (Ro.335), *madhnisht* (Ro.338).

Filip Ndocaj

F.Ndocaj ndryshe nga lidhëzat, përdor edhe disa ndajfolje dialektore përveç atyre të gjuhës së sotme:

- ...Pjetër Uka e kishte pa se *njimend* e kishte shkelë lirinë e diskutimeve...(V.56):
- ...që edhe shtegun e ri ja kishin çelë katundit *kund* nja njiqind pashë ma nalt...(V.55).
- Megjithkëtë , *gjithkah* nëpër katund vlonte puna...(V.151).
- Mandej*, sa ma parë po e mbledhim katundin e nisim shkollën. (V.170)
- Instiktivisht Çunishikoi nga shpati *kundruell*, nga ai shtegu...(V.275).
- ...kur i shikonte të hallakatun *kahmos* mbas fitimit...(V.38).
- ...fjalët e punët e Pjetrit nuk ja mbushnin mendjen *kurrsesi*. (V.64).
- ...prandej Tuçi mori me vete çantën e mjekimeve dh era fluturim *teposhtë*. (V.125).
- ...rrinte tue name vedin e shkoi e hupi *ndokahë*, sepse s'jetonte patë...(V.154).
- ...shtroheshin në spital *veçse* kur u kishte koha me ulë kryet e me vdekë...(V.188).

Parafjalët, përdorimet

Arshi Pipa

Parafjalët shprehin marrëdhënie sintaksore varësie midis një emri, një numërori ose të një përemri në një rasë të caktuar dhe një gjymtyre tjetër të një togfjalëshi.

Simbas kriterit sintaksor parafjalët përdoren me këto fjalë në një rasë të caktuar e konkretisht në rasat emërore, gjinore, kallëzore dhe rrjedhore. Ka gjuhëtarë që mbështesin mendimin se parafjala mund t'i paraprihet edhe rasës dhanore. M.Çeliku duke folur për parafjalët e përbëra me përngjitje (*nëpërmjet*, *ndërmjet*, *ndanë*, *mbanë*), si edhe për parafjalët emërore të thjeshta , sipas autorit në kundërshtim me trajtimin tradicional duhen interpretuar si parafjalë të rasës dhanore.¹ Por ende nuk ka ndonjë studiues ta mbështesë që rasa dhanore të përdoret me parafjalë.

Nga parafjalët që përdoren në shqipe vetëm parafjalët *për* dhe *ndaj* përdoren me rasën kallëzore dhe rrjedhore, ndonëse nuk kemi ndeshur ndonjë rast që Pipa ta përdorë parafjalën *ndaj* me rasën kallëzore. Janë pak ato parafjalë, shumë pak, që Pipa t'i përdorë dhe që nuk përfshihen në standardin e sotëm.

Me rasën emërore janë përdorur parafjalët : *nga*, *te* dhe *kah*. Nuk kemi ndeshur ndonjë fjalë që të përdoret parafjala *tek*.

Kah është një parafjalë me përdorim të kufizuar i të folmeve të veriut që e ndeshim më shumë në ligjërimin e folur se atë në të shkruar:

...Andej kur kryet e lodhun *kah* toka do ta shtrijë...(L.B.88).

...Ngjat dritares qi shiqon *kah* fusha...(R.13).

...Çka memi andej *kah* deti? (L.B.16).

Standardi i sotëm nuk e përfshin në parafjalët e rasës emërore.

1. M.Çeliku, *Lokucionet parafjalore emërore në gjuhën letrare shqipe, në botimin e autorit "Probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe"*, Tiranë, 1997, f.174. Autori në mbyllje të këtij shkrimi në f.203, shkruan: "Lokucionet parafjalore dhe parafjalët me përngjitje janë parafjalë të rasës dhanore kur ndiqen nga forma me –ve (në shumës dhe nga njëjësi që i korrespondojnë kësaj forme shumësi."

Pipa parafjalën *te* e përdor si para emrave që fillojnë me zanore, ashtu edhe para atyre që fillojnë me bashkëtingëllore:

...djaloshi serb ndeshet *te* një gurrë...(R.22).

...ashtu si formulohen *te* Kanuni...(R.5).

...*te* buzët tua jeta ngazullon...(L.B.47).

...Unë jam kufizue *te* një lexim jo i plotë i veprës...(P.114).

...ende për s' gjalli *te* gropë u-zhyten...(L.B.72).

...kush prej mbrapa *te* arrçi i kaptinës...(R.23).

... Një parafjalë që po gjen një përdorim të gjerë *te* Pipa është parafjala *nga*, e cila gjithnjë

po pëson rritje në dëm të parafjalës *prej*:

...*nga* gjoksi i shtypun shungullon...(L.B.51).

...u-shkund trolli përçark *nga* duhmat e topit...(L.B.19).

...*nga* Shkodra ...në Prizren e Tivar...(R.5).

Parafjalët e rasës gjinore në veprën e Pipës janë të kufizuara. Kemi ndeshur lokucione të rasës gjinore : *në mes* (të), *në saje* (të).

Problemi i nyjës të shkojë me lokucionin apo me emrin që vjen pas, ka interpretime. A.Xhuvani e merr si pjesë përbërëse e lokucionit.² Për M.Çelikun e ashtuquajtura nyjë nuk duhet përfshirë në përbërje të lokucionit parafjalor³, gjë që ka gjetur miratim edhe nga studiuesit e mëpastajmë duke u pajtuar me mendimin e autorit, njëkohësisht përligjet edhe nga teksti i Akademisë së Shkencave.

...Ujt merrej nga një pus dikund *në mes* t'oborit...L.B.208

...tue vleftë... edhe për mësimin e stylistikës *në saje* të kapitullit mbi gjuhën figurative...P.121

Parafjalët e rasës kallëzore: *pa*, *me*, *për*, *nepër*, *mbi*, *nën*, *ndër*, *në*, *përmbi*, *bashkë me etj.*

...qi *pa* to e bafsha be (L.B.127), i harlisin *me* lojna, (L.B.163, kam ndie *për* gra e vasha (L.B.160)...qi kalon *nepër* hekura (L.B.163), e hekrave *mbi* mur (L.B.178), *me* zemër fëmijore *nën* parzëm adamanti (L.B.179), oh sa herë *ndër* muzgjet e robnis (L.B.191), si ipeshkëv i kishës katolike *n'atë* qytet...(P.118), *bashkë me* miq e dashmirë bashkue...(R.39).

Është një numër i konsiderueshëm parafjalësh të rasës rrjedhore më pak të parme dhe më shumë të prejardhura, kryesisht me origjinë emërore dhe ndajfoljore.

Parafjalë të parme të rasës rrjedhore:

Prej, *për* dhe *ndaj*.

...se për çdo dhjetë *prej* nesh...(L.B.23).

...disa për mall e tjera *prej* trishtimi, ndonjenën *prej* hareje...(L.B.48).

...shtrojet, jamullinë e rëndë *prej* plisi...(R.16).

...Shumë *prej* familjeve princore...(R.5).

...kurse Uroshi *ndaj* tij është bërçik...(R.39).

...E del *për* flegrash sikur afsh lëngate, avull *për* goje ...(L.B.83).

...por eja tash e shifi *ndaj* kanalit...(L.B.65).

...tue lanë *ndaj* teje sikush gjurmët e veta...(L.B.137).

2.A.Xhuvani, *Parafjalët, në botimin e A.Xhuvanit "Vepra", I, 1980, f.330.*

3.M.Çeliku, *Parafjalët emërore të thjeshta në gjuhën letrare shqipe, në botimin e autorit "Probleme të morfologjisë...", f.142; Shih edhe: M.Samara, Parafjalët në shqipen e sotme (Vështrim leksiko-semantik), Tiranë, 1999, f.85.*

Është theksuar se gjuha shqipe si një gjuhë analitike-sintetike, analitizmi gjithnjë vjen duke u rritur dhe e vërejmë edhe në disa shembuj këtu kur përdoren ndërtimet me parafjalët nga, prej etj.⁴

Parafjalë të prejardhura:

Parafjalë emërore: *mes, maje, rreth, buzë*, mes etj.

...Mund t'objektohet se paralelizmi *mes* dijes e gjuhës...(P.107).

...nji poemë tregimtare mbi marrëdhëniet *mes* shqiptarëve...(R.5).

...Përtej veç *maje* malesh, lik me pyllin... (L.B.156).

...E u-shuan pishat *rreth* saj...(L.B.173).

...nji farë bari i naltë *buzë* ujnave...(L.B. 199).

...u- ndez lufta *mes* ballistëve dhe komunistëve...(L.B.205).

Parafjalë ndajfoljore: *mbas, para, mbrenda, kundër, drejt, larg, përtej, përmbrenda, bri, gjatë, afër, jashta, anës, rrotull etj.*

...*Mbas* ksaj date shqiptarët...(R.6)

...*Para* tij nji vashë...(R.28).

...*mbrenda* muejsh nën ligjën e Shkodranit...(R.39).

...*kundër* serbit je? (R.43).

... dy- tri hurdhë ngau *drejt* saj...(R.46)

...*Larg* meje ata duer...(R.47).

...E ke nji tjetër short *përtej* kohës ndër vise...(L.B.32).

...Ngjiten burrat prej pazari, vinë te pusi *bri* çinari...(L.B.125).

...ishte nisë kah Rusha n'tjetër krah *gjatë* nji shtegu...(R.45)

...Kjo don me thënë se janë dashtë *afër* dy shekuj...(P.121).

...Kosova mbet jashta kufinjve t'atdheut...(P.122).

...Mbi leshterikun *anës* detit...(L.B.50).

...*Rrotull* shtratit at'herë të nipn shifte... (L.B.105).

Parafjalë të përngjitura:

...*Përveç* gjuhës amtare, ai dinte mirë...(P.117).

...për me lavrue *nepërmjet* gjuhës e letërsisë...(P.124).

...nji djalosh *përmbas* dritorje...(L.B.20).

...*Simbas* historianit t'universitetit...(R.6).

...pranija e tyne *përpara* ksaj kohe...(R.6).

...e kam lakmi me mbjellun *përmbrenda* meje pemën! (L.B.92).

...Ulet *anekand* dhenave...(L.B.156).

...rroken egër gjymtyrët *ndërmjet* sish...(L.B.85).

...m'u desh mue *ndepër* punët e ushtërisë...(P.108).

.. *përmbi* kashtë nji kambë...(R.33).

...fu'e shetitun *përgjatë* kanalit...(L.B.66).

...E ke nji tjetër short *përtej* kohës...(R.32).

Ngjat pallatit larg sa hidhet guri...(R.40).

Siç analizohet edhe në veprën e Pipës parafjalët me origjinë ndajfoljore përbëjnë numrin më të madh në raport me parafjalët e rasave të tjera dhe ky numër vjen e rritet vazhdimisht.

4.M.Domì, *Dukuri dhe prirje të zhvillimit të structures sintaksore të shqipes së sotme letrare*, "Gjuha jonë", 1985, nr.1, f.52.

Sami Repishti

Autori përdor kryesisht ato parafjalë të standardit me ndonjë ndryshim.

Me rasën emërore janë përdorur parafjalët: *kah*, *nga*, *te* dhe *tek*.

Kah është një parafjalë me përdorim të ngushtë dialektor të disa zonave të Veriut. Prof. Gj.Shkurtaj ngre një problem lidhur me këtë parafjalë. Duke qenë se parafjala nga ka një ngarkesë shumë të madhe në shqipen standard, ajo mund të zëvendësohet me simotren krahinore kah së paku në disa kontekste e përdorime ku ajo edhe merr një kuptim kryesisht të drejtimit¹, si mund ta vërejmë edhe në ndonjë shëmbull që po japim më poshtë:

...që të çon *kah* kodrat ... (P.L.122).

...shkojnë *kah* kalaja e marrin drejtimin... (P.L.132).

...e zemrën e vrame *kah* qyteti... (P.L.123).

Parafjala nga edhe në gegërishte si në shkrimet e autorit, po merr gjithnjë një përdorim të gjerë në krahasim me parafjalën prej të rasës rrjedhore :

...rrozullime të tana të çlira *nga* unë... (P.L.128).

...pemët e nalta e të krehuna me mjeshtri *nga* lulishtari... (P.L.128).

Edhe në shëmbujt e mëposhtëm ndeshim përdorimin e parafjalës *nga* ndaj parafjalës *prej*:

...u largua *nga* shtëpia... (P.L.135).

...kanosej pak *nga* të ftohtit... (P.L.134).

...*nga* ky rrenim i pafre... (P.L.148).

...të vdesë *nga* uria... (P.L.125).

...kromin e bardhë që ndritte *nga* dielli... (P.L.129).

...ju që vdiqët nga uria epagjumësia, *nga* dhimbja... (Ro.340).

Dy parafjalët e rasës emërore *te* dhe *tek* autori përparësi i jep parafjalës *te* pa bërë dallimin nëse emri nis me zanore apo me bashkëtingëllore:

...Pastaj dërguam partizanët *tek* anëtarët e Këshillit. (P.L.101).

...Sepse ajo që ngjet *tek* unë... (Ro.60).

...me pa efektin e talljes së tij *tek* të tjerët... (P.L.111).

Te: ...çdo ditë atje *te kampi*... (P.L.132).

...ta afroj letrën *te* goja... (P.L.127).

Është një risi e shqipes që rasa emërore përdoret me parafjalë, gjë që nuk ndodh në gjuhët e tjera europiane. E ka shpjeguar edhe J.Rrota se si ka ndodhur kjo dukuri në gjuhën shqipe. Për shpjegimin e kësaj dukurie që Rrota jep fjalinë: *Shetita kah zalli i Kirit d.m.th. andej kah asht Zalli i Kirit, E hasa Kolën te posta d.m.th. e hasa tek është posta.*²

Parafjalë të rasës gjinore autori përdor këto lokucione: *në mes...*, *në drejtim (të)*, *për hirë (të)*, *me përjashtim (të)* etj.

...strukë në një qoshe të dhomës *në mes* të dy shokëve ... (P.L.48).

1.Gj.Shkurtaj, *Kundrime gjuhësore*, Tiranë, 2006, f.57-58

2.J.Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Shkodër, 2005, f.415.

Këtë parafjalë e përdor edhe me rasën rrjedhore, kur nuk e shoqëron me një emër të rasës gjinore por në rrjedhore:

... Kjo qenie e mjerë që jetonte *në mes* nesh ditë e natë...P.L.106.

...me një lëvizje koke *në drejtim* të bajraktarit...P.L.103

...Ndërkaq kishte dale dielli *në drejtim* të fshatit...P.:103

...Për hir ...nëpër gojë të atyne që *për hirë* të kauzës...P.L.148

...Me përjashtim: ...në shtëpinë e tyre *me përjashtim* të kryetarit të këshillit të fshatit...(P.L.104).

Parafjalët e rasës kallëzore : *pa, për, nën, mbi, ndën, me, në* etj, dhe lokucionet: *bashkë me... mbrenda në...në kundërshtim me...*

... *pa* gëzim (P.L.126), *për* mue (P.L.128) ...*nën* një hapsinë...(P.L.122)...*mbi* tryezë...(P.L.122)...*ndën* drunin e turturës...(P.L.116), me që të rrih *me* mue...

(P.L.20),. *bashkë me*:

...pak kohe *bashkë me* të drejtat tjera të mohueme...(P.L.131).

...hyn *brënda në* fshat...(P.L.103).

...tue e paraqitë *në kundërshtim me* fenë...(P.L.149).

Të shumta janë parafjalët që perdoren në rasën rrjedhore jo vetëm të parme , por edhe me prejardhje emërore, ndajfoljore.

Parafjalë të parme:

prej:...nji *prej* atyre urave...(P.L.29).

...fluturoi fëmija *prej* gëzimit...(P.123).

...që kërkonte *prej* të vorfnit...(P.147).

...të largoheshin *prej* Shkodre...(P.117).

për: rrëmbente të borgosunin *për* krahu...(P.L.114).

ndaj:Nënshtrimi i plotë *ndaj* struktures së re...(P.L.151).

Parafjalë ndajfoljore janë të shumta që përdor autori, pjesën më të madhe e ndeshim edhe në gjuhën e sotme shqipe. Janë rreth 20 parafjalë me origjinë ndajfoljore.,

Përpara: ...*përpara* syve të të gjithëve...(P.L.52).

Para:me dale *para* vrejteve të shokëve ..(P.L.49).

Përreth: ...atë mbramje...në qelitë *përreth* nesh (P.L.114).

Kundër : tue luftue *kundër* vdekjes...(P.L.67)

Kundrejt: qëndrimin e ashpër *kundrejt* “infidelëve”(P.L.147)

Pranë : Nji oficer u afrua *pranë* qelisë së Mehmetit...(P.L.76)

Mbrenda: ...që po rritej *mbrenda* meje...(P.L.115).

Përkrah: Atëherë ishte ulë plaku *përkrah* plakës...(P.L.29)

Poshtë: ...tue zbritë *poshtë* kodrës...(P.L.31).

Përballë: *Përballë* nji filozofie jete...(P.L.147).

Përqark: ...pa e kuptue botën që rrokullisej *përqark* tij...(P.L.106).

Përgjatë:...me nji lëvizje të krahëve u shkye *përgjatë* kurrizit...(P.L.98).

Drejtë: ...edhe nji hap *drejt* shërimit...(P.L.143)

Jashtë: ...me dale *jashtë* këtij rrethi vicioz...(P.L.143).

Përjashta:...u hodh *përjashta* kuvendit...(P.L.117).

Gjatë: ...ky bujk qëkërrusi kurrizin *gjatë* gjithë jetës...(P.L.106).

Mbas: *Mbas* fjalëve të para...(P.L.87).

Afër: ...e mbajta *afër* meje...(P.L.20).

Parafjalë emërore:

Mes: ...si të vetmen formë komunikimi *mes* nesh...(P.L.20).

Rreth:...*rreth* kohës së drekës...(P.L.44).

Midis:...*midis* të shëmtuemve...(P.L.146)

Lokucione:..

Rreth e rrotull (lokucion)...*rreth e rrotull* oborrit të mbrendshëm.(P.L102).

Në mes...kjo qenie e mjerë që jetonte *në mes* nesh...(P.L.106).

Filip Ndocaj

Simbas kriterit sintaksor parafjalët përdoren me fjalë të rasës emërore, gjinore, kallëzore dhe rrjedhore. Parafjalë të rasës dhanore nuk pranohen, përveç ndonjë gjuhëtari.¹

Me rasën emërore në veprën e Filip Ndocajt janë përdorur parafjalët : *kah, nga, te dhe tek*.

Kah është një parafjalë me përdorim të kufizuar i të folmeve të veriut që e ndeshim më shumë në ligjërimin e folur se atë në të shkruar. Duke qenë se parafjala *nga* ka një ngarkesë të madhe përdorimi ka gjuhëtarë, siç e theksuam, që në disa përdorime duhet të zëvendësohet më parafjalën *kah*:

...që ngjiten llastar *kah* qielli...(V.25).

...atëherë u afrue *kah* plaku...(V.43).

...*kah* përroni që ndante bashtinën...(V.49).

...drejtonte ujin *kah* arat e tija...(V.50).

Standardi i sotëm nuk e përfshin në parafjalët e rasës emërore.

Ndocaj parafjalën *te dhe tek* ie përdor si para emrave që fillojnë me zanore, ashtu edhe ata me bashkëtingëllore, pa bërë një dallim të prerë:

...nuk e shikonte *te* asnjëni ndër baballarët e tyne...(V.35).

...ec *te* unë...(SR.6).

...e rrobave të gatshme e deri *te* enët shtëpiake...(V.83).

Ajo arriti *te* rrapit taman në kohën...(V.30).

...doli *te* dera e jashtme e kullës...(V.26).

...gjithmonë të shitun *tek* i hueji...(V.10).

...i zoti i punës ndodhej *te* shtëpa...(V.52).

...suell mendjen *tek* ata të katër...(V.52).

...deri *te* hija e atij rrapit shekullor...(V.47).

...që blente *tek* ai dyqan...(V.85).

...atje *te* votra arriti...(132).

...halli i plakut të votrës ishte *te* ajo frika pa kuptim...(V.132).

...po *te* ato tokë të reja...(V.211).

...uli shaminë e ndërsa mbante pishën *te* ato dhi të plagosuna...(V.172).

...u largue prej tyne e shkoi *tek* ajo tokë...(94).

1. M.Çeliku, *Lokucionet parafjalore emërore në gjuhën letrare shqipe, në botimin e autorit "Probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe"*, Tiranë, 1997, f.174. Autori në mbyllje të këtij shkrimi në f.203, shkruan: "Lokucionet parafjalore dhe parafjalët me përngjitje janë parafjalë të rasës dhanore kur ndiqen nga forma me –ve (në shumës dhe nga njëjësi që i korrespondojnë kësaj forme shumësi."

Siç vihet re autori diku e ka parasysh se *tek* është më e drejtë të përdoret para fjalëve që fillojnë me zanore, por nuk është gjithnjë konsekuent.

Parafjala *te(k)* mund të paraprihet edhe nga pjesëza *deri*:

Kufoma u bart *deri te* vorri...(V.197).

...ka ngelë cung i zi e i thamë *deri te* rranjët...(V.25).

Parafjala *nga* ka një përdorim të gjerë në standard, por edhe në veprën e F.Ndocajt, duke zëvendësuar në disa përdorime parafjalën *prej* e cila gjithnjë po pëson rritje në dëm të parafjalës *prej*:

...pa u largue *nga* votra e të parëve...(V.25).

...i madh dhe i vogël *nga* ajo shtëpi djersinin pranverë...(V.54).

...kishin marrë shkas *nga* rrethimi i tokës së re...(V.55).

...e u nis *nga* kulla ...(V.53).

Parafjalët e rasës gjinore në veprën e Pipës janë të kufizuara. Kemi ndeshur lokucione të rasës gjinore: *në mes (të)*, *për shkak (të)*, *në krye (të)*, *në drejtim (të)*:

...e kishin varë mu *në mes* të katundit...(V.49).

...edhe një hetë drama e Galan Lulashit për *shkak* të së cilës ai djalë...(V.103).

...doli ta përcillte deri *në krye* të katundit.(V.121).

...ngurruen ta merrnin nën armë *për shkak* të operacionit të kamës.(V.198).

...ndërsa shënonte me kokë *në drejtim* të grepave të Çunit...(205)

Problemi i nyjës të shkojë me lokucionin apo me emrin që vjen pasi ka interpretime. A.Xhuvani e merr si pjesë përbërëse e lokucionit.² Për M.Çelikun e ashtuquajtura nyjë nuk duhet përfshirë në përbërje të lokucionit parafjalor³, gjë që ka gjetur miratim edhe nga studiuesit e mëpastajmë duke u pajtuar me mendimin e autorit, njëkohësisht për ligjet edhe nga teksti i Akademisë së Shkencave.

...

Parafjalët e rasës kallëzore: *pa*, *me*, *për*, *nëpër*, *mbi*, *nën*, *ndër*, *në*, *përmbi*, *bashkë me*, *tok me etj.*

...por edhe *mbi* të gjithë atë rrethinë...(V.30).

...mbështetë *për* oxhak...(V.18).

... e *tok me* ta u nis për te “fangu”...(V.29).

...zhduken delet *ndër* sy...(V.52).

E u nis... vetëm *pa* shkop...(V.53).

...mbasi *tok me* ta kishte ra...(V.59).

...të punonte *bashkë me* ta...(V.63).

...si ky rrap *nën* degët e të cilit po pushonte...(V.36).

Është një numër i konsiderueshëm parafjalësh të rasës rrjedhore më pak të parme dhe më shumë të prejardhura, kryesisht me origjinë emërore dhe ndajfoljore.

2.A.Xhuvani, *Parafjalët, në botimin e A.Xhuvanit "Vepra"*, 1, 1980, f.330.

3.M.Çeliku, *Parafjalët emërore të thjeshta në gjuhën letrare shqipe*, në botimin e autorit “*Probleme të morfologjisë...*”, f.142;

Shih edhe: M.Samara, *Parafjalët në shqipen e sotme(Vështrim leksiko-semantik)*, Tiranë, 1999, f.85.

Parafjalë të parme të rasës rrjedhore:

Prej, për dhe ndaj.

...ndodhej shtëpia *prej* druni...(V.30).

...mbi tabakanë e rrumbullakët *prej* tunxhi...(V.26).

...erdhën *prej* asaj rruge...(V.67).

...po digjej flakë *prej* ethesh...(V.132).

...në zemër vnerin e urrejtjes *ndaj* njerëzve...(V.107).

...atëherë shtëpiaku e kapi *për* krahësh...(V.133).

...mbante qëndrim kritik *ndaj* vetes! (V.200)

Është theksuar se gjuha shqipe si një gjuhë analitike-sintetike, analitizmi gjithnjë vjen duke u rritur dhe e vërejmë edhe në disa shëmbuj këtu kur përdoren ndërtimet me parafjalët nga, prej etj.⁴

Parafjalë të prejardhura:

Parafjalë emërore: ballë, buzë, faqe, majë, qafë:

...pa mbërritë te katundi Firëz, *ballë* të cilit , në bregun e përtejme...(V.9).

...që gjeti aty *buzë* votrës...(V.59).

...ta turponte *faqe* qarkomandantit... (D. 133).

...si ai lumi i Drinit *buzë* katundit të tij. (V.199).

U ngjit *majë* shkrepit...(V.206).

Udha për në krue binte *qafë* kullës se Lulë Gjeloshes...(V.219).

Parafjalë ndajfoljore: *mbas, para, mbrenda, kundër, drejt, larg, përtej, përmbrenda, bri, gjatë, afër, jashta, anës, rrotull etj.*

...i duket se lufta *kundër* së vjetrës...(V.13).

...kishte dalë *këndej* Drinit...(V.22).

...sa kishte afrue grigjën e deleve *afër* lavrës...(V.171).

...tue mendue *rreth* fjalëve të djalit. (Kalimi: emër/ndjafolje/parafjalë), (V.125).

...*Përreth* tij , një urdi burrash...(V.22).

...atje nalt *përbri* Poravit...(V.22).

...ishte turp i madh pusia e vrasja *mbrapa* krahëve...(V.22-23).

...i kishte përpi dhe *përpara* kohe...(V.21).

...u prini *përposh* shkallëve...(V.29).

...rrëshqitën *përposhtë* trupit ... (V.29).

Siç shihet këtë parafjalë e jep në dy trajta.

...Flinin *pranë* djepeve të foshnjeve...(V.26).

...bile kishin nisë presionin *kundrejt* Vorfajve...(V.55).

...i kanë ndodhë *gjatë* jetës.(V.126).

...Si i mbeti kryet *mbas* katundit...(V.54).

...ata zunë vend *kundruell* tij...(V.60).

...kishte dalë edhe *jashtë* shtetit...(V.162).

4.M.Domí, *Dukuri dhe prirje të zhvillimit të structures sintaksore të shqipes së sotme letrare*, "Gjuha jonë", 1985, nr.1, f.52.

Parafjalë të përngjitura:

Si rrypinë gjelbërimi *ndërmjet* pyjeve të bjeshkës...(V.22).

Përkrah çunit dhe ai ishte i premë...(V.164).

Tue u përashkue *nëpërmes* maleve...(V.219).

...fërkoje para e mbrapa e *gjithkah* trupit...(V.141).

...Lokucione:

...dhe një shnjë kënaqësie që shndërruen *në mes* tyne Mirushi dhe Rama... (V.88).

...tue i lëshue sytë *rreth e rrotull* asaj dhome...(V.137).

Siç analizohet edhe në veprën e Pipës parafjalët me origjinë ndajfoljore përbëjnë numrin më të madh në raport me parafjalët e rasave të tjera dhe ky numër vjen e rritet vazhdimisht.

3.Lidhëzat, llojet, veçoritë e tyre

Arshi Pipa

Lidhëzat që janë përdorur në veprën e A. Pipës, si dhe të dy autorët e tjerë, i përkasin shqipes së sotme standarde.

Shumica e lidhëzave në gjuhën shqipe janë të parme. Ndërsa lidhëzat e prejardhura kanë ardhur nga pjesë të ndryshme të ligjeratës, si nga përemrat, ndajfoljet, pjesëzat e tjerë. Disa lidhëza janë formuar me përngjitje ose mund të jenë lokucione lidhëzore.

Shënojmë disa nga lidhëzat bashkërenditëse

Këpujore: e, dhe, edhe, as...as etj.

Zbrazen kamjona me gurë n'udhen e gjanë te bregu e hudhen ndër anë vagona...(L.B.45).

As vasha fringe, as edhe trimi Kola...(L.B.186).

...as ndër Serbë as n'Arbën...(R.53).

Veçuese: ose, apor, daç...daç, a etj.

Mos je dikur e trembuna flatër e ndonji malli n'idylin qi s'u korr? *Apor* je vetë i dashuni...(L.B.109).

...n'daç komunist n'daç kriminel...(L.B.57).

...të tanë ditën qoftë me diell a natë me hanë...(R.24).

Përmbyllëse: ndaj, prandej etj.

Ndaj gra e vajza e deshën prej nga çdo vend e kohë...(L.B.86).

Prandej ktu ndryshe gurgullojnë currilat e vala ka një melodi pa fund...(L.B.148).

Kundërshtore: porse, ndërsa, veç, por, veçse etj.

Ai rrinte larg si hylli qi ndritë *porse* nuk ngrohë. (L.B. 87).

...nalt përmbi çimenton e bodrumit, *ndërsa* hijet prej harqesh...(L.B.116).

E shojtën *veç* turrin, jo flakën, jo dritën...(L.V.194).

Ajo u-shuejt ma në fund, *por* mizorija e pashembullt...(L.B.197).

Prej nanduer ...Shqipnija nuk qe *veçse* ...(L.B.199).

...nji katund pranë Durrësit, *kurse* një pjesë tjetër punonte...(L.B.199).
 Lidhëza nënrenditëse:
Ftilluese: qi, se etj.
 Dihet *se* shkrimtari nuk shkruen vetëm për andjen me lexue veten...(P.109).
 Ma thonte zemra e ngrata *se* jeta t'kishte lanë...(L.B.59).
Vendore: ku, kah etj.
 Kisha frigë se po birresha, kaq shumë ngjate larg meje *ku* dergjem e s lëshoj...(L.B.107).
 ...I pëlqente me ndenjën buzë detit mbi greminë tallazet tue përgjue *kah* theh'shin për shkambinj.(L.B.89).
 ...ranishte e lanë...ku bijt e tu *qi* e gjetën. (L.B.148).
Kohore: kah, kur, tek, para se, deri sa, posa, mbasi, sa, teksa, si, ndërsa etj.
 ...I vetoi te syni thika e sllavit *kah* u çue tinzisht...(R.25).
 E mue at'herë një mllef mendjen ma bren *kah* shof...(L.B.30).
 I iku Dardhomelit *tek* e pa...(R.26).
 ...e stepa qenë dëshmina janë e prova çka munden skllevnit *kur* të jenë miljona...(L.B.71).
 ...e largon ajo *tek* e shef e trembun...(L.B.41).
 ...sipër valesh ku ngjyra vërsheu *para se* t'falesh...(L.B.49).
 ...dhe kjo duhej t'u ngjiste *der'sa* n'at fé i mësoi...(L.B.59).
 ...e shokët tue prekun nepër trup *posa* dha shpirt...(L.B.73).
 Na ramë, por *mbasi* mbollëm virtytin e një fare...(L.B.37).
 Kqyri djalin e *si* e pau t'ardhangun tha me hov...(R.29).
 Sa të hyjshe mbrendë, një taftt i randë ta merrte frymen. (L.B.200).
 ...ndër blegrima kingjash poshtë te gjëni *der'sa* qielli u err e zhurma mëni. (R.30)
 Dita e majit *teksa* kish ague, *kur* prej shtratit vajza tue u çue...(R.19).
 Por *ndërsa* cezura e deseterac-it bie rregullisht...(R.86)
Qëllimore: në mënyrë qi, qi etj.
 Fjalori asht përpilue *në mënyrë qi* çdo fjalë e rrallë ...të ketë aty shpjegimin e vet .(R.85)
Shkakore: se, pse, si, për arsye se, deri sa etj.
 E ndofta harroj un fyemjet *se* provat e dashunis, edhe ma të imtat i shpërblej...(L.B.45).
 Na shajnë...*pse* duem Shqipnin...(L.B.51).
 Koha shumë i prishi, *si* u-lanë mbas dore e kush ma nuk i ndreqi...(L.B.115).
 ...u arrestuen *për arsye se* kishin mbrojtur haptas Kosovën...(L.B.197).
 ...flamuri i Skanderbegut do t'valvitet *derisa* flamuj tjerëdo t'njofi bota...(L.B.119)....
 Krahasore-mënyrore: *si, posi, se, sikur etj.*
 ...fort i ri e i hieshëm *si* një vashë...(R.25).
 ...hâna e plotë *posi* kuleçën dasdash...(R.30)
 ...me syt e shkruem e me faqet e kuqe aq të kuqe *sa* thue ja ngjeu e ama...(L.B.40).
 Sa gëzojnë fëmijt e vorfën tash *qi* vjen e pritun stina, *posi* tufa zogjsh përhapen nepër rruga...(L.B.41).
 Kishte dalë mâ e rëndë *se* ç'ish gjykue...(R.27)
 Oh se ç'andje e parrëfyeshme me u-shulla *sikur* hardhuca, (L.B.41).
 E ndiej *si* tash prej valave buçet Adriatiku...(L.B.109).
 Pa gur , pa shenj, ndër gropa plehu hjedhun *si* coftina na kallin...(L.B.52).
Kushtore: në se, po qe se, si, n' etj.

E *n'se* lypet durim e besë qi s'vdaret...(L.B.52).
 E rueje peng kujtimi prej meje *po qe se* fati desht t'ishte ajo e endun...(L.B.49)
N'se jo, ti lutju Zotit, se mire na jemi nda.(L.B.86).
 Mendojeni *si* t'ishte një lot i ndonji hylli qi ra mbi kët ranishte.(L.B.86).
 E *n'i* shërbeva atij tue lanë ashtu mbas dore zyren birnore qi detyrë ta kisha...(L.B.141).
 Rrjedhimore:aq sa, sa etj.
 E *n'se* lypet durim e besë qi s'vdaret, *aq sa* me dhambë me bre hekurin qi...(L.B.52).
 U mshon me shkop *sa* mundet...(L.B.65).
 Lejore: *edhe pse, sidoqi* etj.
 Ma thonte zemra e ngrata se jeta t'kishte lanë, *edhe pse* miqtë e shokët nuk dojshin...(L.B.59).
 ...tash qi edhe ujt b asht mangut e ndahet me çanak *sidoqi* ka krymba...(L.B.162).

Sami Repishti

Lidhëzat

S.Repishti përdor dendur ato lidhëza që i ndeshim edhe sot në mbarë shqipen, por jo me një larmi të madhe.

Lidhëza bashkërenditëse:

Këpujore: *e, dhe, as, sikur* etj.

Dukagjini i babës *e* Shkodra e tij...(P.L.52)

Ishte një nga çastet ma të vështira *dhe* ma solemne njikohësisht.(P.L. 65)

Mehmeti nuk lëvizte, *as* përgjigjej.(P.L.66).

As nana, *as* vllau s'e trazuen. (P.L. 57).

As njerëzit, *as* vendi s'ishin njilloj.(P.L.50).

Ngujue në vend, atij iu duk *sikur* po ndigjonte nga larg hapa...(P.L.53).

Atëherë, një farë frike e pashpjegueshme *sikur* e rrethonte nanën.(P.L. 7).

Veçuese: *ose* etj.,

...ndjente frikën e largimit tonë *ose* të një rreziku të ri...(P.L.16).

...na jemi kuptimi i çdo gjaje në këtë botë që *ose* asht e jona *ose* nuk asht fare për ne...(P.L.128).

Përmbyllëse: *prandaj* etj.

Prandaj vazhdova...(P.L.112)

Kundërshtore: *por, kurse, megjithatë, veçse, veç,ndërsa,*

Marku dha emrin, *por* nuk dinte...(P.L.53).

Ajo bani kult urrejtjen, *kurse* karrieren ideal.(P.L. 124).

Nuk më kujtohej se kishte vuetjtë nga zemra, *megjithatë* ka mundësi...(P.L.59).

... ofrova të paguej, *por* ai refuzoi. (Ro.297)

Veçse Marku ndjente ma shumë se të tjerët peshën e randë...(P.L.50)

...pa asnjë fjalë tjetër, *veç* tue përsëritë me vete emnin e djalit...(P.L.28).

Përqafova nanën me gjithë shpirt, *ndërsa* ajo dredhte lot gëzimi. (Ro. 295)

Të shkallëzimit: *jo vetëm ...por, jo vetëm ...por edhe etj.*

Me rrokë pushkën ishte *jo vetëm* një detyrë, *por* kryesisht gjesti suprem i çlirimit (P.L. 52)

Marku ishte dëshmitar *jo vetëm* i gjendjes së familjes së vet, *por edhe* i qindra familjeve... (P.L.50).

...I jepte formë *jo vetëm* së tashmes, *por edhe* së ardhmes....(Ro.334)

Lidhëza nënrenditëse

Ftilluese: *që*, *se etj.*

Unë buzëqesha *e* i sigurova *që* isha mirë. (Ro, 252).

Ma vonë kuptova *se* ishin “në gjak”...(P.L.6).

Më kujtohet *sesi* shpeshherë gjymtyrët *e* mia veproshin...(P.L.23).

Vendore: *ku*, *ngado që*, *kudo që etj.*,

Të gjithë studentëve shqiptarë të Universitetit të Firenzës *ku* kishte ndjekur studimet...(P.L.35).

Ngado që sillesha, vrejsha *vetëm* një prirje...(Ro.336).

Lutu për të gjitha zemërplasunat *kudo që* janë *e* *që* nuk kanë shpresë...(P.L.62).

Kohore: *porsa*, *kur*, *para se*, *mbasi*, *sa*, *sa here që*, *sa kohë që etj.*,

Kushedi *sa* herë gjatë ditës *kur* isha në kanal...(P.L.17).

Porsa bie *perdja e* aktit të parë, fillon planifikimi dhe përgatitja *e* aktit të dytë...(P.L.145).

Gjendej lumi i Kirit *që* gjatë verës kishte pak ujë *para se* shterrej krejtësisht në gusht...(P.L.5).

Katërbëdhjetë orë rrugë bani Marku *derisa* në mengjezin *e* ditës tjetër hyni në shtëpi...(P.L.56).

Mbasi merr baltën... , ecë disa hapa ... (P.L..64).

Sa më shihte, *i* qeshej fëtyra...(P.L.10).

Sa herë do të ketë shkue...diku në një qoshe... do të ketë vajtue...(P.L.13)

Sa herë që e këshilluen, ai refuzoi...(P.L.98).

Unë *e* kuptoj ...*sa kohë që* të rrijshe me mue...(P.L.20).

Qëllimore: *që*, *me qëllim që etj.*

Ne kemi urdhna ...*e* jemi këtu *që* t’i zbatojmë , *jo* të diskutojmë...(P.L.55).

Kishte ba buzën në gaz *e* *me qëllim që* mos t’i prishte qefin malsorit...(P.L.24).

Mënyrore-krahasore: *si*, *ashtu si*, *aq sa*, *sikur*, *siç*, *sesi etj.*

...përpiquej të na përfshinte *ashtu si* kishte ba kur ishim ende fëmijë...(P.L.16) .

Sa ma shumë kjo rritej, *aq* ma shumë ai afrohej me te. (P.L.6)

...*që* qendrojshin *si* trupa të ngritun deri në brez...(P.L.7).

...shikova me sy *sa* lutës *aq sa* edhe ngulës rojën *që* u ndal...(P.L.12).

...U ula mbi rrobe *sikur* po i bibindesha një urdhni të padukshëm.(P.L.23).

...fëtyra *e* tij u ndrit...*siç* asht *vetë* natyra *e* fëmijëve të moshës së tij.(P.L.129).

...Mehmeti nuk kishte spjegue hollësisht *sesi* kishte ngja...(P.L.69).

Shkakore: *se*, *pse*, *sepse*, *nga friga se*, *me qenë se etj.*

Markut iu mbush mendja *se* ai dhe të tjerët ...do të ishin në gjendje me ndërtue jetën *e* re...(P.L.53).

...ajo viente nga një ndjenjë faji *pse* nuk punonte...(Ro.278).

Duket *se* unë kisha ndryshue shumë në fytyrë, *sepse* ajo po përpiquej të më njihte...(P.L.12).

Mbasi më mori besimin *se* një ditë kur do të isha i lirë, do ta bajsha të njohun...(P.L.116)

Me një gjest mbrojtës tue na shtërngue fort *nga frika se* do të shkëputeshim prej saj.(P.L. 7).

Më përqafoi e *meqenëse* kishte ndigjue ...e kishte kapë frika...25

Foli nanës më tha, *se* asht lodhë shumë për ty .(Ro, 253)

Kushtore: *sikur, po, në qoftë se* etj.

Sikur ta kishte ditë se fati i saj do të kishte kenë ai që kemi sot...(P.L.9)

Çdo të mendonte...*po* të na shihte kështu...(P.L.39).

...*në qoftë se* do t'ia delsha qëllimit, do të vulossha për familjen time...(P.L.136).

Lejore: *edhe pse, megjithëse, edhe sikur* etj.

Kjo ishte përshtypja e ne fëmijve *edhe pse* ajo nuk ankohej asnjherë.(P.L. 7).

Megjithëse tashti gjindeshim nën hijen e një kodrine, vapa e madhe...na e nxjerrte djersën lumë..(P.L.80).

...as që dëshirojsa ne mendue për ditën e ardhshme, *edhe sikur* të mos vinte kurr një tjetër mëngjes...(P.L.68).

Rrjedhimore: *sa, sa që, aq sa* etj.

...e filloi me i ra, *sa* gjaku plasë menjherë...(P.L.95)

Por ajo kishte pa dhe ndigjue mbi të mirat e arsimit *sa që* ishte bindë...(P.L.8).

...e së cilës i kushtoi të gjitha energjitë e kohës së tij *aq sa* nuk e shikojshim ma njëni-tjetrin...(P.L.38).

Lidhëzat

Filip Ndocaj

F.Ndocaj përdor një numër të konsideueshëm lidhëzash, por shumica i përkasin standardit,

qofshin të parme, qofshin të prejardhura.

Sipas funksionit sintaksor, po shënojmë disa prej tyre:

Përdor këto lidhëza bashkërenditëse:

Këpujore: dhe, e, edhe, as, si...si etj.

...tue qitë shkumë e tue hungrove...(V.133)

Veçuese: apo, ose o, qoftë..qoftë etj.

...në atë katund *aq* të vogël *apo* do ta emnonin...(V.122)

...shikonte buzët e vajzës që shtangoreshin *ose* dridheshin nga zjarri ...(V.133).

...për atë që punon token *qoftë* në sipërfaqe, *qoftë* në thellësitë e galerive...(V.177).

Kundërshtore: po, por, megjithatë, megjithëkëtë, veç etj.

...nuk dolën haptas kundër Pjetër Ukës, *por*...ja nisën si me shaka:...(V.10)

...*megjithkëtë*, kohë pas kohe, koka e tij mbështetej në...(V.17).

...Plau e ndigjont...e tundte kokën . *Veç* një natë u mërzit dhe ja preu djalit...(V.191).

Përmbyllëse: pa, pra, ndaj, prandaj etj.

Kishin një vajzë të sëmurë keq, *prandaj* Tuçi mori me vete çantën e mjekimeve dh era fluturim *teposhtë*. (V.125).

Të shkallëzimit: jo vetëm...por, le që...por edhe, le që...por as, jo vetëm që...por edhe etj.

...të bahej i zoti në mjekësi *jo vetëm* për me ua shërue sëmundjet, *por* sidmos me ua hjekë...(V.141)

...ai edhe e meritonte të ishte...edhe kryetar këshilli, sepse *jo vetëm që* ishte trim, *por edhe* i arsyeshëm...(V.62-63).

Lidhëza nënrenditëse:

Ftilluese: se , që , në etj.

Mandej ajo i shkroi *se* si ndodhej ajo në Shkodër...(V.238).

Sa e pa *se* të gjithë ishin largue, iu drejtue Çunit. (V.161).

Vendore: ku, kudo, tek, kah, ngado etj.

...ishte si bazamenti gjigand i atij podi, *ku* dikur ndodhej shtëpia...(V.30).

...ai e merrte me vete *kudo që* shkonte...(V.106)

Kohore: kur, sa , sapo, para se, mbasi, tek etj.

...*ndërsa* mbante pishën te ato dhi të plagosuna, u përgjegj me dënesë...(V.172).

...ishte ...nana e Vatës së vogël , i cili, *tek* zbriste nga mani, kishte shkye...(V.30).

...asgjë nuk do të bajnë...*derisa* të jetojë ai...(V.16).

Sapo i doli gjumi, i dha trupit...(V.48)

Qëllimore: që, me qëllim që etj.

...ja fërkoj kambën *me qëllim që* t'ja ngjallte dejt...(V.186),

Kur Puka u kishte dërguar edhe agronomin *që* t'u caktonte vendet e kulturave të ndryshme...(V.178)

Shkakore: se, sepse, ngasei, mbasi, nga shkakun se etj.

...s'kemi si të largohemi nga toka, *se* kjo puna e bujqësisë asht bash si ai maraku...(V.154).

...ata që nuk donin të ndiqnin shembullin e Vorfajve *ngase* ja pritonin...(V.55).

Pjetri iu drejtue kështu Masjan Gjurës, *sepse* ato ditë dyshohej se ajo familje

Krahasore-mënyrore: se, sikur, sesa, ashtu si etj.

Ai mbeti i habitur se sa me zell punonin ata bujq...(V.241)

...të mos lodheshin me dalë deri në Firëz, *siç* kishte dalë ajo për filloren...(V.202).

...I dukej vetja *si* në një vend të shkretë...(V.154).

Kushtore: po, në, në se, sikur, në qoftë se etj.

Gjela...*sikur* ta shikonte, *sikur* ta dinte që e kishte pranë , do t'i thoshte...(V.133).

...tue shikue nga praku i votrës ku, *po* të kishte qenë gjallë, do të ishte ende Lulash Preka...(V.270)

Rrjedhimore: që, saqë, kështu që etj

...buzëqeshja e saj ishte aq e hidhun, aq e zyrtë *sa që* djali ndjeu si një të ftoftë në zemër.(V.173)

Përpiqeshin *kështu që* ...fasulet...të mos prisheshin...(V.152).

...ua kishte marrë dorën aq shumë punëve ta shkollës, *saqë* tani ai ishte i pari i klasës...(V.201)

4.Përmbyllje e kreut të gjashtë

Pjesët e pandryshueshme të ligjeratës i kemi trajtuar në kreun e gjashtë. Duke analizuar ndajfoljet, parafjalët dhe lidhëzat e përdorura veç e veç te secili autor.

Ndryshe nga parafjalët te të tre autorët ndeshim të përdoren edhe mjaft ndajfolje dialektore, si: *vrik, gand, ngjetiu, kotsëkoti* etj, por te dy autorët e tjerë Repishti dhe Ndocaj përdoren më pak. Arshi Pipa krahas parafjalëve të rasës emërore të standardit përdor edhe parafjalën dialektore *kah*, e cila në gegërishten ka një përdorim të dendur, po ashtu edhe në veprën e dy autorëve të tjerë. Për gjuhëtarin Gj.Shkurtaj kjo parafjalë duhet të zëvendësojë parafjalën *nga* në disa përdorime pasi ka një ngarkesë të madhe. Nuk ndeshim te Pipa parafjalën *tek*, ndërsa dy të tjerët e përdorin , por nuk ndjekin ndonjë kriter në zbatimin e saj.

Parafjalët e rasës gjinore kanë një përdorim të kufizuar te tre autorët dhe ata që i ndeshim i përkasin standardit. Edhe parafjalët e rasës kallëzore që i përdorin autorët, janë të mbarë shqipes me ndonjë rast të izoluar.

Parafjalët e rasës rrjedhore më të shumtit janë të prejardhura, kryesisht me origjinë emërore ose ndajfoljore, por që janë të mbarë shqipes, ndonëse ndeshim edhe dialektore, si: *qafë, ngjat, përposh, gjithkund* etj.

Lidhëzat që janë përdorur te tre autorët qofshin bashkërenditëse, qofshin nënrenditëse, janë të mbarë shqipes Më të shumtit janë të prejardhura nga pjesë të ndryshme të ligjeratës, si nga përemrat, ndajfoljet, pjesëzat etj.

Me të vërtetë shumë prej tyre i ndeshim në standard, por duhet ditur se ata janë të mbarë shqipes dhe jo të një krahine të veçantë. Në materialin që kemi shfrytëzuar, nuk kemi mundur të gjejmë të gjitha lidhëzat e shqipes, por disa prej tyre, gjë që nuk pasyron atë pasuri të gegërishtes në këtë fushë.

PËRFUNDIME

- Në doktoratë, mbështetur në botimet e Arshi Pipës, Sami Repishtit dhe Filip Ndocajt kemi vështruar se si paraqitet gegërishtja në rrafshin leksikor, fonetik, fjalëformues dhe morfologjik të tre autorëve, zhvillimet e saj, të përbashkëtat dhe risitë e tyre dhe prirjen që mund të ketë për të përdorur një gegërishte sa më të njësuar.
- Veprat e fundit të tre autorëve të shkruara në gegërisht dallohen nga botimet e para, pasi gjuha e tyre është më e zgjedhur, me më pak trajta gjuhësore dialektore, duke pëlqyer në mjaft raste trajtat gramatikore të mbarë shqipes.
- Theksojmë se dy autorët e parë: Arshi Pipa dhe Sami Repishti gjysmën e jetës e kanë kaluar në emigracion, duke i shkruar veprat në gegërisht, ndërsa Filip Ndocaj që ka jetuar vazhdimisht në Shqipëri, veprat që botoi pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës shqipe të vitit 1972 i botoi në përputhje me standardin e sotëm.
- Nga analiza e dukurive gjuhësore kemi konstatuar se gegërishtja e përdorur nga të tre autorët u është larguar trajtave të ngushta të dialektit që përfaqësojnë, duke u paraqitur përgjithësisht mjaft e kodifikuar dhe e pranueshme për shqipfolësit. Ndoshta jo me ndërgjegje, por për mendimin tonë, kemi një gegërishte deri diku të njësuar dhe me një përdorim të trajtave dhe formave gramatikore të mbarë shqipes. Kështu ne kemi paraqitur se cila ka qenë rruga që u ndoq nga autorët gegë edhe pas Kongresit të Drejtshkrimit, ndonëse dihet që numri i atyre që e përdorin gegërishten është tepër i kufizuar që vërehet kryesisht në diasporë.
- Për të ballafaquar veçoritë e tyre gjuhësore, kemi zbatuar metodat përshkruese – analizuese – sintetizuese, si dhe metodën krahasuese – statistikore, pikërisht për të dalluar edhe se ç'është e gegërishtes dhe ç'është e gjuhës së sotme shqipe.
- Doktoratura është konceptuar në gjashtë krerë, pa përfshirë përfundimet dhe bibliografinë e shfrytëzuar.
- Fillimisht jepen të dhëna bibliografike për të tre autorët, duke ditur, siç e theksuam se dy të parët një pjesë të jetës së tyre e kanë kaluar jashtë atdheut dhe veprat e tyre, ndonëse janë botuar pas Kongresit të Drejtshkrimit, janë shkruar para këtij tubimi, por edhe ato të shkruara më pas nuk kanë zbatuar vendimet e tij, me përjashtim të shkrimtarit Filip Ndocajt.
- Është listuar leksiku i gegërishtes në veprat e tre autorëve, duke veçuar gegizmat që ndeshen te autorët, por edhe në Fjalorin e vitit 2006, si dhe ato që nuk janë pasqyruar në fjalor. Gjithashtu janë shënuar neologjizmat e krijuara, si dhe fjalët e huaja të përdorura. Materiali leksikor është krahasuar edhe me fjalorët dialektorë.
- Për të tre autorët janë dhënë në veçanti dukuritë e përbashkëta dhe risitë, ku vërehen edhe dallime.
- Është paraqitur leksiku dialektor jo i të gjithë krijimtarisë së tyre, por i disa veprave të cilat janë shfrytëzuar në këtë rrafsh, krahasuar me Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006 dhe me fjalorët krahinorë.
- Leksiku i paraqitur nga tre autorët do të shërbejë si informacion konkret leksikografëve të gjuhës shqipe, pasi ka edhe fjalë të rralla, të cilat mund të përzgjidhen dhe të përfshihen edhe në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe.

- Në veçoritë fonetike është për t'u theksuar se përgjithësisht si theksi dhe llojet e tij, togjet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve përputhen me standardin e sotëm, me përjashtim të Arshi Pipës që e përdor gjerësisht si theksin hundor ashtu edhe theksin e mprehtë.
- Një trajtim të veçantë ka përdorimi i zanores *ë* në pozicione të ndryshme, disa janë në pajtim me normën e sotme, disa jo, pasi vihen re edhe luhatje. Ngjet që e njëjta fjalë të shkruhet në dy mënyra, dhe veprat e autorëve dallohen në këtë fushë. Më afër stadardit qëndron F. Ndocaj.
- Është analizuar edhe grupi dialektor *vo* dhe alternimi *f/h*, alternativiteti tek i cili kemi vënë re dallimin në mes të tre autorëve. Kështu S.Repishi përparësi i jep bashkëtingëllores *h* në raport me *f*-në, F.Ndocaj faringalen *h* e buzorizon në *f*, siç e ka e folmja e Shkodrës.
- Diçka e veçantë që vërehet në shkrimet e F.Ndocajt, është kthimi në disa fjalë i qiellzores *j* në *nj*, por që ndeshet në fjalë të veçanta edhe te A.Pipa, që nuk është dukuri e të folmeve të gegërishtes.
- Në kreun kushtuar veçorive fjalëformuese të tre autorëve janë analizuar sipas formimit të tyre gegizmat e përdorura dhe jo gjithë leksiku që ndeshet në veprat e tyre. Në rrafshin fjalëformues vihen re tipare të përbashkëta dhe dallime. Të tre autorët dallohen nga njëri – tjetri, pasi nuk kanë përdorur të njëjtat mënyra dhe me të njëjtin intensitet. Por S.Repishi në formimin e fjalëve të përbëra ka përfshirë edhe fjalët: *gjysma*, *vetë*, *bashkë etj*, ku njëra nga gjymtyrët si nga ana kuptimore, ashtu edhe nga funksioni sipas ndonjë gjuhëtari, ka marrë tiparet e një ndajshese, duke u dalluar nga dy autorët e tjerë. Kemi edhe formime të tilla nga F.Ndocaj që autori i konsideron kompozita, por që realiteti gjuhësor i sotëm nuk i pranon si: *dashuni – robni*. Janë konsideruar si kompozita vetëm se autori, i ka shkruar me vijë lidhëse.
- Edhe në trajtimin e veçorive morfologjike të veprave të autorëve, gegërishtja është mjaft e standardizuar.
- Janë evidentuar ato trajta morfologjike të veprave të autorëve që i ndeshim jo vetëm si dukuri të gegërishtes, por edhe të mbarë shqipes, duke i përshkruar sipas veprave të analizuar. Përgjithësisht të tre autorët nuk janë gjithnjë koherent në përdorimin e së njëjtës trajtë, pasi vërehen edhe luhatje .
- Dygjinisia, kjo dukuri e gegërishtes, emrat e gjinisë mashkullore, numri shumës që marrin prapashtesat *-e* dhe *-ra* përdoren si emra të gjinisë femërore, zbatohet nga tre autorët, rregull edhe i gjuhës standarde. Në raste tepër të veçanta përdoret edhe në emrat mashkullore që marrin prapashtesën *-a*, që sot nuk këshillohet zbatimi i një rregulli të tillë.
- Krahas përdorimit të prapashtesave të ndryshme për formimin e numrit shumës, që në punimin tone janë analizuar me hollësi, kemi ndeshur edhe fjalë që shumësin e formojnë në dy mënyra: *elementë / elementa*, *studentë / studenta*, *si dhe kufij / kufinj*.
- Haplogjia, kjo dukuri me karakter fonetik, që ka të bëjë me rënien e njëres prej dy rrokjeve të njëjta të një fjale, në veprat e tre autorëve ka luhatje, diku përdoret, diku jo.
- Rënia e treguesit të shquarsisë në rasat e zhdrejta në numrin shumës që sot është kthyer në normë, zbatohet nga tre autorët, por me një ndryshim. A. Pipa në studimin për P.Bogdanin, botuar më vitin 1990 në SHBA, autori jo vetëm që nuk është konsekuent, por vërehet prirja për të përdorur trajtën me mbaresën *-vet*.

Duke iu referuar një shkrimi të prof. Sh. Demirajt kundërvënia trajtë e pashquar/trajtë e shquar nuk është zhdukur, por dallimi bëhet me tregues të jashtëm të rrafshit sintaksor.

- Të tre autorët përdorin sistemin e rasave të gjuhës shqipe, por me ndonjë veçori. Kështu A.Pipa edhe S.Repishi parapëlqejnë togfjalëshat emët+emër në rrjedhore me mbaresën *-sh*, në krahasim me togun emër+emër në rrjedhore me mbaresën *-ve*. Sot në gjuhën shqipe vepron prirja që analitizmi ka përparësi mbi sintetizmin. F.Ndocaj në ndikimin e ligjërimit të folur të zonës ,rrjedhorja me *-sh* mund të paraprihet nga një folje ose mbiemër prejfoljor, p.sh.*hyn dritaresh*.

- Të tre autorët në ndërtimin e shkallëve të mbiemrit përdorin forma analitike, ndryshe nga disa gjuhë evropiane. Janë po ato skema të ndërtimit të shkallëve të mbiemrit si në gjuhën standarde, por formanti *më* përdoret në trajtën geqe *ma*.

- Përemrat, përgjithësisht, përdoren si në standard, por me disa veçori dialektore. Ndeshim edhe përemrin vektor të vetës së parë njëjës në trajtën *un* në emërore te A.Pipa, kurse në emërore shumës *na* te S.Repishi. Përdoren në rasën rrjedhore, veta e tretë njëjës dhe shumës trajtat e vjetra të rrjedhores pa *a*-në nistore: prej *si*(=asi), *sinh* (=asish). Autorët nuk janë konsekuent në shkrimin e trajtave të bashkuara *ma*, *ta*, pasi nuk mbajnë të njëjtin qëndrim. Në vepra të ndryshme nuk i shkruajnë njëllor , meqë ndeshim si trajtën me apostrof, si atë pa apostrof. Një dukuri e tillë vërehet edhe në drejtshkrimin e trajtës *ia*, që në një vepër përdorin trajtën *ja*, kurse në një tjetër trajtën *ia*.

- Përemrat pronorë përdoren si në standard, por vërejmë edhe gegizma, kryesisht të praqitura në trajtën geqe. Vërehet edhe shkrimi i përemrave pronorë me nyjë, ndikim i ligjërimit të folur. Nuk janë të rralla rastet kur nuk përputhet gjinia e pronës me pronarin, edhe kjo në ndikimin e ligjërimit të folur.

Përemrat pronorë të vetës tretë, numri shumës njëjës dhe shumës si për gjininë mashkullore, ashtu edhe femërore përdorin trajtën me mbaresën *-a* : *e tija*, *e saja*: *ndjenjat e tija*, *kambët e saja*, si te S. Repishi, ashtu edhe te F.Ndocaj.

Përemrat pyetës, lidhorë dhe të pacaktuar janë kryesisht ato të standardit. Kemi ndeshur përemra që kanë ndonjë ndryshim fonetik me standardin ose janë karakteristikë për gegërishten, pa përjashtuar luhatjet.

- Në veprën e tre autorëve ndryshimet gjuhësore me të sotmen nuk janë të shumta, por vërejmë edhe raste të izoluara.

- Foljet e kohës së tashme që i përkasin zgjedhimit të parë, marrin po ato mbaresa si në standardin e sotëm. Por në këtë zgjedhim gegërishtja dhe autorët tanë përfshijnë edhe ato folje që dalin me temë në zanore: *dij*, *pij* dhe në gramatikën e sotme i përkasin zgjedhimit të tretë.

- E pakryera që në dialekt dhe në të folme të ndryshme ka një larmi formash kohore, edhe te autorët tanë përdoren mbaresat e gegërishtes. Gjithashtu janë trajtuar edhe disa folje të veçanta forma e të cilave nuk përputhet me standardin e sotëm, ndonëse jo gjithnjë ata janë koherent, pasi vërehen edhe luhatje. Foljet që dalin në temë me *t/s* autorët kanë pëlqyer trajtën me *-t*, edhe në vetën e tretë njëjës, me ndonjë luhatje.

- E kryera e thjeshtë përdoret me ato mbaresat që i ndeshim në standard. Vërehen luhatje në përdorimin e mbaresës *i* dhe *u* në vetën e tretë njëjës ose në raste të izoluara kur nuk marrin mbaresë: *erdh* hingllima e një kali.

A.Pipa foljet joveprore, formantin *u* e ndan me vijë nga folja: *u-hodha*.

- Kohët e përbëra ndërtohen duke i paravendosur pjesores së shkurtuar të gegërishtes foljen ndihmëse *kam* për veporen dhe *jam* për joveproren.

Në të kryerën e tejshkuar veta e tretë numër njëjës folja ndihmëse *kam* del në trajtën *pat* e jo *pati*, ndonëse në raste të veçanta ndeshim edhe trajtën e dytë.

Trajtat e mbipërbëra kanë një përdorim të papërfillshëm.

- E ardhmja në veprën e tre autorëve përdoret me dy konstrukte: i pari që është mbizotërues formohet nga formanti *do* + foljen në kohën e tashme të lidhore: *do të shkoj*. A.Pipa në foljet që dalin me temë në bashkëtingëllore, përdor edhe mbaresën *-i*, veçori e dialektit të Veriut: *do t'nojfi bota*. Ndërsa në shkrimet e F. Ndocajt ndeshim edhe trajtën pa formantin të që përbën shkelje të normës: *do baj*.

Konstrukt i dytë ndërtohet nga folja ndihmëse *kam* që i paravendoset formës së pashtjelluar të gegërishtes të tipit *me punue: ka me thanë*. Për Sh. Demiraj kjo trajtë e ka humbur nuancën e detyrimit.

Edhe e ardhmja e së shkuarës përdoret me dy konstrukte: *do të shkojshe* dhe *kisha me shkue*. Te F. Ndocaj ndeshim konstruktin e parë edhe pa formantin të: *do mbetsha*.

E ardhmja e përparme dhe e ardhmja e përparme e së shkuarës përdoren si në standard, por pjesorja është e trajtës geqe.

- Mënyra habitore ka një përdorim të kufizuar te tre autorët. Formimi i kohëve të saj është në pajtim me standardin. Kohët e përbëra formohen nga folja ndihmëse + pjesoren e shkurtuar të gegërishtes.

- Mënyra lidhore dalohet nga formanti *të* që i paraprin foljes. Mohimin e shpreh me pjesëzën *mos* që A.Pipa ia paravendosë foljes së mënyrës lidhore: *mos të lajë*, ndonëse ndeshim edhe trajtën si në standard: *të mos delte*, të cilën kështu e përdor edhe F.Ndocaj.

- E pakryera, përveç se dallohet nga formanti *të*, por edhe nga mbaresat e gegërishtes. Si e tashmja, si e pakryera shoqërohen edhe me foljet modale *mund, duhet, lë*.

- Dy kohët e përbëra formohen nga folja ndihmëse *kam* që i paraprin pjesores së shkurtuar të gegërishtes.

- Për mënyrën kushtore, që është homonimike me të ardhmen e së shkuarës dhe të ardhmen e përparme të së shkuarës së mënyrës dëftore, janë përdorur mbaresat e gegërishtes për të tashmen e kushtores dhe për të kryerën folja ndihmëse plus pjesoren e shkurtuar të gegërishtes.

- Mënyra dëshirore nuk ka ndonjë ndryshim për formimin e kohëve të saj, vetëm se në të kryerën përdoret pjesorja e shkurtuar e gegërishtes: *pastë rregullue*.

- Edhe urdhërorja ndeshet si në standard, por për formën joveprore përdoret herë bashkëtingëlloret antihijatizuese *h*, por edhe *j: çohu, shtriju*.

- Janë analizuar format e pashtjelluara që ndeshim te vepra e secilit autor. Përdorimi i formave të pashtjelluara janë shoqëruar edhe me statistika.

- Te të tre autorët gegë formë mbizotëruese është paskajorja geqe e tipit *me punue*, ndërsa format e tjera kanë një përdorim më të kufizuar. Të gjitha format e pashtjelluara i ndeshim në trajtat e gegërishtes letrare e jo trajta të ngushta dialektore.

- Autorët në veprat e tyre përdorin edhe një numër ndajfoljesh dialektore, ku shquhet A.Pipa, ndërsa S.Repishti e F.Ndocaj i përdorin më pak.

- Janë përdorur shumë parafjalë, disa edhe dialektore si: *kah*, që për Gj.Shkurtaç duhet të përdoret në gjuhën e sotme për të lehtësuar përdorimin e parafjalës *nga* prej disa funksioneve.

- Pipa nuk e përdor parafjalën *tek*, por *te*, ndërsa Repishti dhe Ndocaj përdorin si *te* dhe *tek*, por pa përcaktuar ndonjë kriter në zbatimin e tyre.

- Të tre autorët kanë përdorur një numër të konsiderueshëm lidhëzash qofshin bashkërenditëse, qofshin nënrenditëse, por më shumë ato janë të mbarë shqipes dhe jo të një krahine të veçantë. Materiali i vjelë nuk ka pasqyruar atë pasuri që ka shqipja në këtë fushë edhe të vetë gegërishtes.
- Për çdo kapitull janë shënuar veçoritë e përbashkëta të veprave të tre autorëve, si dhe risitë që kemi konstatuar.
- Si përfundim , nga i gjithë materiali i analizuar, vëmë re se nuk bëhet fjalë për një gegërishte arkaike, por në veprën e tre autorëve dallojmë një gegërishte mjaft të njësuar, duke përjashtuar luhatjet. Në gjuhën tyre ka prirje afruese, jo gjithëherë të ndërgjegjshme, por të kushtëzuara edhe nga vetë zhvillimi i shqipes dhe nga përgatitja intelektuale e autorëve.

B I B L I O G R A F I

AGALLIU, Fatmir:

- Sa rasa ka në gjuhën shqipe, në botimin e autorit “Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë, 1988.
- Mënyra lidhore në gjuhën shqipe , në botimin e autorit “Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë, 1988.
- Rreth kategorisë së numrit të emrave në gjuhën shqipe, në botimin e autorit “Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë, 1988.
- Pjesorja në gjuhën shqipe, në botimin e autorit “Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë, 1988.
- Vëzhgime mbi formën gramatikore pa + pjesore, në botimin e autorit “Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë, 1988.
- Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, Tiranë, 1999.

ASHTA, Kolë:

- Leksiku historik i gjuhës shqipe, vëll.I, Shkodër, 1996.

BECI, Bahri :

- Mbi disa veçori fonetike të të folmeve të gjuhës shqipe në përqasje me gjuhën letrare , “Studime filologjike”, 1982, nr.4.

BUÇELI, Ludmilla:

- Rreth fjalëve të përngjitura në gjuhën e sotme shqipe, “Studime filologjike”, 1986, nr.2.

CIPO, Kostaq:

- Gramatika shqipe, Tiranë, 1949.

ÇELA, Mitro:

- Profesori, shkrimtari Filip Ndocaj (Internet).

ÇELIKU, Mehmet:

- Probleme të diskutueshme rreth Drejtshkrimit të gjuhës shqipe të vitit 1973, në Seminarin XVII të gjuhës, letërsisë dhe të kulturës shqiptare, Tiranë, 1995.
- Lokucionet parafjalore emërore në gjuhën letrare shqipe, në botimin e autorit “Probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë, 1997.
- Parafjalët emërore të thjeshta në gjuhën letrare shqipe, në botimin e autorit “Probleme të morfologjisë...”, Tiranë, 1997.
- Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën shqipe, Tiranë, 2000.

DEMA, Benedikt:

- Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe, Tiranë, 2005.

DEMIRAJ, Shaban:

- Kategoria e shquarsisë dhe e pashquarsisë në gjuhën shqipe, “Studime filologjike”, 1969, nr.4.
- Rreth formave të së ardhmes në gjuhën shqipe, “Studime filologjike”, 1970, nr.3.
- Habitorja dhe mosha e saj, “Studime filologjike”, 1971, nr.3.
- Rreth ndërrimit të gjinisë së emrave në numrin shumë, vështruar edhe në përqasje me rumanishten, në veprën e autorit “Çështje të sistemit emëror në gjuhën shqipe, Tiranë, 1972.
- Rreth shumësit të emrit kalë, “Studime filologjike”, 1973, nr.3.

- Rreth kategorisë së mënyrës dhe kohës në gjuhën shqipe, “Studime filologjike”, 1977, nr.3.
- Gramatika historike, Tiranë, 1986.
- Prirjet kryesore në strukturën morfologjike të gjuhës së sotme letrare shqipe, “Studime filologjike”, 1984, nr. 4.

DIZDARI, Tahir:

- Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe, Tiranë, 2005.

DOMI, Mahir:

- Dukuri dhe prirje të zhvillimit të strukturës sintaksore të shqipes së sotme letrare, “Gjuha jonë”, 1985, nr.1, f.52.
- Disa shënime për gjuhën e P.N.Luarasit, në përmbledhjen “Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve, III, Tiranë, 1989.

Drejtshkrimi i gjuhës shqipe Tiranë, 1973.

DHRIMO, Ali :

- “Për shqipen dhe shqiptarët”, I, Tiranë, 2008.
- Shkallëzimi i mbiemrave , në botimin e autorit “Për shqipen dhe shqiptarët”, I, Tiranë, 2008.

ELEZI, Mehmet:

- Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2007.

FJALOR I “BASHKIMIT”, 1908

FJALOR ENCIKLOPEDIK SHQIPTAR, Tiranë, 2008.

FJALOR I GJUHËS SHQIPE, Tiranë, 1954.

FJALOR I GJUHËS SË SOTME SHQIPE, Tiranë, 1980.

FJALOR I SHQIPES SË SOTME, Tiranë, 2006.

FRIDMAN, Viktor:

- Shqipja standarde në Amerikë : Studime shkencore, pedagogjike dhe planifikimin gjuhësor, “Gjuha jonë”, Tiranë, 2002, nr.3-4.

GAZULLI, Nikoll:

- Fjalorth i fjalëve të rralla në Veri të Shqipnisë, Tiranë, 1941.

GERO, Mina:

- Lidhorja dhe paskajorja në prozën letrare të Martin Camajt, në botimin “Martin

Camaj-tradita dhe bashkëkohësia”, Shkodër, 1994.

GRAMATIKA E GJUHËS SHQIPE, Tiranë, 2002.

GJINARI Jorgji – SHKURTAJ Gjovalin:

- Dialektologjia, Tiranë, 1997.

GJUHA LETRARE SHQIPE PËR TË GJITHË, Tiranë, 1976.

HAXHI, Artan - OSMANI, Tomor:

- Forma të shumës në rrafshin e planifikimit gjuhësor të shqipes, në “Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”, Tiranë, 2011.,

HAXHI, Artan – TOPALLI, Tefë:

- Histori i gjuhës së shkruar shqipe, Shkodër, 2007.

HYSA, Enver:

- Mbi shkallët gramatikore dhe mjetet e shprehjes së tyre në gjuhën shqipe, në “Konferencën II albanologjike”, Tiranë, III, 1969.

- Rreth prirjeve për formimin e shumësit të disa emrave, në Seminarin XX të gjuhës, letërsisë dhe të kulturës shqiptare, Prishtinë, 1972.
- Rreth përdorimit të së pakryerës së dëftores në gjuhën shqipe, “Studime filologjike”, 1975, nr.1.
- Sindajshtesat dhe vendi i tyre në formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, “Studime filologjike”, 1986, nr.2.

ISMAJLI, Rexhep:

- Drejtshkrimet e shqipes, Prishtinë, 2005.

KALAKULA, Uran :

- Arshi Pipa, njeriu dhe vepra, Tiranë, 1999.

KOSTALLARI, Androkli:

- Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, “Studime filologjike”, Tiranë, 1986, nr.2.

LAFE, Emil:

- Mbi habitoren dhe disa trajta të saj, “Studime filologjike”, 1975, nr.2.

MARASHI, Ardian:

- Përftesa poetike të gegënishtes në botimin “Martin Camaj-tradita dhe bashkëkohësia”, Shkodër, 1994.

MISJA, Vladimir:

- Filip Ndocaj , njeriu i vlerave erudite në arsimin shqiptar (Internet)

NDOCAJ, Filip:

- Në sytë e rinisë, Tiranë, 1961.
- Vlega e dheut, Tiranë, 1968
- Diell nën kreshta, Tiranë, 1971.

OSMANI, Tomor-PRIKU, Mimoza:

- Rreth disa tipave të fjalformimit në publicistikën e sotme të sistemit foljor, në Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 2007, nr.26/1.

PIPA, Arshi:

- Lundërtarë, Tiranë, 1944.
- Libri i burgut, Tiranë, 1994
- Rusha, Tiranë, 1995
- Politika e gjuhës në Shqipëri socialiste, Tiranë, 2010.
- Lyrika latine, 3, Plejad, 2010
- Lundërtarë dhe libri i dashunis dhe i fatit, Plejad, Tiranë, 2010.

PRIKU, Mimoza:

- Rreth disa ndërtimeve dhe kuptimeve foljore në veprën e M.Camajt, në botimin “Martin Camaj për kulturën shqiptare “Shkrimtari dhe albanologu”, Studime shqiptare 17, Shkodër, 2011.

RREGULLA MBI ORTHOGRAFIN E GJUHËS SHQIPE TË SHKRUEME, në “Laimet

e Komsis Letrare Shqipe në Shkodër, 1918, nr.1.

RROTA, Justin:

- Gjuha e shkrueme asa vërejtje gramatikore, Shkodër, 2005.

SAMARA, Miço:

- Parafjalët në shqipen e sotme (Vështrim leksiko-semantik), Tiranë, 1999.

SHKURTAJ, Gjovalin:

- Kundrime gjuhësore, Tiranë, 2006.
- T'i përdorim drejt përemrat pronorë, "Gjuha jonë", 1081, nr.1.

TOPALLI, Kolec:

- Vepra e Martin Camajt në aspektin gjuhësor në botimin "Martin Camaj-tradita dhe bashkëkohësia", Shkodër, 1994.
- Fonetika historike në gjuhën shqipe, Tiranë, 2007.

TOPALLI, Nikollë:

- Mënyra kushtore e foljes në gjuhën shqipe, "Studime filologjike", 1982, nr.4.

THOMAI, Jani:

- Leksiku dialektor dhe krahinor në shqipen e sotme, Tiranë, 2001.

XHOLI, Albert Z:

- Filip Ndocaj mbeti profesori i rinisë (Internet).
- Kur kujtojmë profesorin e rinisë.(Internet)

XHUVANI, Aleksandër- ÇABEJ, Eqrem :

- Parashtesat e gjuhës shqipe në Veprën 1 të A. Xhuvanit, Tiranë, 1980, f. 361-415.
- Prapashtesat e gjuhës shqipe, po aty, f. 419-581.
- Pjesorja në gjuhën shqipe, po aty, 245-259.
- Paskajorja në gjuhën shqipe, po aty, f.260-262.
- Parafjalët në gjuhën shqipe, po aty, f. 263-332.

Abstrakt

Objekti i doktoratësi ka qenë të vështuarit nga ana gjuhësore të veprave të tre autorëve: Arshi Pipa, Sami Repishti dhe Filip Ndocaj në rrafshin leksikor, fonetik, fjalëformues dhe morfologjik ku dy të parët gjysmën e jetës e kanë kaluar në emigracion, kurse F.Ndocaj ka jetuar në Shqipëri.

Jemi përqendruar në veprat e botuara të tre autorëve për të analizuar se si paraqitet gegërishtja në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, ndryshimet që ka pësuar drejt njësimimit.

Konstatohet se gegërishtja si mbarë gjuha e sotme shqipe është bërë më transparente, më e përpunuar, me veçori më të pakta dalluese me gjuhën e sotme letrare, duke përdorur në mjaft raste trajtat fonetike dhe morfologjike të shqipes së sotme. Kështu gegërishtja e veprave të tre autorëve paraqitet mjaft e kodifikuar.

Te të tre autorët, siç i kemi paraqitur në trajtimin e kësaj teme, ndjehet lëvrimi, zhvillimi dhe pasurimi i gjuhës shqipe edhe në veprat e shkruara në gegërisht, ku tashmë ndryshimet e thella midis dialekteve po vijnë gjithnjë duke u rrafshuar, sigurisht që autorët kanë ruajtur të folmen që përfaqësojnë.

Në gjashtë kërret e doktoratës janë analizuar veçoritë leksikore, fonetike, fjalëformuese dhe morfologjike të tre autorëve, duke veçuar dukuritë e përbashkëta, si dhe risitë e tyre. Materiali leksikor nuk përfshin leksikun e plotë të veprave të tre autorëve, por atë dialektor, që sipas rasteve është krahasuar me fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006 dhe me fjalorët krahinorë.

Ndonëse autorët nuk janë gjithnjë konsekuent, pasi vihen re edhe luhajtje, si në rrafshin fonetik, ashtu edhe fjalëformues ndeshim edhe trajta të mbarë shqipes, dukuri që konstatohet edhe në rrafshin morfologjik.

Fjalë kyçe: gegërishte, leksik, standard, forma foljore.

Abstract

The subject of the PhD was the linguistic observation of the works of these authors: Arshi Pipa, Sami Repishti and Filip Ndocaj in the lexical, phonetic and word-forming planes. The first two authors half of their life spent in migration, while Filip Ndocaj lived in Albania. We are focused on the published works of these three authors to analyze how Gheg appears in the second half of the last century and the changes that it has made to go towards the unity. It is noticed that Gheg as the current Albanian language has become more transparent, more refined, with less distinctive features from today's literary language, using in many cases the phonetic and morphological forms of today's Albanian language. So Gheg of the works of these three authors is quite codified.

In the three authors, as we have presented in dealing with this topic, feels the spread, development and enrichment of Albanian language, even in works written in Gheg where now the profound differences between dialects are coming ever decreasing, of course that the authors have preserved the spoken language they represent.

In the six PhD chapters, the lexical, word-forming and morphological features of the three authors have been analyzed, distinguishing common occurrences and their innovations. The lexical material does not include the complete lexicon of the work of the three authors, but the dialect, which sometimes has been compared to the 2006 Albanian vocabulary and the regional vocabulary. Although the authors are not always insistent in their approach, as fluctuations are noticed, facing thus Albanian speaking form, both in the phonetic and in word-form fields, the phenomenon is found also in the morphological plane.

Key words: Gheg, lexicon, standard, verb forms.